INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM

NAUČNI BILTEN
BULETINI SHKENCOR

Međunarodni naučni časopis
Revista Shkencore ndërkombëtare
International Scientific Journals

Br/Nr. 6
God - Viti IV / 2014

Ulcinj-Ulqin

Montenegro

REDAKSIA

Dr. Shefket Jakupi, (kryeredaktor)
MA Ardita Bylo (sekretare shkencore)
Dr.Dragoljub Janković
Dr.Mirsad Nuković

DREJTOR I REVISTËS
Prof.Ass.dr. Elez Osmani

CIP – Каталогизација у публикацији
Централна народна бибиотека Црне Горе, Цетиње 330(905L)
NAUČNI bilten:ekonomska istraživamja
Buletin Shkencor:hulumtime ekonomike
Urednik:Elez Osmani- God.1,br.1(2009)
Ulcinj:(Pinješ bb):Centar za ekonomska istraživanja 2013.24 cm
Godišnje.
ISSN 1800-9794
COBISS.CG-ID 20683538

Shtëpia botuese Qendra për hulumtime ekonomike -Ulqin
Shtypëshkronja **ROZAFA 1** Shkodër

Korrektoi dhe punoi në kompjutër
Dr.Shefket Jakupi

E drejta e autorit :
Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim
"Redaksia e Buletinit Shkencor"
Ulqin

Adresa e redaksisë :
Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim
"Redaksia e Buletinit Shkencor"
Ulqin ++382 69 265 707

web.: www.ekonomskiinstitut.com

KOMITETI EDITORIAL INTERNACIONAL
INTETNATIONAL EDITORIAL COMMITTEE

Bordi shkencor i buletinit shkencor

Prof.Dr Arta Museraj- Themeluese dhe drejtuese e "Academicus- International Scientific Journal,Kryetare

Prof.Dr.Arjeta Troshani dekani i fakultetit Ekonomik,Universiteti"Luigj Gurakuqi"Shkodër (kryetare)

Prof.Dr.Predrag Goranoviq-Fakulteti Ekonomik Podgorica

Prof.Ass.Dr.Artan Haxhi- Rektor Universiteti"Luigj Gurakuqi",Shkodër

Prof.Dr.Isak Mustafa-Kryetar i Institutit të financave Kosovë

Prof.Dr.Beqir Kalaç-Universiteti internacional Novi Pazar

Dr.Dragoljub Jankoviqi-Fakulteti per studime te biznesit ne Podgoricë

Prof.Ass.Dr.Hidajet Shehu Unvivrsiteti Bujqesor"UBT", Tiranë

Prof.Ass.Dr.Mithat Mema-Rektor Universiteti"Aleksanderr Moisiu",Durres

Prof.Ass.Dr Armand Universitetit publik"Haxhi Zeka"Peje

Prof.Dr.Halid Kurtoviq-Universiteti i Zenicës

Prof.Dr.Husnija Bibiljica –Dekan i fakultetit të turizmit Universiteti"Haxhi Zeka" Peje

Prof.Dr.Laszlo Karpati Universiteti per biznes në Budapesht-Hungari

Prof.Ass.Dr.Ilir Hoti-Dekan-fakulteti ekonomik"Aleksanderr Moisiu"Durres

Prof.Ass.Dr.Edmond Beqiri-Rektor Kolegji "Dugagjini" Pej, Kosovë

Prof. Dr.Shefket Jakupi, Kolegji "Iliria"Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

Dr.sc, Armand Krasniqi
1 Reformimi i sistemit fiskal i vendeve të Evropës Juglindore konform parimeve të Unionit Evropian 6
Prof. Ass.Dr. Nehat Ramadani
2 Impakti fiskal i partneritetit puibliko-privat- Rasti Maqedonisë 15
Dr. sc.Shefket Jakupi
3 Rëndësia e qeverisjes së mirë publike në çështjet tatimore dhe buxhetore 22
Dr. Bajram Fejzullahu
4 Shqyrtime teorike mbi filozofinë e pronës dhe pronësisë hap drejtë privatizimit 29
Adem Shala
5 Qeverisja dhe Institucionet në Kosovë 1999-2013 36
Dr. Proces Adrian Leka
6 Ankimi si pjese themelore e të drejtave të njeriut..... 44
Dr.Agim Berisha
7 Borxhi publik në Republikën e Kosovës 52
Phd. Cand Arjeta Hallunovi;Msc. Kozeta Jana;Dr. Elidiana Bashi
8 The liquidity risk and the albanian banking system..... 59
Dr. sc. Bislim Lekiqi
9 Reflektimi i motivimit të të punësuarve në suksesin e ndërmarrjes 64
Ma.sc.BurimHaliti
10 Politikat fiskale në Kosovë dhe harmonizimi I tyre me vendet e rajonit dhe të BE-së 74
Elmi Aziri PhD (c)
11 Borxhi publik dhe efektet e tij:Rasti i Republikës së Maqedonisë 80
Ma.sc.Fatmir Halili, PhD ;Dr.cs.Sheqir Kutllovci
12 Globalizimi - proces shumëdimensional..... 87
Dr. Sc. Hamdi Hoti ;Mr. Sci. Remzi Ahmeti ;Msc. Shefsat Kryeziu;Skender Tahiraj,Ecc. dipl
13 Menaxhimii riskut në Bizneset Kosovare 92
M.A Haseda Rragami
14 Bashkimi doganor i Shqipërisë me Komunitetin Europian 100
Kastriot Blakaj ;Armend Huskaj
15 The influence of internet services on e-business and electronic economy profits..... 107
Manjola Xhahysa Striniqi ;Bledar Striniqi;Servete Ligataj ,Elmira Nehani
16 Albania, Internal Control and Internal Audit at Local Levels *within the frameworkof EU integration*..... 113
Teuta Kryeziu Msc ;Besjana Kryeziu (candidate Msc)
17 Foreign trade export and import flows in Kosovo 118
Albulena Shala;Vlora Berisha,Edona Perjuci;Arbana Sahiti
18 Faktorët ndikues në fitimin e bankave në Kosovë 126
Prof.Ass.Dr. Fatbardha Molla(Beqiri);Prof.Ass.Dr. Brilanda Bushati
19 Standartet dhe perdorime te analizes financiare ne cilesine e raportimit financiar 135
Flamur Bunjaku
20 Models of fiscal policy harmonization of SEE countries to the European Union 141
Prof. Asc.Dr. Safet Merovci ;MSc, Phd Canditate Arbana Sahiti;MSc, Yllka Ahmeti
21Foreign Banking Investments in Cyprus: What can Kosova learn from Cyprus ‘’Bailout’’148
Elira Hoxha
22 SME-të dhe politikat nxitëse të taksimit 156

Vlora Prenaj ;Vlora Berisha;Albulena Shala;Arta Hoti
23 Rëndësia e menaxhimit të riskut 167
PhD. MBA. MSc. Enriko Ceko
24 Fiscal policy management and fiscal sustainability management in Albania during 2000 - 2013, compare with European countries 174
Fatos Ukaj
25 Efektet e Biznesit Ndërkombëtar në zhvillimin e turizmit bazuar në resurset e vendit-gjendja në Kosovë. 185
PhD (c). Jeta Nushi
26 Kriza globale financiare dhe ndikimi i saj në ekonominë e Kosovës 192
Ma.Marsida (Salihi) Tafilica;Drnt. Kilda Gusha (Çela)
27 The role of the eu in conflict resolution (the case of the south caucasus) 200
PhD. Orhan M. Çeku, Mll ;Ph.D. Ismail mehmeti
28 Harmonizimi i Sistemit Fiskal nga Vendet e Ballkanit Perëndimor në Funksion të Integrimit në BE 205
Pr.Dr.Husnija Bibuljica
29 The possibilities for investments in special sectors of the economy 214
Egzona Hasani
30 Promocioni - Aplikimi dhe efekti i tij në ngritjen e shitjes tek bizneset Kosovare 219
Mr. Llokman Hebibi
31 Roli i politikës fiskale ne zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë..... 227
MSc Anila Medja ;MSc Suzana Taipoviq
32 Impaktet e festivaleve dhe eventeve në Shkodër & Ulqin 235
PhD Florida VeljanoskaMSc. Majlinda Axhiu
33 The level of sophistication of e-tax services in the southestern countries in comparison to the EU member states 241
PhD (c) Lisjana Çukaj
34 Refugees protection in Albania..... 249
Mcs. Thodhori Puleri ;Kristaq Çombi - Lektor
35 Harmonizimi i mënyrave të taksimit të Pasurive të Paluajtshme, si oportunitet për një politikë fiskale sa më pranë Europës. 253
Shaip Osmani
36 Vështrime gjeostrategjikë mbi rolin e bashkësisë ndërkombëtare pas viteve të 90-ta në Ballkanin Perëndimor 266
Dr.sc. Jetmire Zeqiri
Denisa Bruçaj, MA
37 Nevoja për zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri.....282
Dr.sc. Jetmire Zeqiri
Dr.në process Artan Osmani
38 Siguria e pagesave ndërkombëtare.....286
PhD(c) Labeat Mustafa

39 Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik të Kosovës 290
Doc. Dr. Bejadin AMETI

40 Therrja e kafshëve sipas sheriatit islam.....300

Dr.sc, Armand Krasniqi, Prof.asoc.[1]
mandikrasniqi@gmail.com

1 Reformimi i sistemit fiskal i vendeve të Evropës Juglindore konform parimeve të Unionit Evropian

Abstrakt

Pavarësisht zhvillimeve pozitive dhe efekteve të globalizimit, shoqëria njerëzore po ballafaqohet edhe me fenomene negative të shkaktuara nga një numër i caktuar krizash. Dihet botërisht se kriza ekonomike globale i ndryshojë përherë tregjet financiare situatë kjo e cila ende nuk ka gjasa që të tejkalohet. Por, fatkeqësisht kjo krizë nuk është e vetmja. Me rrezikshmëri të lartë shoqërore është komprometimi dhe debalancimi i ekosistemit. Nuk ka dilemë se burimet natyrore janë në degradim dhe zvogëlim të vazhdueshëm gjë e cila për secilin vend duhet jetë sinjal për ndryshimin e modelit ekonomik dhe strukturat themelore. Pa asnjë kalkulim, nëse me shpejtësi politikat botërore nuk marrin masa për të zvogëluar emetimin e CO2 me mbi 50 deri 80 %, atëherë do humbet aftësia e për të kufizuar rritjen së temperaturës globale. Pikërisht për këtë arsye, qeveritë gjithsesi duhet të tregohen të përgjegjshme dhe të matura që të krijojnë një model më të avancuar ekonomik mbi baza të zhvillimi të qëndrueshëm. Për të realizuar këtë model duhet bërë reformimi substancial edhe i sistemi fiskal. Baza legjislative duhet i ri - dizajnuar në atë mënyrë që taksat, tatimet, licencat dhe instrumentet tjera të jenë kompatibile me konceptim për një zhvillimin të qëndrueshëm mjedisor. Në kuadër të këtij aktiviteti procesi i reformimit të sistemit duhet bërë kryesisht edhe mbi bazën e rregullave, parimeve, programeve dhe procedurave të institucioneve relevante të Unionit Evropian. Respektimi i këtyre elementeve krijon mundësi me të mëdha të unifikimit të sistemeve fiskale të këtyre vendeve që në instancë të fundit qëllim final kanë aderimin në këtë organizate.

***Fjalët Kyçe**: Tatimet, taksat, ekologjike, reforma, qëndrueshëm, ekonomike,*

Hyrja

Sistemi fiskal në Unionin Evropian është segment më rëndësi vitale në kuadër të avancimit dhe garantimit të proceseve të integrimit të tregut unik duke mundësuar një nivel të lartë kohezioni në kuptim të mbajtjes së një shkalle të lartë të politikave ekonomike integruese në UE. Struktura e sistemi fiskal të UE-së bazohet në buxhetin e saj si instrument i vetëm zbatimit të politikave financiare më nivelin supranacional. Pjesa tjetër e mbetur e sistemit fiskal konsiderohet si tërësi e rregullave dhe e përgjegjësive juridike nëpërmjet të cilave vendet anëtare bëjnë harmonizimin dhe koordinimin e segmenteve tjera të politikave fiskale unilaterale. Unioni Evropian aktualisht paraqitet si një institucion unik me qëllim të realizimit të vlerave, interesave dhe qëllimeve për çfarë është formuar duke qenë çdo herë koherentë dhe efikas në funksion të politikave dhe aksioneve konkrete. Rregullat fiskale në UE, janë të bazuara në kriteret e Mastrihtit, Paktin e Rritës dhe Stabilizimit dhe po ashtu janë një produkt i Unionit Monetar me qëllim final stabilizimin e çmimeve. Unioni Evropian në veçanti viteve të fundit ka ndërmarr një seri masash për të eliminuar konkurrencën e dëmshme tatimore si dhe fenomenet tjera negative të cilat ndikojnë në procesin e forcimit të tregut të përbashkët. Harmonizimi i formave fiskale në UE është realizuar vetëm më sferën e tatimeve indirekte (TVSH dhe pjesërisht në akciza), derisa pjesa e tatimeve indirekte praktikisht ka mbetur të pa harmonizuara, përveç disa tentativave për rregullimin e tatimeve në fitim të ndërmarrjeve.

[1]*Autori është pedagog në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës*

Arsye e kësaj situate është refleksioni respektivisht botëkuptimi aktuale se interesi substancial i EU-së, më rëndësi është angazhimi për harmonizimin e tatimeve indirekte me qëllim të funksionimit të tregut të përbashkët dhe eliminimin e barrierave eventuale tatimore të ndërlidhura me lirinë e qarkullimit, kapitalit, prodhimit, shërbimeve, punës, etj,.

Kosova dhe vendet tjera të Evropës Juglindore, në cilësi të kandidateve për anëtarësim të plotë në UE, duhet që të ndërmarrin një seri aktivitetesh dhe masash në mënyrë sa më të shpejtë që të jetë e mundur të harmonizojnë legjislacionin e vet me rregullativen e UE-së. Me rëndësi të veçantë në kuadër të këtij procesi konsiderohet përafrimi dhe unifikimi i sistemeve fiskale me direktiva programet dhe burimet tjera juridike të Unionit Evropian. Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë informata iniciale për rolin, strukturën dhe rëndësinë e sistemit fiskal ekologjik të UE-së, duke propozuar dy çështje thelbësore. E para, reformimin e sistemit fiskal në kuptim të strukturës sistemore dhe së dyti kompletimin e bazës ligjore nëpërmjet e një seri masash të cilat vendet e Evropës Juglindore duhet që t'i ndërmarrin për anëtarësim në këtë organizatë por duke mos i harruar rrezikun mjedisor, proceset aktuale të globalizimit, problemet e konkurrencës tatimore ndërkombëtare dhe tatimimin e shumëfishtë në planin ndërkombëtare.

Problemet mjedisore në shoqëritë moderne dhe kultura mjedisore

Problemetmjedisore aktualisht janëakumuluar si kurrë më parë dhe si të tilla, me një trend dinamik, ende po vazhdojnë duke e karakterizuar këtë fenomen si pjesë eqytetërimit modern. Problemet mjedisore pothuajse botërisht po përkufizohensi "çdo ndryshim që ndodh nëmjedisin fiziksi rezultat iaktivitetit të njeriutqë shkaktonkëtë gjendjedhe kjoprodhon pasojaqë shoqëriai konsiderontë papranueshme mestandardet e një mjedisi të qëndrueshëm". Këto problememund të identifikohennë këndvështrime të ndryshme: në nivel globalkur trajtohen fenomenet e ngrohjes globaledheatmosferike,dëmtim dhe shpenzim tështresës së ozonitnëndotjen"shiu acid"; në nivelin rajonal, ndotje tëujërave nëntokësore,të naftës, përmbytjeve dhendotjen lokale të ujit, ajritsi dhelloje të ndryshme tëdeponimit të pamjaftueshëm të mbeturinave.

Sipas Jens Hilgenberg drejtues i Shoqatës për Mjedisin dhe Mbrojtjen e Natyrës në Gjermani (BUND) në cilësi të një aktivisti të ndërgjegjshëm alarmon se ndotja e ajrit është problemi më i madh mjedisor në Evropë.

Sipas tij, lirimi i gazit (CO2) është problemi më i madh i mjedisit në gjithë botën. Fakti që cilësia e ajrit shkakton edhe më tej shqetësime të mëdha në Evropë, shihet edhe në raportin e botuar nga Agjencia Evropiane për Mjedisin", pohon ai. Sipas të dhënave të kësaj Agjencie, 90 % e banorëve të qyteteve në UE përballen me lëndë, të cilat cilësohen si të dëmshme prej Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO). I sipërpërmenduri shpjegon për DW se në këto lëndë ka dioksid karboni dhe gazra e pluhura të dëmshme.[2]

Formimi ikulturësmjedisorenuk është njëdetyrë e lehtë të krijohetsidomoskur kemi parasyshqë këto marrëdhëniet specifike dhe sjelljetsociale me dekada janë karakterizuartë një natyre problematike. Andaj disiplinat shkencore që nga psikologja duhet që të angazhohen dhe përpiqen për të gjeturnjë mënyrëtë përshtatshme përnjëndërgjegjësimin për çështjet mjedisorengritur nënivelin e ardhshëm.

Zbatimi i ligjeve,vendosja e sanksioneve si dhe kultura qytetare për mbrojtjen dhe kujdesin e mjedisit ku jetojmë është çështje thelbësore për fëmijët tanë dhe për te ardhmen. Ajri, flora dhe fauna, pyjet, detet, liqenet etj, gjithçka po shkatërrohet çdo dite e me shume për shkak te mos zbatimit te ligjeve dhe konventave ndërkombëtare qe vendet tona i kanë ratifikuar. Te mbrosh mjedisin nuk do te thotë vetëm te miratosh ligje por thelbësore është t'i zbatosh ato me përpikëri çka le shumë për te dëshiruar ne vendin tone kjo si pasoje e

[2]*Marrë në; http://www.dw.de/ndotja-e-ajrit-n%C3%AB-evrop%C3%AB/a-17171687 me 01.02.2014*

moszbatimit te sanksioneve dhe shfrytëzimin pa kriter te gjithçkaje qe ka te beje me natyrën. Është detyre e institucioneve përkatëse qe te bashkërendojnë punën e tyre për mbrojtjen me fanatizëm te mjedisit ku ata, fëmijët e tyre, ne, populli jetojmë çdo ditë. Subjekteve te cilat shkelin këto ligje mjedisore nuk i ndodh asgjë madje mund te paguajnë një gjobe mospërfillëse dhe do vazhdojnë aktivitetin e tyre fitimprurës ose mund te vazhdojnë punën te qetë sepse autoriteti shtetëror përkatës nuk i intereson çështja e ndoshta për te madje nuk përben as një shqetësim ajo çka mund ti ndodh natyrës. Shoqëria jone ndoshta ka shumë probleme ne fushën e drejtësisë por mendoj se është thelbësore te ndalemi ne ketë çështje sepse është dëmtim i ajrit qe thithim, i ujit, i mjedisit ku ne jetojmë çdo dite dhe ku rriten fëmijët tanë.[3]

Sistemi tatimor në Unionin Evropian

Tatimet janë para të mbledhura në bazë të ligjit nga personat fizikë e juridikë dhe kategoritë tjera të tatimpaguesve të cilat përdorën për garantuar financimin e mallrave dhe shërbimeve publike të nevojshme nëpërmjet të institucionit të buxhetit dhe fondeve tjera publike. Financat publike të çdo vendi përbehen nga buxheti dhe një numër i caktuar i fondesh publike. Mbledhja e mjeteve publike realizohet nëpërmjet pagesave të një numri të caktuar formash tatimore dhe të hyrave tjera publike siç janë doganat, taksat, akcizat, kompensimet, taksat e banderollave dhe ngarkesave tjera para - fiskale. Deri sa pjesa e inputeve buxhetore përbehet nga tërësia e mjeteve publike të mbledhura, pjesa e autputeve i dedikohet shpenzimit të tyre. Në sistemin tatimor të Unionit Evropian, të hyrat tatimore mblidhen dhe shpenzohen nga nivelet e ndryshme qeverisëse duke u nisur nga niveli lokal, regjional, nacional e deri të ai supranacional. Fondet e publike të mbledhura shpenzohen nëpërmjet institucioneve kompetence financiare mbi bazën e rregullave buxhetore dhe fondeve respektive.[4]

Diferencat tatimore mes shteteve anëtare të UE-së, janë zgjidhur në momentin kur janë rregulluar çështjet e eliminimit të pengesave tarifore dhe jo-tarifore të mbetura në kuadër të tregut të brendshëm me dobi të zhvillimi të koncepteve të tregut të lirë e të përbashkët.

Së bashku me instalimin e regjimit të Unionit Doganor, gradualisht janë hequr barrierat paraprake doganore të tregjeve të brendshme dhe njëkohësisht janë eliminuar pengesat dhe barrierat tjera jo doganore lidhur me qarkullimin e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Por, brenda vendeve anëtare të UE-së, ende kanë mbetur ndryshime ta cilat kanë qenë produkt i strukturave të ndryshme tatimore, mënyrave dhe qëllimeve të përdorimit të mjeteve publike si dhe një seri ndryshimesh të lidhura për rregullat, teknikat, standardet etj, të politikave shtetërore në këtë segment të rëndësishëm. Përveç kësaj, vendet e UE-së, dallohen edhe për nga niveli i ndryshëm i fenomenit të korrupsionit dhe ekonomisë informale të cilat kanë efektet e veta në nivelin e të të dyja strukturave të financave publike dhe funksionimit të segmentit të ekonomisë legale.[5]

Në Unionin Evropian ka shumë diskutime për strukturën e taksave, harmonizimin e pjesshëm të tij si gjetjen e mundësive për harmonizimin e plotë. Ky debat në fakt tregon edhe kompleksitetin e sistemit fiskal në tërë territorin e UE-së. Edhe pse realisht deri me tani është shënuar një rezultat i vogël në harmonizimin e sistemit fiskal në territorin e UE - së, nuk mungojnë aktivitete për gjetjen e një bazave për politika dhe sistem të përbashkët fiskal. Politikat fiskale të Unionit Evropian[6] janë të decentralizuara dhe karakteri i tyre është edhe

---

1.1 [3] *Arjana Kokonozi " Zbatimi i ligjit per mbrojtjen e mjedisit" IMIM marrë në http://www.justforumalbania.org/zbatimi-i-ligjit-per-mbrojtjen-e-mjedisit-t83.html*

[4] Këto burime ju referohen të dhënave të marra nga ueb -i si në vijim me darën 20.01.2014 http://ec.europa.eu/taxation_customs/taxation/gen_info/economic_analysis/tax_structures/index_en.htm

[5] Po aty

[6] EU FiscalPolicy

nacional për faktin se tatimet janë të lidhura fortë me vendet anëtare. Kjo për shkak se, me përjashtim të harmonizimit të tarifave doganore, normat më të ulëta të TVSH-së, dhe vetëm disa akcizave në produkte të caktuara, sistemet tatimore janë të vendosura në kompetencë ekskluzive e shteteve anëtare. Deri në këtë moment kanë dështuar të gjitha përpjekjet lidhur me barazimin e politikave tatimore të UE-së, si dhe çdo përpjekje për të transferuar të paktën disa tatimeve te juridiksionit të organeve të Unionit Evropian. Deri sa UE-ja financohet nga shtetet anëtare, institucionet e saja qeverisëse dhe legjislative nuk kanë asnjë fuqi fiskale. Kjo nënkupton që UE-ja nuk është në gjendje të vendos, të imponojë dhe të mbledhura taksat.[7]

Eko - tatimet në UE

Lidhur me fjalën eko-tatim ekonomistgjermanBankFrankZipfelsqaron seme një term i tillënuk ekzistonporështë bërënjë termstandard qëpërdorettaninë reformëne taksaveekologjike. Ky term ka filluar që të përdoret gjatëviteve gjashtëdhjetë dheshtatëdhjetë të shekullit XX, me qëllim të ringjalljes dhe forcimit tëndërgjegjësimit mjedisornë veçanti promovimin e idesë së Piguo-t,për enjë tatimmbifaktorët e jashtëm. Vala e parë ereformës së tatimeveekologjikenuk ka dhënë rezultatet e pritura për faktin se pagesa etaksavemjedisoreështë konsideruarsi një lloji kompensimeve të caktuara ose taksa për lejen ekologjike. Vetëm nëfund të viteve tetëdhjetëshuma eeko-tatimeve është rriturdheintensifikuar duke i dhënë çështjes edhe karakterin penal.[8] Tatimet e gjelbra, tatimet ekologjike ose eko - tatimet janë të hyra të paguara nga subjektet që kualifikohen si ndotës të mjedisit të cilët me aktivitetin e tyre kanë ndikim negativ në ambientin jetësor.

Këto tatime janë futur në kuadër të sistemit fiskal për të zvogëluar shfaqjen e efekteve të jashtme negative siç është ndotja dhe zakonisht si të tilla konsiderohen instrumente korrigjuese. Ato, jo vetëm që krijojnë të hyra por në anën tjetër ndihmojnë lidhjen në mes të stimulimeve private dhe përfitimeve sociale të cilat gjithsesi kanë efekt përmirësues në jetën e përgjithshme ekonomike.[9]Realisht, koncepti i tatimeve mjedisore në literaturë nuk është përcaktuar zyrtarisht. Megjithatë, Komisioni Evropian, Evrostati dhe OECD, tatimet ekologjike i definon nga aspekti i përcaktimit të bazës tatimore. Sipas tyre, këto janë forma të tatimeve e cila ju caktohet në barrë tatimpaguesve mbi bazën e njësisë fizike të substancës ose materies e cila ka ndikim negativ në ambienti jetësor. Të gjitha aktivitet e UE-së lidhur me tatimet e gjelbra, si në retrosprektiv ashtu edhe në perspektiv, ndahen në gjashtë programe ekologjik si në vijim:[10]

1) Programi ekologjik I. (1973-1976), dokument që ka përcaktuar politikat gjelbra-ekologjike në UE, në drejtim të zvogëlimit të ndotjeve, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së ambientit;
2) Programi ekologjik II. (1977-1981), dokument i cili ka zgjeruar veprimin e programit të parë. Fokusi kryesor i këtij dokumenti bazohet në parandalimin e ndotjes së ujit dhe ajrit, ruajtjen e pyjeve dhe drejtimin e qeverisjen racionale me resurse natyrore.
3) Programi ekologjik III. (1982-1986), dokument që konsideron me prioritet politikat për ambientin njerëzor, zvogëlimin e zhurmës, menaxhimin e mbeturinave, promovimin e teknologjive mjedisore. Vendosja e bashkëpunimit me vendet në zhvillim për të zgjidhur problemet e mbrojtjes së mjedisit;

[7] Këto burime ju referohen të dhënave të marra nga ueb -i si në vijim me darën 20.01.2014 http://ec.europa.eu/taxation_customs/taxation/gen_info/economic_analysis/tax_structures/index_en.htm

[8]Filipović, S., Ekonomski anali br 162, jul 2004. - Septembar 2004. Str.212.

[9]Stiglic, E. Joseph, Ekonomija javnog sektora, Ekonomski fakultet, Zagreb, 2004. Str 736-738.

[10]EU Environmental Issues and Policies Guidelines marrë në http://www.ueapme.com/business-support%20II/Training%20Tools/Confartigianato/Environment/EU%20Environmental%20Guide.pdf faqe 7, e shkarkuar me datën 08.02.2014

4) Programi ekologjik IV. (1987-1992), dokument i cili përfshinë edhe politikat për mbrojtjen e mjedisit në fushën e bujqësisë, tregtisë;
5) Programi ekologjik V. (1993-2000) dokument që së pari ka përcaktuar bazën e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa programet e brezit të mëparshëm të fokusuar në përmirësimin e mjedisit; dhe
6) Programi ekologjik VI. (2001-2010) zbatohet me emërtimin " *E ardhmja jonë, zgjedhja jonë 2010*", duke propozuar pesë prioritete të ardhshme; përmirësimi i legjislacionit ekzistues; bashkëpunim më i ngushtë në tregtar; integrimin e organeve të përfshira në politikën e mjedisit; të ndihmojë njerëzit për të ndryshuar sjelljen dhe planifikimi dhe mbrojtjen e mjedisit.[11]

Në UE ka tri kategori themelore të tatimeve mjedisore: tatimi mbi energjinë, tatimi mbi transportin dhe një tatim mbi ndotjen e burimeve natyrore.[12] Në tatimet mbi produktet e energjisë përfshijnë: tatimin mbi vajrave minerale dhe lëndëve djegëse motorike, benzinë (plumb dhe pa plumb), naftë, vajguri, vajguri tatimi mbi natyrore gazit dhe konsumit të energjisë elektrike.

Tatimi mbi transportin përfshijnë: regjistrimin dhe përdorimin automjeteve motorike, tatimin për importin dhe shitjen e mjeteve motorike, taksat për përdorimin e rrugëve dhe autostradave, jahte luksoze e sigurimit dhe të trafikut ajror të pasagjerëve.

Tatimi mbi ndotjen e burimeve natyrore përfshijnë: një taksë mbi pesticideve dhe plehrat artificiale, paketimit prej metali, plastike, qelqi, qeramika, mbeturinave (Landfill), ndotja e ajrit (CO2, SO2, NOx), bateri, goma, kontejnerët në dispozicion, (mbrojtja e ujit) për të humbur ujin (të brendshme apo industrial), qese plastike, ndotja e ujit, CFC, HFC, PFAC dhe SF6 (ndotësit e ozonit) dhe bërthamore të energjisë.

Ndërkombëtarizimi i qasjes fiskale ndaj faktorëve ekstern - ose eksternatlieti

Çështja emetimit të gazrave të tepërta serë dhe format tjera të larta të ndotjes mjedisore për zhvillimet ekonomike jo vetëm që janë vlerësuar negative por tano ato konsiderohen me një rrezikshmëri të lartë shoqërore. Prandaj, eksternalitetet janë faktorë ose efekte të karakterit negativ apo pozitiv të cilat një subjekt i caktuar gjatë ushtrimit të një aktiviteti specifik, gjatë procesit të prodhimit ose të konsumit, i shkakton subjektit tjetër, si rezultat i procesit te prodhimit ose konsumit, e jo nga veprimi i mekanizmave të çmimit.

Instrumentet tatimore ekologjike me të cilat dëshirohet që të mbrohet mjedisi zakonisht ndahen në tri grupe:

1) *Pigou - tatimet* ekologjike konsiderohen tërësi tatimesh specifike ku barra e ngarkesë së tyre matet drejtpërdrejtë në bazë të njësive ndotëse të cilat subjektet e caktuara i emetojnë në mjedis. Ndryshe, me anë të këtyre tatimeve pretendohet që të zvogëlohet emetimi i sasisë së caktuar e ndotëse. Në këtë çështje, esenciale është realizmi i Pigou ndalesave respektivisht që nëpërmjet këtyre tatimeve të behët i internalizim i të ashtuquajturave kostove eksterne cilat rrefkëtohen për shkak se ndotësit e mjedisit i krijojnë kundër palëve të treta të cilat farë nuk janë të kyçur në tregun specifik (*p.sh qytetarët të cilët thithin ajrin e ndotur dhe nga kjo kanë probleme shëndetësore*). Prandaj, kostoja për tatimin ekologjik duhet të jetë barrë e ndotësve të caktuar gjë që me këtë akt mblidhen mjete që duhet të orientohen dhe harxhohen në të mirë të përmirësimit dhe valorizimit të burimeve natyrore.[13]

[11]Po aty nga faqe 7 deri në faqen 9

[12]D. Pîrvu i E. Clipici, Perspectives of the Environmental Taxes Evolution in the European Union, The Romanian Economic Journal, No. 38., December, 2012., str. 147. – 161

[13] *John V. C. Nye - George Mason University / The Pigou Problem, marrë me 20.01.2014 në: http://object.cato.org/sites/cato.org/files/serials/files/regulation/2008/6/v31n2-5.pdf*

2) *Tatimet para Pigou* konsiderohen tërësi instrumentesh që konsiderohen tatime indirekte si. p.sh. tatimet doganore, akcizat, etj,. Sipas kësaj, me norma më të ulëta tatohen ato mallra apo shërbime të cilat konsiderohen se gjatë prodhimit ose konsumit të tyre nuk prodhojnë efekte negative në mjedis ndërkaq kur janë në pyetje mallrat dhe shërbimet që kanë ndikim negativ në ndotjen e mjedisit i nënshtrohen një regjimi me të lartë tatimor.[14]
3) *Tatimimi i dyfishtë* ekologjik përdorët për mbledhjen e të ardhurave të cilat fokusohen në aktivitete të caktuara ekskluzivisht në mbrojtjen e mjedisit respektivisht në projekte për të financuar ndotjen mjedisore.[15]

Në përgjithësi janë të njohura tri tërësi instrumentesh që ju dedikohen politikave mjedisore. Të parat janë instrumente e komandës dhe të kontrollit që drejtpërdrejtë rregullojnë ndalimin ose lejimin e prodhimeve dhe shërbimeve gjatë ushtrimit të aktiviteteve njerëzore në përgjithësi, të dytat janë instrumente ekonomike të rregullimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (tatimet, dënimet, shpërblimet, subvencionet, etj, forma tjera të menaxhimit të mjedisit, dhe të treta: instrumentet vullnetare të cilat dalin nga aspiratat e prodhuesve, konsumatorëve dhe e shtetit për të promovuar ekuilibrin ekologjik të njohura si planifikimi i integruar mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm, përgjegjësia e prodhuesve gjatë ciklit jetësor të produktit, marrëveshjeve për masat e kontrollit, të vlerësimit të gjendjes në mjedis, sistemit të informimit të publikut për gjendjen dhe problemet mjedisore.[16]

Reformimi, harmonizimi dhe struktura tatimore

Harmonizimi i sistemit tatimore përfshin një proces të ndërlikuar sinkronizimit, koordinimit dhe unifikimit të sistemeve tatimore në mes shteteve anëtare dhe atyre pretenduese në UE me qëllim të eliminimit të instrumenteve tatimore nacionale të cilat kanë ndikim negativ në funksionimin e tregut të përbashkët. Prandaj,ky proces zakonisht propozohet të ndërtohet ose konstituohet mbi parimet vepruese institucionale që janë të ndërlidhura me qartësinë, maturinë, drejtshmërinë, thjeshtësinë, fortësinë, përshtatshmërinë, besueshmërinë, solidaritetin, dobishmërinë, përgjegjësinë, etj,. Prandaj, mbi bazën e këtyre parimeve del se qëllimet e reformës së tatimeve ekologjike gjithsesi duhet të jenë reale, të besueshme dhe të vendosura me saktësi ndërkaq opinioni publik të jetë i njoftuar rregullisht. Krijimi i sistemit për futjen e tatimet ekologjike duhet të bëhet gradualisht pa e përdor instrumente e dhunës shtetërore. Për krijimin e sistemit duhet kihet kujdes për nivelin, gjendjen, strukturën, etj, ekonomike, gjendjen ekologjike, demografike, bio-regjionale, etnokulturore, psiko-sociale, etj. Posaçërisht, secili i veprim i ndërmarr duhet të jetë i matur dhe çdo pakujdesi, qoftë ajo e rëndë ose lehtë, mund të shkaktojë probleme serioze duke e humbur edhe autoritetin e institucioneve. Duhet shikohen mundësitë që vendosja dhe zbatimi i tatimeve ekologjike te kompensohen nga uljet e tatimeve ose taksave tjera duke e ruajtur çdo herë stabilitetin ekonomik. Në rast se tatimet ekologjike veprojnë në mënyrë regresive është e nevojshme që gjithsesi të planifikohen dhe zbatohen masa kompensuese. Tatimet ekologjike duhet të jenë të thjeshta në mënyrë që zyrtarët financiarë të mund t'i aplikojnë më lehtësi. Qëllimi i shtrirjes sa të me të madhe të te hyrave ka mundësi të sjellë deri të dukuria e evzionit fiskal. Për këtë arsye, përveç krijimit të mekanizmave të pagesës, duhet punuar edhe në ngritjen e vetëdijes për detyrimin që ka subjekti për këtë çështje.Element i rëndësishëm i çdo strategjie për mbrojtje mjedisore është përshtatshmëria e saj konform me thelbin e zhvillimet ekonomike dhe ndryshimeve mjedisore. Çështje të ndjeshme konsiderohen përcaktimi optimal e i saktë i lartësisë së tatimit ekologjik

[14] *Po aty*
[15] *Po aty*
[16] *J. Klarer e të tjerët : Sourcebook on Economic Instruments for Environmental Policy Central and Eastern Europe, The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, Szentendre, Hungary, 2000., str. 23.*

dhe përcaktimi i tatimpaguesve. Kjo lartësi tatimore nuk duhet të jetë përcaktuar në mënyrë arbitrare dhe si rezultat i ndonjë procesi eventual lobues. Përfundimisht, suksesi për futjen e këtyre llojesh tatimeve varet se a do kualifikohen si tatime të rënda-larta ose optimale.
Ndër elemente e rëndësishme të strategjisë duhet të jetë përshtatshmëria e tyre në raport me dinamikën e zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore-ekonomike. Nga kjo del detyrimi i kujdesit që me rastin e vendosjes së këtyre tatimeve të mos rritet barra ose ngarkesa e përgjithshme tatimore në mënyrë që të rrezikohet sistemi në përgjithësi.
Përcaktimi i lartësisë reale të tatimeve ekologjike dhe përshtatja e tyre më aftësinë pagues e tatimpaguesve është njëra ndër çështjet me të ndërlikuara. Lartësia e tatimeve ekologjike në asnjë mënyrë nuk guxon që të vendoset në mënyrë arbitrare ose në bazë të presioneve nga strukturat joformale. Është e pakontestueshme se procesi i reformimit të një sistemi të realizohet vetëm në një vend. Prandaj, për të realizuar projekte të tilla duhet angazhime dhe aksione të nivelit ndërkombëtar respektivisht një fryme e solidaritetit. Parimi i dobishmërisë ndërlidhet me aplikimin e tatimeve ekologjike vetëm atëherë nëse për burime të dëmtuara mjedisore dizajnohen dhe përgatiten projekte të zbatueshme që sigurojnë një impakt të sigurt dhe cilësor të zhvillimi. Mbi të gjitha i tërë aktiviteti i reformimit, harmonizimit, balancimit respektivisht sinkronizimit të sistemi tatimor, duke përfshi këtu edhe eko-tatimet, duhet realizohen me një profesionalizëm të përgjegjshëm e cila do derivojë një rezultat zhvillimor dhe mbrojtje efektive dhe substanciale mjedisore.[17] Edhe vendet e Evropës Juglindore të cilat gjenden në nivele të caktuara të tranzicionit gjithsesi duhet që të krijojnë parakushte e nevojshme institucionale për një zbatim të suksesshëm të reformës tatimore. Në këtë funksion rekomandohet që gjatë këtij procesi duhet krijuar dhe siguruar stabilitet makroekonomik, mirëfunksionimi i shtetit ligjor, krijimit i një bashkëpunimi dhe partneritetit më të ngushtë teknik-teknologjik, rritja substanciale e efikasitetit menaxhues në sferën publike dhe rritjen e profesionalizimit për ruajtjen dhe valorizimin e burimeve mjedisore.

Përfundimet

Që nga vitit 2008 Evropa dhe pothuajse tërë bota po përballen me një krizë financiare dhe ekonomike. Ajo që filloi si krizë bankare u bë shpejt krizë fiskale gjë e cila jo vetëm shteteve të UE -së u shkaktojë një stres fiskal nga e cila nuk bëhet fjalë për këndellje. Kjo ndikojë në angazhimin dhe orientimin e vendeve në mobilizim të mjeteve financiare nëpërmjet programeve të stimujve ekonomik me qëllim të politikave stabilizuese. Është interesante se sa me shpejtësi dhe forcë reagojnë qeveritë e vendeve të UE -së, për t'u përballur me krizën financiare ndërkaq është shumë dëshpëruese që ndaj ndotjes globale, e cila është me rrezikshmëri edhe me të lartë se e para, sillemi me komoditet dhe brenga e tyre shfaqet vetëm në mënyrë deklarative.

Prandaj, punimi konstaton se në UE dhe në shtetet të cilat synojnë që të jenë anëtarë të kësaj organizate karakterizohen për sisteme tatimore me ngjashmëri dhe dallime të theksuara. Posaçërisht, dallimet evidentohen si në të ardhura totale tatimore, në strukturë, normë dhe bazën e përcaktimit të tyre. Të ardhurat tatimore në botë moderne janë të nevojshme për të garantuar demokracinë, rendin publik dhe funksionimin e sistemit ligjor. Ato, duhet të jenë më shumë sesa thjesht burim të ardhurash për funksionimin e shtetit, të garantojë gjithashtu që autoritetet publike të kontribuojnë në mënyrë aktive për realizimin e synimeve të politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore.

[17] *European Environment Agency - Environmental tax reform in Europe: opportunities for eco-innovation, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011*

Tatimet janë instrumente të rëndësishme për rishpërndarjet të te ardhurave të mbledhura tek dhe në dobi të qytetarëve. Garantimi i një solidariteti dhe kohezionit social në shoqëri në mënyrë automatike kërkon transferime në masë sociale ku nevoja tatimore në këtë funksion është e pa alternativë.

Tatimet ekologjike, tatime e gjelbra ose tatimet e së ardhmes janë instrumente të karakterit ekonomike-juridik të cilat vendosen nga institucionet kompetente me qëllim të parandalimit, kufizimit ose eliminimin e ndotjeve mjedisore. Politikat moderne të mbrojtës mjedisore duhet krijuar në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, ekosistemit, ruajtjes së biodiversitetit dhe balancës ekologjike për faktin se mjedisi është asteti më i rëndësishëm njerëzor. Vendosa dhe aplikimi i tatimeve ekologjike si instrumente nëpërmjet të cilave arrihet plotësimi i qëllimeve të mbrojtje mjedisore duhet të jenë të drejtuara mbi bazën e parimeve të barazisë dhe të drejtësisë tatimore për shkak se një shtet të se drejtës të gjithë subjektet në kuadër të marrëdhënieve të tyre juridike - tatimore presin që barra tatimore e cila duhet të paguhet në emrin e tatimit mjedisor te jetë e shpërndarë në mënyrë të barabartë. Tatimet ekologjike sipas UE-së definohen si forma tatimore baza e së cilës është e shprehur në njësi fizike të materies dhe ndikimit të saj negativ në mjedis.

Projektimi dhe implementimi i suksesshëm garanton një sistem të qëndrueshëm tatimor. Kjo përmban në vete edhe qeverisjen e mirë së bashku me posedimin e burimeve njerëzore të përgatitura për ekzekutimin e këtyre politikave. Një qeverisje e dëshirueshme duhet bazuar në koherencë në mes të objektivave dhe politikave të ndryshme dhe krijimin e një mjedisi ku subjektet do të trajtohen me barazi. Andaj, kjo detyrë që konsiderohet publike në sferën e menaxhimit financiar kërkon transparencë fiskale, përgjegjësi, përgjegjshmëri ose aktivitet cilësor në vazhdimësi i drejtuar nga e ardhmja. Kësaj qasjeje duhet me kujdes t'i shtohet edhe krijimi i një kulture për sjelljen konform me interesin publik.Arritja e kësaj kulture kërkon një proces të gjatë, të vazhdueshëm dhe gradual të ndryshimit në qëndrime dhe vlera. Në mungesë të një kulture të tillë nuk do të ketë besim tek qeveritë dhe do të jetë e vështirë për të bindur qytetarët që të paguajnë taksat e kërkueshme.

Literatura dhe burimet tjera të referimit ose konsultimit

1) Baldwin,R.andWyplosz,Ch.,TheEconomicsofEuropeanIntegration,NewYork: The McGraw-Hill, 2006;
2) Barry,F.:FiscalPolicyinEMU,UE.Pentecost&vanPoeck,A.(ed.),European Monetary Integration, Aldershot: Edvard Elgar, 2001
3) CodeofConductforBusinessTaxation, OJ C 2, 6.1.1998;
4) D. Pîrvu i E. Clipici, Perspectives of the Environmental Taxes Evolution in the European Union, The Romanian Economic Journal, No. 38., December, 2012
5) Filipović, S., Ekonomski anali br 162, jul 2004. - Septembar 2004
6) Eichengreen,B.:InstitutionforFiscalStability,WorkingPaperPEIF-14, Berkeley: Institute of EuropeanStudies, 2003;
7) Eichengreen,B.&vonHagen,J.:FiscalPolicyandMonetaryUnion:IstthereaTradeoffBetweenFederalismandBudgetaryRestrictions?NBERWorking Paper, WP/5517, 1996b;
8) European Commission: AEuropeanEconomicRecoveryPlan,Novembar, 2008;
9) EuropeanCommission:EuropeanUnionPublicFinance,EuropeanCommunities, Brussels, 2002;
10) EuropeanCommission:TheEuropeanUnionBudgetataglance,European Communities, Brussels, 2007;
11) European Council, 1997 i 1997b;
12) EuropeanTaxHandbook2006.,IBFD, Amsterdam, 2006;
13) European Environment Agency - Environmental tax reform in Europe: opportunities for eco-innovation, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011

14) EUTaxation,(2005a),Commontaxationofparentcompaniesandtheirsubsidiaries[http://www.europa.eu.int/scadplus/leg/en/lvb/l26037.htm];
15) Klarer i drugi: Sourcebook on Economic Instruments for Environmental Policy Central andEastern Europe, The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, Szentendre,Hungary,
16) Kokonozi Arijana "Zbatimi i ligjit per mbrojtjen e mjedisit" IMIM marrë në http://www.justforumalbania.org/zbatimi-i-ligjit-per-mbrojtjen-e-mjedisit-t83.html
17) Stiglic, E. Joseph, Ekonomija javnog sektora, Ekonomski fakultet, Zagreb, 2004
18) Shoqëria dhe Mjedisi i saj - Botim i Qendres Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore - Zyra në Kosovë / Titulli origjinal: Society and Its Environment an Introduction - Egbert Tellegen and Maarten Wolsink, University of Amsterdam, the Netherlands Publisher: Gordon and Breach Science Publishers Amsteldijk 166, 1st Flor 1079 LH Amsterdam The Netherlands

Summary

Since 2008, Europe and nearly the whole world, is facing a financial and economic crisis. What began as a banking crisis, it quickly turned into a fiscal crisis, which caused a fiscal stress that has impacted countries in the EU and beyond, with no sign of rapid recovery. This has impacted countries to commit and orient financial resources into economic stimulation programs, aimed at implementing stabilizing policies. It is interesting how quickly and fervently governments of EU countries have reacted, in order to cope with the financial crisis, however, it is very sad that global pollution, which is an even higher risk than the first, is dealt with obliviousness and their concerns appear only declaratively. Therefore, the paper concludes that the EU, and the countries which are intended to be members of this organization, are characterized by tax systems with significant similarities and differences. Specifically, the differences are identified in the total income tax, structure, rate, and the set base. Tax revenues in the modern world are necessary to guarantee democracy, public order and the functioning of the legal system. They should be more than just a source of income for the functioning of the state, to also ensure that public authorities actively contribute to achieving the goals of economic, social and environmental policies. Taxes are important instruments for the redistribution of income, which are collected from, and serve to the benefit of, the citizens. Guaranteeing solidarity and social cohesion in society automatically requires mass social transfers, where the need for taxes to serve this function has no alternative. Environmental taxes, green taxes or future taxes are instruments of the legal and economic character, which are established by the competent authorities for the purpose of preventing, restricting or eliminating environmental pollution. Modern environmental protection policies must be founded for the aim of achieving sustainable development for the economy, ecosystem, conservation of biodiversity, and ecological balance, given the fact that the environment is the most important asset humans have. Environmental taxes are defined by the EU as tax forms, the basis of which is expressed in physical units of matter and its negative impact on the environment.A stable tax system is ensured through the successful design and implementation of policies and processes. It involves good governance along with the possession of human resources prepared for the execution of such policies.

Prof. Ass.Dr. Nehat Ramadani
Business Administration Faculty
State University of Tetova
Str. Ilindenpn, 1200 Tetovë, Republic of Macedonia
nehati73@yahoo.com ; tel: 00 389 71 292 001

2 Impakti fiskal i partneritetit puibliko-privat- Rasti Maqedonisë

Abstract

This scientific paper considers theoretical and practical aspects of public private partnership in the context of the fiscal policies' impact either in local or central level. Public-private partnerships scheme in EU is successfully operational, and this paper brings a general overview of various European states. The paper has a particular focus on public-private partnerships in Macedonia, and brings concrete projects that have targeted public investments and budgetary reliefs. The methodology applied in this paper is qualitative, while interviews were conducted with the resources that were detected as mostly relevant for developing this study. The paper concludes that public-private partnerships, is suitable model to generate additional private investments, hereby generating public budget revenues and facilitating public investments.

Key words: *public private partnerships, public investments, private investments, fiscal impact*

Abstrakti
Ky punim shkencor merr në konsideratë aspektet teorike dhe praktike të partneritetit publiko privat, në kontekst të impaktit mbi plitikat fiskale qoftë në nivle lokal apo qëndror. Partneriteti publiko privat është një skemë tani funksionale në BE, dhe punimi shkencor sjell pasqyrën e këtij mekanizimi në shtete të ndryshme Euuropiane. Punimi ka një fokus të vecantë mbi partneritetin publiko-privat në Maqedoni, si dhe sjell projekte konkrete të cilët kanë synuar lehtësimet buxhetore gjatë investimeve publike. Metodologjia e aplikuar në këtë punim është kualitative, ndërsa intervistat janë zhvilluar me burimet të cilat ishin detektuar si më relevante për punimin e këtiij studimi. Punim shkenvor vjen në përfundim se partneriteti publiko privat, është model I përshtatshëm për të gjeneruar investime shtesë private, si dhe për të gjeneruar të ardhura për buxhetet publike nga njëra anë, dhe lehtësime në investimet publike nga ana tjetër.
Fjalët kyçe: *partneriteti publiko-privat; investimet publike, investimet private, impakti fiskal*

I. Hyrje

Maqedonia nga pavarësia e saj në vitin 1991, ende nuk ka arritur të stabilizojë klimën politike dhe ekonomike në vend. Prioritetet e politikës së Maqedonisë kanë të bëjnë me objektivat për stabilizimin ekonomik të vendit, si dhe anëtarësim e saj në BE (Bashkimin Europian) dhe NATO. Rrugëtimi drejt këtyre objektivave ka qenë i vështirë gjatë gjithë periudhës së kaluar, ndërsa kohëve të fundit është shtuar edhe më tepër skepticizmi për plotësimin e tyre. Arsyet janë të shumta, ndërsa ajo që përmendet më shpesh është mungesa e vizioneve politike nga politikbërësit, si dhe qeverisja jo e mirë e vendit.

Tranzicioni ekonomik pas pavarësisë së Maqedonisë, diktoi ristrukturimin e kapaciteteve industriale, të cilat në masë të madhe u privatizuan. Megjithëse procesi i privatizimit vlerësohet si jo-transparent dhe në disa raste i shoqëruar me manipulime deri në shfaqje të korrupsionit, ristrukturimi apo mbyllja e ndërmarrjeve të mëdhaja publike, ndikoi negativisht në rritjen e papunësisë në Maqedoni ,e cila gjatë gjithë këtyre viteve sillet në nivelet reth 30 %[18].
Mungesa e zhvillimit ekonomik në Maqedoni, është përshkruar pothuajse në secilin raport të Komisionit Europian, duke i sugjeruar dhe rekomanduar vendit që të angazhohet për një qeverisje më të mirë, përfshi ngritjen e një administrate publike profesionale, përmirësimin e gjyqësisë, krijimin e mekanizmave për funksionimin më të mirë të tregut, apo përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend. Ende Maqedonia nuk ka treguar aktivitete serioze se është duke punuar sipas rekomandimeve të Komisionit Europian, ndërsa edhe pse në pritje të hapjes së negociatave për anëtarësim me BE-në, janë vërejtur një mori incidentesh që lidhen me procese politike gjyqësore.
Të ardhurat fiskale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë në tre vitet e fundit (2011-2013) janë rreth 29% të GDP-së, ku vërehet një rënie në përputhje me strategjinë e qeverisëpër uljen e barrës tatimore mbi ekonominë. Në këtë mënyrë, gjenerimi i të ardhurave fiskale nga taksat logaritet në nivelin 54%, e ndjekur nga të hyrat në bazë të kontributeve sociale me rreth 29%, të hyrat jo-tatimore dhe të hyrat kapitale me rreth 13%, ndërsa pjesa tjetër e të hyrave realizohen kryesisht nga fondet e BE-së IPA. Për sa i përket të ardhurave nga taksat, shumica e të ardhurat realizohet në bazë të TVSH-së, tatimit mbi të ardhurat personale dhe akcizat.Në përputhje me të ardhurat buxhetore dhe projeksionet e shpenzimeve, niveli i deficitit buxhetor sillej prej 2.5% në vitin 2011, me një tendencë të reduktimin e deficitit në 2.2% në 2012 dhe 1.9% në vitin 2013. Financimi i deficitit në periudhën afatmesme ishte planifikuar që do të mbulohej kryesisht nga burimee të huaj financiare (kredi të favorshme nga IFI, eurobonove dhe lloje tjetra të huamarrjeve nga jashtë)[19].

II. Objektivat e studimit dhe metodologjia

1. Objektivat

Është e natyrshme se dinamika zhvillimore e çdo vendi ndryshon duke u bazuar në faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që disponon çdo shtet. Disa shtete janë më të zhvilluara ekonomikisht (si shtetet perëndimore), si dhe kanë mundësinë që të investojnë shuma nga të ardhurat publike. Disa shtete tjera, më pak të zhvilluara ku bën pjese edhe Maqedonia, nuk kanë buxhete të fuqishme dhe si rrejdhojë paraqitet nevoja e impakteve fiskale dhe mënyrës së bashkëpunimit me sektorin privat për të realizu projekte publike.
Përveç objektivave të përgjithshme siç u përmendën më lartë, studimi ka për qëllim të sjellë objektivat konkrete si :

- A është partneriteti publiko privat në shërbim të politikave fiskale, me theks të vecantë në nivel lokal?
- Cilat janë barrierat për të implementuar partneritetin publiko privati?

Limitet e disertacionit
Fusha e partneritetit publiko privat dhe impakti në politikën fiskale të një vendi, mundet të jetë një fushë mjaft e gjerë. Andaj, ky punim sikurse çdo punim tjetër shkencor, do të jetë objektivisht i limituar për të studiuar të gjithë fenomenet e fushave të partneritetit publiko privat.

[18]Enti statistikor i Republikes se Maqedonise (http://www.stat.gov.mk/Default_en.aspx)
[19] Pre-accession Economic Programme 2011 – 2013Macroeconomic Policy, Public Finances and Structural Reforms Ministry of Finance of the Republic of Macedonia p.57

Punimi nuk do të studiojë partneritetet publiko private në nivel ndërkombëtarë apo nacional, fokusi i hulumtimit do të jenë partneritetet publiko private në nivel lokal në frymën e influencës së politikave të Bashkimit Europian.

2. Metodologjia

Gjatë zhvillimit të këtij punimi shkencor, janë mbledhur të dhëna dhe informacione mënyrës kualitative dhe kuantitative. Janë zhvilluar takime, intervista dhe diskutime me persona të caktuar, që mundësuan krijimin e të dhënave bazë të punimit. Të dhënat sekondare janë siguruar nga publikimet e ndryshme në lidhje me fushën e studimit. Ato vijnë nga publike të ndryshme të Bashkimit Europian, Kombeve të Bashkuara, libra dhe artikuj të ndryshëm shkencorë, të dhëna të publikuara nga institucionet publike apo private të vendit e kështu me radhë. Pyetësorët janë formuluar si gjysmë të strukturuar gjatë realizimit të intervistave direkte. Pyetësorët përpara se të plotësoheshin, ishin përshtatur me fushën e studimit, më pas ishin testuar në disa variante nëse pyetjet janë të kuptueshme për palën e tretë, dhe vetëm më pas ishin shpërndarë.

III. Aspekte teorike

1.Historiku i partneriteteve publiko-privat

Në kohërat e lashta, shumë nga çështjet publike (strehimoret, tregjet publike) si dhe infrastruktura publike (banjat publike), u ishin dhënë personave privat). Sipas një publikimit të Kombeve të Bashkuara [20], libri 50 i doracakëve të mbledhur (Ligji Publiko Privat i publikuar në vitin 530), ishte kryekëput i dedikuar për punët publike se si munden të jepen në duart e ndërmarrësve privat. Ky libër tregonte ekzistencën e ligjit të koncesionit si dhe ligjit që kishte të bënte me licencimin e qeverisjes së pasurisë publike. Pas rënies së perandorisë romake, procedurat e këtilla ishin zhdukur, dhe kishin ardhur sërish në pah gjatë shekujve 12 dhe 13 kur edhe filluan ndërtimet e qyteteve të fortifikuara si dhe okupimi i tokave të reja në rajonet jug-perëndimore të Francës psh. kontratat e okupimit, siç quheshin aso kohe dhe siç trajtohen në publikimin në fjalë, kishin të bënim me dhënien e fshatrave të tërë për rindërtim.

Një zhvillim i hovshëm i partneriteteve publiko private kishte ngjarë gjatë shekujve të 16 dhe 17, kur shtetet e fuqishme Europiane si Franca apo Anglia e asaj kohe, i jepnin punët publike ndërmarrësve privat. Punë të tilla përfshinin punime rreth shtratit të lumit, gropimi i kanaleve, trotuar rrugësh, mbledhja e plehrave, ndriçimi publik, shpërndarja e postës, transporti publik, deri në dhënien e dyqaneve apo edhe shtëpi operash. Këtu vlen të përmenden shembujt si dhënia me koncesion e kanalit të Oksfordit në Britani më 1791, apo kanali Von Thurn në Spanjë në atë periudhë.Deri më 1820, gjashtë kompani private të ujësjellësit operonin në Londër.[21]

Në fillim të shek.19, gati shumica e ndërmarrjeve që operonin me ujëra ishin privat. Objektet e energjisë elektrike në shek 19 në Brazil, Chile, Costa Rica dhe Mexico, ishin entitete private. Në Argjentinë, Brazil dhe Urugvaj, kompani private nga Britania, Franca dhe SHBA-të, ndërtuan dhe operuan shumë nga hekurudhat e shekullit 19 dhe 20. [22]

Megjithatë, hulumtues të kësaj fushe shprehen se luftërat në gjysmën e parë të shekullit 20 e kishin dobësuar mjaft ekzistencën e partneriteteve publiko private. Pas luftërave të ashpra në Europë, rroli i shtetit ishte rritur.

[20] UN Publication on PPP for infrastructure development , 2000, f. 6
[21] UN Publication on PPP for infrastructure development , 2000, f.6
[22] *Facilitating Public Private Partnership for Accelerated Infrastructure Development in India, 2006, f.20*

Nocioni i ndërmarrjeve shtetërore aso kohe kishte lindur për të shmangur dobësimin financiar lidhur me projektet afatgjata. Kjo lëvizje u zgjerua në tërë Europën gjatë dy luftërave botërore.[23]

2.Definimi i partneritetit publiko privat

Autorë të ndryshëm japin definicione të ndryshme lidhur me partneritetin publiko privat. Sipas Ian Taylor[24] "PPP janë kontrata afatgjate duke përfshirë të dy sektorët atë publik dhe privat, për të siguruar dhe operuar me shërbimet publike dhe me theks të veçantë shërbime mbi infrastrukturën publike". Sipas këtij autori partneriteti nënkupton ndarjen e përgjegjësive/rreziqeve si dhe përfitimeve nga të dy palët në partneritet.

Sipas Kombeve të Bashkuara [25] PPP definohen si "koncesione ose tipe tjera të marrëveshjeve kontraktuale ku sektori publik pajtohet tí japë sektorit privat, të drejtën të operojë, ndërtojë, menaxhojë dhe/ose shpërndajë një shërbim për publikun e gjerë."

Komisioni Europian në publikimin e tij[26], jep një definim si në vazhdim: "Partneriteti Publiko-Privat është një partneritet midis sektorit publik dhe atij privat me qëllim të shpërndarjes së një projekti apo shërbimi i cili tradicionalisht është ofruar nga sektori publik".

Megjithatë, të gjitha këto defincione kanë një gjë të përbashkët, dhe ajo është lehtësia buxhetore e qeverisjes, e cila krijohet nëpërmes thithjes së investimeve private për politika dhe projekte publike. Në të kundërt, politikat fiskale të shtetet do të duhej të merreshin me këto inciativa, ndërsa vështirësia buxhetore e shteteve në zhvillim është mjaft limituese për arritjen e këtyre objektivave.

3.Parteritetet publiko-private në kontekstin Europian

Ka mjaft konfuzion për atë se çfarë është partneriteti publiko privat (PPP), ndërsa dilemat më të mëdha nga skeptikët e PPP-ve lidhen me mungesën e njohjes së përfitimeve që dalin nga një partneritet midis dy sektorëve.

Vërehet një dobësi e theksuar në fushën e negociatave të kontratave mbi PPP me sektorin privat. Kështuqë Kombet e Bashkuara kanë përgatitur një platformë[27] për tí ndihmuar qeverive në negociatat e tyre që të mbrojnë interesin publik. Një problem tjetër është organizimi i tenderëve të hapur dhe konkurrues, ndërsa një numër mjaft i madh i qeverive është akuzuar për mungesë transparence. Sipas disa studimeve, përfshi edhe studimin e Kombeve të Bashkuara, thuhet se disa projekte të PPP-ve nuk kanë pasur sukses jo për shkak të mungesës së fondeve, por për shkak të mungesës së strategjisë së mirëfilltë, përfshi këtu edhe përfshirjen publike në projektet e ndryshme.

Një element mjaft i rëndësishëm i funksionimit të PPP-ve është edhe niveli i klimës për partneritet që ekziston në shtete të ndryshme. Për ta përforcuar këtë pohim po sjellim përfundimet e një studimi të Bankës Botërore[28] , që kishte kategorizuar shtetet e ndryshme, ndër to edhe shtetet e rajonit tonë në nivele të ndryshme. Gjatë kategorizimi të shteteve ky studim kishte përdorur një numër kriteresh, sipas përshtatshmërisë së mjedisit për të operuar PPP-të. Katër nivele ishin krijuar si më poshtë:

---

[23] *UN Publication on PPP for infrastructure development , 2000, f. 6*
[24] *Ian Taylor, 2000,Public-Private Partnerships: Lessons from the MDC Toll Road, f.3*
[25] *Publikimi i Kombeve të Bashkuara Komisionit Ekonomik për Europë, no 84 , Shtator 2004, f. 6*
[26] *Guidelines for successful PPP, EC Directorate General , Regional Policy March 2003, f.4*
[27] *Publikimi i Kombeve të Bashkuara - Komisioni Ekonomik për Evropë, no 84 , Shtator 2004, f.3*
[28] *World Bank, M. Sohail, B. Gentry & O. Maslyukivska, (tek UNECE), f.6*

- PPP që kanë klimë për tu realizuar , ku bënin pjesë shtetet si Republika Çeke, Hungaria, Sllovakia dhe Sllovenia
- PPP të cilat ndeshen me vështirësi realizimi; Romania, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Lituania, Letonia,
- PPP me probleme të theksuara për realizim; Federata Ruse, Ukraina, Kazakistani, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina , Serbia dhe Mali i Zi.
- PPP pothuajse të parealizueshme: Bjellorusia, Moldova, Armenia, Azerbajxhani, Gjeorgjia, Taxhikistani, Turkmenistani dhe Uzbekistani.

Duke parë një vlerësim të këtillë nga një institucion me renome siç është ai i Kombeve të Bashkuara, normalisht se ndikohet fluksi i investitorëve për të investuar në një shtet apo në tjetrin. Siç shihet shtetet ku bën pjesë edhe Maqedonia, Shqipëria apo Mali i zi, janë vende të cilat i takojnë grupit të parafundit lidhur me mjedisin që ofrojnë për partneritete. Ky nivel perceptohet si i vështirë dhe siç potencon publikimi me vështirësi të shumta realizohen projektet e partneritetit. Në radhë të parë, dilemat vijnë nëse në shtetin ku pretendohet të hyhet në partneritet, funksionon siç duhet ligji, ekzistojnë procedura transparente gjatë tenderimeve, si dhe a garantohet prona private dhe marrëveshja që njëherë arrihet midis dy palëve.
Një studim[29] tregon se tre nga shtetet që u futën së fundmi në BE , Bullgaria dhe Rumania, kishin treguar një nivel të lartë të decentralizimit lidhur me shërbimet publike. Nga njëra anë kjo nënkuptonte një liri më të madhe për pushtetet lokale, por nga ana tjetër kjo shkaktonte një paqartësi lidhur me kompetencat e nivelit lokal dhe atij rajonal në këto shtete. Megjithatë, që të tre këto shtete kishin arritur një progres të dukshëm lidhur me reformat ligjore, të cilat kishin krijuar një ambient më të favorshëm për sektorin privat dhe si rezultat përfitim nga lehtësimet e tyre buxhetore lidhur me investimet publike.

IV. Partneriteti publiko privtat – rasti Maqedonisë

Ky punim shkencor merr në konsideratë dy projekte të partneritetit publiko privat me synim ndikimin e tyre në politikat fiskale të buxheteve komunale. Njëri rast është realizuar në qytetin e Strumicës, ndërsa tjetri ka të bëjë me qytetin e Shkupit, I cili për mungesë strategjie nuk ishte reazliauar. Megjithatë, punimi shkencor ka për synim të sjellë "dy anët e medaljes", për të mesuar si nga pësimet, ashtu edhe nga sukseset.

1. Ndërtimi i tregut në qytetitn e Strumicës

Në vitin 2006 Komuna e Strumicës filloi me realizimin e projektit Rikonstruktimi dhe mbindërtimi i Tregut të qytetit, sipas parimit të partneritetit publiko private. Për këtë qëllim komuna shpalli tenderin për zgjedhjen e investuesit për ndërtimin e tregut të qytetit në të cilin ishte zgjedhur kompania nga Strumica "Deluks inxhinjering". Investimi i plotë në këtë objekt i investuar nga ana e investuesit është mbi 15.000.000 euro. Investuesi kishte obligim që të realizojë projektin për 24 muaj dhe për të njëjtën dorëzoi garanci bankare. Për vetëm 17 muaj prej fillimit të punëve të ndërtimtarisë, objekti ishte lëshuar në përdorim.
Objekti u ndërtua sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare. Ai përmban: - pjesën e mbyllur të tregut të qytetit– sipërfaqe afariste për– ashensorë për mallra me peshë të madhe si dhe për livrimin e mallrave nëpër kate – garazh në kat me kapacitet prej 380 vetura të lehta.Objekti ka hapësirë të përgjithshme prej 40.000 m², paraqet objektin më të madh në Strumicë.

[29]Olena Maslyukivska, 2006, Review of the national policy, legislative and institutional environment necessary for the establishment of municipal public private partnerships (PPPs) for public service delivery and local development in the Europe and CIS region. p. 3

Nevojat për një investim të këtillë buronin nga tregu i mëparshëm i qytetit në Strumicë, i cili ishte ndërtuar në vitin 1963 dhe me kalimin e kohës, tregu nuk i plotësonte më kushtet për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe produkteve ushqimore të zonës. Komuna duhej të bënte një zgjidhje, duke investuar nga buxheti komunal, apo duke kërkuar mundësi shtësë që do ta lehtësonin buxhetin komunal nga ky synim.
Në vitet e nëntëdhjeta ishte miratuar plani detal urbanistik për këtë pjesë të qytetit ku ishte parashikuar ndërtimi i tregut bashkëkohor. Ndërtimi i objektit ishte planifikuar në atë mënyrë që të zgjidhte edhe problemin e parkingut të qytetit të Strumices, me çrast do të ndërtohej garazhi në kat në objektit e njëjtë të tregut.
Impaktet pozitive të këtij projekti publiko-privat ishin hapja e të paktën 1.000 vendeve të reja të punës, duke përmirësuar edhe klimën e biznesit në qytetin e Strumicës. Komuna rriti buxhetin për vitin 2007 me 100.000 euro nga pagesa e kompensimeve komunale nga ana e këtij objekti, ndërsa përfitoi edhe 500.000 Euro që u gjeneruan nëpërmes tatimeve. Më tutje, implikimi pozitiv mbi buxhetin e komunës është edhe nga tatimi personal i 1.000 vendeve të reja të hapura të punës. Një impakt indirekt që siguroi ky projekt është kontributi për buxhetin qendror, ku nëpërmjet grumbullimit të tatimeve të ndryshme mendohet se grumbullohet rreth 3.000.000 euro në vit.
Ky projekt i Partneritetit Publiko-Privat ishte zgjedhur si praktika më e mirë në Maqedoni dhe kishte marrë çmimin e parë nga EAR (Agjencioni për Rindërtim i Komisionit Europian).[30]

2. Përmirësimi i ujësjellësit në qytetin e Shkupit

Projekti ishte iniciuar nga ana e qeverisë së Maqedonisë në vitin 2001, si dhe tregon për një tentim të pasuksesshëm për të hyrë në partneritetin publiko privat. Projekti parashikonte një angazhim të qeverisë me 32.8 milion $ amerikan. Vlera e përgjithshme e projektit ishte vlerësuar në 50.1 mil $, prej të cilave 19.7 mil hua nga EBRD (Banka Ekonomike për Ripërtëritje dhe Zhvillim) , 13.1 mil nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim IDA, 8.9 mil shumë e garantuar nga NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi i Shkupit, si dhe 0.8 mil mjete nga NP Higjiena Komunale e Shkupit.
EBRD kishte ofruar kushte shumë të favorshme kreditimi, me grejs periudhë 5 vjet, dhe afat pagese 20 vjet me interes vjetor prej 4.7%. Gjithashtu IDA kishte ofruar norma interesi prej 0.75%, me afat pagese prej 35 viteve dhe grejs periudhë prej 10 viteve. Mirëpo mjetet e parashikuara nga dy ndërmarrjet publike si Ujësjellësi ashtu edhe Higjiena e Shkupiy nuk kishin gjasa të siguroheshin. Qëllimi primar i projektit ishte përmirësimi operativ dhe më efikas i Ndërmarrjes Publike të Ujësjellësit, me çrast do të sigurohej një kualitet më i mirë për popullatën.
Projekti paraqiste gjithashtu krijimin e një kompanie të përbashkët publiko private, me dominim 51% të kapitalit nga kompania huaj. Një prej pikave që parashihej në projektin në fjalë, ishte edhe lëshimi nga puna i punëtorëve si tepricë teknologjike, ndërsa qyteti i Shkupit do t'i marrte përsipër obligimet për dëmshpërblimin e tyre që dilnin nga ndërprerja e detyrueshme e marrëdhënieve të punës. Megjithatë, qyteti i Shkupit nuk dispononte me mjete të mjaftueshme dhe kjo barrë sërish do të binte mbi supet e qeverisë. Këto ishin edhe disa prej arsyeve që filluan disa shkresa negative të dalin nëpër media, përfshi edhe rrolin e Sindikatës së punëtorëve që u aktivizua mbi çështjen e punëtorëve. Qyteti i Shkupit nuk tregoi ndonjë strategji si të menaxhojë me rastin, apo se si do ta zgjidhë çështjen e punëtorëve të rrezikuar. E gjithë kjo situatë, solli që projekti edhpse shumë afër realizimit të mos rezultonte me sukses.[31]

[30] *Stojan Dinev dhe Kiril Partallov, Komuna Strumicë, Praktikat e Vetëqeverisjes Lokale në RM, BNJVL*
[31] *Dokumentacioni i njësisë për prokurim publik pranë qytetit të Shkupit për vitin 2008, f.18*

V. Perfundimet

Ky punim vjen në përfundim se partneriteti publiko privat, është në funksion të politikave fiskale, qofshin ato lokale apo nacionale. Përpjekjet e përbashkëta të dy sektorëve (publik dhe privat), janë kruciale për të iniciuar projekte publike. Ky partneritet është i domosdoshëm për tejkalimin e gjendjes aktuale në shtetet më pak të zhvilluara, sic është Maqedonia, dhe është në frymën e iniciativave të sukseshme të Bashkimit Europian.

Partneriteti publiko privat mundet të shfrytëzojë si fondet e brendshme, ashtu edhe fondet e huaja për qëllime zhvillimore dhe në kohë të njëjtë lehtësime buxhetore. Fondet të cilat shkojnë në favor të iniciativave publike, vijnë nga institucione financiare të cilat ofrojnë kredi, apo investime tjera.

Duka pasur parasysh modelet e partneritetit publiko privat dhe efektet ekonomike të cilat munden të gjenerojnë këto skema, mundemi të themi se impakti fiskal është pozitiv nga PPP-të, i cili ndikon në gjenerimin e të ardhurave fiskale nga tatimet që realizohen nga projektet si dhe lehtësime buxhetore në investimet e infrastukturës publike.

Bibliografia

1. Dokumentacioni i njësisë për prokurim publik pranë qytetit të Shkupit për vitin 2008
2. Enti statistikor i Republikes se Maqedonise.
3. Facilitating Public Private Partnership for Accelerated Infrastructure Development in India, 2006
4. Guidelines for successful PPP, EC Directorate General , Regional Policy March 2003, Bruksel
5. Ian Taylor, 2000,Public-Private Partnerships: Lessons from the MDC Toll Road,
6. Olena Maslyukivska, 2006, Review of the national policy, legislative and institutional environment necessary for the establishment of municipal public private partnerships (PPPs) for public service delivery and local development in the Europe and CIS region.
7. Pre-accession Economic Programme 2011 – 2013 Macroeconomic Policy, Public Finances and Structural Reforms Ministry of Finance of the Republic of Macedonia
8. Publikimi i Kombeve të Bashkuara Komisionit Ekonomik për Europë, no 84 , Shtator 2004,
9. Stojan Dinev dhe Kiril Partallov, Komuna Strumicë, Praktikat e Vetëqeverisjes Lokale në RM, BNJVL
10. UN Publication on PPP for infrastructure development, 2000, New York
11. World Bank, M. Sohail, B. Gentry & O. Maslyukivska, (tek UNECE)

Dr. sc.Shefket Jakupi
Kolegji "Iliria" Prishtinë, Kosovë

3 Rëndësia e qeverisjes së mirë publike në çështjet tatimore dhe buxhetore

Abstract

Fiscal policy is the use of government spending and taxes that affect economic activity.Fiscal policy can be expansionary or restrictive. Determination of fiscal policy in a given year actually takes into account the limits of the past (the current socio - economic status),and the implications for the future (fiscal stability) .An expansionary fiscal policy means the abbreviation of direct and indirect taxes and increase government spending . These policies will encourage more spending and boost economic activity While fiscal policy tightening will mean tax increases and government spending cuts.These policies will reduce the level of aggregate demand and help reduce inflation. Choose between two types of fiscal policy is not an easy decision , both in terms of the current state of the economy , as well as political decisions
.

***Keywords** : fiscal policy , tax policy , government spending , taxes and budget deficits*

Abstrakt

Politika fiskale është përdorimi i shpenzimeve dhe taksave qeveritare të cilat ndikojnë aktivitetin ekonomik. Politika fiskale mund të jetë ekspansioniste ose shtrënguese. Përcaktimi i politikës fiskale në një vit të dhënë kohor faktikisht merr parasysh si të kaluarën (gjendjen aktuale social-ekonomike),ashtu edhe implikimet për të ardhmen (qëndrueshmërinë fiskale).
Një politikë fiskale ekspansioniste do të thotë shkurtim i taksave direkte dhe indirekte si dhe rritja e shpenzimeve qeveritare. Këto politika do të inkurajojnë më shumë shpenzimet dhe do të rrisin aktivitetin ekonomik.
Ndërsa një politikë fiskale shtrënguese do të thotë rritje taksash, si dhe shkurtim të shpenzimeve qeveritare. Këto politika do reduktojnë nivelin e kërkesës agregate dhe ndihmojnë në uljen e inflacionit. Të zgjedhësh midis dy tipeve të politikës fiskale nuk është një vendimi i lehtë, si përsa i përket gjendjes aktuale të ekonomisë, ashtu edhe vendimeve politike.

Fjalë kyçe:politika fiskale,politikat tatimore, shpenzimet qeveritare,taksat dhe deficit buxhetor

Hyrje

Aktualisht qeveritë e vendeve përballen me probleme shumë të mëdha financiare për shkak të normave tepër të ulëta të punësimit, niveleve të larta të punës së padeklaruar, disiplinës së ulët financiare dhe një mungese të barazisë dhe efikasitetit në çështjet tatimore. Si rrjedhojë, këto qeveri varen në një shkallë të caktuar nga mbështetja e institucioneve europiane dhe ndërkombëtare financiare për caktimin e buxheteve të tyre. Kjo situatë është e paqëndrueshme në planin afatgjatë. Projektimi dhe zbatimi i suksesshëm i një sistemi të qëndrueshëm tatimor kërkon praktika të qëndrueshme dhe të konsoliduara të qeverisjes së buxhetit publik.

Qeverisja efektive publike duhet të ofrojë:

- koherencë midis objektivave të ndryshme të politikave;
- një mjedis në të cilin njerëzit trajtohen me drejtësi dhe barazi.

Qeverisja e mirë publike në fushën e buxhetimit publik dhe manaxhimit financiar kërkon:

a) transparencë fiskale, duke nënkuptuar një proces të hapur fiskal (për shembull, me informacion për de-buxhetimin e shpenzimeve ose për mandatet e dhëna qeverive nënqendrore) dhe informacion në lidhje me faktorët ekonomikë të përdorur për krijimin e buxhetit (shpesh qeveritë përdorin llogaritje mjaft optimiste të zhvillimit ekonomik);

b) përgjegjësi, duke nënkuptuar kontroll të pavarur për shpenzimet, manaxhimin financiar dhe respektimin e procedurave (për shembull prokurimi publik), me qëllim shmangien e abuzimit të pushtetit nga individë ose grupe të caktuara;

c) përgjegjshmëri, duke nënkuptuar kapacitet për t'u përgjigjur në mënyrë fleksibël ndaj ndryshimeve të paparashikuara kombëtare ose ndërkombëtare (për shembull më të ulëta sesa rritja e parashikuar ekonomike);

d) të orientuara ndaj të ardhmes, duke nënkuptuar marrjen tërësisht parasysh të kostove të ardhshme (borxhi publik, plakja e popullsisë) dhe duke njohur pasojat e ardhshme fiskale të politikave aktuale (për shembull në fushën e punësimit publik) dhe sjelljen (për shembull degradimi mjedisor) me qëllim mosvendosjen e barrave të rënda ndaj brezave të ardhshëm.

Qeverisja e mirë në fushën e politikave buxhetore dhe tatimore - si në nivelin politik, institucional dhe burokratik - mund të funksionojë vetëm nëse ka një kulturë mbështetëse për sjelljen, në përputhje me rregullat e orientuara drejt interesit publik.

Objektivat e politikës tatimore

Të ardhurat e mjaftueshme tatimore janë të nevojshme për të garantuar demokracinë, rendin publik dhe funksionimin e sistemit ligjor.

Tatimi modern duhet të jetë më shumë sesa thjesht burim të ardhurash për funksionimin e shtetit: tatimi duhet të garantojë gjithashtu që autoritetet publike të kontribuojnë në mënyrë aktive për ndjekjen e synimeve të politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Një rrjet i duhur rrugor, një sistem efikas i transportit publik, një shërbim modern shëndetësor dhe ofrimi spitalor, një sistem i përshtatshëm i politikave arsimore, të mbrojtjes mjedisore dhe punësimit aktiv si dhe trajnimit profesional kërkojnë injektimin e dozave të mëdha të financave publike.Garantimi i solidaritetit dhe kohezionit social në shoqëri kërkon transferime të mëdha sociale dhe nevoja tatimore për të luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm. Më tej, tatimi është një instrument për të ndikuar tek sjellja e njerëzve, për shembull në fushën mjedisore ose në lidhje me plakjen aktive (shpërblimi në punë).

Politikat tatimore nuk duhet të jenë instrumente konkurrence për qeveritë, me qëllim tërheqjen e investimeve. Politika të këtij lloji çojnë në konkurrencë tatimore dhe dëmtojnë synimet bazë të politikave tatimore.

Politikat tatimore

Politikat tatimore duhet të përmbushin një sërë kriteresh të rëndësishme:

Para së gjithash, tatimet duhet t'i nënshtrohen marrëveshjes/ujdisë me partnerët socialë në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelin evropian. Në veçanti në kuadrin e barrës së rëndë tatimore të përballuar prej tyre, punëtorët dëshirojnë të kenë fjalën e tyre në përcaktimin e politikës tatimore.

Së dyti, tatimet duhet të konceptohen në mënyrë të drejtë, me qëllim që të garantohet barazi e taksave. Aktualisht, të ardhurat e punës tatohen shumë më tepër në krahasim me konsumin dhe të ardhurat nga kapitali.

Për më tepër, puna e shpërblyer me pagë tatohet më shumë në krahasim me vetëpunësimin si rezultat veçanërisht i një lirie veprimi të konsiderueshme që gëzohet nga të vetëpunësuarit dhe anëtarët e profesioneve në përcaktimin e të ardhurave të tyre të tatueshme.

Së treti, e lidhur ngushtë me çështjen e barazisë tatimore është çështja e efikasitetit tatimor. Nuk është e mjaftueshme që sistemi tatimor duhet të projektohet në mënyrë të barabartë: ai gjithashtu duhet të operojë me efektivitet dhe vendosja e taksave duhet të garantohet nga procedura që funksionojnë realisht.

Së katërti, tatimi duhet të jetë edhe funksional, dmth, masat tatimore duhet të konceptohen në mënyrë të tillë që të çojnë në arritjen e qëllimeve të synuara.

Së pesti, sistemi tatimor duhet të jetë i thjeshtë dhe transparent, i lehtë për t'u administruar, duke i dhënë mundësinë autoriteteve tatimore të përqendrojnë përpjekjet e tyre në punën e verifikimit dhe kontrollit. Transparenca duhet të jetë e tillë që t'u japë mundësinë taksapaguesve të kuptojnë logjikën dhe mekanizmat e sistemit.

Së gjashti, sistemi tatimor duhet të jetë në përputhje edhe me politikat e tjera të realizuara.

Së shtati, tatimi duhet të respektojë parimet e specificitetit dhe subsidiaritetit, domethënë secilës prej niveleve të ndryshme të qeverisë duhet t'i jepen kompetencat e veta për vendosjen e taksave në përputhje me përgjegjësitë e tyre dhe natyrën e problemeve.

Taksat që prekin drejtpërdrejt ose që preken drejtpërdrejt nga sjellja e Shteteve të tjera Anëtare duhet t'i nënshtrohet rregullave bazë të pranuara në nivel europian dhe ndërkombëtar. Shembuj të këtyre lloje taksash janë, për shembull, taksat e korporatave dhe taksat për të ardhurat nga kursimet (interesat, dividendët).

Politika fiskale dhe rritja ekonomike

Lidhja makroekonomike midis politikës fiskale[32] dhe rritjes ekonomike për shumë kohë ka tërhequr vëmendjen e ekonomistëve. Fatkeqësisht, studimet e kryera në lidhje me këtë lidhje kanë rezultuar të dështuara. Një nga shkaqet kryesore të këtij dështimi vjen për shkak të pamundësisë për të ndërtuar një tregues të politikës fiskale.

Treguesit kryesor të politikës fiskale janë:

- shpenzimet qeveritare,
- taksat dhe
- deficit buxhetor.

[32] *Xhenet Syka,"Ndikimi i politikave fiskale të qëndrueshme në ngritjen e mirëqenies sociale të vendit",f.208*

Por literatura ekonomike nuk favorizon asnjërin nga këta tregues si përfaqësuesi më i denjë i politikës fiskale.
Në literaturën ekonomike asnjë nga komponentët e politikës fiskale,taksat, shpenzimet qeveritare dhe deficiti buxhetor nuk tregojnë korelacion të fortë me rritjen ekonomike kur ata analizohen të veçantë.
Pavarësisht se nuk është gjetur një lidhje e qëndrueshme empirike midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike, roli i politikës fiskale në zhvillimin ekonomik është thelbësor.
Teorikisht pranohet se një politikë fiskale ekspansive do të rrisë kërkesën agregate e cila do të rezultojë me rritje të prodhimit.
Një rol tepër të rëndësishëm që luan politika fiskale në rritjen ekonomike është ndikimi i saj në stabilizimin makroekonomik.
Një ekonomi me një mjedis makroekonomik të paqëndrueshëm, në një botë me kontrata nominale, do të rrisë riskun e marrëveshjeve afat gjata, duke ndikuar kështu në reduktimin e prodhimit. Një nga treguesit kryesorë me ndikim të ndjeshëm në luhatshmërinë e prodhimit është niveli i ndryshueshmërisë së çmimeve.
Një ekonomi me një normë inflacioni të paqëndrueshme dhe të lartë do të rrisë koston e biznesit duke ndikuar negativisht në aktivitetin ekonomik.
Politika fiskale mund të ndikojë në nivelin e inflacionit nëpërmjet shumë kanaleve, si nëpërmjet nivelit të taksave ashtu edhe nëpërmjet nivelit të konsumit publik dhe nivelit të defictit buxhetor.
Sipas vlerësimeve të FMN–së, roli i politikës fiskale gjatë dekadës së fundit ka luajtur një rol të rëndësishëm në stabilizimin makroekonomik duke rezultuar me një normë inflacioni të ulët dhe nivel të borxhit publik që vlerësohet i qëndrueshëm.
Një rol të konsiderueshëm në zhvillimin ekonomik afatgjatë ka patur edhe procesi i decentralizimit fiskal. Ky proçes ishte projektuar të ndikonte si në rritjen e përdorimit të fondeve buxhetore, ashtu edhe në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor.

Qëndrueshmëria e politikave fiskale

Qëndrueshmëria fiskale[33] është një nga treguesit më të rëndësishëm të vlerësimit të politikës fiskale..Një politikë fiskale e qëndrueshme do të thotë që borxhi publik në termat e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nuk ka prirje pozitive.
Megjithatë, literature teorike fokusohet në atë që politika korente fiskale mund të ndiqet për një periudhë të pacaktuar pa ndikuar në fuqinë paguese të qeverisë, e cila nuk nënkupton domosdoshmërisht që borxhi publik duhet të mos ketë prirje pozitive.
Një kriter tjetër për të vlerësuar nëse një politikë fiskale është e qëndrueshme apo jo është edhe kushti që norma e parashikuar e rritjes së borxhit publik duhet të jetë më e vogël se norma e interesit gjatë një periudhe afatgjatë.
Niveli i borxhit publik ka qenë dhe është një çështje e debatueshme edhe për Bashkimin Europian. Niveli i borxhit publik është një nga kushtet e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike, i nënshkruar në vitin 1997 si element i Traktatit të Maastricht.
Vendet e BE që kanë nënshkruar këtë pakt nuk lejohen të kalojnë nivelin e borxhit publik mbi 60% e PBB, dhe ato vende që e kanë më të lartë duhet të bëjnë përpjekje për ta ulur.
Ky nivel është rezultante e disa llogaritjeve matematikore bazuar në literaturën makroekonomike, dhe gjithashtu është objekt diskutimi dhe debatesh, por ai na jep sinjalin që nivelet e borxheve publike duhet të studiohen me kujdes nga politikëbërësit.

[33] *Xhenet Syka,"Ndikimi i politikave fiskale të qëndrueshme në ngritjen e mirëqenies sociale të vendit",f.208*

Borxhet publike shfaqen pasi qeveritë kryejnë më shumë shpenzime se niveli i të ardhurave të tyre korente. Gjatë viteve të tranzicionit, të gjitha qeveritë e shumta në vendin tonë kanë operuar me nivele shpenzimesh më të larta se niveli i të ardhurave. Situata ekonomike e sociale mbi të cilën filloi epoka e re drejt ekonomisë së tregut e bënte të pashmangshme ndërhyrjen e shtetit në ekonomi nëpërmjet subvencioneve dhe investimeve publike.
Përsa i përket borxhit publik të brendshëm, politika fiskale e ndjekur gjatë viteve të fundit dhe tendenca për vitet në vazhdim do të prodhojnë një nivel borxhi publik që do të vijë gjithnje e në ulje. Gjatë viteve të tranzicionit rreth 40 % e investimeve publike janë financuar me burime të huaja. Financimet e huaja për vendet ballkanike kanë qënë në formën e ndihmave dhe kredive të buta, për shkak të nivelit të ulët të të ardhurave për frymë që ka karakterizuar ekonominë tonë gjatë këtyre viteve. Megjithëse niveli i borxhit të huaj është në nivele relativisht të ulta, komercializimi i tij do të rezultojë me rritje të kostos së këtij financimi.
Qëndrueshmëria e nivelit të borxhit të huaj nuk shihet e kërcënuar në kushtet kur rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi 4%,niveli i remitancave për një periudhe relativisht afatgjate parashikohet mbi 10% e PBB dhe eksportet parashikohen në rritje.
Megjithatë absorbimi i financimeve të huaja (rritje borxhi) nga qeveria duhet të jetë i studiuar mirë duke u përqëndruar në sektorët që ndihmojnë rritjen ekonomike dhe rrisin aftësinë konkuruese të vendit.

Politika fiskale dhe mbrojtja sociale

Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve publike dhe taksave qeveritare ndërmerren për të arritur objektiva specifike dhe jo thjesht për shkak të efektit të tyre fiskal. Një nga sektorët që kohët e fundit ka marrë një rëndësi të veçantë është mbrojtja sociale dhe veçanërisht financimi i fondeve të pensionit.
Politika fiskale[34] luan një rol të rëndësishëm në çështjet sociale të një vendi. Një vend me një nivel varfërie të lartë detyron qeveritë që një pjesë të të ardhurave të mbledhuara nga takspaguesit të drejtohen në këto shtresa.
Një ekonomi me një nivel të lartë varfërie, e bën zgjedhjen e politikave fiskale/buxhetore më të vështirë. Politika fiskale ndikon në reduktimin e varfërisë si nëpërmjet rritjes ekonomike, ashtu edhe nëpërmjet politikave rishpërndarëse.
Përveç nivelit të varfërisë, plakja e popullsisë dhe rritja e normës natyrore të papunësisë konsiderohen si faktorë negativë në nivelin e shërbimeve publike dhe nivelin e deficitit buxhetor. Plakja e popullsisë e bën të vështirë financimin e fondeve të pensioneve, problem me të cilin po përballen shumë vende të Evropës Perëndimore. Përgjigjja ndaj këtij fenomeni ka qënë rritja e moshës së pensionit dhe mbështetja për fuqizimin e fondeve private të pensioneve.
Mosha e daljes në pension për shumicën e shteteve te OECD (Organisation for Economic Cooperation and Development) është 65 vjeç, por pothuajse në të gjitha shtetet mosha mesatare *de facto* e daljes në pension është më e vogël. Për disa shtete të OECD mosha e daljes në pension në gjysmën e 90-ës e deri tani për gratë ishte 56 - 57 dhe për burrat 59 vjeç.
Kombinimi i skemave të pensioneve shtetërore dhe private klasifikohet si një masë për financimin e periudhës së pensionit. Politika sociale në vendin tonë nuk është se nuk ka qenë në vëmendjen e politikës fiskale që me fillimin e tranzicionit.
Në një moment të caktuar rruga drejt një ekonomie tregu intensive, filloi me një rënie të madhe të prodhimit, norma e inflacionit ishte treshifrore dhe papunësia u rrit ndjeshëm. Kjo situatë detyroj qeverinë që të rriste transferimet / subvencionet për shtresat që u goditën më shumë nga ky ndryshim.

[34] *Xhenet Syka,"Ndikimi i politikave fiskale të qëndrueshme në ngritjen e mirëqenies sociale të vendit",f.213*

Edhe sot, shpenzimet sociale përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të shtetit. Financimi i fondeve të pensioneve në vendin tonë ka ardhur duke u rritur,si për shkak të rritjes së politikave sociale që ka ndërmarrë qeveria për grupe të ndryshme shoqërore, ashtu edhe të rritjes së numrit të pensionistëve.

Përfundimet e politikave

Sistemet tatimore në Shtetet[35] Anëtare të BE-së, kanë më shumë ndryshime sesa ngjashmëri. Ndryshimet vazhdojnë jo vetëm në lidhje me të ardhurat totale tatimore por edhe në lidhje me strukturën tatimore, normat e taksave dhe përcaktimet e bazave tatimore.

BE-ja ka mundur të harmonizojë në një farë shkalle bazën tatimore dhe normat e taksave (TVSH, tatimet për akcizën),ndryshimet mbeten.

Veçanërisht në fushën e taksave direkte dhe në veçanti taksat korporative dhe taksat e tjera të kapitalit, BE ka bërë shumë propozime por jo aq shumë progres ndaj një politike të përbashkët tatimore.

Arsyeja kryesore për këtë situatë është se vendimet e politikës tatimore në BE kërkojnë unanimitet në Këshillin e Ministrave dhe qeveritë kanë tendencën të konsiderojnë taksat (dhe mbrojtjen shoqërore) dhe në veçanti taksat korporatave, si njëinstrument të politikës kombëtare ekonomike.

Në mënyrë që të rritet efikasiteti i sistemit të taksave, duhet të trajtohen evazioni fiskal dhe mashtrimi tatimor. Masa të ndryshme mund të kontribuojnë për të përmirësuar mbledhjen e taksave dhe për të rritur përputhshmërine:

- Përmirësimi i kapaciteteve të administratës tatimore;
- Investimi në rekrutim, trajnim dhe pajisje moderne të inspektorëve tatimore dhe sociale (IPA ka fonde në dispozicion për ngritjen e kapaciteteve);
- Kontrolli i rregullt i llogarive të kompanive dhe të bankave (në BE, bankat do të jenë të detyruara që nga 2015 të raportojne përfitimet e tyre dhe taksat e paguara sipas vendeve);
- Të gjitha pagat dhe shpërblimet duhet të paguhen nëpërmjet llogarive bankare, asnjë shperblim fund-viti pa llogari bankare);
- Të gjitha transaksionet tregtare mbi 500 € të detyrueshme nëpërmjet llogarive bankare;
- Analizimi i të dhënave, përputhja e të dhënave dhe komunikimi i të dhënave: organizimi i lidhjes së të të dhënave të ndryshme, p.sh. ndërmjet të ardhurave të deklaruara dhe të dhënave mbi shpenzimet nëpërmjet kartave te kreditit midis regjistrit tq punësimit dhe fondeve të sigurimeve shoqërore; ndërmjet të ardhurave të deklaruara dhe regjistrimit të makinave apo apartamenteve, etj
- Detyrimi për të regjistruar punonjësit para se të fillojnë punën;
- Krijimi i një regjistri qendror të të gjitha llogarive bankare dhe kontrolli i llogarive bankare në rastin e indikacioneve të mashtrimit tatimor;
- Kontrolli i shtrënguar për transaksionet në fusha të caktuara të ndjeshme ekonomike: antikitete, arti,ari, argjendaria;
- Përfshirja në formularin e deklarimit tatimor vjetor të një pyetjeje, nëse personi ka një llogari bankare apo sigurim jashtë vendit;
- Rregullimi dhe mundësitë e amnistisë për riatdhesimin e kapitalit, me penalitete të arsyeshme financiare;
- Marrëveshjet reciproke automatike të shkëmbimit të informacionit me autoritetet tatimore të huaja mbi të ardhurat e jorezidentëve.

[35] *Martin Hutsebaut,Politikat tatimore sipas këndvështrimit Europian,,f.14*

Konkluzione

1. Integrimi në BE është një proces i udhëhequr nga standardet, i cili përmes formave të ndryshme të komunikimit, kërkon nga vendet e mundshme kandidate të fokusohen si dhe të krijojnë standarde të rëndësishme të ndërtimit të shtetit dhe institucioneve. Megjithatë, për qeveritë shpesh është mjaftë i komplikuar investimi në standarde që avancojnë shtet-ndërtimin dhe forcojnë praktikat e qeverisjes së mirë, sidomos lidhur me praktikat e planifikimit të buxhetit.
2. Arsyeja kryesore ndërlidhet me faktin se partitë politike në pushtet e humbasin monopolin e tyre mbi sjelljet e qeverisë dhe administratës.
3. Në vendet në tranzicion, elitat politike përshtatin buxhetin shtetëror për nevojat e tyre politike/partiake me qëllimin përfundimtar që të sigurojnë kontroll afatgjatë mbi administratën shtetërore, dhe kështu shmangin krijimin e mekanizmave që mund të pengojnë mundësinë e partive të tyre që të mbështesin monopolet dhe interesat partiake.
4. Planifikimi i buxhetit është një tregues i zotimit të zbatimit të politikave shtetërore, dhe si i tillë duhet të korrespondoj me prioritetet e politikave të shtetit. Në veçanti, buxheti shpreh zotimin e qeverisë ndaj një politike, dhe normalisht tregon nivelin e prioritetit që i është vendosur.
5. Një përcaktues i rëndësishëm i suksesit të një vendi të caktuar në adresimin e standardeve të politikave evropiane është niveli i ndërlidhshmërisë dhe mbështetjes së prioriteteve evropiane me buxhetin shtetëror.

Rekomandime

1. Analiza e Politikës fiskale të jetë një raport me këshilla politike të cilat synojnë të ndikojnë mjetet kyçe përmes të cilave bëhen vendimet e politikave në nivelet lokale si dhe ato qendrore të qeverisë.
2. Qëllimi i Analizës së Politikave fiskale është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, për të shqyrtuar argumentet e ndërlidhura me politikën përkatës, dhe të analizojë zbatimin e asaj politike.
3. Zgjedhja e politikës fiskale duhet të jetë një nga çështjet më të debatueshme të rolit të qeverisë në jetën ekonomike sociale të një vendi, jo vetëm nga ekonomistët, por nga një gamë më e gjerë njerëzish.

Bibliografia

1. Alvaro Riascos Banco and Carlos A. Vegh “Procyclical Government Spending in Developing Countries: The Role of Capital Market Imperfections” IMF Working Paper, 2008.
2. Ames, B., Brown, W., Devarajan, Sh., and Izquierdo, A.“Macroeconomic Policy and Poverty Reduction” IMF and World Bank, 2007
3. Dokumeta dhe Materiale të Ministrisë së Financave, Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, EBRD, OECD, PNUD (2012)
4. Dong Fu, Lori L. Taylor, Mine K. Yücel “Fiscal policy and growth” Federal Reserve Bank of Dallas, Working Paper 0301, 2006
5. Eurostat.http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal
6. Martin Hutsebaut,Politikat tatimore sipas këndvështrimit Europian
7. Xhenet Syka,**N**dikimi i politikave fiskale të qëndrueshme në ngritjen e mirëqenies sociale të vendit

Dr. Bajram Fejzullahu
Kolegji Universitar " Vizioni për Arsim" - Ferizaj

4 Shqyrtime teorike mbi filozofinë e pronës dhe pronësisë hap drejtë privatizimit

Abstrakt

Me vetë aktin e lindjes qeniet njerëzore marrin karakterin e pronarit. Ata kanë të drejtën në pronë së paku të paisjeve të cilat janë të dedikuara për ata si veshëmbathja, pisjet e ushqimit etj. Me kalimin e kohës vie deri te rritja e pronës së tyre. Nga kjo arrihet në konstatim se prona është kategori e të drejtës natyrore e cila i takon individit. Format e rritës dhe krijimit të sjë janë ndër ma të ndryshmet: filluar nga trashëgimi e deri te përvetësimi me forma të dhunshme.Një ndër format pronësore mjaft specifike ishte "prona shoqërore" e cila ishte karakteristikë e sistemit socialist, dhe atë konkretisht e ish Jugosllavisë. Procesi i definimit të sajë me ratin e transformimit përmes procesit të privatizimit (sidomos në rastin e procesit të privatizimit në republikën e Kosovës) solli probleme të theksuara. Ku më shumë e ku më pak ajo arrijti që të ketë pronarin e vet. Prona e cila ishte e gjthkujtë dhe e as kujtë, tani ka pronarin e vet, duke abstrahuar format e legjitimitetit të pronarit të ri.

***Fjalët kyçe** : prona, prona shoqërore,privatizimi, shteti, transformimi*

Prona është e drejtë e trashëguar natyrore e njeriut e cila vjen në shprehje me lindjen e tij. Lidhjet korelative duhet vështruar në aspekt të përkatësisë dhe raporteve obligative të cilat krijohen me këtë akt. Deri sa fëmijës të vogël i përket, dhe është pronar i djepit të tij dhe pajisjeve për ushqim dhe mirëmbajtje, kjo krijon edhe marrëdhënie obligative për mbikëqyrësin në mënyrë që fëmijës ti mundësoj qasjen në pronën e tij. Nisur nga një qëndrim i tillë, njeriu që nga lindja, edhe në aspektin pronësor nuk është "tabulla rasa". Kjo ka kuptim nëse konstatohet se njeriu me vetë lindjen e tij është pronar si në aspektin material ashtu edhe në aspektin intelektual.

Filozofia e Hegelit mbi të drejtën dhe të drejtën natyrore bazohet në analizën e të kuptuarit të teorisë dhe zbatimit të filozofisë në aspektin praktik të së drejtës dhe të së drejtës natyrore. Ajo nismë ka filozofinë e pronësisë, filozofinë e pronës (S.Selmanaj 1996). Qasja ndaj një mënyre të tillë ka të bëjë me aspektin juridik. Mirëpo prona ka karakter shumëdimensional si nga aspekti ekonomik, sociologjik, intelektual dhe shumë aspekte të tjera nga të cilat mund të vështrohet ky koncept.

Kur flitet për pronën, për nevoja të hulumtimit tonë, këtë duhet vështruar nga aspekti ekonomik. Këtu kemi të bëjmë me marrëdhëniet pronësore, të drejtat dhe obligimet të cilat rrjedhin nga posedimi dhe krijimi i sajë. Nga kjo rrjedh se prona ka karakter natyror , po ashtu sikur se vetë njeriu. Vetë ekzistenca e njeriut nuk është e mundur pa krijimin e marrëdhënieve prodhuese, para së gjithash ndaj natyrës, pastaj edhe marrëdhëniet tjera të cilat krijohen gjatë jetës. Dinamika e këtij procesi është se çdo kujt i takon çdo gjë, deri sa prona e tërësishme ju takon të gjithëve. Një libër i mirë, edhe pse është pronë e autorit, ajo së bashku me autorin i takon njerëzimit, nga njëra anë, deri sa nga ana tjetër në aspekt individual, njerëzimi i përket edhe atij.Çështje në vete janë format e krijimit të pronës.

Kryesisht janë dy forma;

Në formë natyrore- prona intelektuale dhe materiale e cila mund të krijohet gjatë shekullit të jetesës së njeriut. Kjo nënkupton pronën e cila është krijuar përmes punës dhe trashëgimisë. Në formë të dhunshme, përmes ligjit të forcës- kjo nënkupton përvetësimin e pasurisë dhe pronës në formë të dhunshme me zbatimin e forcës dhe marrjen nga ata të cilëve ajo më herët ju përkiste. Një formë e tillë e përvetësimit vjen në shprehje edhe në kushtet e monopolit. Deri sa në fillim të lindjes së njerëzimit, format e pronës kishin karakter hapësinor në krijimin dhe mbajtjen e jetës, të cilat ishin të shprehura me zbatimin e dhunës (ruajtja e ushqimit dhe hapësira e jetesës), në sistemin feudal krijohen mundësitë e përvetësimit të pronës që nënkuptonte pronën mbi pasuritë materiale e njëherazi edhe ndaj njerëzve. Më vonë kjo formë e pronës përcaktohet dhe merr karakter formal në sistemet ekonomike. Në bazë të interpretimit të së drejtës romake, prona ka kuptim edhe të mundësisë së kontrollit, që ka karakter të pushtetit ndaj sendeve nga ana e individit apo institucionit i cili ka mundësi të marrjes së vendimeve dhe përdorimin e tyre. Në bazë të kësaj, prona është institucion më i rëndësishëm i së drejtës sepse shkalla dhe zhvillimi i qarkullimit, të drejtat e detyrimeve, varen nga prona. Romakët pronën e quajnë ***proprietas*** apo ***dominum***, terme të cilat kanë lindur vonë në shekullin e parë p.e.r. Nga këto shprehje kanë edhe prejardhjen shprehja pronë (nga proprietas).

Romakët pronën e quajnë ***proprietas***. Ndonëse kjo shprehje është paksa e çuditshme, megjithatë paraqet një nga të arriturat e Romakëve në historinë e së drejtës botërore. Në bazë të disa hulumtimeve, popujt e vjetër, përfshirë edhe Grekët, me gjuhën e tyre mjaft të përparuar, nuk kanë ndonjë termin gjithëpërfshirës i cili do të bënte diferencimin në mes potencialit natyror dhe material me të cilin disponon individi, bashkësia apo shteti. Mirëpo kjo nuk do të thotë se ata nuk e kanë pasur të kartë se çka është prona. Ajo ekziston, mirëpo nuk kanë pasur ndonjë termin i cili do të shprehte në tërësi kuptimin e kësaj fjale.
Ekzistojnë dy lloje të pronës: kolektive dhe ajo individuale.
Prona kolektive, ekziston që nga komuniteti i parë, sistemin skllavopronar, feudal, socialist si dhe atë kapitalist, në të cilin paraqiten më shumë titullar pronësor. Vështruar nga aspekti i krijimit të pronës, atëherë arrihet në përfundim se llojet e sajë janë për aq sa janë mënyrat. Te prona kolektive paraqitet më shumë se një titullar. Të drejtat të cilat i kanë pronarët përfshijnë jo vetëm ato që kanë të bëjnë me pronën por edhe për ato që nuk kanë karakter pronësor. Raporti ndaj gjërave dhe sendeve është i përzier me raportin e pushtetit ndaj njerëzve, politikës, ekonomisë etj
Prona individuale apo private, ka vetëm një titullar i cili ka të drejta ekskluzive ndaj sendeve kurse jo edhe të atyre që kanë karakter politik. Mirëpo pronësia ndaj kësaj prone, varësisht nga forma e shfrytëzimit të sajë, pronarit mund ti sjellë privilegje si në aspektin ekonomik, social, andaj edhe politik.
Sipas historisë së drejtës romake, mund të vërehen katër faza të zhvillimit pronësor:

1. Periudha e hershme- paraqet mbetje të pronës kolektive,
2. Familja- paraqet formë të pronës kalimtare,
3. Familja kognate- prona klasike skllavopronare,
4. Elementet e pronës feudale- ku ishte në shprehje gërshetimi i pronës private dhe asaj të sunduesit.

Sqarimet të cilat u cekën më lartë, e të cilat kanë të bëjnë me çështjen e pronës, do të na japin në vazhdim të këtij punimi drejtimin lidhur me procesin e privatizimit sepse këtu në radhë qëparë kemi të bëjmë me ndërrimin e titullarit të pronës. Shqyrtimi i pronës në sistemet ekonomike do të na mundësoj të kuptuarit e sajë në aspekt të pronësisë ndaj mjeteve të prodhimit e cila paraqet bazën shoqërore dhe ekonomike të dominimit. Në bazë të kësaj do të mund të epet edhe një definicion (jo gjithëpërfshirës) i asaj që quhet pronë. Pra ajo" *nuk paraqet gjë tjetër përpos një e drejtë e një njeriu apo grupeve të caktuara të njerëzve për zbatimin e vendimeve lidhur me shfrytëzimin e objekteve pronësore*" (S.Selmanaj 1996)

Pronësia është një institut i lashtë juridik i cili ka lindur me lindjen e vetë të drejtës. Pronësia respektivisht e drejta e Pronësisë paraqet njërin ndër institutet juridike më të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi, respektivisht institutin juridik më të rëndësishëm të të drejtës sendore në veçanti. Rëndësia e saj shprehet me faktin se ajo është objekt rregullimit dhe mbrohet jo vetëm në aspektin ligjor por edhe kushtetues dhe ndërkombëtar. Kështu e drejta e pronësisë gëzon mbrojtje ne aspektin nacional dhe ndërkombëtar. E drejta e Pronësisë është kategori kushtetuese. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës garantohet e Drejta e Pronësisë në nenin 121 paragrafi 1,2,3.

Në rrafshin ndërkombëtar E drejta e Pronësisë garantohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948, dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me Protokollet e saj. Protokolli nr. 1 garanton të drejtën në pronë dhe cek: "*...çdo person juridik apo fizik ka të drejtë në gëzimin e pronës së vet. Askush nuk mund të tjetërsohet nga prona e tij, përpos për interesin publik dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligje të së drejtës ndërkombëtare*"[36]

Në bazë të Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me rastin e hartimit të saj, shtetet nuk kanë mundur të kenë marrëveshje lidhur me mbrojtjen e pronës. Formulimi i cili në fund edhe është aprovuar kufizon të drejtat ndaj pronës dhe në një masë të madhe i jep shtetit të drejtën që të influencoj në këtë të drejtë.

Nga kjo vërehen tri lloje të drejtash të cilat konsistojnë në gëzimin e pronës:

1. E drejta në kontroll,
2. E drejta në përvetësim të rezultateve të cilat janë realizuar në bazë të objektit të pronës,
3. E drejta në tjetërsim, të drejtën për bartje të pronës te të tjerët.

Në bazë të kësaj, prona trajtohet si tërësi e të drejtave. Nëse këto të drejta përkohësisht iniciohen te pronari, apo një grup e tyre, ata shndërrohen në pronar (J.Bajec, L.Joksimoviq). Këto të drejta ndaj pronës vlerësohen si bazë themelore për përcaktimin e pozicionit dominues gjatë procesit të reproduksionit. Gjatë krijimit të pronës materiale, titullarët e sajë, janë para së gjithash pronar ndaj mjeteve të prodhimit. Nga kjo rrjedhin edhe te format dhe llojet e pronës.

Prona private- Në bazë të klasifikimit tradicional, në mënyrën kapitaliste të prodhimit, dominon prona private ndaj mjeteve të prodhimit. Në sistemet etatist dominon prona shtetërore ndaj mjeteve të prodhimit, deri sa në sistemin vetëqeverisës dominonte prona shoqërore .[37]

---

[36] *Aida Grgić, Zvonimir Mataga, Matija Longar i Ana Vilfan- Pravo na imovinu prema Evropskoj Konvenciji o ljudskim pravima- Savet Evrope, 2007 fq..4*

[37] *Kjo formë e pronës e emërtuar si "prona shoqërore" ishte krijesë e ish Jugosllavisë, e cila nuk kishte karakter të qartë ,që nga atëherë e deri në ditët e sotme. Thënë ndryshe, kjo prone ishte "e çdo kujt dhe e askujt". Ky kuptim i dyfishtë gjatë tërë ekzistimit të këtij shteti, mund të thuhet se ka sjell një varg problemesh të cilat janë trashëguar, kështu që këto problem paraqiten edhe tani me rastin e procesit të privatizimit të sajë.*

Prona private është pronë e individit apo korporatës. Në sistemet të cilat e njohin këtë formë të pronës, pronari ka të drejta pronësore, me ç'rast ekziston sistemi i mbrojtjes dhe kufizimet lidhur me shfrytëzimin e saj.
Lidhur me konceptin e pronës nuk ekziston ndonjë definicion i pranuar në aspekt të përgjithshëm. Ngjashëm me konceptet tjera, rëndësia e këtij koncepti nuk është e njëjtë për të gjithë. Shkencat e ndryshme si ekonomia, drejtësia, sociologjia, antropologjia etj. definojnë këtë koncept në forma të ndryshme, të përshtatshme për nevoja të studimit vetanak.
Në aspekt të gjerë, prona ka karakter që paraqet "diçka personale" të dikujt dhe paraqet lidhjet në mes objektit (të mirave) për të cilat individi pretendon se janë të tij. Në shkencat shoqërore kjo ka karakter si "tërësi e të drejtave dhe obligimeve". Në këtë kontest, prona nuk është raport në mes individëve dhe sendeve mirëpo raport në mes individëve që kanë ndaj këtyre sendeve apo objekteve.

Kuptimi bashkëkohor i pronës këtë çështje e vështron si çështje e cila ka të bëjë me pronën personale. Kjo nënkupton individin si person fizik, dhe grupet të cilat si të tilla mund të kenë karakter të korporatave. Ky koncept dallon edhe të mirat publike (ajri,resurset tokësore etj.) të cilat në shumicën e rasteve janë të drejtuara nga qeveritë e vendeve, mirëpo parimisht mund të jenë të shfrytëzuara nga të gjithë. Po ashtu ekziston edhe prona e përbashkët e cila në të shumtën e rasteve i përket bashkësive më të vogla (bashkësive lokale).

Prona private është mjaft e lashtë gjë që e gjejmë edhe në sistemet më të hershme ku pronari e përdor atë dhe realizon interesin e tij si rezultat i pronësisë. Të drejtat pronësore të tanishme janë zhvilluar sipas idesë që prona private është e rëndësishme si e mirë e përgjithshme dhe se është gjenerator i zhvillimit ekonomik.

Me pronësi shpesh kuptohen edhe tërësia e të drejtave të cilat garantojnë pavarësinë lidhur me të. Kjo pavarësi definohet edhe si" e drejtë të patjetërsueshme për shtrirje të autoritetit" posaçërisht në raport me pronën. Kjo nënkupton se e drejta ndaj pronësisë nuk do të thotë edhe pavarësi, në të vërtetë ekziston kufizimi ndaj pronësisë. Në të vërtetë thënia "kjo është pronë e imja dhe mund të bëjë çfarë të dua me të" nuk paraqet një koncept modern ndaj të drejtës pronësore.
Tradicionalisht, të drejtat dhe obligimet nënkuptojnë :

- Kontrollin e përdorimit të pronës,
- Dobitë nga eksploatimi i saj,
- Ndërrimin apo shitjen e pronës,
- Të drejtën e patjetërsueshme ndaj pronës.

Sistemet ligjore kanë evoluar në drejtim të kontrolli të cilat mund të lindin lidhur me të drejtat , përdorimin, operimin, ndarjen ose shitjet të cilat kanë të bëjnë lidhur me pronën dhe pronësinë. Prona private, si një formë e sistemit kapitalist të prodhimit, përfaqëson një grup të drejtash me të cilat shoqëria obligon pronarët, grupet, individët dhe shoqatat e ndryshme për kujdesin dhe racionalizimin e përdorimit të këtyre pronave. Në bazë të kësaj, pronari ka të drejtë që ta shfrytëzoj dhe gëzoj pronën e tij në bazë të ligjeve të përcaktuara.

Bazuar në liritë dhe të drejtat e pronës private, pronarët mund të hyjnë në transaksione të ndryshme me qëllim të maksimizimit të fitimit. Ndërmjetësues në këto çështje është ligji i cili kërkon edhe zbatimin e tij.

Kjo do të thotë se shteti është obligues për mbrojtjen e pronës private dhe pronarëve, kurse ata janë obligues në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga posedimi i pronës në formë të tatimeve dhe formave të tjera të përcaktuara me ligj. E tërë kjo mundëson zhvillimin ekonomik, akumulimin, dhe paraqet shprehje të civilizimit.

Prona shtetërore - Ky lloj i pronës është karakteristikë e vendeve me rregullim shoqëror dhe politik socialist. Ajo ka tretman si pronë e përgjithshme popullore dhe me të qeveris shteti përmes organeve të veta. Rezultatet e prodhimit, në bazë të kësaj forme pronësore, i përvetëson shteti i cili njëherazi përmes sistemit centralist të planifikimit vendos edhe lidhur me shpërndarjen. Nga ky fakt qëndron edhe fuqia dhe dobësia e shtetit. Nga njëra anë ka fuqinë e përvetësimit të rezultateve, kurse nga ana tjetër bënë shpërndarjen jo të barabartë të tyre.

Një nga pyetjet e cila për një kohë të gjatë është shtruar në qarqet shkencore ishte se cila formë e pronës është më efikase; ajo private apo shtetëror. Diskutimet lidhur me këtë çështje kanë vijuar përgjatë një shekulli. Historia deri tani ka dëshmuar se vetëm prona private është themeli i vetëm i shëndoshë i zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye sistemet të cilat mbështeteshin në pronën shtetërore dhe atë shoqërore, ngadalë janë në shuarje të tërësishme.

Teoria bashkëkohore ekonomike vlerëson se prona shtetërore janë njëjtë efikase nëse plotësohen parakushtet mbi tregun e përkryer, informatat e plota dhe marrëveshjet korrekte dhe të përkryera.

Argumentet klasike në favor të pronës shtetërore janë ato të cilat kanë të bëjnë me dobësitë e tregut, respektivisht mbi rrënimin e konkurrencës së përkryer në degët në të cilat vjen deri te rënia e shpenzimeve mesatare, e kjo pastaj sjell deri te krijimi i monopoleve. Pasi që monopolet janë në pronësi private, që paraqet çështje jo të mirë, andaj është mirë që kjo ndërmarrje të jetë në pronësi shtetërore, duke paragjykuar se shteti është qëllim mirë për popullin e vet. Kështu arrihet deri te konstatimi se shumë ndërmarrje ishin nacionalizuar dhe kishin kaluar në monopol të shtetit (pas luftës II botërore)

Ky argument në favor të pronës shtetërore, me kalimin e kohës u zbeh dhe në fund u zhduk. Kjo ndodhi me rastin e proceseve zgjedhore duke vërtetuar se qëllimet e mira të shtetit, politikanëve të dala nga zgjedhjet, nuk ishte konstatim i saktë. Këtë e vërteton edhe e dhëna e hapjes së tregjeve vendore ndaj konkurrencës në nivel global, kurse një hapje e tillë nuk lejonte gabimet e përvjedhur në nivel të tregjeve vendore dhe zvogëlojnë rolin e shteteve të cilat ishin dominuese në këto tregje.

Nga konstatimet e mësipërme, shteti përmes pronësisë dhe instrumenteve të tjera, arrinte të përvetësonte rezultatet e prodhimit dhe pastaj përmes buxhetit shtetëror të mbulonte humbjet deri sa mbetjet ti shpërndaj përmes fondeve investive. Me pronën shtetërore dispononinshteti në emër të popullit përmes punonjësve publik.[38] Në krye të ndërmarrjeve vendoseshin drejtorët në mënyrë centraliste dhe organeve të tjera shtetërore. Mirëpo, nga presioni i kohës, në kushtet e tregut bashkëkohor, shtetet me rregullim socialist filluan të lëshojnë pe në aspekt të kontrollit.Në vendet socialiste përpos pronës shtetërore e cila ka karakter popullor, ekziston edhe prona kooperativiste dhe ajo individuale e cila kryesisht shtrihet në fushën e bujqësisë dhe formave të ndryshme me karakter zejtar. Kooperativat kanë karakter grupor. Kjo formë e pronësisë karakterizohet me jo stabilitet ekzistent dhe ka karakter të përkohshëm.Prona shtetërore në bllokun e vendeve socialiste kryesisht është krijuar si rezultat i konfiskimit të pasurisë nga titullarët e mëhershëm në emër të nacionalizimit, eksproprijimit etj me qëllim që ajo të shpallet si pronë popullore, ku shteti luante rolin qendror në drejtimin dhe shfrytëzimin e saj.

---

38 Pasuria e konfiskuar pas luftës së dytë botërore nga ana e shteteve socialiste në emër të popullit, kanë ndikuar që pronarët e mëhershëm të pamundësohen që të shfrytëzojë pronën e tyre, kurse shteti ishte mëshehur pas parullës "unë nuk kam asgjë, kurse ti i ke të gjitha. Ta ndajmë pasurinë tënde që të kemi të dy."

Përvojat me pronën shtetërore ishin të pavolitshme. Ndërmarrjet shtetërore kryesisht kanë funksionuar jo nga ajo që është pritur. Ato ishin në dëm të arkës shtetërore dhe konsumatorit. Qeverisja jo e mirë dhe të nënshtruara ndaj diktateve politike, organizimi joefikas, numri i madh i punëtoreve joproduktiv, teknologjia e vjetruar, pamundësia konkurruese, ndihma e vazhdueshme nga shteti etj. janë faktor të pamundësisë se ekzistimit të ndërmarrjeve të tilla, andaj edhe të një forme pronësore të tillë.

Prona shoqërore - Prona shoqërore[39] është kategori relativisht e re e të drejtave pronësore andaj edhe analiza e saj është relativisht e re. Nisur nga fakti se kjo kategori e pronës është aplikuar në ish Jugosllavi gjatë viteve 1950, teoricienët duke analizuar këtë formë të pronës kanë cekur se ajo nuk mundet të përfaqësoj një teori të kënaqshme si e tillë me të cilën individi shpronësohet në formë të plotë nga struktura pronësore.

Lidhur me definimin e pronës shoqërore ekzistojnë qasje të ndryshme. Disa teoricien pronën shoqërore e konsiderojnë si pronë e bashkësisë së gjerë (jo e shtetit), bashkësisë së qytetarëve. Me këtë vlerësohet se të gjithë qytetarët janë bashkëpronar dhe nga kjo rrjedh interesimi për rritje dhe zhvillim.

Prona shoqërore lind si pasardhëse e pronës shtetërore[40] në ish Jugosllavi gjatë vënies në jetë të një sistemi i panjohur dhe unik në botë si " sistemi socialist vetëqeverisës". Shikuar historikisht kjo formë e pronës daton nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve të Jugosllavisë me Rusinë me ç'rast prona shtetërore zëvendësohet me pronën shoqërore. Prona publike edhe tutje mbajti karakterin e pronës shtetërore, pronar i së cilës është shteti, kurse te prona shoqërore pronari mbetet i pa definuar[41].

Këtë formë të pronësisë, edhe pse jo e definuar plotësisht, pushteti Jugosllav përmes "vetëqeverisjes" bëri përpjekje që ta perfeksionojnë dhe ti japin formë të qartë. Në bazë të Kushtetutës të vitit 1974 të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Ligjit të Punës së Bashkuar, në ndërmarrjet shoqërore aplikohen dy lloj të drejtave dhe dy lloj marrëdhënieve pronësore:

- e drejta për punë me mjete shoqërore,
- e drejta me diskonim me mjete shoqërore

Bartësit e së drejtës sipas çështjes së parë ishin punëtorët pjesëmarrës në "punën e bashkuar", deri sa bartës të çështjes së dytë ishin personat juridik. E drejta e parë sipas natyrës është e drejtë jo pronësore dhe shprehet si e drejtë vetëqeverisëse e punëtorëve me mjete në pronësi shoqërore, deri sa forma e dytë ruajti formën e vetë pronësore.

---

[39] *Isa Mulaj, Redefining Property Rights with Specific Reference to Social Ownership in Successor States of Former Yugoslavia: Did it Matter for Economic Efficiency? Central European University, Budapest, Hungary, 5 – 7 May 2006 pg. 5*

[40] *Pas luftës së dytë botërore Jugosllavia miratoi Ligjin për vërtetimin dhe ndryshimin për Vendimet në kalimin në pronë shtetërore të pronës së okupatorit, mbi qeverisjen shtetërore të pronës të personave të cilët nuk ishin prezent si dhe me sekuestrimin e pasurisë të cilën okupatori në mënyrë të dhunshme e kishite përvetësuar.*

Neni 1.

Prona e Republikës Federale të Jugosllavisë kalon dhe bëhet pasuri kombëtare : 1) e tërë pasuria e Rajhut gjerman dhe qytetarëve të saj e cila është në Republikën Federale të Jugosllavisë.2) të gjithë personave me kombësi gjermane. 3) e tërë pasuria e kriminelëve të luftës dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, dhe të gjithë personave të cilëve me vendim gjyqësor apo civil ju është konfiskuar kjo pasuri.

[41] *Augestad Knudsen, Privatization in Kosovo:The International Project 1999–2008 NUPI Report pg. 34*

Lidhur me marrëdhëniet pronësore po ashtu ato ishin të dy llojesh:

- ndërmarrjet në vete ishin objekt i pronësisë të cilat përmes akteve të veta përvetësonin dhe bartnin pronën në persona të tjerë.

- Themeluesit e ndërmarrjes ishin kreditor rezident të cilët përvetësonin neto fitimin e ndërmarrjes, merrnin pjesë në shpërndarjen e fitimit, bënin kontrollin ndaj ndërmarrjes dhe sipas nevojës bënin mbulimin e humbjeve. E tërë kjo, në sistemet ekonomike ku prona shoqërore paraqitet si dominuese, punëtorët kanë të drejtë që të qeverisin me ndërmarrjet e tyre dhe të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit mirëpo nuk janë kreditor rezident të ndërmarrjes. Me këtë rast shteti paraqitet si kreditor.

Në bazë të kësaj, në asnjë moment nuk kontestohet pronari nga njëra anë, dhe nga ana tjetër ai përsëri është i pa qartë dhe i papërcaktuar. Kjo bënë të ditur se kjo formë e pronës paraqitet si mjaft komplekse sepse në të njëjtën kohë pronar paraqiten " të gjithë dhe askush" të cilët ishin të shpërndarë " çdo kund dhe askund". Konstatim tjetër i cili mund të shtohet është se kjo formë e pronës para së gjithash kishte karakter politik, kurse në masë fare të vogël atë ekonomik. E tërë kjo ndodhte me qëllim të ruajtjes së "qetësisë sociale", i cili më vonë tregoi se as në aspektin politik, social, ekonomik, etik etj ishte i pa qëndrueshëm, dhe me kalimin e kohës parashtrohet domosdoshmëria e ndryshimeve. Këto ndryshime mund të bëheshin vetëm përmes procesit të transformimit dhe privatizimit, ku pastaj do të pasoj procesi i tranzicionit si element i cili do të sjell deri te ndryshimet rrënjësor në çdo sferë.

Përfundime dhe rekomandime:

Prona është kategori ekonomike, juridike, sociale dhe etike e cila zë fill me ekzistimin e njerëzimit. Andaj si e tillë është burim i mirëqenjes në njerëan anë, dhe në anën tjetër burim i konflikteve. Për arsye të shumëdimensionalitetit të sajë, ajo zë vend të rëndësishëm në të gjitha shkencat shoqërore. Vendet në tranzicion, dhe jo vetëm ato, transformimit e sajë e realizuan përmes procesit të privatizimit. Privatizimi i pronës shoqërore në Kosovë ishte proces i veçantë krahasuar me vendet e tjera. Prona shqërore kishte karakteristikat vetanakesi;

- Prona shoqërore është rezultat i sistemit socialist në ish Jugosllavi.
- Kjo kategori e pronës nuk ishte mjaft e njohur dhe e studijuar nga faktori ndërkombëtar me rastin e procesit të privatizimit në republikën e Kosovës.
- Prona shoqërore më tepër kishte karakter politik se sa ekonomik

Bibliografia

1. Aida Grgić, Zvonimir Mataga, Matija Longar i Ana Vilfan- Pravo na imovinu prema Evropskoj Konvenciji o ljudskim pravima- Savet Evrope, 2007 fq..4
2. Isa Mulaj, Redefining Property Rights with Specific Reference to Social Ownership in Successor States of Former Yugoslavia: Did it Matter for Economic Efficiency? Central European University, Budapest, Hungary, 5 – 7 May 2006 pg.
3. Selman Selmanaj – Sistemet ekonomike bashkëkohore), Prishtina 1996 faqe 35
4. Dr. Ramiz Livoreka, Argumentet relevante për shfrytëzimin e mjeteve nga privatizimi i ekonomisë së Kosovës. "Economia" nr.1-2 2003,Instituti Ekonomik, Prishitnë
5. Dr Nuri Bashota, Ekonomia e Tregut-detyrë prioritare në dokumentin "Standardet për Kosovën"-Publikim 2006

Adem Shala, PhD Candidate at the European University in Tirane.
Department of Juridical Sciences
Doctoral research in governing processes.
E-mail: shala.ad@live.com,
Adresa: Ruhot-Pejë 32000 Pejë Republika e Kosovës
tel.+ 377(0) 44 222 770

5 Qeverisja dhe Institucionet në Kosovë 1999-2013

Governing and Institutions in Kosovar 1999-2013

Abstract

Global processes in the recent 20 years have undergone essential changes in the institutional, legal, economic, information, values, attitudes, decisions, action etc. Therefore, global effects, depending on regions and countries, have taken specific characteristics. Specific effects were noticed in the last 20 years in the transition countries. The crisis and reforms in these countries and societies were a result of local efforts to change the conditions of all scopes. In order to achieve these goals, transition countries, needed support from developed countries and global organizations. Global effects were not enough, were inefficient, delayed, unclear, uncoordinated, unreformed, and inadequate among others. Furthermore, social, economic and native political initiatives were unable to promote reforms without foreign help. In the case of Kosova, the global effects were even more specific as a result of the large collection of problems over longer periods of time, and the politics of the surrounding countries, especially the dominating Serbian politics. Even though, global processes were advanced, global organization and international law were unreformed and inefficient. The activity and the determination of the Kosovar society to overcome the situation compelled the International Community towards establishing attitudes, making decisions and acting, among others, in the case of Kosova. Kosova, as a country that belongs to all communities and citizens, is a specific case. The governing processes and institutions are directly influenced by the International Community and global effects. This Kosova specific governing process is a compound of two processes, specific kosovar circumstances and global effects in the region. A special approach should be applied when global effects are evaluated and analyzed in the case of Kosovo, of special interest the practical and theoretical activity, for understanding problems, circumstances, and causes as well as the way towards surpassing obstacles and the advancement of positive processes in governing, institutions and development.

Kosova, Global Processes, Governing, International community, Development, Region

Kosova para vitit 1999, kishte përvojë dhe traditë tejet negative në procesin qeverisës dhe institucional. Kjo qeverisje paraprake ishte e imponuar, e dhunshme, totalitare, autoritare e arbitrare, më pasoja negative në të gjitha sferat dhe në mungesen e traditës qeverisëse demokratike për të ardhmën. Qeverisja dhe institucionet kosovare në RSFJ, karakterizoheshin me sistemin socialist dhe mohimin e barazisë e lirisë kombëtare të shqiptarëve. Kishte edhe të arritura pozitive, kryesishtë gjatë viteve 70-ta, të cilat u kurorëzuan dhe u përcaktuan edhe më Kushtetutën e vitit 1974. Vetëqeverisja socialiste e RSFJ-së, ishte më liberale dhe dallohej dukshem nga qeverisja e vendeve tjera të bllokut socialist. Politika serbe gjatë viteve 80-ta dhe 90-ta, për ta realizuar dominimin në Federatë dhe për t'i shuar përpjekjet kosovare për liri e barazi, shkeli Kushtetutën dhe Rendin federativ. Rrënoi autonominë e Kosovës dhe e okupoi atë më forca policore e ushtarake nga marsi 1989 deri 1999.

Kosova gjatë këti okupimi, u ballafaqu më reprezalje të theksuara dhe forma të apart'hejdit me elemente gjenocidale. Njëherit, gjatë fazës okupuese filloi dhe u realizu edhe procesi i shpërbërjes së Federatës.

Në anën kosovare u shfaqen proceset rezistuese politike më përpjekje, synime dhe të arritura në qeverisje e institucionalizim vetanak demokratik në kushte të okupimit. Popullata shqiptare kosovare që përbënte 92% të popullsisë, e bllokoi politikisht dhe institucionalisht pushtuesin, përmes proceseve rezistuese politike, aprovimit të akteve kushtetuese, organizimin institucional asociativ dhe qeverisës specifik nën okupim. Gjatë viteve 1998-99 edhe më rezistencë ushtarake. Rezistenca politike dhe ushtarake 1989-1999 ishte këmbëngulse e gjithëpopullore dhe më shum sakrifica. Rrethanat ishin tejët të rënda si rezultat i terrorit serb. Të gjitha këto rrethana e procese të rënda, lanë pasojat e tyre në kulturën, traditën, shprehit politike e qeverisese, pasojat postraumatike dhe shkatrrimin ekonomik. Kjo përvojë pati influenca të drejtëperdrejta e të tërthorta në procesin qeverisës e institucional në periudhën e pas vitit 1999 dhe deri në ditët e sotme. Pra, këto procese e përvoja qeverisëse para vitit 1999 nuk ishin aspak të përshtatshme për krijimin e kushteve, traditës dhe kulturës politike, për qeverisje e institucione demokratike.

Ngjarjet në BRSS dhe në vendet e lindjes, proceset globale të shoqëruara më përfundimin e Luftës së Ftohtë, ndryshimet e sistemit socialist, etj, ishin procese dhe rrethana që reflektuan dhe vërshuan edhe rajonin e ballkanit. U krijuan rrethana të reja globale e rajonale për formë dhe përmbajtje të re qeverisëse e institucionale dhe vetëvëndosje të njesive federative në RSFJ. Këto rrethana krijuan parakushte të reja edhe për çështjen e Kosovës, e cila u gjend e okupuar dhe më statusin federativ autonomi e jo republikë siç ishin njësitë tjera federative.

Faktori vendor kosovar, ishte njëri ndër faktoret esencial zbërthyes në ndryshimin e gjendjës, kuptohet krahas proceseve e veprimeve të faktorëve të jashtem. Ndërthurja pozitive e faktorit vendor më rrethanat e jashtme ndërkombëtare nuk ishte fare e lehtë, por ishte më i favorshem se sa më parë. Veprimtaria, këmbëngultësia dhe sakrificat kosovare paraprake, gjatë viteve 80-ta e 90-ta, dhe veçmas 1998-99, e thelluan përkrahjen e çështjes së Kosovës dhe ndërhyrjen e drejtëpërdrejtë të Bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Më ndërhyrjën ndërkombëtare u krijuan rrethana dhe forma të reja qeverisëse dhe institucionale më ndikime të theksuara nga faktori i jashtëm. Ndërhyrja ndërkombëtare në rajon ishte e vazhdueshme gjatë viteve të 90-ta, më një mori vendimeve, rezolutave, sygjerimeve dhe presioneve. Por, ndërhyrja më e drejtpërdrejtë në Kosovë ndodhi në vitin 1999, përmes një mori akteve dhe veprimeve ndërkombëtare, kryesisht me Organizimin e Konferencës së Rambujesë, Ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe Rezoluten 1244 e KS të OKB-së, të cilat krijuan rrethana të reja përcaktuese qeverisëse e institucionale në Kosovë

Gjatë Administrimit ndërkombëtar 1999-2008, qeverisja dhe institucionalizimi në Kosovë bazohej kryesishtë në Rezoluten 1244 të OKB-së. Kjo Rezolutë karakterizohej nga qendrimet kompromisëse të kontradiktave ndërkombëtare ndaj statusit të Kosovës dhe gjendjes në rajon, si dhe menaxhimin e konfliktit deri në rrethana të reja. Vendet më ndikim, kishin qendrim kontradiktor e hezitues sa i përket Statusit të pavarësisë së Kosovës. Si e tillë, kjo Rezolutë ishte kundërthënëse dhe qëllim kishte pengimin e pavarësisë së Kosovës, deri në ndonjë zgjidhje politike. Në realitetin kosovar, kjo rezultonte në pengim të qeverisjes dhe institucionalizimit të mirëfilltë demokratik e të pavarur. Kjo situatë vendore, rajonale e globale dhe përcaktimet e Rezolutës, reflektuan karakteristika specifike juridike, institucionale e vendimmarrëse në qeverisjen kosovare 1999-2008. Faktori qeverises vendor ishte i penguar në kompetenca dhe si i tillë nuk kishte efektivitetin e duhur në asnjë sferë.

Zhagitja e një gjendje të tillë e *status quos* statusore dhe qeverisëse, ishte faktori kryesor që ndikoi në mungesën e cilësisë qeverisëse me pasoja të damshme gjatë kësaj periudhe, por edhe për proceset e shumta në të ardhmën .

Kuvendi i Kosovës nuk e kishte funksionin e vertetë ligjëvënes e kontrollues, gjyqësori nuk ishte i pavarur, e edhe ekzekutivi më institucionet tjera gjithashtu. Kompetencat tejet të reduktuara të faktorit vendor në qeverisje u sanksionuan edhe më Kornizen kushtetuese 2001, e cila nuk i lejonte faktorit politik vendor mundësi krijimi të vullnetit politik dhe as vendimmarrje të rëndësishme në procesin qeverisës. Procesi i qeverisjes 1999-2008, ishte i subordinuar nga faktori ndërkombëtar. Si i tillë sillte gjendje kaotike, anarki, papërgjegjëshmëri dhe ishte i papërcaktuar në shumë aspekte. Në realitet kjo përkthehej në pengim të qeverisjes dhe institucionalizimit të mirëfilltë kosovar. Periudhë kjo, që zgjati mbi tetë vite mbajtje peng të shum proceseve e reformave të tranzicionit dhe të vullnetit politik të shqiptarëve në Kosovë. Këto rrethana, ndikuan drejtëpersedrejti në cilësinë e reformave, funksioneve dhe efekteve institucionale e qeverisëse në Kosovë, gjatë periudhes 1999-2008. Pra, kjo periudhë karakterizohej:

- Qeverisja ndërkombëtare 1999-2008, ishte joefektive dhe penguese e proceseve, për shkak të papërcaktimit të statusit të pavarur të Kosovës.
- Institucionet kosovare gjatë bashkëqeverisjes më faktorin e jashtem 1999-2008, ishin të penguara, të varura dhe u mungonin kompetencat. Si të tilla ishin joefektive e joefikase, të papërgjegjshme e jodemokratike, në procesin politik dhe qeverisës.
- Pengesat dhe vonesat në reforma e integrim, kanë ndikuar negativishtë në shum sfera e procese, pasojat e të cilave janë afatëgjata.

Sekretari Gjeneral i OKB-së në nëndor 2005, e ngarkoi Marti Ahtisarin të filloj bisedimet për përcaktimin e statusit të Kosovës. në mes Kosovës dhe Serbisë përmes ndërmjetësimit ndërkombëtar më përfaqësuesit e Grupit të kontaktit. Në mars 2007, u prezentun rezultatët e bisedimeve në Planin e Ahtisarit, ku Kosovën e propozon vend të pavarur më një mbikqyerje ndërkombëtare, në funksion të zbatimit të përcaktimëve të parapara në këtë Planë. Ky Plan, e obligonte qeverisjen dhe institucionet kosovare të përmbajë dhe garantojë mekanizmat ligjor dhe institucional të domosdoshëm, për t'u siguruar se Kosova qeveriset sipas standardeve më të larta demokratike, e cila do të promovojë bashkëjetesën paqësore dhe prosperitetin e të gjitha komunitetëve e qytetarëve të saj. Që, Kosova të jetë shoqëri shumetnike, të qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe respektimin e nivelit më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe pjesëmarrjes së tyre në të gjitha proceset. Kosova obligohej që këto parime t'i përmbaj edhe në Kushtetutë.

Plani i Ahtisarit, nuk ishte parimor sa i përket multietnicitetit, ngase e favorizonte pakicën serbe në Kosovë dhe i jepte hapsirë politikes destruktive të Serbisë. Pakicën serbe e barazonte më 92% të popullatës dhe i nënvlersonte komunitetët tjera pakicë. Nga koncepti i multinacionalitetit u kalue në Komuna të veçanta më ,,shumicë serbe'', pasojat e kësaj zgjidhje shihen edhe sot e kësaj dite. Në Kosovë nuk kishte konflikte ndëretnike, por kishte instrumentalizim të pakicës serbe nga politikat dominuese e okupuese të Serbisë dhe tolerimit ndërkombëtar. Për ta amortizuar këtë instrumentalizim të pakicës serbe nga ana e Serbisë dhe pengesat e jashtme për Pavarësi, zgjidhjet që u përfshin në Planin e Ahtisarit, u bënë të pranueshme për faktorin politik institucional vendor, edhepse dihet së Kosova nuk ishte shoqëri e theksuar multietnike.

Pra, si rezultat i rrethanave, zgjidhjet e këtij Plani u përkrahen nga shumica e subjekteve politike e lidershipi kosovar. Ata, besuan se këto zgjidhje stabilizohen dhe nuk do jenë pengesë në forcimin dhe funksionimin institucional të shtetit demokratik, më decentralizimin e theksuar komunal, si dhe më proceset integruese në të ardhmen. Pra, besonin se do të amortizohen e pengohen politikat ndërhyrëse të Serbisë dhe aleatëve të saj. Por, të gjitha këto pengesa nga jashtë, veçmas problemi i veriut i instrumentalizuar nga Serbia dhe i toleruar nga një pjesë e faktorit ndërkombëtar, po i kushtojnë Kosovës në cilësinë e efektivitetin qeverisës, në institucionalizim dhe në integrim.

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi shpalli Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës në pajtim më Planin e Ahtisarit. Pasoi njohja ndërkombëtare e një numri të konsiderueshëm të vendeve më ndikim global. Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 përcaktoi karakterin, funksionet, kompetencat dhe organizimin e institucioneve. U konsoliduan shumica e institucioneve dhe vazhduan funksionimin e tyre sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjeve e akteve nënligjore përkatëse, më përjashtim të shtrirjes së pushtetit në veri. Aspekti kushtetues e juridik përcaktoi organizimin dhe veprimtarinë institucionale, duke respektuar parimet demokratike, multietnike, joreligjioze, me gjuhën shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare. Afroi elemente kryesore për të drejtat minoritare, më një formë të fortë të vetëqeverisjës lokale të decentralizuar në nivelin komunal dhe përfaqësim përmbajtësor të pakicave në nivelin qendror të qeverisjes. Më mbrojtjen e identitetit nacional-etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha Bashkësive dhe anëtarëve të saj. Qëllimi ishte që pakices serbe t'i siguroi status të veçantë, për ta integruar dhe deinstrumentalizuar nga politika destruktive e Serbisë ndaj Kosovës. Por, nga koncepti i multietnicitetit që afirmohej më të madhe nga Bashkësia ndërkombëtare, u kalua në Komuna „serbe'' e jo multietnike. Kjo ndarje në baza etnike nuk ishte parimore dhe nuk shpreh strukturën reale të popullsisë kosovare, dhe si të tilla më tepër krijojnë parakushte enklavizimi se sa bashkëjetesë multietnike. U formuan Komunat më shumicë serbe dhe u integruan në institucione e qeverisje qendrore, përpos pjesës veriore. Pjesa veriore më pakicen serbe në këte rajon, ende janë instrumentë i politikes destruktive të Serbisë, e cila është shndërruar në penguese të shtrirjes së qeverisjes në këte anë.

Të gjitha përcaktimet e autorizimeve të pushtetit qeverisës e institucional u konsoliduan sipas kërkesave të Planit të Ahtisarit, duke i theksuar garancat juridike e politike të të gjitha grupeve etnike, vëçmas minoritetit serb në Kosovë. Të gjitha këto suksese, paten rezultat afirmimin e Kosovës dhe përmbylljen e mbikqyerjes ndërkombëtare dhe vlerësimet pozitive të saj, si dhe qetësinë rajonale që solli pavarësia. Pavarësia, në thelb ishte qeverisja dhe institucionalizimi i saj i pavarur, i mohuar për një kohë të gjatë. Vazhdoi njohja ndërkombëtare e vendeve më ndikim global dhe i 25 vendeve të BE-së. Kosova, u antarësu në një mori organizatave rajonale e globale tejet të rëndësishme.

Forma qeverisëse është Republikë parlamentare, e ngjajshme më vendet në tranzicion dhe më demokracitë perëndimore. Shtet unik, më qeverisje lokale në nivelin komunal më kompetenca të theksuara vetëqeverisëse. Me sistem proporcional zgjedhor deri më tani dhe me garanca të theksuara sistemore e kushtetuese për komunitetët pakicë, në veçanti për komunitetin serb. Pra shtet i ri, i vonuar në reformat e tranzicionit dhe më traditë fillestare në procesin qeverisës e institucional të pavarur e demokratik. Por, më një shoqëri që ka sakrifikuar shum për këtë pavarësi dhe që ka përcaktim e nevoj për liri, demokraci dhe zhvillim të të gjitha sferave. Pas pavarësisë 2008, qeverisja kosovare realizoi një varg suksesësh në konsolidim juridik dhe institucionalizim organizativ, por mëgjithate, efektiviteti dhe funksionet qeverisëse ënde nuk janë në pajtim më kërkesat e kohës dhe standardët demokratike të qeverisjes. U krijuan parakushtet për qeverisje e organizim institucional, më përcaktime kushtetuese e ligjore sipas standardeve demokratike dhe sipas standartëve të se drejtës ndërkombëtare.

Por, implementimi praktik efektiv e qëllimor nuk është i knaqshem. Moszhvillimi ekonomik, veçmas në sferat prodhuese e shërbyese private, po ndikon në përqendrimin e theksuar të pushtetit mbi burimet egzistenciale, dhe si rezultat i këti përqendrimi e jozhvillimi, po shfaqen dukuri negative në qeverisje. Pa zhvillimin ekonomik të qendrushem privat, nuk ka shpërqendrim të pushtetit e as qeverisje demokratike, ngase të gjithë po varën vetëm nga sfera publike dhe administrata për të ''siguruar'' egzistencën dhe punësimin,etj. Sferë kjo e pamjaftueshme, ndërsa sfera private sherbyese e prodhuese nuk është e zhvilluar. Pa zhvillimin e sektorve ekonomikë e sherbyes privat, konkurrues dhe të pavarur nga pushteti-shpërqendrim i burimeve të pushtetit në këta sektor, nuk ka qeverisje demokratike. Mundësia e punësimit dhe e të ardhurave në sektoret joshtetëror e jopublik, do të krijonte parakushte për shoqëri të mirëfilltë civile dhe me qytetarin e pavarur më pamundësi për ta manipuluar. Kjo gjendje po ndikon edhe në psikologjinë politike të qytetarëve: kulturë politike, vlera, qendrime e sjellje të caktuara me efekte konkrete.

Egziston konstitucionalizmi dhe legjislacioni konkret, por implementimi i tij është i vështirë, ngase lidershipi partiak dhe qytetaret nuk janë sa duhet në funksion të mirëvajtjes së procesit zgjedhor, të sundimit të rendit juridik dhe ligjit, të pjesëmarrjes cilësore në procesin politik për qeverisje demokratike, etj. Ky konsolidim juridik e institucional-organizativ nuk është i mjaftueshem vetëvetiu. Kërkohet implementim më efikas, më cilësor e përmbajtësor efektiv i rendit juridik e politik, duke mos lejuar tjetërsimin e qëllimëve e përcaktimeve kushtetuese në procesin qeverisës. Është proces tejet i vështirë, për shkak të mungesës se kushteve bazë për demokraci: nivelit të ultë i zhvillimit ekonomik, mungesa e traditës demokratike, pengesat e jashtme, kultura politike e biznesore, institucione fillestare dhe të brishta, autonomi e ndarje e pamjaftueshme e pushteteve, mungesa e sundimit të ligjit, joefikasitet dhe joefektivitet i institucioneve themelore të shtetit të Kosovës, përqendrim i pushtetit mbi burimet dhe sektoret egzistencial, etj.

Pas shpalljes së pavarsisë, gjatë pesë viteve qeverisje dhe veprimtarie institucionale, Kosova u karakterizu më këto rezultate efektive në qeverisje:

- Ka filluar qeverisja përmes institucioneve të pavarura, legjitime dhe funksionale sipas përcaktimeve juridike. Nuk ishte cilësia e duhur e lidershipit dhe e zyrtarëve në institucionet përfaqësuese, ekzekutive, në gjyqësor, në administratë, në shërbimet publike dhe as në institucionet tjera të pavarura. Vërejtje të theksuara ka në organet e ndjekjes dhe tëk gjyqësori, të cilat nuk ishin efektive kundër dukurive negative dhe nuk kishin përkrahje serioze nga institucionet kryesore politike.
- Nuk ka politika të qarta ekonomiko-zhvillimore. Ka ngecje në krijimin e kushteve për mjedis të përshtatshëm biznesor. Ënde mungojnë reformat dhe politikat e qarta ekonomike e makroekonomike. Këto politika nuk janë konkrete e specifike, ënde nuk janë projekte e strategji afatëmesme dhe afatgjata për zhvillim të qëndrushem ekonomik.
- Autoriteti dhe legjitimiteti qeverisës e institucional po përceptohet negativ, si rezultat i dukurive negative të grupeve në udhëheqjet partiake dhe në institucione.
- Konkurrenca ndërpartiake është jo parimore: e përcjellur më akuza, shpifje e ofendime dhe jo bashkërenduese në krijimin e institucioneve dhe në vendimmarrje.
- Mungojnë forca opozitare të mirëfillta. Si rezultat i kësaj ka edhe pjesëmarrje të ultë në votime dhe munges të pjesëmarrjes cilësore e sasiore të qytetarëve në procesin politik.
- Mosndëshkim nga gjyqësori i bartësve të dukurive negative në qeverisje dhe përzierja e politikës në gjyqësor.

- Mosndëshkim me votë nga qytetarët, si rezultat i votuesve emocional dhe më struktur të vetëdijes politike të ngarkuar nga e kaluara dhe jo sa duhet kognitive, si dhe nga përqendrimi i lartë i pushtetit mbi burimet egzistenciale publike.
- Shkelje të rënda të parimeve demokratike në procesin zgjedhor, të cilat po ndikojnë në uljen e nivelit të legjitimitetit, autoritetit dhe efektivitetit qeverisës dhe institucional.
- Me sistemin zgjedhor proporcional u influencua paksa bashkërenditja, kooperimi dhe toleranca ndërpartiake dhe ulja e tensioneve në mes tyre në procesin qeverisës dhe në funksionet institucionale. Si rezultat i proporcionalitetit zgjedhor/elektoral, nuk kemi dy taborre dhe dy tirani të shumicave, por disa parti të mesme të detyruara për aleanca e bashkëpunim për të kriju pozitë, si dhe për efekte opozitare.
- Kishte dhe ende ka ndërhyrje të theksuara ndërmjetësuese nga faktori i jashtem, në zgjidhjen e krizave instiucionale dhe në proceset vendimmarrëse.
- Toleranca ndëretnike është në rritje.
- Përpjekjet në eliminimin e kundërshtarve partiak përmes metodave jodemokratike, antikushtetuese e joligjore, gjithnjë po relativizohen dhe zbehen. Tiranizmi si metodë e veprimtarisë politike po pakësohet.
- Guximi qytetar dhe aktiviteti racional politik ka fillue të rritet. Shoqëria civile përmes OJQ-ve gjithënjë po konsolidohet. Edhe mediat kanë ngrit nivelin e pavarësisë , analizës dhe kritikës së bazuar.
- Shtresëzimi dhe struktura plurale e shoqërisë kosovare po mungon, si rezultat i jozhvillimit.
- Mbrojtja nga sulmet e jashtme po bëhet nga forcat ushtarake ndërkombëtare dhe politikat përcjellse të Bashkësisë ndërkombëtare. Ruajtja dhe mbikqyerja e kufirit dhe siguria e brëndshme po bëhet nga Policia e Kosovës. Kosovës, ënde po i mungon forca ushtarake më rolet dhe funksionet e saja.
- Zbatimi i ligjit nuk është në nivelin e duhur, por të gjithë po vetëdijsohen për gjendjen dhe pasojat. Ka përpjekje konkrete dhe kërkesa, presione e përkrahje nga jashtë që të përmirësohet kjo sferë esenciale për qeverisje demokratike, pa të cilën nuk ka efekte dhe funksione demokratike qeverisese në asnjë sferë.
- Vetëmbrojtja e brëndshme po bëhet nga institucionet e sigurisë, të mbikqyrura e të kontrolluara nga forcat civile institucionale dhe nga sistemi juridik.
- Mbështetja kulturore dhe konsolidimi i vlerave demokratike në qeverisje, në ekonomi, në respektim të të drejtave të njeriut dhe pakicave, barazisë gjinore, etj., janë në rritje.
- Interpretimi dhe mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në qeverisje, po bëhet nga gjykata kushtetuese, në të cilën ka edhe përfqësues ndërkombëtar. etj.

Pra, përpos sukseseve të arritura, veçmas pas shpalljes së pavarësisë dhe përmbylljes ndërkombëtare e deri më sot, qeverisja kosovare nuk i ka dhënë efektet e kërkuara në sundimin e ligjit, në luftimin e dukurive negative, në cilësinë e procesit zgjedhor, në krijimin e sigurisë dhe kushteve për investime e rritje ekonomike, në cillësinë e punëve e veprimtarisë administrative, në cilësinë e shërbimeve publike, në politikën e jashtme dhe integruese, etj.

Efektiviteti dhe funksionimi i qeverisjsës dhe i institucioneve kosovare, po varen nga një mori faktoresh, kushteve e rrethanasve: niveli i ultë i zhvillimit ekonomik; struktura e vetëdijes politike tëk qytetarët; procesi zgjedhor i manipuluar; subjektet politike dhe lidershipi i pareformuar; cilësia e dobët e funksioneve parlamentare; ekzekutivi joefektiv; tradita paraprake politike në qeverisje; joautonomia e gjyqësorit dhe joefikasiteti; jollogaridhënja për rezultatët; vonesat në proceset integruese; rrethanat ndërkombëtare, rajonale e globale; niveli i shoqërisë civile dhe mediave; raporti pozitë-opozitë; mungesa e forcave të reja opozitare; cilësia e administratës, etj.

Të gjitha sferat qeverisëse dhe institucionet janë funksionale dhe më rezultate konkrete, por ende nuk janë të knaqshme e cilësore sipas kërkesave e mundësive të shoqërisë kosovare.

Për të arritë rezultate po kërkohet edhe thellim i proceseve bashkëpunuese rajonale, integrim në BE dhe integrimi në organizatat e proceset rajonale e globale. Këto arrihën përmes angazhimit e veprimit të faktorit vendor dhe ati ndërkombëtar njëkohësishtë.

Këto janë procese esenciale të konsolidimit demokratik të institucioneve dhe zhvillimit ekonomik. Po kërkohet harmonizimi i legjislacionit dhe plotësimi më legjislacion sekundar, për të qenë më praktike në implementim sipas praktikave të BE-së. Këto po kërkohen edhe nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Po kërkohet bashkëpunimi intenziv rajonal. Në këtë frymë duhet thelluar edhe bashkëpunimin mbarëshqiptar në të gjitha sferat, ngase ky bashkëpunim do jetë katalizator i proceseve zhvillimore rajonale e globale. Qeverisja kosovare dhe e vendeve të rajonit mu për këtë duhet të krijojnë parakushte infrastrukturore juridike e fizike, për procese bashkëpunuese intenzive, në pajtim më proceset e kërkuara të bashkëpunimit rajonal si domosdoshmëri paraprake për integrim në BE. Ky bashkëpunim i mirëfilltë dhe zhvillim reciprok i tejkalon më se miri pengesat dhe politikat negative në Ballkan. Këto procese janë kyçe për zhvillimin ekonomik, sigurinë dhe cilësinë e jetës në Kosovë dhe në vendet e rajonit.

Bibliografia:

a) Dokumente dhe Akte zyrtare:

* Amandamentet kushtetuese të vitit 1967,68,e 1971 në Kushtetuten 1963.
* Deklarata kushtetuse e 2 korrikut1990
* Deklaratë e Këshillit të NATO-s mbi Kosovën,8 dhjetor 1998,Q.për informim, Prishtinë
* Konferenca Rambujesë 1999
* Korniza e përkohshme Kushtetuese 2001
* Kushtetuta e R. së Kosovës 2008.
* Kushtetuta e R.së Kosovës 1990
* Kushtetuta e Repulikës së Serbisë e datës 23 mars vitit 1990
* Kushtetuta e RPFJ e vitit 1946
* Kushtetuta e RSFJ e vitit 1963
* Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974
* Kushtetuta KSAK e vitit 1974
* Marrëveshja për bashkëqeverisje më Bashkësinë ndërkombtare në Kosovë-KPK,KTK,2001
* Pakoja e Ahtisarit 2007
* Rezoluta e KS e OKB-së nr.1244,1999.
* Rezoluta e KS NR.1199(23 shtator 1998)
* Rezoluta e KS Nr.1203(24 tetor 1998
* Rzoluta e Këshillit të sigurimit të OKB-s,Nr.1160(31 mars 1998)
*Deklarata e Pavarësisë 17 shkurt 2008.Prishtinë(internet)
*Deklarata e Pavarësisë,17 shkurt 2008
*Deklaratë e Këshillit të NATO-s mbi Kosovën, 8 dhjetor 1998, Qendra për informim, Prishtinë.
*Deklaratë për Kosovën:Takimi i grupit të kontaktit 9 mars1998; 25 mars 1998; 29 prill1998; 9 maj1998; 12 qershor 1998; 8 koorik 1998). Prishtinë:Qendra për informim.
*Dokumenti I OKB: S /1999/699 (2 qershor 1999).
*Marrëveshja kompakte mbi objektivat e përbashkëta deri në qershorin 2014.Qeveria,zyra e BE-së dhe EULEX-i
*Plani i Ahtisarit:*Propozim Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës 2007*.Prishtinë

°Opinioni i GJND-së 2009,(Korrik, 2010),Gaz.Koha ditore.

b). Raportet:

* Bankës Botrore (http://data.ëorldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD) e vizituar më 1 janar2012
* BB,(18 Dhjetor 2012),:*Raporti ekonomik për EJL*, Telegrafi.
* BERZH,(10.03.2013),D*raftstrategjia*,Telegrafi,f.2
* BGK:,*Gjyqësia, sektori më i korruptuar*,Kosova sot 9.07.2013
* BQK: *Raporti Vjetor 2011; 2012*, Prishtinë. Korrik, 2012.
* FMN,Bruksel, 4 janar 2013,*Rritja ekonomike 2012*,Telegrafi.
* FMN. *Global Financial Stability Report*. October 2008.
* Freedom House, 2003-2013
* KE: *Raporti i progresit për Kosoven:2009,2010,2011,20122013*
* KE:Raporti i progresit për Kosovën, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe2013
* KE-*Studimi i fisibilitetit të marrëveshjes së stabilizim-asocimit në stabilizim-asocimit në mes të BE dhe Kosovës*,tetor/2012
* KKK: *Lufta kundër Korrupsionit*,Kosova sot, f.2
* Komisineri Stefan Fule , *MSA për Kosovën*,(Koha ditore,10.tetor2012,5500:11).
* OECD (2010). *Development Co-Operacion*.
* OEGJ,(25/qershor/2013),:*Korrupsioni largon investitoret nga Kosova*, Gazeta: Kosova sot,1)
* Presidentja:Jahjaga,A.,*Lufta kundër korrupsionit*,21.12.2012 gazeta, Koha ditore, f.2
* Raportet e *Freedom House*, Gazeta kosova sot,9/dhjetoe 2012,f.2).
* Raportet *e Ombudspersonit.2000,2001,2002,2004*,Instituti i Ombudspersonit në Kosovë
* UNDP:*Human Development Report*,World Report,New York, 2007
* UNDP:*Impulsi publik,2013*
*38 Fondacioni Bertelsman 2008,
*KDI: Raport monitorues:*Mbi* 10 *vjet parlamentarizem në Kosovë*, Koha ditore 04.08.13,f.2
*Raporti tre mujor për Kosovën,nga Sekretari i përgjithshem i OKB-së,nandor-2012,G.Kosova sot,f.1

Dr. Proces Adrian Leka
Pedagog prane Univesitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",
Fakulteti i Drejtësisë
Email: leka-ad@live.com

6 Ankimi si pjese themelore e të drejtave të njeriut

Abstrakt

Në këtë punim analizohet pozita e së drejtës së ankimit në legjislacionin shqiptar dhe në korpusin e të drejtave themelore të njeriut si dhe vendin që kjo e drejtë zë në sistemin europian të së drejtës (Neni 13 KEDNJ)[42].
Qëllimi i tij është evidentimi i rolit,pozicionit dhe rëndësisë që kjo e drejtë paraqet në legjislacionin e brendshëm,si dhe në kuadrin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë europian.
Legjislacioni jonë paraqitet mjaft i plote për sa i përket garantimit formal të të drejtave dhe lirive themelore.Ky aspekt bëhet akoma më i dukshëm nqs marrim parasysh faktin që këto liri janë sanksionuar në Kushtetute në standartin më të lartë,në formën e një katalogu të të drejtave të njeriut.[43] *Njohja e statusit të brendshëm për traktatet ndërkombëtare të ratifikuara dhe e statusit kushtetues për K.E.D.NJ,përfaqëson një tjetër aspekt të rëndësishëm të legjislacionit shqiptar.Akordimi i këtij statusi në rendin e brendshëm juridik,bën të mundur që individët të mund të gëzojnë në kuadrin e së drejtës së brendshme,të drejtat dhe liritë e njohura nga KEDNJ.*
Përvec garancisë formale të ofruar nga legjislacioni në fuqi,ekzistenca e institucioneve dhe procedurave nëpërmjet të cilave individët adresojnë ankimet e tyra,plotëson kuadrin material të garancive të ofruara.Në sajë të funksionimit të sistemit gjyqësor individëve iu krijohet mundesia të paraqesin pretendimet e tyre,në mënyrë që ata gjykojnë mbi themelin e këtyre cështjeve.
Rekursi administrativ paraqet një tjetër alternativë efektive për të zgjidhur konfliktin e lindur me nxjerrjen e aktit admministrativ publik i cili cënon të drejtat e individëve.
Mënyrat e tjera të garantimit të të drejtave të njeriu janë ankimi në Gjykatën Kushtetuese si shkalla më e lartë e sistemit gjyqësor,si dhe ankimi në institucionin e Avokatit të Popullit.
Pavarësisht të gjitha mundësive për ankimim që i ofrohen individit në ditët e sotme ende hasen probleme serioze dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

1.legjislacioni aktual shqiptar dhe garancitë që ofron ai për garantimin dhe zbatimin e nenit 13 të konventës europiane të të drejtave të njeriut.

Deklarata universale e të drejtave të njeriut në nenin 10 dhe 8 të saj shprehet:

- Çdokush ka të drejta të barabarta të dëgjohet,drejtësisht e publikisht,nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme,në mënyrë që të merret një vendim mbi të drejtat dhe detyrimet e tij apo mbi akuzën penale të ngritur ndaj tij.

[42] NENI 13"E drejta për zgjidhje efektive" Çdokush,të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë,ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para nje organi kombëtar,pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.
[43] Neni 15 e në vazhdim i Kushtetutes së RSH-së

Çdo person ka të drejtën e një rekursi efektiv përpara juridiksioneve kombëtare kompetente për veprimet që shkelin të drejtat themelore që i njihen atij nga kushtetuta apo nga ligjet.

Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut në nenin 6.1 dhe 13 të tij shprehet:

Çdo person ka të drejtë që ceshtja e tij të degjohet drejtësisht,publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj,e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile,ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale qe i është drejtuar.

Çdo personi të cilit i janë shkelur liritë dhe të drejtat e njohura në këtë Konventë,ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe atëhere kur kjo shkelje mund të jetë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

Ankimi është mjeti më i rëndësishëm për të realizuar apo rivendosur një të drejtë të shkelur,të cënuar apo mohuar.Ankimi është mjet procedurial,rruga me anë të të cilës individi mund të arrijë poltësimin e të drejtës së tij të pretenduar.Si një e drejtë e rëndësishme ankimi në aspektin procedurial duhet të jetë i specifikuar,i hollësishëm,i qartë për të mos lejuar shkeljen e të drejtave të tjera nga pamundësia për të bërë ankim.

Kushtetuta e RSH e sanksionon këtë të drejtë në një sërë nenesh të saj sic janë: neni42,neni 43,neni 44 dhe neni 48.

Liria,prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proçes të rregullt ligjor.

Kushdo për mbrojtjen e të drejtave,lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore,ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ,ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik,brenda një afati të arsyeshëm,nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme,e caktuar me ligj.

Kushdo ka të drejtën të ankohet kundër një vendimi gjyqësor,në një gjykatë më të lartë,perveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Kushdo ka të drejtë të reabilitohet dhe/ose te zhdëmtohet në përputhje me ligjin ,në rast se është dëmtuar për shkak të një akti,veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Kushdo vetë ose së bashku me të tjerët mund ti drejtojë kërkesë,ankesë ose vërejtje,organeve publike,të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Ankimi është një e drejtë themelore e njeriut,e drejtë e cila presupozon të drejtën e individit për ankim me pretendimin e një të drejtë të shkelur,ekzistencën e autoriteteve shtetërore kompetente për shqyrtim,pranimin e ankimit për shqyrtim,afate të kënaqshme për shqyrtim,shqyrtim objektiv,të drejtën për shqyrtimin e ankimit në shkallë më të lartë si dhe garantimin për reabilitimin e tij si rezultat i shqyrtimit dhe pranimit të ankesës.

1.1 E drejta e ankimit në nivel kushtetues.

Për të nisur analizën e legjislacionit shqiptar nën dritën e nenit 13 padyshim që fillimisht i drejtohemi Kushtetutës,në të cilën garantimi i këtyre të drejtave shfaqet në mënyrë të dukshme sic e përmendëm dhe më lart.Perveç Kushtetutës që përbën burimin primar të së drejtës për një proces të rregullt ligjor,vend të rëndësishëm zë dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut,si pjesë e sistemit të brendshëm dhe më konkretisht neni 6 i saj.[44]Me rëndësi shfaqen edhe mekanizmat garantues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

[44]NENI 6 E drejta për një proçes të rregullt 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme,e krijuar me ligj,e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile,ashtu

Së pari:mund të përmendim organet që janë të detyruara të zbatojnë e të sigurojnë për çdo person që paraqitet para tyre,të drejtën për një proces të rregullt ligjor.Të tilla janë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.Interpretimet e këtyre gjykatave janë shumë të rëndësishme për të garantuar të drejtën për një proçes të rregullt ligjor,për aq kohë sa ajo mbetet e papërkufizuar,e pakufizuar dhe në zhvillim.Gjykatat e zakonshme kontrollojnë njëra tjetrën në lidhje me respektimin e proçesit të rregullt ligjor.Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë i prishin vendimet e gjykatave më të ulëta nëse konstatojnë shkelje proçeduriale,që në thelb janë shkelje të së drejtës për një proçes të rregullt ligjor.
Së dyti:si mekanizëm garantues shfaqet Gjykata Kushtetuese e cila për shkeljen e proçesit të rregullt ligjor vepron si shkallë e katërt gjykimi.Praktika e kësaj gjykate është shumë e rëndësishme për këtë të drejtë sepse bëhet interpretimi i saj në këndvështrimin kushtetues dhe zgjidhen në mënyrë përfundimtare ankesat e individëve.
Së treti:shfaqet Gjykata Europiane e të drejtave të njeriut.Ky mekanizëm shqyrton ankesat e individëve ndaj shteteve që shkelin të drejta dhe liritë e njohura nga Konventat.

a. Gjykata Kushtetuese si mjet efektiv ankimi[45]

Mbrojtja në përgjithësi e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve përbën padyshim boshtin qendror të të gjithë organizimit dhe funksionimit të gjykatave kushtetuese.Ndër të tjerat një nga kompetencat e saj është dhe ajo e shqyrtimit të kërkesave të individëve,e njohur me termin "ankim kushtetues".
mundësia e ankimit edhe në Gjykatën Kushtetuese është jo vetëm në dobi të individit por edhe të shtetit që e krijon këtë mundësi,pasi vendoset edhe një 'filter' tjetër brenda vendit për shqyrtimin e çështjeve konkrete,aq më tepër që ky 'filter' është tejet i specializuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.Gjykata Kushtetuese shqiptare konsiderohet si mjet ankimi efektiv i brendshëm ligjor,për sa i përket kërkesave me objekt shkelje e së drejtës për një proçes të rregullt ligjor.
Kufizimet që mund ti bëhen të drejtës së ankimit sipas përcaktimit të nenit 6 të Konventës bëhen vetëm në rastet kur këto kufizime ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe nuk cënojnë thelbin e kësaj të drejte.

b. Avokati i Popullit,si organ Kushtetues[46]

Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në 28.11.1998,solli një risi në organizimin institucional shtetëror.

---

edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.Vendimi duhet të jepet publikisht,por prania në sallën e gjykatës mund ti ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë proçesit ose gjatë një pjese të tij,në interes të moralit,të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike,kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proçes ose në shkallën qe çmohet tepër e nevojshme nga gjykata,kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm,derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a)të informohet brenda një afati sa më të shkurtër,në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme,për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; b)ti jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; c)të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës zgjedhur prej tij,ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin,t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; d)të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjës së dëshmitarëve në favor të tij,në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; e)të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

[45] Ligji nr.8577 datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

[46] Ligji Nr.8454 dt:04.02.1999"Mbi Avokatin e Popullit "

Për herë të parë i parashikua krijimi i një institucioni të ri të pavarur,institucioni i Avokatit te Popullit,funksion kryesor i të cilit është "mbrojtja e të drejtave dhe lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës shtetërore."Avokatit të Popullit mund ti drejtohet çdo individ,grup individësh dhe organizata jofitimprurëse,të cilat pretendojnë se i janë shkelur të drejtat,liritë dhe interesat e ligjshme.Këto shkelje duhet të kenë ndodhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme e të parregullta të administratës publike.

Avokati i Popullit mund të nisë shqyrtimin e një çështje,përveç se me anë të kërkesave dhe ankesave të individëve edhe me iniciativën e tij,kryesisht për çështje të veçanta që janë bërë publike paraprakisht.

Kur vendos të pranojë një kërkesë Avokati i Popullit vendos në mënyrë diskrecionale dhe vendimet e tij nuk i nënshtrohen rregulave të cilave u nënshtrohet një vendim gjykate,dhe përgjithesisht nuk njihet një instancë më e lartë kur vendimi i Avokati i Popullit mund të ankimohet.

1.2Tipare të organizimit gjyqesor në Republikën e Shqipërisë

Një nga instancat kryesore të ankimit ku individi mund të drejtohet është dhe sistemi gjyqësor.Sistemi gjyqësor përbëhet nga tre shkallë ankimi përkatësisht:Gjykata e Shkallës së Parë,Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.Gjithashtu ekziston dhe Gjykata Ushtarake e Shkallës së Pare dhe Apelit.Me ligj mund të krijohen gjykata të veçanta të cilat janë të specializuara në fusha të caktuara,ku mund të përmendim Gjykatën e Krimeve të Rënda.Gjykata e Shkallës së Parë sipas juridksionit gjykon çeshtje civile dhe penale.Këto gjykata ndodhen në çdo rreth dhe gjykojnë çështje për herë të parë.Gjykata e Apelit shqyrton në shkallë të dytë të gjitha çështjet e gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të cilat ankimohen nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata e Lartë është autoriteti më i lartë gjyqësor i cili ka juridiksion rishikues dhe fillestar.Këto vendime janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta me gjykimin e çështjeve të ngjashme.

Ndjekja penale dhe akuza përfaqësohen nga prokurori.Prokurori ushtron funksionin e tij pranë sistemit gjyqësor,por si një organ i pavarur.Prokuroria është organ hiearkik dhe i centralizuar nën autoritetin e Prokurorit të Përgjithshëm.

1.3Tiparet e ankimit civil sipas Kodit të Procedurës Penale[47]

Legjislacioni proçedurialo-civil ka reflektuar në një mënyrë më të detajuar kërkesat e nenit 13 të konventës Europiane për të drejtat e njeriut.Në të trajtohet gjërësisht ankimi civil,efektiviteti i padisë civile,proçedurat e ankimit ndaj veprimeve të formës së prerë dhe shumë aspekte të tjera që lidhen me gjykimin e një pretendimi civil.Karakteristikë për juridiksionin civil është fakti se gjykatat vihen në lëvizje vetëm nga palët.Në këtë mënyrë individi që i drejtohet gjykatës gjen tek ajo një mënyrë për të realizuar të drejtat e tij.Procesi i gjykimit të pretendimeve civile mbështetet në disa parime ndër të cilat mund të përmendim:

- Pavarësia e gjykatave
- Dhënia e drejtësisë vetëm nga gjykata
- Kontradiktorialiteti
- Disponibiliteti
- Barazia e provave
- Oraliteti

[47]Kodi i Proçedurës Civile Pjesa e tretë "Ankimi dhe mënyrat e gjykimit të tyre"

- E drejta e mbrojtjes
- Zhvillimi i gjykimit me dyer të hapura

Në tërësinë e tyre këto parime krijojnë premisa dhe mundesojnë për personin që i drejtohet gjykatës,një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.në përshtatje me kërkesat e nenit 13 për një tërësi mjetesh ankimore Kodi i Proceduës Civile parashikon si mjete të tilla ndaj vendimeve të gjykatës,ankimi në gjykatën e apelit,rekursi në gjykatën e larte dhe rishikimin e vendimit.Ankimi është akti me anë të së cilës palët në proçes parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës për të mbrojtur të drejtën dhe interesat e tyre.Gjykata e Apelit pasi shqyrton cështjen në themel mund të vendosë.

- Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë
- Ndryshimin e vendimit
- Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes
- Prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë

Vendimi i Gjykatës së Apelit mund të ankimohet nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë vetëm kur:

- Nuk është respektuar ose zbatuar keq ligji
- Për shkelje të rënda proçeduriale
- Për shkelje që kanë ndikuar në vënien e drejtësisë

Në këtë rast Kolegji Civil i Gjykaët së Lartë mund të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit
- Prishjen e vendimit
- Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë
- Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe dërgimin për rishikim me një tjetër trup gjykues
- Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë
- Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Shkallës së Parë
- Prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes

Si një mjet ligjor mbrojtës ,legjislacioni parashikon edhe rishikimin e vendimit të formës së prerë.Kjo kërkesë paraqitet para Gjykatës së Lartë.

1.4 Juridiksioni penal sipas Kodit të Proçedurës Penale[48]

Neni 2 i protokollit 7 të Konventës parashikon të drejtën e apelit për një çështje penale." Çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimin.Ushtrimi i kësaj të drejte,duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrojë,janë të përcaktuara në ligj.
Kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për veprat e lehta siç janë përcaktuar nga ligji,ose i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë,ose deklaruar fajtor dhe dënuar në vijim të një rekursi kundër pafajsisë se tij"
Shkelja e të drejtës së ankimit mund të cojë në shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proçes të rregullt ligjor.

[48]Kodi i Proçedurës Penale të RSH,Kreu VIII"Ankimi" nenet 470-461

Pamundësia e ushtrimit të kësaj të drejte mund të cënojë të drejtën e mbrojtjes,parimin e barazisë së mjeteve,parimin e kontradiktorialitetit në seancë gjyqësore,parimin e debatimit mbi provat e paraqitura nga palët kundërshtare,të drejtën e paraqitjes së provave për të kundërshtuar akuzën etj.Proçesi penal që zhvillohet ndaj të pandehurit,mbështetet në rregullat dhe normat e parashikuara në Kodin e Proçedurës Penale.Ky proçes udhëhiqet nga një sërë parimesh ku si ndër më kryesore mund të përmendim:

- Parimi i ligjshmërisë
- Pavarësia e gjykatës
- Prezumimi i pafajësisë
- E drejta për tu mbrojtur
- Ndalimi i gjykimit dy herë për të njejtën vepër
- Rivendosja e së drejtës së shkelur

Këto parime përbëjnë bazën e proçedimit penal.Kodi i Proçedurës Penale parashikon tre mjete proçeduriale me anë të të cilave mund të kundërshtohet vendimi i gjykatës së Shkallës së Parë:

- Apelimi në Gjykatën e Apelit
- Rekursi në Gjykatën e Lartë
- Kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë

1.5 Ankimi administrativ dhe tiparet e tij

Subjekteve të interesuar iu lind e drejta të ankohen në organin kompetent për aktin administrativ që i ka cënuar si dhe për të këekuar nxjerrjen e një akti apo kryerjen e veprimeve konkrete kur këto refuzohen të realizohen.Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi i detyruar të shqyrtojë ligjshmërinë,por nëse është evoja edhe rregullsinë e aktit të kontestuar.Sipas nenit 135 të Kodit të Proçedurës administrative: "Personat privatë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin,shfuqizimin ose modifikimin e akteve administrative,në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Kod."
Mënyra e ushtrimit të kësaj të drejte nga përsonat konkretë paraqitet me anën e një kërkese jo formale drejtuar ose organit përgjegjës për ankim,si dhe me anën e e një ankimi drejtuar organit që ka nxjerrë aktin e ankimuar ose organit më të lartë te tij.Paraqitja e një kërkese joformale ka kuptimin e një pëticioni apo ankese të thjeshtë e cila megjithëse nuk përmban elementët e domosdoshëm proçedurialë të një ankimi,ajo për organin që do ta shqyrtojë ka të njëjtin efekt,pasi ai duhet të japë përgjigje brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës.Ndryshe ng kërkesa joformale,ankimi administrativ është një mjet juridik më i plotë për të kërkuar shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ pasi kërkon edhe ndjekjen e një proçedure të veçantë shyrtimi.

1.6 Gjykimi në seksionin administrativ [49]

Në kompetencën e seksionit administrativ të gjykatës civile janë edhe padia me anë të së cilës kundërshtohet refuzimi i miratimit të një akti administrativ ose lihet pa u shqyrtuar në afatin e caktuar kundërshtimi i shtetasit në organin administrativ kompetent.

1.7 Rishikimi i aktit administrativ

Akti administrativ mund të jetë objekt shqyrtimi jo vetëm nga gjykata e zakonshme por edhe nga Gjykata Kushtetuese.Sipas nenit 13 pika c të Kushtetutës,Gjykata Kushtetuese vendos për papajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

[49] Kodi i Proçedurës Administrative të RSH,Pjesa e Peste"Procedimi administrativ"

Ndërsa neni 326 i Kodit të Proçedurës Civile parashikon se nuk mund të ndrihet padi në Gjykatën e Zakonshme për akte administrative që sipas Kushtetutës janë kompetencë vetëm e Gjykatës Kushtetuese .

Konkluzione

Legjislacioni aktual shqiptar paraqitet mjaft i plotë,përsa i përket garantimit formal të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.Ky aspekt i legjislacionit bëhet akoma dhe më i dukshëm nqs marrim parasysh se të drejtat dhe liritë e njeriut sanksionohen në Kushtetutë në standartet më të larta,në formën e një katalogu të drejtash dhe lirish.Njohja e statusit të brendshëm për traktatet ndërkombëtare të ratifikuara dhe e statusit kushtetues për K.E.D.NJ përfaqëson një tjetër aspekt të rëndësishëm të legjislacionit shqiptar.Akordimi i këtij statusi në rendin e jashtëm juridik,bëhet i mundur qe individët të mund të gëzojnë në kuadrin e të drejtës së brendshme,të drejtat dhe liritë e njohura nga K.E.D.NJ.
Perveç garancive formale të ofruara nga legjislacioni në fuqi,ekzistenca e institucioneve dhe proçedurave nëpërmjet të cilave individët adresojnë ankimet e tyre ,plotëson kuadrin material të garancive të ofruara.Sistemi gjyqësor i krijon mundësi individëve të paraqesin pretendimet e tyre para organeve gjyqësore,në mënyre që ato te gjykojnë mbi themelin e këtyre pretendimeve.Rekursi administrativ përfaqëson një tjetër alternativë efikase për të zgjidhur konfliktin e lindur me nxjerrjen e aktit të administratës publike,i cili cënon të drejtat e individëve.Paraqitja e ankimit,në të njëjtin organ që ka nxjerrë një akt të tillë,nuk mund të konsiderohet efektiv,ndërkaq kur ankimi i drejtohet një organi superior përmbush kriterin e efektivitetit te mjetit të ankimit.Ndërsa mundësia për tiu drejtuar gjyqësorit,duke kërkuar ndryshimin ose shfuqizimine aktit administrativ,i shërben atyre individëve që janë të pakënaqur nga rekursi administrativ.Nje hap përpara në garantimin e së drejtës së ankimit të individit,realizojnë nenet e Kushtetutës mbi të drejtën e individëve për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.Kjo e fundit kur gjykon mbi shkeljen e ssë drejtës për një proçes të rregullt ligjor paraqitet si një mjet efektiv ankimi në kuptimin e nenit 13 të K.E.D.NJ. Një tjetër institucion kushtetues,Avokati i Popullit,nuk mund të cilësohet si efektiv,mbështetur në kompetencat që u njihen këtij institucioni.Megjithëse në vija të përgjithshme normat e së drejtës materiale përqasen me kërkesat e nenit 13,për mjete efektive ankimi,nuk mund të themi të njejtën gjë për normat proçeduriale të së drejtës.Mangësitë ne rregullat proçeduriale janë më të dukshme në fushën e zbatimit të vendimeve të gjykatave.Mosekzekutimi në më të shumtën e rasteve të vendimeve të formës së prerë,privon individët nga e drejta për të përfituar nga të drejtat që gjykata i njeh atyre.Nga ana tjetër,duke mos ekzekutuar vendimet gjyqësore,atyre u mohoet e drejta për të përfituar dëmshpërblim për cënimin e të drejtave.Nën këtë këndvështrim paaftësia e organeve shtetërore për të marrë masat e nevojshme,në mënyrë qe individët të përfitojnë nga vendimi i gjykatës,mund të konsiderohet si shkelje te nenit 13 te K.E.D.NJ. Sistemi ligjor shqiptar,përveç ankesave lidhur me të drejtat kushtetuese nuk parashikon një mjet ankimi të veçantë,të cilën ankuesit mund ta përdorin me qëllim adresimin e pretendimeve të tyre për tejzgjatjen e proçedurave.Atje ku sistemi gjyqësor ka mangësi në lidhje me kërkesën mbi kohëzgjatjen e proçedurave sipas nenit 6 dhe 1 të Konventës,krijimi i një mjeti ankimi për të përshpejtuar proçedurat me qëllim parandalimin e tejzgjatjes së tyre është zgjidhja më e mirë.Pavarësisht nga sa më sipër,duhet vënë në dukje se Palëve të Larta Kontraktuese u njihet një pushtet diskrecionar lidhur me mjetet e ankimit të ofruara në nivel të brendshëm për ankime të mundshme të individëve.

Si rrjedhim,perveç parimeve të nënvizuara nga GJ.E.D.NJ mbi kriteret për zbatimin e nenit 13 të K.E.D.NJ ,janë karakteristikat,përkatësisht të çdo sistemi ligjor ato që bëjnë themelet kryesore për mjete efektive në të drejtën e brendshme të çdo Pale të Lartë Kontraktuese.

BIBLIOGRAFI

1. Anastasi A"E drejta Kushtetuese"2001
2. Kodi i Proçedurës Administrative
3. Kodi i Proçedurës Civile
4. Kodi i Proçedurës Penale
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
6. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
7. Kristq Traja "E drejta kushtetuese" tirane 2000
8. Kushtetuta e RSH-së
9. Ligji Nr.8454 dt.04.02.1999 "Mbi Avokatin e Popullit"
10. Ligji nr.8577,dt.10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese të Republikës së Shqipërisë."

Dr.Agim Berisha
agim.berisha74@hotmail.com
Address: No. 29 Rr.Motrat Qiriazi
Ulpian, 10000 Pristinë-Kosovë

7 Borxhi publik në Republikën e Kosovës

Abstrakt
Në këtë punim shtjellohet borxhi publik në Republikën e Kosovës. Borxhi shtetëror në veçanti është i pranishëm në vendet jo mjaft të zhvilluara, i cili ngarkon, edhe ashtu të ballafaquara me probleme të shumta, ekonominë dhe popullatën e këtyre vendeve. Vendet e rajonit duke përfshirë Kosovën me nivel të ulët zhvillimor balafaqohen viteve të fundit me borxhin publik. Në Kosovë, materia e borxhit publik rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-175 „Për borxhet publike'' në Republikën e Kosovës ku përcaktohet format e borxhit dhe mënyra e menaxhimit të tij. Në Republikën e Kosovës, borxhi publik zë fill viteve të fundit dhe krahasuar me vendet tjera të rajonit ka nivelin më të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në. Koncepte kyçe: Borxhi publik, BPV-ja, Borxhi i jashtëm, Borxhi i brendshëm, Borxhi i Nën-Huazuar.

1.Borxhi publik

Për të mbuluar deficitin buxhetor, shteti duhet të hyjë borxh, që shprehet negativisht në rrjedhat ekonomike. Borxhi shtetëror apo publik, siç quhet ndryshe, paraqet vlerën e akumuluar të huave, të cilat shteti i ka huazuar për t'i financuar deficitet e kaluara. Borxhi shtetëror për një periudhë të caktuar kohore është i barabartë me deficitin buxhetor të të njëjtës kohë. Borxhi shtetëror në veçanti është i pranishëm në vendet jo mjaft të zhvilluara, i cili ngarkon, edhe ashtu të ballafaquara me probleme të shumta, ekonominë dhe popullatën e këtyre vendeve. Kjo aq më parë kur dihet se borxhi qeveritar paraqet barrë të madhe për ekonominë dhe popullsinë e vendit përkatës, pasi që ai duhet kthyer me interes dhe si i tillë ngarkon, përkatësisht zvogëlon, të ardhurat kombëtare. Vendet e rajonit duke përfshirë Kosovën me nivel të ulët zhvillimor balafaqohen viteve të fundit me borxhin publik. Ligji Nr. 03/L - 175 „Për borxhet publike'' në Republikën e Kosovës, neni 1 i këtij ligjii jep të drejtën Qeverisë së Republikës së Kosovës për të huazuar para, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e Borxheve të saja Shtetërore. Veç kësaj, i jep Ministrit të Ekonomisë dhe Financave të drejtën dhe përgjegjësinë, për t'u kujdesur për tërë menaxhimin dhe administrimin e Borxheve. Në tabelën vijuese pasqyrohet zhvillimet fiskale në raport me BPV-në në vendet e rajonit.

Tabela 1:Zhvillimet fiskale në raport me BPV-në (në përqindje) në periudhën 2012

Shtetet	Të hyrat/BPV	Shpenzimet/BPV	Borxhi publik/BPV
Kosova	27.8	29.2	8.59
Maqedonia	28.7	31.3	30.9
Bosnjë e Hercegovina	47.0	49.8	43.7
Mali i Zi	37.6	42.7	53.9
Serbia	41.7	48.3	63.1
Kroacia	37.0	41.4	54.3
Shqipëria	24.9	28.4	63.8

Burimi:Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Buletini vjetor për vitin 2012, Prishtinë 2013

Grafiku 1: Zhvillimet fiskale në raport me BPV-në



Në tabelë dhe grafikë, pasqyrohen zhvillimet fiskale në raport me Bruto Produktin Vendor (BPV-në) në vendet e rajonit, ku vërehen dallime në mes të vendeve të rajonit sa i përket pjesëmarrjes së të hyrave në BPV-në, shpenzimeve në BPV-në dhe borxhit publik në BPV-në. Nga vendet e rajonit Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova kanë nivel më të ultë të pjesëmarrjes së të hyrave dhe shpenzimeve publike në raport me BPV-në në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në këtë kuadër, Kosova për dallim me vendet e rajonit ka nivelin më të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në.

Borxhi publik në Republiken e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit mbetet në nivel më të ulët, mirëpo duhet pasur kujdes në vijueshmëri rreth menaxhimin të tij.

Borxhet gjithnjë e më të mëdha të shtetit, prirja gjithnjë e më e madhe e organëve ligjdhënëse dhe ekzekutive të pushtetit që shumë shpenzime nga kompetenca e shtetit ti financojnë me mjetet e huas, tendenca gjithnjë e pranishme në shumë vende për zgjerimin e aktivitetit financiar të shtetit po e aktualizojnë gjithnjë e më tepër problemin e kufirit të hyrjes borxh të shtetit.[50] Në Kosovë kufiri i hyrjes borxh të shtetit parashihet në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-175Për borxhet publike në Republikën e Kosovës, ku përcaktohen kufizimet në Borxhin e Përgjithshëm, i cili nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV-së. Borxhi i përgjithshëm i Kosovës është borxh shtetëror, pasi Republika e Kosovës akoma nuk ka borxh komunal dhe nuk ka emetuar garanci shtetërore.

Në tabelen në vijim jepet borxhi i përgjithshëm sipas llojit.

Tabela 2:Borxhi i përgjithshëm (në milion euro)

	2009	2010	2011	2012	2013
Borxhi i jashtëm	249.01	260.42	253.60	336.60	323.21
Niveli Qëndrorë	249.01	260.42	253.55	336.46	321.73
Nën-huazimet	0.00	0.00	0.05	0.14	1.48
Garancionet shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Borxhi i Brendshëm	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51

[50]Prof.dr. Bozhidar Jelçiq, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, faqe 442, Prishtinë 1985

Niveli qëndrorë	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i përgjithshëm	249.01	260.42	253.60	409.92	475.72
Borxhi i përgjithshëm(% BPV-së)	6.37%	6.22%	5.51%	8.44%	9.10%

Burimi: Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm faqe 4, Prishtinë 2013.

Grafiku 2:Borxhi i përgjithshëm



Grafiku 3: Borxhi i përgjithshëm në % të BPV-së



Raporti në mes Borxhit/BPV-së është një nga mënyrat për të matur qëndrueshmërin e borxhit. Raporti Borxhi/BPV tregon nivelin e borxhit që ngarkohet ekonomia e vendit, që në Kosovë borxhi total në lidhje me BPV-në vazhdon të jetë në nivel të ulët.

Vështruar tabelen dhe grafikun vërehet se borxhi i përgjithshëm i Kosovës në fund të vitit 2013 arriti në 475.72 milion euro, apo 9.10% të BPV-së, nga të cilat borxhi i jashtëm 323.2 milion euro apo 6.20% të BPV-së dhe borxhi i brendshëm 152.5 milion euro apo 2.90% të BPV-së. Borxhi i përgjithshëm në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak është rritur për 16%, si rrezulltat i emetimit të bonave të thesarit në shumë prej 80 milion euro.

2.1.Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm paraqet borxhin që një vend u detyrohet vendeve të huaja ose institucioneve financiare ndërkombëtare nga të cilat ka marrë hua.[51] Borxhi i jashtëm i Kosovës është borxhi që e ngarkon Kosovën ndaj kreditorëve të jashtëm, ku pjesa më e madhe e borxhit është ndaj Bankës Botërore dhe FMN-së.

Tabela 3:Borxhi i jashtëm (milion euro)

	2009	2010	2011	2012	2013
Borxhi i jashtëm	249.01	260.42	253.60	336.60	323.21
Niveli Qëndrorë	249.01	260.42	253.55	336.46	321.73
Nën-huazimet	0.00	0.00	0.05	0.14	1.48
Garancionet shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i përgjithshëm	249.01	260.42	253.60	409.92	475.72
Borxhi i jashtëm në(% të Borxhit të përgjithshëm)	100%	100%	100%	82.11%	67.94%
Borxhi i përgjithshëm(% BPV-së)	6.37%	6.22%	5.51%	8.44%	9.10%

Grafiku 4: Borxhi i jashtëm



Nga tabela dhe grafiku vërehet se Borxhi i jashtëm i Kosovës i referohet nivelit qendrorë ndërsa nivelet lokale (Komunat) ende nuk kanë qasje në borxhin publik. Borxhi i jashtëm i Kosovës është rritur që nga viti 2009 në vijueshmëri, duke arritur nga 249.01 milion euro sa ishte në vitin 2009 në 323.2 milion euro në vitin 2013. Në portofolin e borxhit, vërehet se pjesmarrja e borxhit të jashtëm është më e madhe karshi borxhit të brendshëm, kështu që në vitin 2013 borxhi i jashtëm përbën 68% të borxhit të përgjithshëm.

[51] Prof.dr.Musa Limani, Makroekonomia, faqe 241, Prishtinë 2013.

2.2.Borxhi i brendshëm

Borxhi i brendshëm paraqet pjesë të borxhit publik që shteti u detyrohet subjekteve ekonomike dhe qytetarëve të vet.[52]Në nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L - 175 „Për borxhet publike'' në Republikën e Kosovës, përcaktohet forma e borxheve, ku një nga format e borxheve është edhe emetimi i letrave me vlerë. Qeveria ka filluar të emetoj Letra me Vlerë (Bona të thesarit) në janar të vitit 2012. Ankandi i parë ka përfunduar me sukses më 17 janar 2012.[53] Sipas Ligjit për Borxhet Publike[54], komuna nuk mund të hyjë në borxh publik pa i plotësuar parakushtet e parapara, kështu që aktualisht nuk ka ndonjë borxh komunal.

Tabela 4: Borxhi i brendshëm (milion euro)

	2009	2010	2011	2012	2013
Borxhi i Brendshëm	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51
Niveli qëndrorë	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i përgjithshëm	249.01	260.42	253.60	409.92	475.72
Borxhi i brendshëm në(% të Borxhit të përgjithshëm)	----	----	----	17.89%	32.06%
Borxhi i përgjithshëm(% BPV-së)	6.37%	6.22%	5.51%	8.44%	9.10%

Grafiku 5: Borxhi i brendshëm



Nga tabela dhe grafiku pasqyrohet borxhi i brendshëm, ku vërehet se deri në vitin 2012 nuk kishte ende borxh të brendshëm në kuadër të borxhit të përgjithshëm. Në vitin 2012 paraqitet borxhi i brendshëm, kështu që në fund të vitit 2013 borxhi i brendshëm arriti në shumen 152.51 milion euro apo 32% e portofolit të borxhit.

[52]Prof.dr.Musa Limani, Makroekonomia, faqe 237, Prishtinë 2013.
[53] Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Strategjia vjetore e borxhit 2013, faqe 9, Prishtinë 2012.
[54] Neni 30, Ligjit Nr. 03/L - 175 Për borxhet publike në Republikën e Kosovës.

2.3.Borxhi i Nën-Huazuar

Borxhi i Nën-Huazuar përfshinë borxhin e huazuar të Qeverisë nga kreditorët e jashtëm. Borxhi i Nën-Huazuar përfshinë në vete fondet e huazuara të Ministrisë së Financave nga kreditorët e jashtëm, të cilat fonde pastaj Ministria e Financave i nën-huazon te organizata e sektorit publik. Në rastet e tilla, MF së pari e nënshkruan marrëveshjen e financimit me kreditorin dhe së dyti hynë në Marrëveshje Nën-Huazuese me organizatën e sektorit publik.[55] Sa i përket shlyerjes së borxhit së pari organizata e sektorit publik e shlyen borxhin te Ministria e Financave, e më pastaj Ministria e Financave e transferon borxhin te kreditorët. Borxhi aktual i nën-huazuar është kryesisht i zotuar për projekte në fushën e ujit, energjisë, dhe ngrohjes qendrore.

Tabela 5:Borxhi i Nën-Huazuar (milion euro)

Organizata e sektorit publik	Kreditori	Shuma	Norma e interesit	Tarifa e zotimit	Distribuimet
KOSST	Kfw	17,000,000	4.82%	0.25%	0
Kompanija Rajonale e ujësjellsit	Kfw	6,000,000	0.75%	0.25%	111,507
Termokos	Kfw	5,000,000	8.79%	0.25%	0
Borxhi total i nën-huazuar		28,000,000			111,507

Burimi: Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Strategjia vjetore e borxhit 2013, faqe 11, Prishtinë 2012.

Grafiku 6: Borxhi i Nën-Huazuar



Nga tabela dhe grafiku vërehet se shuma e borxhit të nën-huazuar është 28,000,000 milion euro, ku si kreditor i jashtëm është Kreditanstalt für Ëiederaufbau (KfË)[56], mirëpo deri tani vetëm 25 % apo 111,507 mijë euro janë distribuar te kompanija rajonale e ujësjellësit.

Përfundimi

Borxhi shtetëror është i pranishëm në vende të ndryshme në veçanti në vendet jo mjaft të zhvilluara, i cili ngarkon, edhe ashtu të ballafaquara me probleme të shumta, ekonominë dhe popullatën e këtyre vendeve. Qeveritë marrin hua duke emetuar letra me vlerë, obligacione qeveritare, etj nga publiku si borxh i brendshëm dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare si borxh i jashtëm.

[55]Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Strategjia vjetore e borxhit 2013, faqe 10, Prishtinë 2012.

[56]Banka për Zhvillim e Gjermanisë

Vendet e ndryshme të botës kanë nivele të ndryshme borxhi dhe ky nivel përcaktohet nga gjendja e ekonomisë.
Borxhi publik është borxh i marrë nga qeveria qendrore dhe është një nga mënyrat e financimit të operacioneve të qeverisë. Sipas ligjit, borxhi publik i Kosovës nuk duhet të kalojë më shumë se 40% të GDP-së dhe deficiti buxhetor jo më shumë se 3% e saj.
Në kuadër të borxhit publik në Republikën e Kosovës vlen të theksohet se:
Kosova për dallim nga vendet e rajonit ka nivelin më të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në.
Borxhi i përgjithshëm i Kosovës përkundër nivelin të ulët prej 9.10% të BPV-së, nga të cilat borxhi i jashtëm 6.20% të BPV-së dhe borxhi i brendshëm 2.90% të BPV-së, ka trend rritës prej 16% në vitin 2013 nga viti paraprak.
Kosova duhet trajtuar në vijueshmëri me kujdes menaxhimin e Borxhit publik.

Literatura

1. Prof. dr. Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë 2013,
2. Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Strategjia vjetore e borxhit 2013, Prishtinë 2012,
3. Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm, Prishtinë 2013,
4. Ligjit Nr. 03/L - 175 ,,Për borxhet publike'' në Republikën e Kosovës,
5. Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Buletini vjetor për vitin 2012, Prishtinë 2013.
6. Prof.dr. Bozhidar Jelçiq, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Prishtinë 1985.

Phd. Cand Arjeta Hallunovi
Lecturer of Finance, Faculty of Business, "Aleksander Moisiu" University, Durres, Albania.
Tel: 0692025212, E-mail address: arjeta26@yahoo.com.

Msc. Kozeta Jana
Chief of finance in the municipality of Kelmend,
Shkoder, Albania

Dr. Elidiana Bashi
Lecturer of Finance, Faculty of Business, "Luigj Gurakuqi" University,
Shkoder, Albania.
Tel: 0682060733, E-mail address: elidianapema@yahoo.com.

8 The liquidity risk and the albanian banking system

Abstract
Liquidity risk is considered as the lack of cash for repay debts and the commitments when they mature. Liquidity Risk is the one of the main financial risks facing any financial institution. The activity of banks, obtained in the study, is characterized from a tense interweaving, of the current cash inflows and outflows, and from the need for harmonization in order to favor the entrances flow in a timely manner and in an economic mean of payment, in order to cope with the burden of liabilities. The banks have determined many ways to measure and manage the liquidity risk, such as: (a) required reserve, which includes the minimum reserve in cash that is a request from the Central Bank, the deposits in the Central Bank, insurances that are used as a collateral in the monetary operations in Central Bank. (b) Liquidity ratios, the level of reliabilityofcash flowforecast, at the entranceandat theexit. (c) The quality ofthe funds diversification, meansthe prediction of astructurepaymentsover aspecifiedtime horizon. (d) The assessmentof thestructureof the bankassetsfordeterminingtheir levelofliquidity.As any business firm, the bank aims to maximizing the profit. The features of its activity put in front of the prediction of a fundamental dilemma that should be resolve, the liquidity dilemma towards the profit.The bank solves this dilemma through the banking management, that includes four main components which are: the liquidity management, the management of assets, the management of liabilities, the management of interest risk rate As statedabove, the basichypothesis ofthis paperis: The good management of liquidity risk is crucial to the survival of the financial system, and more specifically, the banking one.
Key Words: *Banks, Liquidity, Risk, Market.*

I. Introduction on the liquidity risk

The liquidity risk is considered a lack of cash for the debts and commitments, when they mature. It arises as a consequence of the policy of fund administration and administration of position.The liquidity risk is theone of themainfinancialrisksfacinganyfinancial institution. It is definedindifferent ways: asthe extremelackofliquidity, the lackofcurrent assetsto covershort-termliabilities, as wellasdifficultiesin findingfunds.All thefinancialrisks: creditrisk, interestrate risk, marketrisk, foreign exchangerisk, couldthreatenthe solvency offinancialinstitutions, butmorethreateningis the liquidity risk,which will belargelytreatedinthis paper.

This paper is important because it addresses some important current issues such as: the liquidity crises are always just one step away from the bankruptcy crisis; the bank bankruptcies and the liquidity crises have done the bankers more vigilant for the need of liquidity, the liquidity is a good choice which the banks use it to survive, the liquidity is always primary for the banks etc..The banks need to have liquidity to meet the clients' demands for liquidity. Since the banking operations, as withdrawals and borrowings are daily, banks should be prepared for the daily liquidity demand.The liquidity requirements comes from these main resources: customers that withdraw their deposits, customers who wish to borrow, customers who want to renew the existing agreements or loans or they start using the approved lines of credit; discrepancies between assets and liabilities; the causes that can be associated with the reputation of the bank etc..Other sources of the liquidity requirement are related with the payment of obligations that come from bank borrowings, from the Central Bank or other banks of the second level.

II. The treatment of liquidity from the banks of the second level

By looking, at how quickly the market liquidity conditions could change and how long it takes to the market to cover the demolition of the liquidity conditions, for the banks and the regulators becomes necessary to look carefully to the liquidity risk management. The deposits as a banking services are less important in the 21st century, but the liquidity of funds from the credit lines and loans is done most important.The risk managementhasanelement ofpriceandaquantitycomponent.

- *The price factor* or the interest rate risk, is focused on the price with which the assets can be sold and with the rate at which obligations can be provided.
- *The quantity factor* is focused on the existence or not of the assets that will be sold and if it can be provided or not in money market the funds at any cost.

If the assets can be sold with their nominal value, in that case the price of risk that accompanies collected liquidity is negative. If the the assets are sold with losses, then the price of liquidity risk will depend on the price of the concession, which itself depends on the size of the interest rate of assets when they are sold. The liquidity risk can be defined in two ways:

- *The liquidity risk of the product (market)* caused when a transaction can not be performed due of the insufficient activity of market. This may be a problem for the forward contracts (ALL / Valutë), with the aim of protecting the open position. The assessment of liquidity risk is difficult and varies with the changing conditions of the market, the temporal part of the unsystematic risk can be managed with of the assets side of the diversification in time and diversity.
- *The liquidity risk of funds (cash flow)* is the possibility that the banks do not have liquid funds to realize the payments that deriving from the liabilities it has.

This lack of liquidity may be is caused by the discrepancy in value and time of the maturity of the assets with liabilities, that is known as the "maturity gap" or the sudden rise to a demand to realize liquidity. As every business firm, the bank aims maximizing the profit. The special characteristics of its activity, set it in front of a fundamental dilemma that should be solve - the liquidity dilemma versus the profit. The axis on which it relies this dilemma lies on one hand by the needs of the bank in providing liquidity to confront the depositors pressure and on the other hand by the insurance of the profit with few reserves but accompanied with more loans that brings interes. In case that the banks does not handling the requirements for withdrawal, it can be converted in a banking panic, that consequently may lead the bank into bankruptcy. The bank can solves this dilemma between the banking management including four main components, as follows:

II.1The main techniques of management and risk are:

- Keeping a portion of the assets in form of primary reserves, that can be obligatory and excessive.
- The reduction of loans (the non renewal of short term loans in maturity, so this effects the increasing of its primary reserves). This technique on one hand provides the necessary additional liquidity, and on the other hand is accompanied by the cost of the loss of interest and the possible loss of clientele.
- The sale of existing loans. Providing additional resources from the sale with discount of the non mature loans to other banks. Generally, this sale is accompanied with higher discount from the lack of information from the banks that buy, which represents loss for the bank that sells.
- The holding of the liquid assets in the form of secondary reserve. The sale of these liquid assets in the secondary market may fullfill the need for additional reserves.
- The loans with discount, that are taken from the Central Bank. The costs will increase anew by the fact that the Central Bank is prudent in granting these loans.
- Interbank loans. The banks that have surplus, withdraw the liquidity in the market and it is very costly because the interest rates paid for the obtained loans vary according to the market conditions.

The resultant from each method based on the difference between the potential nonpayment of the interest that stems from the application of these methods with the cost represented by the interests of a rejected loan.

III. The risk management of interest rate.

The interest rate risk represents the changes in the bank's earnings due to the changing in the interest rate. This risk comes as a consequence of the fact that the assets and liabilities have different structure of the maturity period. The change of the interest rate in the long run becomes more slowly than at the short term, so the impact of these rules on bank liquidity and profit are realized through the changing in difference between the current assets to short term liabilities. The degree of interest rate risk is measured through these analysis:

The gap - The sensitivity of the bank profits from interest rates measured as the difference between current assets with short-term liabilities.

The duration-thereactiondegreeof assetsandliabilitiesbetween the changeofthe interest rate.

IV. The risk management techniques to the interest rate.

1.The bank aims to integrate the assets and liabilities by making the optimal portfolio choice, so that the specific weight of the current assets to approach as much as to the specific weight in short term liabilities, therefore to have a right proportion between the different maturity terms in active and passive . But, given that the bank may have a very good experience from a structure in a given maturity, it will have a cost in the short term period, so it can be used other techniques that leave the intact the structure of assets and liabilities.

2. *One of the most popular techniques* is the one of the exchange of the direct expenses or revenues between banks that have different terms (the opposite) maturities, known as the technical SWAP. In order to avoid the risk of loss, two banks make an agreement to share the short-term expenses with the long term liabilities. Thus enabling the sharing of profit and loss between them.

IV.1 The sources of the risk of interest rate :

The risk of profitability rate;

The risk ofover appreciation;

The basis risk (the possibility to lose as a result of setting different prices of equivalent instruments);

The risk of the optional effect.

V. The liquidity forecasting

The forecast of liquidity of the banking system is a key element in the management of liquidity by the Central Bank. With the term "liquidity" in view of the Central Bank will recognize the level of reserves that the second level banks have in the Bank of Albania.The level ofreservesdoes notmean onlytheexcessof reserves, butis a summaryofinvestments inrepo(including allmaturities) in overnightdepositsandthe excessivereserves.The main aim to produce a forecast for the liquidity of the banking system is to provide a basic information for the monetary operations, that are carried out to create sustainable liquidity conditions in the market. In these conditions, the forecast of liquidity of the banking system performs two main functions:

- consolidatesthe informationforthestate ofliquidityexpectations;
- helpsthe central banktoavoidlargevolatilityofliquidity.

The horizon of the liquidity forecastshould be atleastequal to the periodof holdingrequired reserves, butthenecessaryintervalis the timebetweentwosuccessiveinterventionsin the money market.As the main instrument of the Bank of Albania is the repurchase agreement with one - week maturity period, the efforts to build a forecasting system are initially done with a one-week maturity. By definition, the change in excess reserves (ΔR) of the banks with the central bank reflects the changes in net foreign assets (ΔNFA), in the net position of the government (ΔNPG), in the cash (ΔC), in the operations of central bank (ΔOCB) and in "other" neto (ΔON). Specifically:

$$\Delta R = \Delta NFA + \Delta NPG + \Delta C + \Delta OCB + \Delta ON$$

VI. Prevention or forecast?

In accordance with the frequent tensions of the market, the question arises about how can be ensure from the liquidity shocks in the future or at least how can it be covered? The proposals arising in the symposium of the bank of France have included two extensive attacks First, the centralbanksshouldbe includedin theimpuritycreatedduringtheliquiditycrisis. According to Andre Crockett, the centralbanksneedto extendthelimitof collateralacceptedwhenthey provideliquidityfor thecommercial banks.

This will facilitate the pressures on the money market, will also improve the liquidity of the market for the appropriate assets as security for the central banks, as well as the acquisition of overall financial stability. Second: This proposal relates to the strengthening of severity of the bank liquidity rules. Maintaining a low level of the yield of liquid assets, it will be cost to the bank. Theydo not wanttowithdraw themselvesfromtheprofitablelending, onlyto protectthemselves fromtheremotechangestoliquidity,especiallyinconditionsofcrisiswithin whichthe centralbanksget helpwithextraliquidity.For these reasons the banks should be encouraged to manage seriously their cash, in the same line with the risk of non-payment of liabilities. Their concern is related to the fact that a liberal regime can shift to the collateral private markets and their disciplines.The proposal of of liquidity insurance may influence the price of the affected assets in the private sector, may also discourage private sources by the keeping of the liquidity, ensuring less satisfactory use of them.

Conclusions

- The unsettlement ofa bank'sliabilitiesinthe interbankmarkettooneor morebanks in the systemcancausetheinsolvency ofother banksinthe formofadomino effect, causing the collapse of theentire financial system.
- The analysis of liquidity risk and the appropriate measures are important because of its crises are one step away from bankruptcy banks.
- The liquidity risk in the banking sector, also is considered moderate. As before, the deposits constitute the main source of funding in the banking sector and they are increased rapidly.The borrowing by non-residents has been declining but remains controlled. The liquid assets of the sector, in domestic currency and in the main currencies, are well above the minimum levels required by the regulatory framework. The ratio "loan / deposit", is at optimum levels.
- Albania is preparing to soon have greater access to the global financial markets, and therefore should hurry developments in international finance, because soon they will become more important, because our markets will become more vulnerable to external shocks due to further integration and the deepening of them.
- In Albania the loan portfolio consists mainly in new loans, which have evolved a lot in the last two years in the presence of high demand for loans from the private sector, and the high willingness of the banks to satisfy this requirement. Currently, we have a slower credit growth.

Recommendations

- For the long term periods, the liquidity needs are related to tendencies of the market in which banks operates and economic development. For countries with fast developing, the liquidity risk is more threatening because the pace of credit growth is higher than the growth of deposits, which may be associated with liquidity problems. As for the stable countries in terms of economic growth, the deposits tend to grow and the loans tend to maintain at a certain level.
- Banksshouldpossessadministrativeproceduresandinternal controlsthatallowmonitoringtheliquidity risk. Theycanuseseveral techniquesto manage thesources of fundsin order to reducethe liquidity risk. Regarding tothe sources of funds, bankscan:

  Requirestabledeposits;
  To raiseits own funds;
  To promote theproductsforlong termperiods;
  Tomaintainitscredibility.

  About their use the banks may:

  Provides credit maturities correlated with the deposits collected;
  Checks carefully the other risks associated with banking activities;
  Diversifies its loan portfolio.
- The improvement of the liquidity forecast in the banking system will come from the institutionalization of the information disclosure for the expected movements of the banks fund of the second level.

References

BoA, (2003), A Guidanceonliquidity.
Grier, W, Credit Analysis of Financial institution, Second Edition.
Salko, D and Dhuci, O, The banking management.
Sinkey, Joseph F, *Commercial Bank Financial Management*.

Dr. sc. Bislim Lekiqi
Universiteti AAB
bislim_lekiqi@yahoo.de

9 Reflektimi i motivimit të të punësuarve në suksesin e ndërmarrjes

Abstrakt

Ndryshimet e shpejta të ndodhura në Kosovë pas vitit 1999, janë rrjedhojë e ndryshimeve politike që u pasuan me ndryshimet ekonomike. Në këtë kuadër angazhimi në studime ekonomike në tërësinë e problemeve që përfshijnë ato, përbën një domosdoshmëri. Një nga drejtimet e punës kërkimore tepër delikate është edhe menaxhimi i burimeve njerëzore.
Ekonomia dhe shoqëria po përjetojnë ndryshime shumë të shpejta në dekadat e fundit. Për këtë arsye ndërmarrjet dhe bizneset në përgjithësi ndodhen para sfidave të mëdha për të ruajtur ekzistencën e tyre, rritjen, zhvillimin dhe nivelin e tyre konkurrues. Kjo kërkon që bizneset në përgjithësi të jenë në përshtatshmëri të vazhdueshme me kushtet.
Dinamika e përshtatshmërisë është e kushtëzuar edhe nga gjendja dhe zhvillimet e burimeve njerëzore.
Problemet e menaxhimit të burimeve njerëzore në tërësinë e tyre, ndihmojnë bizneset për të qenë konkurrent nëpërmjet të krijimit të vlerave. Tradicionalisht vlera është konsideruar dhe trajtuar vetëm nga këndvështrimi i vlerës materiale. Me lindjen dhe zhvillimin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si shkencë, vlera u trajtua edhe nga këndvështrimi i vlerës njerëzore. Nga ky këndvështrim bizneset duhet të bëjnë kujdes për krijimin, ruajtjen dhe avancimin e vlerave njerëzore edhe nëpërmjet të përdorimit të formave të ndryshme të motivimit.
Në këtë punim mbi bazë të hulumtimeve personale trajtohen problemet e motivimit të punonjësve në Ndërmarrjet Përpunuese në Kosovë. Në të do të prezantohen praktika motivuese edhe nga shtete të përparuara.
Rezultatet e punimit do t'i shërbejnë menaxherëve për të ndërtuar punën e tyre në të ardhmen.

Fjalë kyçe: *motivim, burime njerëzore, menaxhim, përshtatshmëri*

Hyrje

Në një situatë të krijuar komplekse, dinamike dhe në një ambient ekonomikisht shumë të vështirë Burimet Njerëzore të ndërmarrjes vlerësohen si faktor strategjik të suksesit të ndërmarrjes. Kjo nuk arsyetohet thjeshtë me faktin se, bashkëpunëtorët e kualifikuar sigurohen vështirë si dhe qasja ndaj aftësive të tyre profesionale dhe njohurit e tyre, kërkon një aftësi të posaçme. Këto zhvillime e pozicionojnë MBNJ në qendër të detyrave dhe funksioneve të ndërmarrjes. Bashkëpunëtori si njeri në qendër të procesit të performancës së ndërmarrësisë, është aktori kryesor në procesin e punës, prandaj është në interes të analizës që të gjejmë karakteristikat esenciale të cilat e identifikojnë bashkëpunëtorin me ndërmarrjen.
Rritja e produktivitetit të njeriut si element organizativ mund të lidhet ngushtë me gatishmërinë për punë, në aftësinë për punë dhe në mundësinë për të punuar (e shprehur shkurtë: Donë - Din -Mundet). Pasi që njerëzit vullnetarisht janë "element" të një sistemi organizativ, mund të menaxhohen, sepse njerëzit janë të gatshëm të kontribuojnë.

Lidhmëria në mes të aftësisë dhe gatishmërisë për të dhënë kontributin në punë është komplekse. Bashkëpunëtorët të cilët janë të kënaqur me punën e tyre i rreken punës më me përkushtim se sa bashkëpunëtorët e pa kënaqur.
Mbështetja sociale e bashkëpunëtorëve ka ndikim të madh në motivim. Në vendet e zhvilluara, bashkëpunimi në mes të ndërmarrjes dhe instrumenteve sociale janë duke gjet përdorim gjithnjë e më të madh.
Këtu në shumicën e rasteve, nga këndvështrimi i ndërmarrjes, kemi të bëjmë me faktin se lehtësimi i bashkëpunëtorëve nga disa obligime, si një Instrument për ZHBNJ do të shërbej për zhvillimin e kompetencave të bashkëpunëtorëve. Nga këndvështrimi shoqëroro – politik, ndërmarrja merr obligimin qytetar (obligim nderi) që të përkujdeset për bashkësinë. Me këtë ndërmarrja tregon dhe forcon pozicionin dhe rolin e saj në ruajtjen e vlerave të ekonomisë në shtet dhe në shoqëri.
Objektivi kryesor i këtij punimi është të vlerësojë situatën aktuale të motivimit të punonjësve dhe të ofrojë zgjidhje të mundshme për rritjen e nivelit të efiçiensës së veprimtarisë së ndërmarrjes me parakusht motivimin.
Realizimi i objektivit kryesor mundësohet nëpërmjet realizimit të objektiva specifike si:

- Të prezentoi vlerësimin e menaxherëve dhe të punësuarve rreth faktorëve motivues në ndërmarrje
- Të argumentojë dhe konfirmojë vërtetësinë e disa teorive shkencore në fushën e motivimit
- Të evidencojë domosdoshmërinë e motivimit për arritjen e suksesit.
- Të argumentojë rolin e pagës si motivator dhe probleme lidhur me të.
- Të rekomandojë disa zgjidhje për periudhën aktuale

Objekt i studimit u zgjodh motivimi i të punësuarve, posaçërisht i atyre në ndërmarrjet përpunuese në Kosovë (që për lëndë të pare përdorë produktet agrare) për faktin se industria përpunuese në Kosovë ka një rol shumë të rëndësishëm nga fakti se ajo ka resurse të konsiderueshme natyrore dhe njerëzore për të qenë një sektor i qëndrueshëm ekonomik, por përkundër kësaj, ato resurse mbesin pak të shfrytëzuara, gjersa ky sektor ekonomik është duke u ballafaquar me një konkurrencë të forte nga jashtë, dhe për këtë arsye, kërkon një qasje të re, me qëllim që të siguroi një vend të merituar në ekonomin kosovare dhe atë rajonale.

Metodologjia

Metodologjia e ofruar për këtë punim ka të bëjë me kërkime në literaturën ekonomike përkatëse të rekomanduar, grumbullim të dhënash nga dokumente të disponueshme, kërkimet, analizat në terren dhe të dhënat të siguruara nga pyetësori i përgatitur për këtë qëllim.

Rezultatet dhe diskutimi i tyre

Ndër faktorët vendimtar që ndikojnë në performancën e bashkëpunëtorëve është edhe motivimi i bashkëpunëtorëve për punë dhe me këtë edhe kënaqësia në punë. Që të rritet motivimi i bashkëpunëtorëve për punë, duhet të ofrohen disa parakushte. Ndër këto llogariten kryesisht kushtet relevante të udhëheqjes në ndërmarrje, të cilat përmbajnë aspekte kualitative. Edhe kultura e ndërmarrjes kontribuon në identifikimin e Burimeve Njerëzore dhe ndikon në atmosferën e punës.Arsyen për motivim e gjejmë në të gjitha poret e jetës. Ato janë të shumëllojshme.
Në punimin tonë do të ndalemi në motivimin për punë dhe për rezultate të punës.Motivacioni shprehet në kuptimin e mobilizimit të forcave, për arritjen e një objektivi pa u larguar nga ai. Pra këtu kemi të bëjmë me atë se dikush ka një objektiv, se ai angazhohet dhe mbetet i pandryshueshëm në realizimin e tij. Motivivacioni mund të jetë si nxitje shpirtërore, pra një ndikim që vjen nga brendia e njeriut, që në literaturë njihet si Motivacion Intrinik (në gjuhën gjermane: Intrinische Motivation), siç është synimi për një punë të rëndësishme dhe me

përgjegjësi të plotë, liria për vendimmarrje, mundësitë për zhvillim personal dhe për punë interesante. Vlerat si besueshmëria, vetëpërgjegjësia, angazhimi dhe kreativiteti janë motivime të brendshme.
Ato janë të bazuara në kureshtje dhe kënaqësi.Motivacioni që ndikohet nga jashtë, i njohur në literaturë si Motivacioni Exstrinik (në gjuhën gjermane: Extrinische Motivation) është e kundërta e Motivacionit Intrinik, dhe ky motivacion vije nga punëdhënësi. Shembuj të motivacionit të jashtëm janë: ngritja në pozitë, rritja e pagës (dhe të gjitha format tjera të shpërblimeve materiale), pushimi shtesë i paguar etj.
Dallimi në mes të këtyre dy forma të motivacionit është se motivacioni nga jashtë si rregull është më i fortë por ka ndikim afatshkurtër, kurse motivacioni i brendshëm është afatgjatë. Në disa raste motivacioni i shkaktuar nga jashtë ndikon negativisht në motivacionin e brendshëm, nga i cili bashkëpunëtori do të kryej punën të cilën nuk do ta bënte me dëshirë, që në një të ardhme do të krijoi pakënaqësi.
Një kontribut të posaçëm në fushë e motivimit ka dhënë Herzberg, me teorinë e dy faktorëve, ku ai cek se sjellja në punë ndikohet nga dy lloj faktorësh: Faktorët Higjienik (rrogëdhënia dhe paga, politika e burimeve njerëzore, marrëdhëniet ndërnjerëzore në mes të punësuarit dhe mbikëqyrësit, stili i udhëheqjes, kushtet e punës, siguria në punë dhe ndikimi në jetën private)dhe Motivatorët (mirënjohja, kontributi dhe suksesi, përmbajtja e punës, përgjegjësia, ngritja profesionale dhe ngritja në pozitë). Sipas Herzvberg, Motivatorët krijojnë kënaqësi dhe motivacion në punë, kurse faktorët Higjienik nuk e bëjnë këtë, por plotësimi i tyre shmang pakënaqësinë në punë.
Rëndësinë e njohjes së formave të motivacionit në MBNJ mund ta vërejmë në disa aspekte.
Së pari, sepse mund të kuptojmë larminë e sjelljeve, të lëvizjeve dhe veprimeve të bashkëpunëtorëve, për të gjykuar më drejtë mekanizmat e motivacionit të tyre, si dhe përmes kësaj mund ta kuptojmë më lehtë pozitën tonë ndaj bashkëpunëtorëve dhe me këtë edhe mënyrën e komunikimit dhe mardhëniet me ta.
Së dyti, sepse mund të vlerësojmë më drejt bashkëpunëtorët dhe që ti përsosim ndërhyrjet në nivelet emocionale të tyre, për të ndikuar në ta, për realizimin e objektivave të ndërmarrjes në një anë dhe plotësimit të nevojave të bashkëpunëtorëve në anën tjetër.
Zhvillimi i një anketimi profesionale tek bashkëpunëtorët se çka i motivon në punë do të sillte rezultate të vlefshme për ndërmarrjes. Para se të ndërmerret një anketim në një ndërmarrje, duhet pas parasysh se rezultatet duhet të jenë të njohura për të anketuarit, sepse bashkëpunëtorët presin që mendimet e tyre të analizohen dhe të vihen në jetë në atë formë që do të ketë ndikim pozitiv në punën e përditshme. Rezultatet e nxjerra japin mundësinë që bashkëpunëtorëve të ju krijohet një ambient pune ku secili mund të shpreh aftësitë pozitive të tija dhe ti aplikoi në një formë që i sjell dobi - fitim ndërmarrjes. Me këtë rast nuk duhet harruar se secili bashkëpunëtor kërkon një qasje individuale, që të ketë mundësi që të liroi potencialin e tij punues.
Por implementimi i rezultateve të një anketimi rreth motivimit - faktorëve ndikues në rritjen e rezultateve tek bashkëpunëtorët, qëndron në aftësitë dhe kompetencat e udhëheqësve në ndërmarrje. Rezultatet e nxjerra shpien në ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara, të cilat duhet kontrolluar, sepse në të kundërtën është e pamundur të dëshmohet efiçenca dhe efektiviteti i aksioneve të ndërmarra.
Anketimi i bashkëpunëtorëve në firmat e vizituara, deri më tani nuk është aplikuar. Në vendet tjera që kanë një ekonomi të zhvilluar është një praktikë që është zhvilluar në vazhdimësi dhe tani shprehet si një domosdoshmëri. Kjo mund të shihet më së miri në punimin e Dr. Rüdiger Hossiep dhe Philip Frieg nga Ruhr-Universität Bochumnga grafiku vijues.



Figura 1. Pamje: Implementimi për herë të parë i anketimit të bashkëpunëtorëve në Gjermani, Austri dhe Zvicër, Burim: Dr. Rüdiger Hossiep dhe Philip Frieg (Projektteam Testentwicklung, Ruhr-Universität Bochum, , Der Einsatz von Mitarbeiterbefragungen in Deutschland, Österreich und der Schweiz, faqe 3.

Pra anketimi i bashkëpunëtorëve në këto shtete është duke fituar vazhdimisht në peshë. Është një shembull i mirë që duhet aplikuar në Kosovë.

Për të pasur një pasqyrë më të mirë për gjendjen në fushën e motivimit të bashkëpunëtorëve në Kosovë, kemi kryer dy hulumtime

Hulumtimi i parë, për synim kishin analizën e gjendjes në ekonomin kosovare, posaçërisht të interpretimit të Teorisë së dy faktorëve nga Herzberg në kushtet kosovare, ku në hulumtimin e parë janë intervistuar 100 persona të profesioneve të ndryshme. Nga ky hulumtim janë nxjerrë rezultate se çka i motivon të punësuarit në Kosovë nga këndvështrimi i të punësuarit.

Në hulumtimin e dytë , që është zhvilluar në 9 (nëntë) ndërmarrjeve përpunuese që për lëndë të parë përdorin produktet agrare janë hulumtuar faktorët që motivojnë të punësuarit nga këndvështrimi i punëdhënësit.

Hulumtimi i zhvilluar me 100 të punësuar ve në dukje se Teoria e dy faktorëve nga Herzberg, në kushtet Kosovare hasë në disa nevoja për modifikime. Gjersa te hulumtimi i zhvilluar nga Herzber, Faktorë Higjienik kryesor, sipas renditjes janë: Politika e firmës, kompetencat teknike të udhëheqësit, raportet personale me udhëheqësin, kushtet e punës, të ardhurat dhe kështu me radhë, ndërsa hulumtimi i bërë në Kosovë ve në dukje se Faktor kryesor Higjienik, sipas renditjes janë: Të ardhurat, kushtet e punës, politika e firmës, siguria, statusi, ndikimi në jetën private dhe kështu me radhë. Ndërsa tek Motivatorët, hulumtimi në Kosovë tregon se kemi një ndryshim të theksuar ku Paga paraqitet motivatori i dytë për nga përqindja e të anketuarve, por edhe disa faktor tjerë higjienik paraqiten si Motivator të theksuar siç janë: kushtet e punës, raporti personal me kolegët, siguria, raportet personale me udhëheqësin. Sipas hulumtimit në Kosovë, kompetencat teknike të udhëheqësit nuk luajnë rrol të theksuar si Motivator.



Figura 2. Rezultatet e hulumtimit nga Herzberg për Teorin e dy faktorëve Burim: Herzberg. F., One more time, How do you employees? In Harvard Business Review 48 (1968), Nr. 1, S57 dhe http://de.wikipedia.org/wiki/Zwei-Faktoren-Theorie_(Herzberg)



Figura 3: Rezultatet e hulumtimit në kushtet e ekonomisë kosovare, të kryer në Gusht 2010, bazuar në teorinë e dy faktorëve nga Herzberg.

Përpunimi individual i të dhënave sjell deri tek informata se ndërmarrjet të cilat janë të pozicionuara mirë në degën e tyre apo në përgjithësi në ekonomin kosovare, përdorin në mënyrë të konsideruar instrumente të duhura të motivimit si mirënjohje për punën e bërë, vlerësojnë kontributin dhe suksesin, për vendin e punës ofrojnë një përmbajtje profesionale të punëve dhe detyrave, të punësuarve përpos që ju kërkojnë përgjegjësia ju ofrojnë edhe kompetenca, ngritja profesionale është pjesë përcjellëse e punës, ngritja në pozitë aplikohet si formë e plotësimit të nevojave të paraqitura. Të ardhurat në këto ndërmarrje janë të pranuara mirë nga të punësuarit dhe dallohen për së miri. Ato kanë sjellë përvojën nga vendet prej të cilave kanë sjellë teknologjinë për punë.

Industria përpunuese, sidomos disa ndërmarrje të reja, të krijuara pas vitit 2000, janë duke aplikuar instrumentet e motivimit në një nivel të kënaqshëm. Edhe pagat në këto ndërmarrje janë mbi pagat mesatare dhe janë synim për punësim të punëkërkuesve të rinj. Këto ndërmarrje, përpos që kanë importuar teknologji të re, ato kanë marrë edhe përvojat e mira nga vendet tjera.Gjetjet reflektojnë prirje te planeve kompesuese aktualisht dhe në të ardhmen si faktorë që shkaktojnë dhe nxisin një qëndrim energjik të punonjësve.
Hulumtimi i dytë, i zhvilluar në nëntë ndërmarrje, nga të cilat dy për prodhimin e bukës dhe pjekurinave, një për prodhimin e verës, një për prodhimin e djathit, një për prodhimin e melmesave, një për prodhimin e pijeve përpos tjerash edhe nga frutat, një për prodhimin e smokave, një për prodhimin e produkteve konditoriale dhe një për prodhimin e smokave, biskotave, shkopinjve dhe përpunimin e kikirikëve.
Nga këto tri kanë kaluan nëpër fazën e privatizimit kurse tjerat, që nga fillimi janë ndërmarrje private.Anketimi në këto ndërmarrje ka pas për qëllim që të marr vlerësimin e pronarëve apo menaxherëve se cilët janë faktorët kryesor që i motivojnë burimet njerëzore të angazhuara në ato ndërmarrje. Anketimi është kryer në lokalet e ndërmarrjes, përpos në Verarinë Ston Castle (për shkak të disa zhvillimeve të atyre ditëve me prodhuesit e rrushit), me të cilët është zhvilluar bisedë telefonike.Rezultatet tabelare nga ky hulumtim, janë si në vijim:

1	Vendi i punës	☺	8	😐	1	☹	0
2	Ambienti	☺	5	😐	4		0
3	Puna në një vend apo e ndryshueshme	1	4	>1	2	≈	3
4	Puna në profesion apo jashtë saj	Po	3	Jo	5	≈	2
5	Rroba pune	Po	5	Jo	3	≈	0

	Rregullimi i mardhënies së punë						
6	Kontratë: 1) gojore, 2) me shkrim 3) pa kontratë	1	0	2	9	3	0
7	Kontratë: 1) afatshkurtër, 2) afatmesme apo 3) e hapur	1	3	2	8	3	3
8	Largësia nga vendbanimi: 1) Afër, 2) Rrethinë, 3) Larg	1	2	2	9	3	3
9	Stili i udhëheqjes dhe organizimi.	Autor	9		0	Kons	9
10	Paga	☺	3	😐	6	☹	0
11	Paga e rregullt: 1) ditore, 0) javor, 3) mujore	1	0	2	1	3	9
12	Paga	Max	800	Min	160		
13	Paga shtesë	Po	3	Jo	3	Pjes	3
14	Akordi (puna me normë)	Po	4	Jo	5	Pjes	0
15	Shpërblime të veçanta	Po	4	Jo	4	Pjes	0
16	Shujta	Po	7	Jo	1	Pjes	1
17	Shpe. e udhëtimit	Po	2	Jo	6	Pjes	1
18	Pushim i organizuar	Po	2	Jo	6	Pjes	0
19	Bursa fëmijëve	Po	0	Jo	9	Pjes	0
20	Benificione në blerje të produkteve dhe shërbimeve të ndërmarrjes	Po	1	Jo	2	Pjes	3

	Zhvillimi profesional:						
21	Trajnimi	Po	6	Jo	3	Pjes	0
22	Shkollimi	Po	1	Jo	7	Pjes	0
23	Çertifikimi	Po	2	Jo	7	Pjes	0
	Zhvillimi në karrierë:						
24	Avancimi	Po	8	Jo	0	Pjes	1
25	Ulja në pozitë	Po	2	Jo	6	Pjes	0
	Mbështetja sociale:						
26	Çerdhet e fëmijëve	Po	0	Jo	9	Pjes	0
27	Përkujdesi	Po	3	Jo	6	Pjes	0
28	Parkingu	Po	9	Jo	0	Pjes	0
29	Manifestime të përbashkëta	Po	9	Jo	0	Pjes	0

	Tjera:						
30	Mundësia e shfrytëzimit të hapësirës dhe pajisjeve për qëllime fitimi	Po	0	Jo	9	Pjes	0
31	Mundësia e shfrytëzimit të hapësirës dhe pajisjeve për qëllime jofitimi	Po	6	Jo	3	Pjes	0
32	Anketim i punëtorëve	Po	0	Jo	9	Pjes	0
33	Mirënjohje	Sh	0	G	7		0

34	Motivatori kryesor	
	Paga	9
	Vetë puna	4
	Paga e rregullt	4
	Raportet me të punësuarit	4

35	Problemet	
	Tatimet, doganat	9
	Lënda e parë	5
	Punëtorët e kualifikuar	4
	Obligimet nga privatizimi	3
	Kultura e punës	2
	Forma e të menduarit	2
	Konkurrenca jo legale	2
	Mosha e punëtorëve	1
	Ngarkesa me nr të madh të punëtorëve	1

A	Nevojat për punëtor të kualifikuar
	Teknolog ushqimi

C	Ofruesit – financuesit e trajnimeve
	USAID

B	Llojet e trajnimeve
	Kontabilist
	Shërbime administrative
	Për përdorimin e softwareve

Riinvest
MBZHR

Rezultatet e nxjerra na japin të kuptojmë se:

- Kushtet e punës vlerësohen shumë të mira
- Vendet e punës konsiderohen në përgjithësi të kënaqshme
- Ambienti – i kënaqshëm por që kërkon përmirësime
- Dominon puna në një vend pune
- Kryesisht të punësuarit janë jashtë profesionit që kërkon vendi i punës
- Kryesisht ofrohen rrobat e punës
- Kontratat me shkrim aplikohen si rregull
- Dominojnë kontratat një vjeçare
- Kryesisht angazhohen punëtorët nga rrethina
    - Pronarët, në shumicën e rasteve janë edhe menaxherë. Ata këshillohen me të punësuarit kurse vendimet i sjellin vet.
    - Vlerësohet se pagat do të duhej të ishin më të larta por kufizohen nga mundësitë.
    - Në të gjitha rastet aplikohen pagat mujore.
    - Paga maximale e deklaruar nga punëdhënësi (nuk ka të bëjë me atë zyrtarisht të deklaruar) është 800 euro dhe ajo minimale e deklaruar është 160 euro.
    - Ka praktika të mira të pagës shtesë, sidomos për dëshmime të theksuara në punë.
    - Puna me normë aplikohet vetëm në raste të jashtëzakonshme.
    - Shpërblime të veçanta aplikohen në disa raste si për festa, fund viti apo raste të dëshmimeve të veçanta.
    - Në disa raste të pakta aplikohen mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit.
    - Ka praktika të mira të udhëtimeve të përbashkëta në Brezovicë apo përcjellja e lojërave sportive.
    - Nuk aplikohen dhënia e bursave për fëmijët e punëtorëve apo të jo punëtorëve.
    - Kryesisht ofrohen benificione për blerjen e produkteve nga 20-30% kurse në sasira të vogla në disa ndërmarrje ofrohen falas.
    - Ka pas raste të trajnimit të personelit, kryesisht për kontabilist, punë administrative apo përdorim të softverëve.
    - Një rast i financimit të shkollimit të një të punësuari.
    - Një rast i çertifikimit për kontabilist.
    - Punëtorët e mirë në raste të caktuara ngritën në pozitë.
    - Rrallë aplikohet ulja në pozitë. Për shkelje apo joproduktivitet, aplikohet zakonisht largimi nga puna.
    - Nuk ka raste të përkujdesje ndaj fëmijëve të të punësuarve gjersa ata janë në punë.
    - Në raste të veçanta ka mbështetje ndaj familjeve të punëtorëve. Rast i veçantë është ndërtimi i një shtëpie për një punëtor të dalluar të komunitetit ashkali.
    - Në të gjitha ndërmarrjet ofrohet parkingu falas për të punësuar.
    - Manifestimet e përbashkëta, si në fund të vitit apo për rezultate të theksuara në ndërmarrje, aplikohen gati në të gjitha ndërmarrjet.
    - Shfrytëzimi i hapësirave dhe pajisjeve të ndërmarrjeve për qëllime fitimi, nuk aplikohen.

- Shfrytëzimi i hapësirave dhe pajisjeve të ndërmarrjeve për qëllime jofitimi, aplikohen në shumicën e rasteve.
- Deri më tani, asnjëra nga ndërmarrjet nuk ka zhvilluar ndonjë anketim të të punësuarve.
- Mirënjohjet me shkrim nuk aplikohen. Ka raste të lavdërimit në manifestime të punëtorëve të dalluar si dhe dhurata financiare.
- Punëdhënësit dhe menaxherët vlerësojnë se motivatori kryesor është paga. Pastaj motivator me rëndësisë vinë: Vetë puna, rregullsia në pagesë dhe raportet me të punësuarit.
- Problemi kryesorë në aktivitetin e ndërmarrjes janë tatimet dhe doganat. Probleme tjera të theksuara janë: lënda e parë, punëtorët e kualifikuar (mungesa e teknologëve), obligimet nga privatizimi (ngarkesa me numër të madh të të punësuarve, kultura e punës, forma e të menduarit, mosha e punëtorëve dhe obligimet financiare), konkurrenca jo lojale, njohurit e pamjaftueshme të punëtorëve të kualifikuar.

Konkluzione

Nga rezultatet e nxjerra mund të konkludojmë se:

- Pronarët e ndërmarrjeve dhe menaxherët, gjithnjë e më shumë janë duke iu kushtuar rëndësi burimeve njerëzore të angazhuara, por akoma ka nevojë për përmirësime.
- Duhet aplikuar edhe format tjera të motivimit, për të arrit rezultate sa më të mira.
- Zhvillimit të burimeve njerëzore duhet kushtuar një rëndësi më të madhe.
- Burimet njerëzore të angazhuara, gjithnjë e më shumë po vetëdijesohen për të drejtat dhe detyrat e tyre që rrjedhin nga mardhënia e punës në ekonomin e tregut.
- Çështja e motivimi të bashkëpunëtorëve kërkon një qasje profesionale.
- Motivimi është një problem me natyrë komplekse që është vështirë për t'u kuptuar dhe aq më shumë për t'u zbatuar.
- Drejtuesit e bizneseve në Kosovë ende nuk janë ndërgjegjësuar plotësisht për ndikimin e motivimit në menaxhimin e cilësisë totale.
- Duhet aplikuar forma të ndryshme të anketimit, me qëllim të njohjes sa më të mirë të mendimit dhe qëndrimit të të punësuarve, si dhe aplikimin e propozimeve të vlefshme si dhe kontrollimin e rezultateve të nxjerra nga ndryshimet e ndërmarra.
- Çështjes së zhvillimit të burimeve njerëzore në fushën e industrisë së përpunimit, posaçërisht asaj që për lëndë të parë përdorë produktet agrare, duhet kushtuar një kujdes të veçantë, sepse përmes kësaj ndihmojmë zhvillimin e agrobiznesit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe me këtë ndikojmë në uljen e papunësisë.
- Kryerja e një studimi të plotë për motivimin në Kosovë, për arsye të bëra publike tashmë përbën një domosdoshmëri.
- Duhet punuar në drejtim të përgatitjes së burimeve njerëzore të afta për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar forma efikase të motivimit.
- Të njihet përvoja e vendeve të tjera të rajonit në lidhje me motivimin e punonjësve,
- Industrisë përpunuese që për lëndë të parë përdorë produktet agrare, duhet kushtuar kujdes të veçantë sepse një popullsi që përdorë ushqim të shëndoshë, ka një perspektivë të mirë të jetëgjatësisë por edhe zvogëlim të shpenzimeve të përkujdesit mjekësorë, e me këtë do të epej një kontribut i madh në kursimin e buxhetit familjar dhe ati shtetëror.

Literatura:

1. Achim Dehnert Web faqja e FH Neu-Ulm.
2. Bislim Lekiqi, Motivimi, një sfidë për një menaxhim të suksesshëm të burimeve njerëzore, Alb-Shkenca, Tiranë Shtator 2010
3. Gallup, Mitarbeiterbefragungen nach dem Gallup Prinzip als Grundlage der Steigerung von Motivation und Leistungsverhalten, Jahr: 2007, ISBN (E-Book): 978-3-638-06715-7
4. Prof. Dr. Galantina Canco (Doraci), Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Tiranë 2009
5. Rüdiger Hossiep, Philip Frieg Der Einsatz von Mitarbeiterbefragungen in Deutschland, Österreich und der Schweiz
6. Schmaler. H.: Grundlagen und probleme der Betriebswirtschaft, Botimi i 10, Köln 1996
7. Thomas Heitzer, Mitarbeiter richtig motivieren - Alle wissen was zu tun ist, aber keiner wie, Essay, 2009, ISBN (E-Book): 978-3-640-43313-1, ISBN (Buch): 978-3-640-43275-2http://www.diplomarbeiten24.de/vorschau/83984.html
8. Ulrike Hellert,Erfolgreich durch Arbeitsmotivation, Lit Verlag, Muenster, 2005
9. URL:http://194.95.21.111:8080/im/content/e49/e132/e133/e668/courseMaterial669/OF_Modul1-GrundlagenderOrganisation.pdf
10. Web faqja e Universitetit të Bernit. URL: ttp://www.iop.unibe.ch/lehre/Personal%202%20WS%200203/Skript%2002-03/MOTIVAT.PPT (Thorn 2002)
11. Wolfgang Peham, Der motivierte Mitarbeiter, Abgabe Dezember 2000 ISBN 978-3-8324-5190-5

Ma.sc.Burim Haliti[57]

10 Politikat fiskale në Kosovë dhe harmonizimi I tyre me vendet e rajonit dhe të BE-së

Abstrakti

Përmes këtij punimi kemi paraqitur sfidat kryesore që polikat fiskale kanë në Kosovë dhe poashtu kemi paraqitur se cilat janë alternativat procedurale ligjore për ti eliminuar defektet e politikave fiskale në Kosovë. Një nga sfidat kryesore që politikat fiskale në Kosovë janë duke u përballur në periudha të ndryshme të zhvillimit të shtetit janë harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së lidhur me politikat fiskale. Parimisht Kosova ka përafrim të legjislacionit rreth politikave fiskale me BE-në, mirëpo paknaqësia lind këtu se tek ne aplikimi i këtyre dispozitave nuk bëhet në mënyrë profesionale dhe shpesh herë me ndërhyrje duke e shpërndarë buxhetin e shtetit nëpër rajone dhe komuna të ndryshme të cilat i sjellin më pak të hyra vendit sesa marrin buxhet dhe kjo politikë disbalancuese fiskale tek ne ka ndikuar shumë ne stabilitetin financiar dhe fiskal të vendit. Republika e Kosovës parimisht është shtet unitar dhe poashtu edhe të hyrat fiskale janë të koncentruara në buxhetin e shtetit, mirëpo nuk kemi shpërndarje të barabartë nëpër regjionet apo komunat të cilat kanë kontribuar në thithjen e tatimeve dhe taksave të ndryshme, duke u dërguar më shumë buxhet komnave të preferuara dhe këtu nuk kemi shkelje ligjore mirëpo kemi shkelje të parimeve të demokracisë, sepse ai që paguan më shumë tatime dhe taksa duhet edhe të merr më shumë të hyra buxhetore.

Fjalët kyçe:

Politikat fiskale, harmonizimi i legjislacionit, stabilitet financiar dhe fiskal, buxheti i shtetit, alternativa procedurale ligjore.

Hyrje

Përmes këtij punim mendoj se do ofrohet një pasqyrë e mirë se si duhet të bëhet harmonizimi i politikave fiskale me vendet e rajonit dhe të BE-së, sepse Republika e Kosovës ka nevojë për lëvizje dhe reformim të politikave fiskale duke i ndryshuar ato gjithmonë nën kushtet, parimet dhe standardet e BE-së. Përmes këtij punimi kam dashur që së pari sqaroj atë se qka janë politikat fiskale dhe si nënkuptohen në kuptimin bashkëkohor politikat fiskale.

Instrumentet e politikave fiskale kanë rol dhe rëndësi të madhe në shtetet bashkëkohore sepse pa to nuk mund të mendohet një shtet stabil në aspektin fiskal dhe financiar, sepse gjithëqka që ka të bëjë me shtetin në aspektin fiskal varet dsrejtpërdrejt nga instrumentet fiskale të cilat i përdor apo aplikon ai shtet ose shoqëri që tek ne janë: tatimet, taksat, huat publike, kontributet, etj

Decentralizimi i politikave fiskale një nga parakushtet dhe parimet se si një shtet duhet të qeveriset në modelin bashkëkohor të demokracisë, sepse ato vende të cilat kanë arritur me kohë ta realizojnë decentralizimin e politikave fiskale ka ngjallur me kohë stabilitetin fiskal në vend dhe njëherit ka ulur mundësinë për të pasur ndonjë krizë në aspektin mikrofinanciar. Njëherit aplikimi i decentralizimit në politika fiskale ka nënkuptuar se politikat fiskale shtrihen në dy rrafshe atë qendror dhe lokal dhe secila e merr përgjegjësinë e vet, në rast se i përcakton normat dhe politikat tjera fiskale si në taksa poashtu edhe në tatime.

[57] Autori ka përfunduar studimet postdiplomike Master, në të drejtën juridike financiare, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Punon në Doganën e Kosovës dhe është i angazhuar asistent në Universitetin Publik të Gjilanit "Kadri Zeka", në katedrën juridiko-financiare. Është pjesë aktive e organizimeve të shoqërisë civile për çështje të ndryshme ligjore, politike, ekonomike në Republikën e Kosovës.

Përgjegjësia fiskale është jetike për menxhimin e mirëfilltë të financave publk, veqanarisht për hartimin dhe aplikimi e politikave fiskale në vend, andaj qdo veprim në drejtim të politikave fiskale në vend nënkupton se duhet dhënë përgjegjësi për ato veprime të cilat janë të karakterik juridiko - financiar.

Harmonizimi i politikave fiskale me vendet e rajonit dhe BE-së është një parametër i mirë se në fakt ku gjendemi ne si shtet sa i përket politikave fiskale. Parimisht në aspektin teorik kosova ka legjislacion të harmonizuar me aktet e BE-së, mirëpo në aspektin praktik të zbatimit të tij ne si shoqëri ngecim poashtu edhe në drejtim të aplikimit të dispozitave ligjore që e rregullojnë fushën e politikave fiskale në vend. Baza ligjore që e rregullon këtë fushë me e rëndësishmja është ligji për TVSH-në, ligji për të ardhurat personale dhe ligji për të ardhurat e korporatave.

Çka nënkuptojmë me politika fiskale!

Konceptet bashkëkohore të funksionimit demokratik të shteteve i kushtojnë një rëndësi të madhe politikave fiskale shtetërore, sepse aplikimi i mirëfilltë i politikave fiskale në një vend nënkuptom më shumë stabilitet institucional fiskal dhe financiar. Trajtimi teorik i politikave fiskale për shtetet demokratike ka pësuar një jehonë të madhe kohëve të fundit sepse shumë teoricienë vendorë dhe ndërkombëtarë janë marrë me këtë qështje që është sa e rëndësishme për funksionimin e shteteve poashtu edhe determinant e stabilitetit fiskal dhe financiar.

Politikat financiare në shtetet bashkëkohore nënkuptojnë që të kemi një mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik dhe planifikim të mirëfilltë të të hyrave shtetërore në drejtim të të dalurave - shpenzimeve shtetërore. Çdo planifikim i matur dhe me kujdes me qëllim kordinimin e të hyrave shtetërore nga ana e qevrisë nënkuptojnë politika fiskale dhe njëherit poashtu edhe çdo planifikim për të dalurat apo arsytimet se ku qeveria duhet të bëjë investime, si p.sh: investimet në infrastrukturën arsimore, rrugore, investimet kapitale, subvencionimin e bujqësisë, krijimin e kushteve më të mirë për zhvillim ekonomik, lehtësimin e procedurave në të bërit biznes, investimet në sport, kulturë etj.

Politikat fiskale janë definuar në mënyra dhe forma të ndryshme nga autorë të shumtë ndërkombëtarë dhe vendor mirëpo, autorët *Prof. dr Budimir Stakić dhe Prof. dr Slobodan Barać* politikat fiskale i nënkuptojnë në kuptimin e gjerë dhe në kuptimin e ngushtë. Në një kuptim më të gjerë sipas autorëve politika fiskale do të thotë *"Procesin e taksimit dhe mbledhjes së të hyrave publike në mënyrë që të krijohen fonde për shpenzimet publike në mënyrë për të zbutur luhatshmërinë e zhvillimit të biznesit dhe të kontribuojë në mirëmbajtjen e ekonomisë në rritje të punësimit të lartë që është i lirë nga situata. Në një kuptim të ngushtë , politika fiskale nënkupton përdorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës ekonomike.*[58]Nga kjo del se politikat e mirëfillta fiskale që shtetet bëjnë për vete, nënkuptojnë që të planifikojmë me kujdes çdo taksë apo tatim që parashohin politikat ekonomike qeveritare në mënyrë që të kemi të hyra të mjaftushme për të mbuluar shpenzimet publike apo të dalurat publike. Andaj çdo veprim i pa matur dhe i pa analizuar mirë në aspektin fiskal nga ana e institucioneve qeveritare lidhur me poltikat fiskale nënkupton që të kemi më shumë evazion fiskal, trazira sociale, pasiguri financiare, pakënaqësi buxhetore etj.

[58] Prof. dr. Budimir Stakić & Prof. dr. Slobodan Barać, "Financat publike", Beograd 2008, faqe 65;

Instrumentet e politikave fiskale

Instrumentet e politikave fiskale janë shumë me rëndësi për çdo mekanizëm shtetëror (qerveri) në botë, sepse përmes përcaktimit të instrumenteve të politikave fiskale kemi grumbullim apo derdhje të parasë nga qytetarët tek institucionet shtetërore, në mënyrë që më pas, të aplikohen palnifikimet financiare dhe këto para lëshohen në qarkullim pikërisht për interesin e qytetarëve duke investuar në infrastrukturë apo shërbime të ndryshme.

Të hyrat dhe shpenzimet publike përcaktohen përmes hartimit - parashikimit të planeve strategjike dhe tek ne politikat fiskale kanë instrumentet e saja të cilat konsiderohen: tatimet, taksat, huat publike, kontributet, etj.

Nga të gjitha këto instrumente të politikave fiskle më të rëndësishme janë tatimet dhe taksat të cilat kanë rëndësi dhe vlerë më të madhe sepse ndikojnë drejtpërdrejt në mbledhjen e të hyrave nga qytetarët. Tatimet janë burime të rëndësishme të të ardhurave publike të shteteve moderne dhe janë të obligueshme për të gjithë qytetarët e saj pasi që janë të paraparë me akte ligjore. Ndërsa taksat janë instrument shumë i rëndësishëm për mbeldhjen e të hyrave sepse taksat realizohen për qdo qytetar i cili kërkon ti kryhet ndonjë punë apo shërbim nga ana e institucioneve shtetëtrore.

Decentralizimi i politikave fiskale

Decentralizimi fiskal është standard i qeverisjes në botën bashkëkohore sepse vjen në shprehje rrespektimi i parimeve të demokracisë, sepse sa më shumë që kemi shpërqëndrim të politikave fiskale, gjegjësisht dekoncentrim të politikave fiskale dhe financiare aq më shumë ka mundësi të aplikimit të drejtë dhe të sigurtë të parasë publike. Decentralizimi i politikave fiskale në vendet në zhvillim sikurse është Kosova nënkupton se njësitë qeverisëse të saj janë të lira në posedimin e buxhetit të tyre dhe në shprehjen e vullnetit të atyre njësive lokale se si duhet shpenzuar paranë, por poashtu dencentralizimi fiskal nënkupton edhe atë se komunat në Kosovë kanë pavarësi financiare sa i përket mbledhjes së taksave dhe të hyrave tjera sepse janë të rregulluara me ligjin për financat e pushtetit lokal - Nr. 03/L-049 dhe përjashtimisht janë të obliguara ta arkëtojnë edhe të hyrat që realizohen nga ligjin për tatimin në pronë.

Decentralizimi fiskal nënkupton, sigurimi i sasive të mjaftueshme i të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe autorizim të komunave që vetë të marrin vendime për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve, me qëllim të kryerjes efektive dhe efikase të kompetencave të *përcaktuara.*[59] Nga ky mendim për decentralizimin e politikave fiskale e shohim qartë se me decentralizim të tillë komunat kanë fuqi financiare që të mbledhin të hyrat nga qytetarët dhe njëherit ti shpenzojnë ato ashtu siq i kanë parapa me plane shpenzuese. Nga dencentralizimi fiskal fitojnë të gjithë akterët institucional si në nivelin lokal poashtu edhe në atë qendror, sepse pushteti qendror lirohet nga procedurat e tepërta lidhur me planin për mbledhjen e të hyrave dhe planin për destinimin e shpenzimeve sipas planprogramit qeveritar lokal, ndërsa poashtu nga kjo përfiton edhe niveli lokal sepse të gjitha këto taksa dhe tatime që realizohen në nivelin lokal destinohen për tu shpenzuar në nivelin lokal.

Decentralizimi fiskal ka disa objektiva që duhet arritur sipas standardeve moderne të qeverisjes dhe ajo nënkupton se nëse kemi decentralizim të politikave fiskale atëherë arrihen këto objektiva:

[59] Mendim i dalë nga konferenca ndërkombëtare e organizuar nga Fondacioni Instituti për Shoqëri të Hapur në Maqedoni me temë "Decentralizimi në RM – i ngadalësuar ose i harruar", në prill të vitit 2010,

1. *Së pari, decentralizimi fiskal i jep kompetenca për të vendosur taksa vendore dhe që të bëjnë shpenzime lokale qeverive vendore dhe*
2. *së dyti, në shumë vende qeveritë lokale gjithashtu kanë kompetenca për rregullimin e tokës duke i përdor ato brenda udhëzimeve të vendosura nga autoritetet më të larta*[60].

Decentralizimi fiskal i politikave për ne si institucione është një sfidë sa e rëndësishme poashtu edhe e vështirë për tu aplikuar sepse nuk është e lehtë në një shtet unitar të menaxhosh me financa në nivelin lokal dhe qëndror, edhe pse deri më tani Kosova në këtë drejtim në aspektin teorik të hartimit të akteve juridike-ligjora për politika fiskale ka pasur progres, mirëpo ngec shumë në aplikimin apo realizimin e këtyre akteve juridike në aspektin praktik nga ana e mekanizmave përgjegjës për ti aplikuar këto ligje dhe akte të tjera nënligjore.

Përgjegjësia fiskale del nga decentralizimi i politikave fiskale dhe i takon institucioneve qendrore, gjegjësisht i takon qeverisë së vendit, mirëpo kjo përgjegjësi poashtu është e dekoncentruar edhe në nivelin lokal pasiqë niveli lokal ka përgjegjësi kryesore në mbledhjen e taksave që i mbledhin institucionet lokale nga qytetarët të cilët kryejnë ndonjë punë apo shërbim, "*Niveli i shpenzimeve është më shumë nën kontroll të Qeverisë se sa që është niveli i të hyrave, të cilat lëvizin me ndryshimet sipas aktivitetit ekonomik*[61].

Harmonizimi i legjislacionit vendor me aktet e BE-së lidhur me politikat fiskale

Republika e Kosovës parimisht ka politika fiskale të rregulluara me legjislacion vendor me parime dhe standarde të BE-së, të cilat janë rrespektuaer si kritere në momentin e hartimit dhe fuqizimit të atyre ligjeve të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejt apo indirekte e prekin fushën e politikave fiskale.

Në aspketin ligjor Republika e Kosovës i ka rregulluar politikat fiskale përmes nxjerrjes së disa ligjeve të cilat janë bazike dhe shumë të rëndësishme në fushën e rregullimit të politikave fiskale siq janë: Ligji për tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK), Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP), Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Detyrimeve doganore dhe të akcizës etj. Nga kjo kornizë ligjore në Republikën e Kosovës prodhohen efektet juridike të politikave fiskale sepse me këto ligje njëherit veprojnë të gjitha institucionet, sa i përket politikave fiskale, mirëpo kujdesi më i madh apo rëndësia më e madhe i kushtohet ligjit për tatimin në të ardhura personale dhe ligjit për TVSH-në sepse prek një kategori më të madhe qytetarëve të vendit.

Me ligjin për tatimin në të ardhurave personale - rregullohet qështja se qdo të ardhur që e realizon një person në Republikën e Kosovës duhet ti nënshtrohet normave tatimore që parashihen në aspektin ligjor për të ardhurat mujore dhe vjetore: të ardhurat mujore deri në 80 euro paguajnë 0%, të ardhurat mujore prej 81 - 250 euro paguajnë 4% , të ardhurat mujore prej 251 - 450 euro paguajnë 8% dhe të ardhurat mujore prej450 euro paguajnë 10% . Të ardhurat vjetore që realizohen, sipas ligjit janë të obliguar të kryejnë obligimet tatimore: të ardhurat vjetore deri 960 euro paguajnë 0%, të ardhurat vjetore prej 961 - 3.000 euro paguajnë 4% të shumës mbi 960 euro, të ardhurat vjetore të shumës mbi 3.001 - 5.400 euro paguajnë 81,6 euro + 8% e shumës mbi 3.000 euro, të ardhurat vjetore të shumës mbi 5.400 euro paguajnë 273,6 euro + 10% e shumës mbi €5.400. Tatimet në të ardhurat personale dallon varësisht nga vendet të cilat i aplikojnë këto tatime sepse është nën sovranitetin e tyre financiar ti përcaktojnë normat e tatimeve, p.sh: Kosovë 4-8-10%, Mali i Zi 12%, Maqedonia 10%, Serbia 10-20%, Kroacia 15-45% , Bullgaria 10%, Greqia 0-40% dhe Rumania 16% tatimohen qdo person qe realizon të ardhura.

---

[60] Gregory K. Ingram and Yu-Hung Hong; "Fiscal Decentralization and Land Policies", botues Lincoln Instituteof Land Policy, ISBN 978-1-55844-178-1, viti 2008 Cambridge - Masaquesetts.

[61] Raport hulumtues, *"Sistemi buxhetor i Kosovës - politikat dhe qëndrueshmëria",* i realizuar nga Instituti Riinvest; faqe 67; 12 qershor 2013; Prishtinë.

Nga këto të dhëna del se tek ne në Kosovë tatimi në të ardhura nuk është statik por është alternativ dhe kjo është e pranueshme sepse këtë kategori e tatimon me ligj në aspektin alternativave nga 4% deri në 10%, varësisht nga ajo se sa të hyra realizon, ndërsa në vende të BE-së kjo normë tatimore është fikse 10% në Bullgari dhe 16% në Rumani, ndërsanë poashtu në mënyrë alternative është edhe në Greqi 0%-40% dhe në Kroaci nga 15%-45%, ndërsa në vendet tjera të rajonit poashtu janë fikse si në Mal të Zi dhe Maqedoni dhe poashtu ka vende të rajonit që e kanë këtë normë tatimorë në mënyrë alternative varësisht nga të hyrat Serbia 10%-20%. Sa i përket lartësisë së normës tatimore për të ardhurat Republika e Kosovës ka përcaktuar një bazë jo të lartë dhe është një nga vendet me lartësi të kësaj norme tatimore më të ultë në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe BE-së dhe arsyeja është niveli i zhvillimit ekonomik dhe standardi i ulët jetësor në Kosovë.

Me ligjin për tatimin e vlerës së shtuar **TVSH-së** - ky tatim aplikohet në Republikën e Kosovës në mënyr fikse dhe është i njëjtë për të gjitha kategorikë e mallrave që parashihet me ligj për tu tatimuar me TVSH-ë dhe baza apo lartësia e normës së tatimit është
16% që për ne si vend në zhvillim mund të jetë edhe joadekuat. Poashtu edhe vendet e rajonit e aplikojnë TVSH-në dhe norma e TVSH-së dallon varësisht nga vendi në vend, p.sh: Kosovë 16% , Mali i Zi 17%, Maqedonia 18%, Serbia 18%, Kroacia 23%, Bullgaria 20%, Greqia 19% dhe Rumania 19%. Shkalla e lartësisë së TVSH-së në Republikën e Kosovës është nga më e ulëta ndër këto vende dhe mund të themi se është një politikë fiskale që institucionet kosovare e kanë aplikuar në harmoni me standardin dhe zhvillimin ekonomik të vendit sepse dihet se Kosova është mbrapa këtyre vendeve të rajonit në aspektin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit ekonomik. Vendet e rajonit të cilat nuk janë anëtare të BE-së kanë norma të TVSH-së më të larta se Kosova edhe atë Mali i Zi 17%, Maqedonia 18% dhe Serbia 18%, ndërsa vendet e rajonit të cilat janë anëtare të BE-së poashtu kanë normë për një shkallë më të lartë se vendi ynë dhe vendet e tjera të rajonit të cilat nuk janë anëtare e BE-së, si p.sh: Kroacia 23%, Bullgaria 20%, Greqia 19% dhe Rumania 19%.

Harmonizimi i legjislacionit me vendet e rajonit dhe ato të BE-së duhet të bëhet në drejtim të asaj që të kemi një unifikim të këtyre specifikave ligjore por duke e marrë parasysh gjithëmonë nivelin e zhvillimit ekonomik dhe standardin jetësor, sepse një qytetar nuk mund të ngarkoht me një taksë të lartë të ndonjë tatimi në rast se ai ka të hyra të ulëta dhe pikërisht për këtë arsye Kosova duhet ti përcjellë trendet e zhvillimit vendor eonomik nëse prek apo harmonizon normat tatimore me vendet e rajonit dhe të BE-së.

Përfundim

Politikat fiskale të vendit duhet të jenë të hartuara mirë, me profesionalizëm dhe duke i rrespektuar parimet fiskale për të hyrat dhe shpenzimet. Ato duhet reformuar dhe ndryshuar në Kosovë por duhet pasur kujdes që këto lëvizje të bëhen duke e pasur parasysh standardin jetësor të vendit dhe nivelin e zhvillimit ekonomik pasiqë mundet drejtpërdrejt të ndikojë në jetën e qytetarëve në aspektin negativ dhe kjo nuk është në interes as të institucioneve e as të qytetarëve.

Analizat juridiko-financiare që kam bërë duke përdorur edhe metodën komparative, kanë sjellë rezultatin se politikat fiskale në Republikën e Kosovës janë modeste në kuptimin ligjor, që nënkupton se ka bazë ligjore të mirëfilltë por e cila duhet të ndryshohet në drejtim të vendeve të rajonit të cilat kanë norma më të larta të tatimeve në të ardhura personale dhe të TVSH-së që nënkupton se më shumë i sjellin të ardhura shtetit përmes këtyre dy normave tatimore.

Zbatimi i politikave fiskale të vendit duhet të përcillet me një vullnet politik të instituciove shtetërore sepse krykëput, politikat fiskale në shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim janë premtime elektorale që në shumicën e rasteve i nxjerrin fituese partitë e ndryshme dhe më pas obligohen që premtimet elektorale për politika fiskale të aplikohen në legjislacion vendor.

Bibliografia

*1. Adrian Civici – "**Kriza financiare apo global"**, botues UET\PRESS 2010;*
2. Alesina, A., R. Hausmann, R. Hommes and E. Stein, "Budget Institutions and Fiscal Performance in Latin America", Journal of Development Economics 1999;
3. Budimir Stakić & Prof. dr Slobodan Barać, "Financat publike", Beograd 2008;
4. Budimir Stakić Prof. dr Slobodan Barać, "Javne finansije", Beograd, 2008;
5. Fondacioni Instituti për Shoqëri të Hapur në Maqedoni me temë "Decentralizimi në RM – i ngadalësuar ose i harruar", në prill të vitit 2010;
6. Gregory K. Ingram and Yu-Hung Hong; "Fiscal Decentralization and Land Policies", botues Lincoln Instituteof Land Policy, ISBN 978-1-55844-178-1, viti 2008 Cambridge - Masaquesetts;
7. Ivana Maletić, Ivana Jakir-Bajo, Ana Zorić; Primjena zakona o fiskalnoj odgovornosti, Zagreb 2011.
8. Jure Šimoviê, Hrvoje Šimoviê "Fiskalni sustav i fiskalna politika Europske Unije" - Zagreb 2006, ISBN 953-6714-89-2 1;
9. *Katri Kosonen &Gaëtan Nicodème "The role of fiscal instruments in environmental policy", June 2009 Luxemburg, ISBN 978-92-79-12795-3;*
*10. **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, Qershor 2008;*
11. Ligji Nr. 03/L-049, për financar pushtetit lokal;
12. Ligji Nr. 04/L-233 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës;
13. Mark Horton and Asmaa El-Ganainy, "What Is Fiscal Policy", Finance & Development June 2009;
14. Musgrave, Richard, "The theory of Public Finance" - New York 1959;
15. Persson, Torsten and Guido Tabellini,"Constitutional Rules and Fiscal Policy Outcomes," The American Economic Review 2004, ,
16. Raport hulumtues, "Sistemi buxhetor i Kosovës - politikat dhe qëndrueshmëria", i realizuar nga Instituti Riinvest; faqe 67; 12 qershor 2013; Prishtinë;
17. Research Department, IDB, "A Decade of Development Thinking." - Washington 2004;
18. Richard T. Ely, PHD dhe LLD: professor I politikës ekonomikë në Universitetin e Wisconsinit, Budget making in a democracy, New York;
19. Von Hagen, J., "Budgeting Procedures and Fiscal Performance in the European Community", European Economy Economic Papers - Brussels1992 ;
20. Zharko Ristiq, "Fiskalna strategija", Beograd 2010;

Msc.Elmi Aziri[62]
Universiteti i Evropës Jug-Lindore,Ilindenska bb,
Tetovë,Republika e Maqedonisë

11 Borxhi publik dhe efektet e tij:Rasti i Republikës së Maqedonisë

Abstract

While many countries feel the consequences of the economic crises caused by public dept a big number of countries use the same as an instrument to fight the consequences of the crises. The case of the Republic of Macedonia is similar since Republic of Macedonia has recorded permanent increase of its public dept since 2006. If the trajectory shows rise in public dept then the risk increases analogically. In absolute values the dept in 6 years records an increase of 1 billion Euro. Even though the Republic of Macedonia keeps its public dept in a low level its trend and purpose remains inconvenient. The Government of Macedonia has projected increase of the public dept for the forthcoming years. It is important that we emphasize the disturbing project of Skopje 2014 on which the Government has spent the money from the public dept. Many economists have considered this project as unproductive which in their opinion will have long term effects on fiscal terms of the country.

Key words: Public debt, Republic of Macedonia, Economic growth

1.Hyrje

"Gjithkund në Evropë kemi rritje enorme të borxheve.Në më shumë vende borxhi llogaritet si pengesë e cila në periudha afatgjate do të çojë në shkatrrim" (A.Smith,1776).Prej kohës kur është shprehur kjo ide kanë kaluar më shumë se dy shekuj,mirëpo edhe sot e kësaj ditë kjo është shumë aktuale,nëse jo edhe më aktualja në shkencën e financave publike.Borxhi publik edhe më tej grumbullohet në shume vende,ai edhe më tej konsiderohet si kanosje për stabilitetin makroekonomik,ndërsa në shumë vende,veçanarisht me përvoja të krizave të borxhit publik shkakton frikë për çrregullime të mëdha eventuale.Megjjithatë,përshkak të një varg përparësive para tatimeve,shtetet hezitojnë të heqin dorë nga borxhi publik si burim i të hyrave,sidomos në periudha me nevoja jashtëzakonisht të larta,por afatshkurte për shpenzime publike (p.sh kriza ekonomike).Nxitja për borxhin publik ne njërën anë dhe rreziqet nga mbingarkesa me borxh në anën tjetër,kërkojnë syçeltësi dhe vëmendje të vazhdueshme gjatë përdorimit të këtij instrumenti të politikës fiskale.

Pikërisht,nevoja për menaxhim racional me borxhin publik ka nxitur shkencën e ekonomisë për studimin e fenomenit të borxhit publik,shkaktarët dhe pasojat e tij,si dhe përcaktimin e kufijve optimal dhe të qëndrueshëm të borxhit publik.Megjithatë,sado që studimi i tij të ketë qenë i frytshëm,arritjet shkencore mundësuan njohjen e problemeve lidhur me borxhin publik,por nuk japin udhëzime të qarta për menaxhimin e politikës fiskale,respektivisht borxhit publik.

Ky punim ka për qëllim të paraqesë një pasqyrë të sintetizuar të rrjedhave të borxhit publik dhe efektet ekonomike të borxhit publik,veçanarisht relacionet e borxhit publik me rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë që do të analizohen përmes analizës kualitative e cila do të jetë e fokusuar në krahasimin e të dhënave për periudhën 2005-2012.

[62]Elmi.aziri@seeu.edu.mk

2.Rishikimi i literaturës

Sipas mednimit Kejnsian, deficiti buxhetor dhe borxhi publik kanë ndikim pozitiv në aktivitetin ekonomik të vendit,veçanarisht përmes mekanizmit të multiplikatorit të shpenzimeve publike.Ata po ashtu argumentojnë egzistimin e fenomenit crowding-in në shpenzimet publike me arsyetimin se ekzistencës së politikës fiskale ekspansioniste e realizuar përmes deficitit buxhetor dhe borxhit publik.Po ashtu,ata ndajnë mendimin se deficiti buxhetor dhe borxhi publik rrisin prodhimin kombëtar çka bënë që investitorët privat të perceptojnë situatën ekonomike në të ardhmën më optimistike dhe ti rrisin investimet e tyre.Nga ana tjetër përfaqsuesit e Shkollës Neo Klasike ndajnë qëndrimin se deficiti buxhetor dhe broxhi publik sjellin efekte të dëmshme për rritjen ekonomike.Ata analizojnë shpenzimet e konsumit të familjeve gjatë ciklit të tyre jetsor dhe konsiderojnë se qeveria përmes borxhit publik zhvendos barrën e tatimeve në gjeneratat e ardhshme dhe rrit konsumin aktual.Në supozimin e pusimit të plotë Neo klasikët argumentojnë se rritja e konsumit zvoglon kursimin.Prandaj është e nevojshme rritja e normave të interesit për të sjellë ekuilibrin e tregut të kapitalit çka çon në zvoglimin e investimeve private (Keho,2010). Megjithatë,avokatët e *Ricardian Equivalence* se deficiti buxhetor dhe borxhi publik janë neutral ndaj rritjes ekonomike.Sipas hipotezës së tyre deficiti aktual i rezultuar nga zvoglimi i tatimeve patjetër të paguhet në të ardhmen nga rritja e tatimeve,kështu që investimet private dhe normat e interesit ngelin të pandryshuara. (Saleh 2003).

Disa ekonomistë si Modigliani (1961),Diamond (1965),dhe Saint-Paul (1992) pohojnë se rritja e borxhit publik gjithmonë kontribon në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër,Patillo Poirson dhe Ricci (2004) konkludojnë se niveli i ulët i borxhit publik ka ndikim pozitiv në rritjen ekonomike ndërsa nivele të larta të borxhit publik kanë ndikim negativ në rritjen ekonomike.

Rezultatet nga analiza empirike e ralizuar nga Kumar dhe Woo (2010) për një grup të vendeve me ekonomi të zhvilluara dhe ekonomive në zhvillim gjet prezenca e ndikimit negtiv të borxhit publik dhe rritjes ekonomike për periudhën prej 1970-2007.Rezultatet nga analiza e tyre konfirmuan se një rritje prej 10% të borxhit publik në raport me PBB-në do të sjell rënje të PBB-së për 0.2% për një vit.

Schclarek (2005) duke analizuar 59 vende në zhvillim dhe 24 e vende të zhvilluara ndan qëndrimin se në vendet në zhvillim gjithmonë ekziston lidhje negative dhe substanciale në mes mes borxhit publik dhe rritjes ekonomike.Nga ana tjetër, në lidhje me vendet e zhvilluara Schclarek (2004) nuk gjen lidhje të rëndësishme në mes borxhit publik dhe rritjes ekonomike.

Ferreira (2009) gjatë analizës së relacioneve në mes rritjes ekonomike dhe borxhit publik duke shfrytëzuar vector autoregression model dhe Granger causality test konfirmon ekzistencën e relacioneve në mes PBB per capita dhe normën e borxhit publik në vendet e OECD-së për periudhën 1988 2001.Për më tepër ai konfirmon se kjo lidhje është gjithmonë dy drejtimëshe.

Njëkohësisht , duhet theksuar se shumë studime empirike të kryera gjatë disa viteve të kaluara sugjerojnë një marrëdhënie jo- lineare në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike (Moore ,Chrystol 2008) . Gjegjësisht , rezultatet e këtyre studimeve tregojnë se borxhi publik ndikonë pozitivisht në rritjen ekonomike,por vetëm në një nivel të caktuar të borxhit publik në raport me PBB-në.

Në përfundime të ngjashme erdhën Elbadawi , Ndulu , dhe Ndung'u (1997), duke analizuar marrëdhënien në mes borxhit publik dhe PBB në 26 vende sub- Sahariane afrikane në periudhën 1980-1994 . Ata kanë treguar se borxhi publik ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike në këto vende , por vetëm deri në 97 % të PBB-së .
Në mënyrë të ngjashme ,Pattillo , Poirson , Ricci (2002) shqyrtuan 93 vendet në zhvillim në periudhën 1972-1998 dhe ata kanë gjetur ndikimin pozitiv të borxhit publik mbi normën e rritjes së PBB-së , por vetëm deri në 35-40% të PBB-së .
Studime të ngjashme kanë kryer SMYTH, dhe Hsing (1995) , të cilët analizuan ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të SHBA-ve në vitet e 80 dhe '90 të shekullit të 20-të. Mirëpo , këta autorë kanë vlerësuar një niveli optimal i borxhit publik (niveli i borxhit publik, i cili maksimizon rritjen ekonomike) për ekonominë amerikane. Rezultatet e tyre tregojnë nivel optimal i borxhit publik ndaj PBB-së amerikane arriti në 38.4 % në periudhën e analizuar .
Reinhart dhe Rogoff (2010) në ekzaminimin e 44 vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim gjatë njëqind vjeqarit të fundit arritën në përfundimin se niveli i lartë i borxhit publik në raport me PBB-në (mbi 90 %) është shoqëruar më një nivel më të ulët të rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim. Për më tepër , në rastin e vendeve në zhvillim ,niveli relativisht i lartë i borxhit të jashtëm në raport me PBB (mbi 60%) ndikon negativisht në rritjen ekonomike.

3.Efektet ekonomike të borxhit publik

Ndikimi i borxhit publik në variablat ekonomike gjithmone ka qenë teme debati në mes ekonomistëve.Ashtu si rritej niveli i borxhit publik rritje edhe interesimi dhe intensiteti i debatit për të.Si në shumicën e temave makroeonomike ashstu edhe për efektet e borxhi publik në ekonomi nuk kemi një mendim të unifikuar shkencor.
Dallimet nganjeherë i arrijnë ekstremet.Kanalet përmes të cilave borxhi publik ndikon në rritjen ekonomike janë të ndryshëm: konsumi privat (i); investimet publike (ii); faktori i përgjithshëm i produktivitetit (iii) dhe normat afatgjate nominale dhe reale të interesit. Meade (1958) ka potencuar se eliminimi i borxhit publik do të: (i) stimulon kursimin; (ii) përmirëson iniciativat për punë dhe ndërmarrësi; (iii) ndoshta per njeë periudhë më të gjatë kohore do të lejohet rënje në tatimete në të ardhura si pasojë e pagesës së interesit mbi buxhetin e kursimit.
Një rritje e borxhit publik në përgjithsi korrespondon me rënje në kursimet qeveritare duke ndikuar në zvoglimin e kursimeve të përgjithshme.Kjo,tenton të rrisë normat e interesit.Rritja e normave të interesit ndikon në zvoglimin e investimeve dhe stokun e kapitalit.Ulja e akumulimit të kapitalit pengon inovacionet të cilat rrisin produktivitetin,për pasojë do të kemi ulje të produktivitetit të punës.Po ashtu rritja e borxhit rrit preminë e riskut.Rritja e premisl së riskut rrit kostot e finansimit të cilat mundë të rrezikojnë aftësinë paguese të financave publike.Kjo mundë të çonë në rritjen e normave të interesit.Rritja e borxhit publik në raste të caktuara mundë të rrisë riskun nga inflacioni.Nëse borxhi rritet me intensitet të lartë.,qeveria mundë të tentojë të ulë vleren e tij (zhvlersim i borxhit) duke gjeneruar inflacionin.Kjo ndodhë nëse borxhi publik monetizohet.

4.Borxhi publik në Republikën e Maqedonisë

Një pjesë e rëndësishme e historisë së Republikës së Maqedonisë është e shënuar me niele të larta të borxhit publik, atij të jashtëm dhe të mbrendshëm, për ta finansuar deficitin buxhetor i cili kryesisht ishte trashiguar nga ish federate jugosllave.

Pas pavarësisë së saj fiskale më 26 prill të vitit 1992, aktivitete ekonomike në rënje e zvogluan bazën tatimore dhe të hyrat janë gërryer nga inflacioni i lartë dhe kapaciteti i dobët për mbledhjen e tatimeve të cilat çuan në monetizimin e deficitit buxhetor. Kështu, qëllimi primar i reformave fiskale ishte kufizimi buxhetor, rritja e të ardhurave dhe ulja e shpenzimeve qeveritare në mënyrë që të zvoglohet deficit buxhetor I cili do të çonte në uljen e normave të inflacionit. Pjesa më e madhe e hendekut buxhetor është finansuar nga borxhi publik si i jashtëm ashtu edhe i mbrednshëm.
Programi stabilizues i viti 1992 dështoi përshkak të efekteve kundërthënëse në mes politikës monetar dhe fiskale, kështu që në vitin 1993 deficiti fiskal ishte 12.5% të PBB-së ndërsa shpenzimet publike arritën nivelin prej 53.6% të PBB-së. Në përgjigje të dështimit të programës stabilizuese të vitit 1992, politika monetare dhe fiskale koordinuan përpjekjet të cilat rezultuan me një qasje të re në lidhje me politikën fiskale e cila do të reduktonte deficitin fiskal në 3% të PBB-së,ndërsa shpenzimet nuk do të kalonin 35% të PBB-së dhe borxhi publik u mbajt nën nivelin prej 60% të PBB-së. Programi u mbështet nga FMN-ja dhe i dha efektet e saj gjatë tremujorit të parë të vitit 1995,kur Maqedonia kishte përshpejtuar ndjeshëm ritmin e reformave të ndërmarra në vitin 1994.
Vendi kishte arritur të normalizon borxhin e jashtëm ndaj BERZH-it dhe FMN-së, dhe kishte arritur marrëveshje për zgjidhjen e birxhit me IFC. Në anën tjetër borxhet ndaj kreditorëve privat kishin vazhduar. Në fund të vitit 1994 borxhi i jashtëm i vednit ishte zvogluar në 40% të PBB-së. Reformae venditgjatë viteve 95-96 kishin për qëllim që tëmundësonin një rregullim strukturordhestabiliziminfinanciar, me thekskryesor nësektorinbankar dhe të ndërmarrjeve.
Objektivat kryesore tëpolitikës fiskaleu orientuan drejt eliminimit të borxhite qeverisë publik..Që nga viti 2000borxhi publik ka shënuar rënie të vazhdueshme.
Përshtatja fiskale vitit 2003 ishte e orientuar drejt zvoglimit të shpenzimeve publike duke përfshirë edhe shpenzimet kapitale që në vitin 2006 ishin vetëm 3% e PBB-së.
Rregullimi fiskal ka përmirësuar qëndrueshmërinë e borxhit publik gjatë këtyre pesë viteve, duke rënë nga 49% të PBB-së në vitin 2001 në 33% të PBB-së në vitin 2006. Niveli i birxhit publik vendos Maqedoninë në grupin e vendeve me përqindje të ulët të borxhit publik. Gjatë kësaj periudhe si borxhi publik ashtu deficiti fiskal ishin të favorshme për qëndrueshmërinë fiskale.
Nëse analizohet struktura e shpenzimeve publik mundë të konstatohet se nuk ka qenë mbështetëse e rritjes ekonomike, pra madhësia e shpenzimeve publike nuk ka qenë problem, por problem paraqiste struktuar e shpenzimeve publike e cila në vitin 2006 dukeshte kështu: 91.2% të PBB-së ishin shpenzimev rrjedhëse nga të cilat 22.1% pagat dhe shtesat, 53.2% transferet sociale, 3% shpenzime të interesave, 12.2% shpenzime për mallra dhe shërbime dhe vetëm 8.8% shpenzime kapitale.
Duke u përballur më këtë strukturë jo të favorshme të shpenzimeve publike, qeveria që doli nga zgjedhjet e viti 2006, në vend të ndërmarrjes së masave për ta dnryshuar strukturën buxhetore e cila do të vendoheshte në funksion të rritjes ekonomike, ata ndërmorrën masa që do të sjellin përkeqsim të mëtutjeshëm në strukturën e shpenzimeve publike, një ndër ato masa ishte vendimi për rritjen e pagave për administratën publike për 30% në tri vitet e ardhshme filluar nga viti 2007.
Përshkak të strukturës së disfavorshme aktuale të shpenzimeve publike si dhe përshkak të numrit të mash të të punësuarve në administratën publike, rritje e mëtutjeshme e pagave do çoj në rritjen e barrës tatimore në të ardhmen ose në rritje e borxhit publik ose në një shtrengim fiskal e cila nga ana e saj do të çojë në përkeqsim të mëtejmë të aktivitetit real ekonomik (B.Fetai,p.43).

Shumica e punimeve emppirike sugjerojnë se rritja e pagave nuk do të thotë rritje e kërkesës agregate (Barro 1991), nëse donte qeveria që të siguronte një veprim të fortë fiskale duheshte të rrisë shpenzimet kapitale.
Pas viti 2008, qeveria e Maqedonisë në vend që të ruante të ardhurat që të krijonte suficit buxhetor, ajo vazhdoi me politikë fiskale ekspanzive e cila ishte në kundërshtim me rekomandimet e FMN-së, me arsyetimin se niveli i borxhit publik ishte i ulët dhe se kjo politikë do te kete veprime anticiklike ndaj gjendjes së rënduar në ekonominë botërore.
Në vitin 2009, përshkak të krizës ekonomike të ardhurat filluan të zvoglohen që kontribuan në përkeqsime në bilancin fiskal.

5.Përgjgje ndaj krizës ekonomike

Kriza ekonomike globale që i shfaq në SHBA dhe më vonë u shpërdna nga vendet e Evropës Perendimore në vendet e Evropës Lindore nuk e tejkaloi Republikën e Maqedonisë.Edhe pse kriza nuk u përhap në sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë,efektet negative u reflektuan në sektorin real kryesisht përmes rënjes së kërkesës së jashtme dhe të mbrendshme.Vitin 2008 ekonomia e Maqedonisë e përfundoi me 4.8% rritje të PBB-së duke qenë ndër vendet me rritje më të madhe në Evropë,efektet e krizës filluan të shfaqen kah fundi i vitit 2008.Kështu që vitin 2009 Maqeodonia e përfundoi me rënje të PBB-së për 0.7%.Edhe përskaj kësaj rënje,nëse krahasohet me vendet tjera Maqedonia kishte performancë të mirë ekonomike parasëgjithash si rezultat i kushteve të mira makroekonomike para paraqites së krizës dhe lidhjes jo të fuqishme të tregut financiar të Maqedonisë me tregun financiar Evropian.Sa i përket financave publike për periudhën e kaluar konsiderojme se është zhvilluar një politike prudente fiskale dhe menaxhim i kujdesshëm i borxhit publik.Poltika fiskale në vitin 2009 dhe 2010 u menaxhua në drejtim të arritjes së baraspeshës në mes dy qëllimeve:ruajtjes së stabilitetit ekonomik dhe inkurajimit të aktivitetit ekonomik në mënyrë që të kompenzohen pasojat nga kriza ekonomike globale.Në këtë drejtim vlen të përmenden edhe masat e drejtëpërdrejta stimuluese,të ashtuquajturat masat antikrizë qe patën ndikim edhe në vëllimin e shpenzimeve buxhetore dhe borxhit public.Si përgjigje e drejtëpërdrejtë e rënjes ekonomike qeveria përpiloi katër paketa të masave antikrizë.
Pakoja e pare konsistonte në masat duke targetauar:kompanitë me porbleme të likuiditetit (amnestisë tatimore,pagesa e tatimeve dhe kontributeve sociale përmes kësteve) dhe dhe ndërmarrjeve në përgjithsi të cilat ishin të mbështetura nëpërmjet reduktimit të tarifave të importit dhe përgjesgjësive doganore,reduktimit të kontributeve sociale dhe ndryshimet në tatimit në fitim.Qëllimi kryesor i këtyre masave ishte të mbështesin kompanitë që të rikthehen nga depresioni.Kjo paketë e masave kap vlerën prej 330 milion eurove.
Pakoj e dytë konsiston në një plan të madh 8 vjeçar të investimeve publike I vlersuar në 8 miliard euro.
Pakoja e tretë përfshinte rishikmin e buxhetit dhe projeskioneve të PBB-së për shkak të mos reallizimit të të ardhurave buxhetore si dhe mbështetje kreditore e kompanive etj.

Në mars të vitit 2010 Qeveria promovoi paketën e katërt të stimulimeve që në mes tjerash përfshinte:

-ndrirje të rrogave në sektorin publik

-rrotjen e rrogave në sektor ku rroga minimale ishte shume e ulët

-krijimi i fondit për token bujqësore që synonte shpërndarjen e tokës bujqësore për personat e papunë.

- Edhe përskaj krizës globale deficiti buxhetor në vitin 2009 ishte 2.7% e PBB-së.Në vitin 2009 RM ishte ndër vendet me borxhin publik më të ulët me 23.8% të PBB-së krahasuar me vendet e UE ku mesatarja e borxhit ishte 74% të PBB-së.Niveli i ulët I borxhit publik, i cili u ruajt si rezultat i shlyerjes së tij në vitet me rritje solide ekonomike (2007 dhe 2008) lejoi që Republika e Maqedonisë të jetë ndër vendet e pakta në rajon që të ketë hapsirë fiskale për huamarrje të reja në drejtim të ruajtjes së aktivitetit ekonomik në kushte të krizës globale të prolonguar.Sa i takon borxhit vlen të theksohet se në vitin vitin 2007 Qeveria e RM-së shfrytëzoi rreth 220 milion Euro mjete nga privatizimi i Elektroekonomisë së Maqedonisë për shlyerjen e borxhit.Në vitin 2010 borxhi i përgjithshëm publik ishte 24.2% e PBB-së dhe paraqet një rritje modeste në krahasim me vitin 2009.Në vitet në vazhdim 2011 dhe 2012 huazimi i Qeverisë vazhdon me të njëjtin ritëm,respektivisht borxhi publik arriti në nivelin 28% të PBB-së në vitin 2011,respektivisht 34.1 të PBB-së në vitin 2012.Edhe pse borxhi publik është në nivele të moderuara nëse krahasohet me vendet e Ballkanit Perendimor (p.sh në vitin 2012 borxhi publik i Sërbisë ishte 57.6% të PBB-së, Shqipërisë 60%të PBB-së,Malit të Zi 59%të ëPBB-së,Kroacia 46.1% të PBB-së) por është edhe nën nivelin e kriterit të Mastrihtit i cili është 60% të PBB-së.Megjithatë për Republikën e Maqedonisë shqetësuese mbete trendi i rritjes së borxhit publik kur kemi parasysh projeksionet e borxhit.

5.Konkluzione

Niveli i borxhit publik dhe lëvizjet e indikatorëve makroekonomik nuk kanë relacione strikte pozitive ose negative.Borxhi publik mundë të ketë ndikim pozitiv në tregues të caktuar makrokeonomik,por përfundimisht normat e larta tëë borxhit publik,veçanarisht të borxhit të jashtëm nuk mundë të llogariten si instrument ku duhet të bazohet rritja ekonomike.Çdo qeveri duhet të mbajë llogari për nivelin e borxhit publik dhe mundësive tl pagesës së tij,sepse do të ketë ndikim në vendimet e ardhshme.Shfrytzimi i borxhit publik për finansimin e defcitit buxhetor ose projekteve investive dhe bartja e kësaj ngarkese finansiare për të ardhmen ndikon negativisht në fleksibilitetin e finansave qeveritare dhe kryesisht nënkupton zhvillim të ngadalsuar ekonomik në vitet e ardhshme.Që të maksimalizohen dobitë dhe të minimizohen dëmet nga borxhi publik duhet që borxhi publik të vendoset në një korrnizo ligjore përshkak të kontrollit të nivelit të huazimit dhe sidomos destinimit të tij.Nivel optimal të borxhit publik dë të mundë të llogarisim nivelin i cili do të mundësonte arritjen e qëllimeve ekonomike si p.sh stabilizimin e ekonomisë,rritja ekonomi,zhvillimi i tregjeve finansiare dhe dhe gjatë kësaj të mos jetë rrezikuar zhvillimi I mëtutjeshëm social dhe ekonomik.Vendi nuk duhet të futet në gjendje të mbingarkesës me borxhe që do të shkaktonte jo stabilitet dhe ku do të rrezikoheshte funskionimi normal i ekonomisë.

Derisa shumica e vendeve ballafaqohen me problemet e krizes ekonomike të shkaktuara nga broxhi publik një numër i madh i vendeve e përdorin atë si instrument për të luftuar pasojat e krizës.I tillë është rasti edhe me Republikën e Maqedonisë, e cila nga viti 2006 ka rritje permanente të borxhit publik.

Në kontekstin e poltikave makroekonomike qevria e Republikës së Maqedonisë duhet të tentojë që borxhi publik të jetë i qëndrueshëm dhe të mundë të servisohet.Borxhi publik në Maqedoni ka filluar të shqetsojë,jo për nga lartësia e tij i cili është nën 60% të PBB-së sipas kritereve të Mastrihtit,por për nga dinamika e viteve të fundit.Nëse trajektorja tregon rritje të borxhit rritet edhe risku prej tij.Në vlera absolute broxhi për 6 vite është rritur me më shumë se 1 miliard euro.Edhe pse RM është me nivelë të ulët të borxhit publik,mbetet shqetësuese trendi i saj dhe destinimi i borxhit publik.Edhe për vitet në vazhdim qeveria ka planifikuar rritje të borxhit publik.Është me rëndësi të potencohet dhe projekti më shqetësues ku edhe janë shpenzuar parat e borxhit publik është projekti famoz Shkupi 2014 i cili nga shumica e ekonomistëve llogariten si shpenzime jo produktive të cilat kanë efekte afatgjate ekonomike në termat fiskal të vendit.Në bazë zë argumenteve të cekuar më lart mundë të konkludojmë se është e nevojshme krijimi i një sistemi të mire për menaxhimin e borxhit publik i cili do të mundësojë maksimalizimin e efekteve positive dhe reduktimin e efekteve negative nga borxhi publik që most ë rrezikohet zhvillimi ekonomik i tanishëm dhe i ardhshëm.

6.Literatura

1. Adam Smith (1776).”An Inquiry into the Causes and the Nature of the Wealth of Nations” 18: 99–104.
2. Barro,R (1991) Economic Growth in a Cross Section of Countries,The Quarterly Journal of Economics,Vol 106, pp 407-443.
3. Diamond, P. 1965. National debt in a neoclassical growth model. American Economic Review. 55: 1126–1150.
4. Elbadaw, I.A., Ndulu, B.J., and Ndung’u N. 1997. Debt overhang and economic growth in Sub–Saharan Africa in: Iqbal Zubair. Kanbur Ravi (eds.). External finance for low–income countries.Washington. International Monetary Fund.
5. Ferreira, C. 2009. Public debt and economic growth: a granger causality panel data approach.Technical University of Lisbon Working Papers. 24: 1–17.
6. Fetai,B (2008) Optimal strategy of monetary and fiscal policy in function of maintaining macroeconomics stability in the Republic of Macedonia,Ljublana.
7. Keho, Y. 2010. Budget deficits and economic growth: causality evidence and policy implications for WAEMU countries. European Journal of Economics. Finance and Administrative Sciences.
8. Kumar, M.S., and Woo, J. 2010. Public debt and growth. International Monetary Fund Working Paper. 174: 1–45.
9. Meade,J.E (1958) “Is the National Debt a Burden” Oxford Economic Papers,New Series,Vol.10(2),pp.163-183
10. Modigliani, F. 1961. Long–run implications of alternative fiscal policies and the burden of the national debt. Economic Journal. 71: 730–755.
11. Reinhart, C.M., and Rogoff, K.S. 2010. Growth in a time of debt. American Economic Review.100(2): 573–578.
12. Saint–Paul, G. 1992. Fiscal policy in an endogenous growth model. Quarterly Journal of Economics. 107: 1243–1259.
13. www.finance.gov.mk
14. www.nbrm.gov.mk

Ma.sc.Fatmir Halili, PhD candidate
Dr.cs.Sheqir Kutllovci
Kolegji Universitar "FAMA" Prishtinë

12 Globalizimi - proces shumëdimensional

Globalization - the multidimensional process

Abstract
Globalization has a history quite early but in scientific terms has begun to be addressed a little later. The study of globalization is made of various aspects of the political, sociological, economic, etc., which presents a multidisciplinary concept. The development of technology and the creation of opportunities for communication and quickly move around the world, have made the world forget national boundaries, linguistic and cultural. In this paper we treat globalization as a process and its role in economic, political, cultural and ideological, in the modern world. Nowadays especially in globalization should be seen as an unstoppable process toward global unification in many aspects especially in economic terms, a process that will follow developments throughout the world in the coming decades. In the paper treated globalization as a process that derives the end of which is not known, and that includes various aspects of social life, whose influence is undeniable if either positively in negative terms.
Key words: *Globalization, process, cultural Globalization, political Globalization, economic globalization, ecological globalization, economic growth, etc.*

Hyrje

Si termë Globalizmi është i vonshëm, mirëpo si proces Globalizmi është paraqitur shumë herët. Mirëpo, ka pika mospërputhje në lidhje me këtë proces, në veçanti, nëse ky term përfaqëson diçka të re, një fazë të ndryshme në evoluimin dhe zhvillimin e kapitalizmit, një epokë të re, apo thjesht, një fazë të fundit dhe jo domosdoshmërisht fazën më të rëndësishme në një proces të gjatë historik[63]. Duke u bazuar në lëvizjet e njerëzve nëpër botë, të mallrave etj. gjatë historisë njerëzore mund të dallojmë disa cikle të zhvillimeve, varësisht nga qasja e autorëve dhe nga aspekti i studimit të çështjeve. Sa i përket studimit të globalizmit kryesisht autorët bazohen në ndryshimet shoqëroro ekonomike të cilat kanë ndodhur gjatë historisë njerëzore. Për shembull autorët Suárez-Orozco dhe Qin-Hilliard globalizmin e kanë përshkruar në katër cikle, ku secili nga këto cikle të globalizmit ka transformuar shoqëritë në tërë rajonet e botës. Sipas këtyre autorëve cikli i parë i globalizmit ka filluar më 1492 dhe zgjati deri në vitet e hershme të 1600 s. Cikli i dytë filloj në fund të shekullit të shtatëmbëdhjetë me rritjen e shpejtë të një valë të dytë të kolonizimit evropian që themeloj kolonitë kryesore të skllevërve në Botën e Re, ky cikël përfundoi me një seri të goditjeve të mëdha në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, duke përfshirë luftërat e Napoleonit dhe Revolucionin Francez. Cikli i tretë ka filluar në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë me rritjen e madhe të tregtisë ndërkombëtare, kapitalit dhe flukseve të teknologjisë, si dhe migrimeve masive nga Azia dhe Evropa për në Amerikë. Ky cikël përfundoi me Depresionin e Madh të viteve 1930.

[63]Henry Veltmeyer, Globalization and Antiglobalization: Dynamics of Change in the New World Order, Ashgate Publishing, Ltd., 2004, fq.12

Cikli më i fundit filloi me liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore dhe u intensifikua me liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë botërore në mallrat e prodhuara pas 1967[64]. Procesi i globalizmit vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe shihet qartë se është një proces i pandalshëm dhe i gjithanshëm, si në aspektin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë njerëzore, po ashtu edhe në aspektet e tjera, politike, kulturore, sociale, ideologjiket etj.

Ç'është Globalizmi

Shumë studiues kanë argumentuar se kemi hyrë në një epokë të karakterizuar prej globalizmit, forcat udhëheqëse që përcaktojnë epokën e ndryshimeve në natyrën e shoqërive dhe ekonomive nëpër botë, rezultojnë në krijimin e një sistemi të ndërvarur[65]. Kështu, brenda mendimit akademik, rëndësia e globalizmit është e tillë saqë tashmë është në krye të një disipline në zhvillim të quajtur studimet e globalizimit. Për më shumë, përtej diskutimeve akademike dhe politike, globalizmi tani është kudo në jetën e përditshme: në gazeta, në televizione, në reklama dhe madje edhe në tekstet e muzikës rok[66]. Globalizmi si proces paraqet integrimin global, si të ekonomisë, kulturës, politikës etj. në këtë kontekst globalizmi nënkupton "*shtetin global*". Nocioni i globalizmit, gjithnjë e më shumë është duke u përshkruar, e më pak përkufizohet, duke pasur parasysh se është shumë i ndërlikuar që të definohet me saktësi. Fjala globalizëm në shumicën e fjalorëve interpretohet si nocion i cili nënkupton botën si tërësi të përcaktuar[67]. Globalizmi është perceptuar më mirë si një proces social shumëdimensional i kufizuar ndaj çdo kornize tematike. Dhe me të vërtet, forcat transformuese të globalizmit arrijnë thellë deri në dimensionet ekonomike, politike, kulturore, teknologjike dhe ekologjike të jetës sociale të sotme[68].

Varësisht nga këndvështrimi i autorëve, si dhe nga disiplinat e hulumtimit të tyre, është bërë edhe përcaktimi i globalizmit, për shembull autorët Wells, Shuey dhe Kiely globalizmin e përcaktojnë si një term që përdorët gjerësisht dhe lirshëm, me qëllim të përshkrimit të proceseve të fundit dhe të shpejta të integrimit ndërkontinental ekonomik, social, dhe politik[69]. Ndërsa John Reader thekson se globalizmi është një shkallë e zgjeruar, madhësi në rritje, përshpejtim dhe thellim i ndikimit të fluksit ndër rajonal dhe model i ndërveprimit shoqëror, dhe i referohet ndryshimit ose transformimit në një shkallë të organizimit njerëzor që i lidh komunitetet në distancë dhe zgjeron marrëdhëniet në të gjithë rajonet e mëdha të botës dhe kontinenteve[70]. Sociologu i njohur Giddens thekson se do të ishte gabim nëse globalizmi do të konsiderohej thjesht si një proces i forcimit të unitetit botëror. Globalizmi i marrëdhënieve sociale duhet kuptuar para së gjithash si një risistemim i kohës dhe i hapësirës në jetën sociale. Me fjalë të tjera, jeta jonë është gjithnjë e më tepër nën ndikimin e ngjarjeve që ndodhin mjaft larg prej kuadrit social ku ne kryejmë veprimtaritë e përditshme[71].

---

[64]Marcelo M. Suárez-Orozco, Desirée Qin-Hilliard, Globalization: Culture and Education in the New Millennium, University of California Press, 2004, fq. 38-39

2 [65]Henry Veltmeyer, Globalization and Antiglobalization: Dynamics of Change in the New World Order, Ashgate Publishing, Ltd., 2004, fq. 11

[66]Andrew Jones, Dictionary of Globalization, Polity, 2006, fq. 1

[67]Jasna Plevnik, Pas Globalizmit, Gjeoekonomia e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2003, fq. 27

[68]Manfred B. Steger, GLOBALIZATION a very short introduction, Oxfort University Press, 2003, fq. 6

[69] Gary Wells, Robert Shuey and Ray Kiely, Globalization, Novinka, 2001, fq. 37

[70] John Reader, Globalization, Engineering, and Creativity, Morgan & Claypool Publishers, 2006, Fq.24

[71] Anthony Giddens, Sociologjia, çabej, 2007, fq.495

Nga këto përkufizime shihet qartë se Globalizmi paraqet një fenomen shumëdimensional, prandaj paraqet nevojën e studimit në këndvështrime të shumta si: ekonomik, politik, social, kulturor, etj. Përgjithësisht mund të thuhet se globalizmi përfshinë proceset ekonomike, politike, sociale, etj. të integrimeve globale dhe që janë të pandalshme dhe do të përcjellin shoqërinë njerëzore deri në pafundësi. Por kurrsesi nuk mund të thuhet se një ditë bota do të ketë një qeveri globale ku do të merren vendimet për secilin vend.

E ardhmja e globalizmit

Globalizmi si proces i shumanshëm nuk ka ndonjë datë se kur ka filluar të zhvillohet, por nuk ka as ndonjë datë të përfundimit të tij. Nuk donë mend se shumë procese në ditët tona janë të pandalshme dhe do të përshkojnë shoqërinë njerëzore në vazhdimësi, këto procese janë ekonomike, politike, kulturore, ekologjike etj. ndaj të cilave bota është e detyruar në shumë raste të veproj si e unifikuar. Lufta kundër terrorizmit paraqet një nga nevojat imediate të bashkësisë ndërkombëtare që të veprohet në mënyrë unike, po ashtu, problemet ekologjike paraqesin faktor të rëndësishëm që e gjithë bota të veproj në parandalimin e këtyre problemeve. Këto dhe faktor të tjerë bëjnë që bota të shkoj drejt unifikimit të qëndrimeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në mënyrë të pandalshme. Në pamje të parë duket tepër e pabesueshme që edhe një luftë që po zgjerohet ndaj terrorizmit mund të ndaloj, ose ngadalësojë një seri procesesh sociale kaq të fuqishme siç është globalizmi. Megjithatë, që tani vihen re disa shenja të hershme paralajmëruese. Kontrolle kufitare shumë më të rrepta dhe masa sigurie në aeroportet dhe portet detare më të mëdha të botës e kanë kthyer udhëtimin dhe tregtinë ndërkombëtare shumë më të bezdisshme. Thirrjet për kontrolle të forta në kufijtë kombëtar dhe ndarjet e forta kulturore mund të dëgjohen gjithnjë më shpesh sot në bisedat publike[72]. E gjithë kjo, megjithatë nuk mund të ndaloj proceset ekonomike dhe teknologjike që po ndodhin sot në botë, përkundrazi janë nxitës të bashkëpunimit ndërkombëtar, sepse këto dukuri paraqesin një interes global e jo vetëm interes të një shteti apo kontinenti. Prandaj, mund të konstatohet se globalizmi si proces do të vazhdoj edhe në të ardhmen dhe është një proces i pandalshëm shoqëror shumëdimensional.

Globalizmi dhe rrjedhat ekonomike globale

Kur kihet parasysh interpretimi i ndryshëm nga studiuesit i konceptit të globalizmit, atëherë "si rezultat i këtyre interpretimeve të ndryshme, ka reagime shumë të ndryshme për globalizimin, disa e shohin atë si një rrezik për sistemin ekonomik botëror, ndërsa të tjerët e shohin atë si një mjet për avancimin e ekonomisë botërore"[73]. Nuk ka dyshim se globalizmi si proces ka impaktet e veta të pamohueshme në ekonominë globale, si në aspektin pozitiv po ashtu edhe në aspektin negativ. Globalizimi e rrit integrimin e ekonomive dhe shoqërive në mbarë botën dhe është një proces kompleks që prek shumë aspekte të jetës sonë. Sulmet terroriste mbi Shtetet e Bashkuara më 11 shtator ishin një aspekt i globalizimit. Rritja e shpejtë dhe reduktimi i varfërisë në Kinë, Indi dhe vende të tjera që ishin të varfra 20 vjet më parë është një tjetër aspekt. Zhvillimi i internetit dhe lehtësimi i komunikimit, dhe transportit në gjithë botën është tjetër aspekt. Përhapja e AIDS-it është pjesë e globalizimit, siç është zhvillimi i përshpejtuar i teknologjisë[74]etj. Të gjitha këto pasoja si edhe të tjera të globalizmit nuk mund të mbikëqyrën dhe të rregullohen. Është fakt se shumë rreziqe globale nganjëherë nuk mund të parandalohen, për shkak se këto në tërësi janë procese të reja, që në mënyrë të rëndomtë është shumë vështirë

[72]Manfred B. Steger, GLOBALIZATION a very short introduction, Oxfort University Press, 2003, fq. 159
[73]Michael Intriligator, Economics of Globalization, Ashgate Publishing Ltd, 2005, fq. 67
[74]Paul Collier, David Dollar, Globalization, Growth, and Poverty: Building an Inclusive World Economy, World Bank Publications, 2002, foreward of bosk,

të identifikohen si rreziqe[75], edhe pse personalisht globalizmin e shoh si një fenomen që ka ndikuar në mënyrë negative në shoqërinë njerëzore, duke krijuar divergjenca sociale dhe ekonomike, dhe duke ju përshtatur kryesisht në favore shteteve të mëdha, megjithatë duhet pranuar se është një proces i pandalshëm që do të përcjell shoqërinë njerëzore në vazhdimësi, posaçërisht në aspektin ekonomik.

Duhet theksuar se "globalizmi ekonomik i referohet intensifikimit dhe zgjerimit të ndërvarësisë ekonomike në mbarë rruzullin tokësor. Shtegtime gjigante të kapitalit dhe teknologjisë kanë nxitur tregtinë e mallrave dhe shërbimeve. Tregjet janë shtrirë në tërë botën duke krijuar në këtë proces lidhje të reja midis ekonomive kombëtare. Korporata shumë të mëdha ndërnacionale, institucione të fuqishme ekonomike ndërkombëtare dhe sisteme të mëdha tregtare rajonale kanë lindur si blloqe të mëdha ndërtimi të rendit ekonomik global të shekullit XXI"[76].

Globalizmi dhe fuqitë e mëdha

Një nga interpretimet më të shpeshta që jepen, përkitazi me efektet e globalizimit është dobësimi i sovranitetit të shteteve në relacion me ekonominë globale. Pa dyshim roli i fuqive të mëdha në botë, jo vetëm tani por edhe më herët, ka qenë i shprehur mjaft shumë, për të mos thënë vendimtar. Globalizmi shumë shpesh interpretohet si amerikanizëm, meqë pasojat e tij për bashkësinë ndërkombëtare janë të njohura si zgjerimi i ekonomisë amerikane, dhe i modelit politik e kulturor amerikan. Dhe jo vetëm kaq, por edhe në sferën e vendimmarrjes në nivelin e sistemit botëror. Amerika është i vetmi faktor i cili mund të veproj në aspektin financiar, ushtarak, ekonomik dhe politik në mënyrë globale[77]. Fakti se bota është amerikanizuar më shumë se më parë, nuk do të thotë se duhet shikuar si proces negativ, por kjo mund të shpie deri te konstatimi se idetë amerikane të demokracisë dhe të tregtisë së lirë gjithnjë e më shumë pranohen si ide universale, e jo si ideologji e pas përfundimit të luftës së ftohtë[78]. Nga kjo mund të konstatohet se në botë ndikimi i fuqisë amerikane është i pakontestueshëm, mirëpo, kjo nuk do të thotë se globalizmi të identifikohet me ndikimin e fuqisë amerikane në botë. Vlen të theksohet se nuk ka ndonjë garanci që fuqia amerikane do të vazhdoj të jetë dominuese, ashtu siç nuk ishin dominuese edhe shumë fuqi të tjera gjatë historisë. Prandaj, interpretimi i globalizmit si amerikanizëm nuk mund të thuhet se është i saktë.

Konkluzione

Globalizmi si proces ka filluar mjaft herët, ndërsa në aspektin shkencor trajtimi i tij ka filluar shumë më vonë. Kur flitet për trajtimin e konceptit të globalizmit në aspektin shkencor, duhet pasur parasysh aspektin shumëdimensional të tij, si aspektin politik, ekonomik, kulturor, ekologjik etj. Impaktet e globalizmit janë të padiskutueshme në secilin aspekt, e posaçërisht në aspektin ekonomik janë shumë më të theksuara, sot në botë prodhimet e një kompanie, për shembull Kineze, mund të gjenden në shitje në shumë vende të tjera të botës, apo të Bashkimit Evropian, apo të ndonjë vendi tjetër.

Në aspektin kulturor po ashtu vërehet mjaft shumë ndikimi i globalizmit, për shembull muzika Rok dëgjohet gati në të gjitha shoqëritë e botës, demokracia liberale është përhapur në shumë vende të botës dhe vazhdon të merret si model në shumë shoqëri etj.

[75]Jasna Plevnik, Pas Globalizmit, Gjeoekonomia e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2003, fq. 16-17

[76]Manfred B. Steger, GLOBALIZATION a very short introduction, Oxfort University Press, 2003, fq. 37

[77]Jasna Plevnik, Pas Globalizmit, Gjeoekonomia e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2003, fq. 30

[78]Jasna Plevnik, Pas Globalizmit, Gjeoekonomia e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2003, fq. 31

Në këtë kontekst globalizmi shpeshherë interpretohet si amerikanizim, meqë pasojat e tij për bashkësinë ndërkombëtare janë të njohura si zgjerimi i ekonomisë amerikane, dhe i modelit politik e kulturor amerikan.
Globalizmi si proces ka ndikuar në çdo shoqëri në mbarë globin, dhe do të vazhdoj edhe më tej të përcjell ndryshimet shoqërore dhe ekonomike në secilin vend. Mirëpo kjo nuk do të thotë se bota po shkon drejt një qeverisje globale, sepse divergjencat kulturore, fetare, gjuhësore etj. janë aq të mëdha sa është e vështir të unifikohen dhe të udhëhiqen nga një qeverisje e vetme globale.

Summary
Globalization is a multifaceted process, and studied from different angles. Globalization as a process has started quite early but scientific treatment of the concept of globalization began in the twentieth century, especially the last two decades of this century and the beginning of the XXI century marked intensification of globalization treatment. Interpretation of globalization has made in various aspects: in terms of economic, political, cultural, ecological, etc. depending on the discipline which belongs to the researcher, and each represents a dimension of globalization, therefore justly conclude that globalization is a multidimensional process. No doubt the role of great powers in the world, not only now but even earlier, has been expressed quite a lot, if not decisive. Globalization often interpreted as Americanism, as its consequences for the international community are recognized as the expansion of the American economy, and American political and cultural model. From this it can be concluded that in the world the impact of American power is unquestioned, but this does not mean that globalization can be identified with the influence of American power in the world, or another power whichever it. Globalization as a process of multilateral there is no date when it has started to develop, but there is not any date of its completion. Remember do not want that many processes nowadays are unstoppable and will continuously permeate human society, these processes are economic, political, cultural, ecological, etc. to which the world is forced in many cases to act as unified. The process of globalization continues to this day and it is clearly an ongoing process and versatile, both in terms of economic development of human society, as well as in other respects, political, cultural, social, ideological, etc..

Bibliografia

Henry Veltmeyer, Globalization and Antiglobalization: Dynamics of Change in the New World Order, Ashgate Publishing, Ltd., 2004,
Marcelo M. Suárez-Orozco, Desirée Qin-Hilliard, Globalization: Culture and Education in the New Millennium, University of California Press, 2004,
Henry Veltmeyer, Globalization and Antiglobalization: Dynamics of Change in the New World Order, Ashgate Publishing, Ltd., 2004,
Andrew Jones, Dictionary of Globalization, Polity, 2006,
Jasna Plevnik, Pas Globalizmit, Gjeoekonomia e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2003,
Manfred B. Steger, GLOBALIZATION a very short introduction, Oxfort University Press, 2003,
Gary Wells, Robert Shuey and Ray Kiely, Globalization, Novinka, 2001,
John Reader, Globalization, Engineering, and Creativity, Morgan & Claypool Publishers, 2006,
Anthony Giddens, Sociologjia, çabej, 2007,
Michael Intriligator, Economics of Globalization, Ashgate Publishing Ltd, 2005,
Paul Collier, David Dollar, Globalization, Growth, and Poverty: Building an Inclusive World Economy, World Bank Publications, 2002,

Dr. Sc. Hamdi Hoti[79]
Mr. Sci. Remzi Ahmeti[80]
Msc. Shefsat Kryeziu[81]
Skender Tahiraj,Ecc. i dipl[82]

UNIVERSITETI I PRIZRENIT,
Rruga e shkronjave p.n,
hamdi_hoti@hotmail.com,
hamdi.hoti@uni-prizren.com
UNIVERSITETI I PRIZRENIT,
Rruga e shkronjave p.n.,
shefsatkryeziu@hotmail.com

13 Menaxhimii riskut në Bizneset Kosovare

Abstrakt

Rregullisht në jetën tonë dhe në praktikat e përditshme të punës sonë dhe bizneseve marrim vendime të ndryshme që përmbajnë risk për bizneset. Në lidhje me riskun ka përkufizime dhe mendime të ndryshme, varësisht prej situatave, këndvështrimeve dhe objektivave të ndryshme.
Risku në përgjithsi ka lidhje të madhe me pasigurinë, mundësinë për të humbur në biznes por edhe për të fituar në situata të ndryshme. Riskudefinohet si ngjarje e mundshme që ndodhë dhe që ka implikime negative në ndërmarrje. Risku është element fundamental i jetës së një biznesi, si dhe mund të ketë domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm, por çdonjëra nga këto risqe ka pasoja të mëdha dhe të paevitueshme financiare për bizneset.
Në përgjithsi për biznese, risku paraqet mundësinë e ndodhjes se ngjarjeve të cilat shkaktojnë luhatje dhe mosrealizim të objektivave. Risku mund të matet, të vlerësohet dhe të menaxhohet.
Risku është proces i vazhdueshëm për bizneset, dhe se risqet mund të shoqërojnë ecurinë e bizneseve dhe janë të vazhdueshme çdo herë.

Në këtë punim do të përpiqemi të japim përgjigje në pyetjet e mëposhtme si:
Cilat janë risqet me te cilat përballen bizneset në Kosovë?
Cilët janë faktorët e riskut dhe ndikimi i tyre në bizneset në Kosovë?
Cilat janë mundësit për parandalimin e riskut në bizneset Kosovare?

Fjalët kyçe: Risk, biznes, menaxhim, ekonomi, proces.
Risk managementinKosovoBusinesses

Abstract

Regularly in our lives and in everyday practices of our work and business we take different decisions that contain risks for businesses.

---

[79] **Dr. Sc. Hamdi HOTI,**
Lecturer: University of Prizren;
Faculty of Economics;
hamdi_hoti@hotmail.com
[80] **Remzi AHMETI, PhDc.**
Anëtar i bordit në ndërmarrjen publike
KRM UNITETI Sh.a. Mitrovicë
[81]**Msc. Shefsat KRYEZIU**
Lecturer: University of Prizren;
Faculty of Economics.
[82] **Skender TAHIRAJ, Ecc.dipl**
Kryeshef i bordit në ndërmarrjen
PublikeKRM UNITETI Sh.a. Mitrovicë

Regarding the risk, there are different definitions and opinions, depending on situations, views and differing objectives.
Overall, risk relates to uncertainty, possibility of loss making in business but also profit making in some circumstances. Riskis definedas an eventlikelytooccurand the one thathasnegative implicationsonenterprise. Riskisa fundamental elementof the business life and itcan have different meanings fordifferent people, regardless each of the views, riskshas major and inevitable financial businesses consequences.
In Business, generally risk representsthe possibilityof occurrence of an eventwhich cause fluctuations andobjectivesshortfall. Risk canbemeasured, be assessedandmanaged
Riskisa continuous processforbusinesses, andmayassociate performance of thebusinessin continuing basis!
In thispaperwilltrytoanswerthe following below questions:
What aretheriskstthat businesses faceinKosovo?
What are the risk factors and their impact in Kosovo businesses?
What are theopportunitiesforriskpreventioninKosovobusinesses?

Key Words: Business, management, economy, process.

Hyrje

Menaxhimii riskut në Biznesin Kosovarë është njëri ndër konceptet më të reja në fushën e ekonomisë por që në përgjithsi është shumë i rëndësishëm për momentin në fushën e menaxhimit, ka të bëjë me identifikimin e analizës, vlerësimit dhe trajtimin e rrezikut të shfaqjes së ndodhive të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të ndërmarrjeve biznesore. Pasiguria dhe mundësia e shfaqjes së dukurive të cilat pengojnë realizimin e objektivave janë shoqërues i çdo aktiviteti pa marrë parasysh natyrën e tij. Risku përkufizohet si mundësi për të humbur. Risku gjithmonë është mundësia që rrjedha aktuale e parasë *(kthimi)* do të ndryshojë nga rrjedha e planifikuar. Aktivitetet me risk janë ato aktivitete me mundësi më të mëdha për të humbur. Mungesa e sigurisë është gjithmonë e lidhur me konceptin e riskut.
Risku lidhet me pasigurinë e kthimit të mjeteve të kursyera apo edhe të mjeteve të tjera të investuara.[83] Kuptimi i riskut është i lidhur me pasigurinë e investitorit për biznese se fitimi i pritur ose fitimi i supozuar do të realizohet në praktikë.
Prandaj, kuptimi i riskut është i lidhur me hezitimin apo me dyshimin se në realitet nuk do të vërtetohet ngjarja ashtu sikurse e kishim parashikuar. Me fjalë tjera, fitimi i realizuar në biznese mund të mos jetë i barabartë me fitimin e pritur ose madje edhe më keq, subjekti mund të mos realizoj fare fitim.[84]
Menaxhimi i riskut është komponentë e rëdësishme për menaxhimin e bizneseve, prandaj menaxhimi i riskut ju referohet rrugëve përmes të cilave evitohet risku. Ky menaxhim është i drejtuar në evitimin e pengesave dhe situatave të cilat janë të papritura në biznese dhe efekteve të tyre në mjedisin e jashtëm. Risku gjithmonë lidhet me faktin se sa drejtuesit të cilët marrin vendime vlerësojnë me probabilitet të lartë nivelin e rezultateve që ata presin dhe të cilat janë produkt i vendimeve të cilat mund të merren prej tyre. Menaxhim i riskut është procesi, i ndarë nga vlerësimi i riskut, i vlerësimit të politikave alternative në këshillim me subjektet e interesuara, duke pas parasysh vlerësimin e riskut dhe faktorët e tjerë të pranueshëm.
Menaxhimi i riskut siguron që masat parandaluese dhe ato të kontrollit, të marra për të parandaluar, zvogëluar ose eliminuar rreziqet për biznesin, të lidhura në rezultatet e vlerësimit të riskut. Analiza e riskut është proces që ka lidhje me tre komponentë të ndërthurur me njëri-tjetrin e të cilët janë: vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe komunikimi i riskut.

[83]Govori,Fadil, "Financë", Prishtinë 2010, faqe 19
[84]Govori,Fadil, "Financë", Prishtinë 2010, Faqe 22

Cilat janë risqet me të cilat përballen bizneset në Kosovë

Menaxhimii riskut në Biznesin Kosovarë në jetën e përditshme ballafaqohet çdo ditë me rreziqe të formave dhe të natyrave të ndryshme kundrejt të cilave përpiqemi që të ushtrojmë kontroll mbi rriskun siç janë: humbja e vendit të punës, rritja enorme e çmimeve, fatkeqësitë e ndryshme natyrore, vozitja e pa kujdesshme në rrugë, vjedhjet e natyrave të ndryshme etj. Të gjitha bizneset që zhvillojnë aktivitetet e përditshme të veprimtarisë së tyre gjithmonë shoqërohen me rreziqe të jashtme dhe të brendshme, rreziqe të cilat patjetër se nëse nuk menaxhohen drejtë, rrezikojnë arritjen e objektivave afariste të organizatave etj. Përgatitja për tu përballur me ngjarjet që e pengojnë realizimin e objektivave të përgjithshme të bizneseve në vend u mundësojnë bizneseve që të shmangen nga risqet, reduktojnë, transferojnë të pranojnë ose edhe të menaxhojnë rrezikun. Kështu biznesi mund të aplikoj strategji të pranueshme përmes të cilave parandalon, ose në përgjithsi korrigjon mundësin për ndodhjen e ngjarjeve të cilat rrezikojnë realizimin e objektivave të bizneseve Kosovare. Gjatë aktiviteteve të punës përvoja e bizneseve të suksesshme ka treguar se menaxhimi i riskut në mënyrën e drejtë ka mundësuar ruajtjen e pronës dhe të pasurisë, rritjen dhe zhvillimin e saj pamvarësisht nga lloji i veprimtarisë duke u bazuar në atë se risku jo vetëm që paraqet kërcënim, por ai paraqet edhe mundësi në qoftë se në kohën e duhur bizneset në përgjithsi përgatiten për ta kaluar këtë risk. Risku ka rëndësi të veçantë për të gjitha bizneset në përmasa rajonale dhe globale, janë hartuar standardet ndërkombëtare për menaxhimin e riskut të ndërmarrjeve në vend dhe në botë. Standardet përshkruajnë rëndësinë dhe përgjegjësinë që ka menaxhmenti dhe personeli punues jo vetëm për aksionet që merren për këtë lëmi, por edhe për të gjitha dështimet që vijnë si pengesë e realizimit të objektivave të biznesit, mandej për rolin dhe përgjegjësinë që kanë funksionet siç janë: Kontrolli i brendshëm, mbikëqyrja, ekipet e auditimit si dhe shumë institucionet tjera brenda biznesit për rritjen e vazhdueshme të pasurisë dhe të biznesit. Në botë çdo ditë ka zbulime shkencore për gjetjen e mënyrave të reja dhe më të përshtatshme për rritjen e bizneseve si dhe cilësinë dhe rritjen e performancës së ndërmarrjeve në treg, e që këto ndikojnë në mënyrë direkte në zhvillimin ekonomik të vendit madje edhe më gjerë. Duhet të ketë iniciativa të reja të institucioneve vendore për subjektet biznesore për stimulimin dhe zhvillimin e bizneseve ku këto institucione janë: Qeveria e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ministria e zhvillimit ekonomik, dhe Organizatat e tjera joqeveritare siç janë: Aleanca Kosovare e biznesit, Asociacioni i bizneseve të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, institucionet shkencore dhe të gjithë individët dhe ekspertët tjerë në fushën e ekonomisë.

Cilët janë faktorët e riskut dhe ndikimi i tyre në bizneset në Kosovë

Faktorët e riskut për biznes ndahen në faktorë të jashtëm dhe në faktorë të brendshëm të biznesit. Çdo biznes ju nënshtrohet risqeve të ndryshme që vijnë si pasoj e ekonomisë ku ai operon, sistemit ekonomik dhe atij financiar, kulturës së punës dhe ligjeve të vendit ku operon[85].

Çdo biznes ka karakteristikat e tij unike dhe specifike, që përveç se i shtojnë vlerë biznesit, ato i ulin ose edhe mund ti rrisin ekspozimin ndaj riskut. Të gjitha bizneset në Kosovë paraqesin karakteristika të një biznesi dinamik dhe fleksibil të cilat janë të fokusuara kryesisht ndaj shërbimeve 80% dhe të organizuar në mikro ndërmarrje ose ndërmarrje të vogla 99%.

[85] Rejnald Muca, Gerdi Lito: Risqet me te cilat perballet biznesi shqiptar dhe manaxhimi i tyre, Departamentii Finances, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranes, 2011

Këto biznese angazhojnë pak kapital, duke qenë kështu fleksibël ndaj ndryshimeve. Faktorët të cilët ndikojnë në mënyra të ndryshme në riskun me të cilin përballen bizneset Kosovare sot janë:

Faktorët e jashtëm të riskut

Rrisqet të cilat identifikohen nga bizneset në Kosovë si pasojë e faktorëve të jashtëm janë:
Risqet strategjike, risqet operacionale, risqet financiare dhe risqet e pastërta.

Risqet strategjike- Janë risqe që kërcënojnë ekzistencën e biznesit dhe vazhdimësinë e tij. Disa prej risqeve më të rëndësishme strategjike janë:

Konkurrenca ose risku i tregut- Shumica e bizneseve dalin jashtë loje për mungese të shitjeve ose të ardhurave të mjaftueshme. Dy elementet që ndikojnë në rënien e të ardhurave janë rënia e kërkesës se klientëve për produktin e kompanisë dhe konkurrenca. Në Kosovë konkurrenca është problem madhor për shumë biznese, për faktin se në mjaft sektorë dhe aktivitete paraqitet e pandershme, që dmth. se risku i konkurrencës është mbi normalen. Format me problematiket janë informaliteti, evazioni fiskal, arbitrariteti ne tatime- taksa, etj. Element tjetër që vlen te përmendet është përqendrimi i madh i bizneseve në pak sektorë. Sipas agjencionit të Statistikor të Kosovës rreth 44% e bizneseve janë biznese që kryejnë tregti me shumicë dhe pakice dhe riparime të automjeteve, ndërsa e dyta për nga veprimtaria vjen hoteleria dhe restorantet e ndryshme me një përqindje rreth 15%[86].

Kërkesat e klientëve dhe fuqia blerëse- Sektorë të ndryshëm kane ndjeshmëri të ndryshme ndaj kërkesave dhe rënies së fuqisë blerëse. Asnjë veprimtari menaxhuese nuk mund të japë efektet e pritura nëse nuk studiohen kushtet në të cilat funksionon sistemi, i cili është objekt i menaxhimit[87]. Në një ekonomi ku dominon sektori i shërbimeve, dhe ku fuqia blerëse është e ndjeshme ndaj krizave ekonomike, risku paraqitet delikat. Ky lloj risku është ndryshuar ndjeshëm nga kriza ekonomike që ka goditur rajonin dhe botën. Fuqia blerëse në Kosovë ka rënë si ndikim direkt i rënies së të ardhurave nga remitancat.

Kultura e biznesit- Është problem që zakonisht te ne neglizhohet. Karakteristikat e bizneseve të vogla Kosovare, bëjnë që të jenë të orientuara drejt fitimit afatshkurtër, pa vizion afatgjate, që shpesh ndikon për keq në fitimin dhe ecurinë afatgjatë. Kultura e biznesit paraqet mënyrën e organizimit, planifikimit, kontrollit dhe sjelljet e organizatës në situata të caktuara[88]. Vendimet merren duke marre për bazë një situate afatshkurtër.

Risqet operacionale:

Aktet juridike dhe zbatimi i tyre- Problem me i madh për biznesin mbetet zbatimi i tyre dhe efektiviteti i sistemit gjyqësor në çështjet që lidhen me biznesin[89]. Ndryshimi i shpeshte i ligjeve, sidomos të atyre fiskale, përbën risk që duhet pasur kujdes të veçantë. Rasti më i freskët në Kosovë është instalimi i arkave fiskale në të gjitha bizneset me çmim të lartë dhe kufizimi i blerjes së arkës vetëm nga një furnitorë. Ky është demotivim për bizneset e reja dhe ato të vjetra që mezi mbijetojnë si biznese të cilat janë të detyruara të paguajnë shuma të mëdha për blerjen e arkës. Kjo rezulton pastaj me neglizhimin e shitjes së rregullt nga bizneset duke u ikur tatimeve.

Ambienti politik- Në Kosovë është tejet i politizuar kjo reflektohet edhe tek aktivitet e përgjithshme të biznesit. Mënyra se si te ne po funksionojnë gjerat po i favorizojnë klientelizmin politik. Ka biznese për të cilat mund të flitet për një lloj cikli politik të biznesit. Ambienti politik ndikon dhe në klimën për investime, në partneritetet me kompani të huaja dhe në imazhin që krijohet për produktet Kosovare.

---

[86] Repertori statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike ne Kosove, Raporti për NVM-te, 2011
[87] Qemal Y. Buqinca: Menaxhimi i sistemeve organizative, Prishtine, 2006, Fq. 95
[88] Bedri Ademi: Menaxhimi i bisnesit familjar, Universiteti Fama, 2008, Fq 34
[89] Rejnald Muca, Gerdi Lito: Risqet me te cilat perballet biznesi shqiptar dhe manaxhimi i tyre, Dep.i Finances, Fakulteti i Ekonomise, Universiteti i Tiranes, 2011

Furnitorët, kontratat etj- Marrëdhëniet me furnitorët dhe me palët e treta mund të bëhen problematike në kushtet e krizës. Vënia në vështirësi e një sektori të caktuar mund të japë efekt negative në shumë biznese. Shembulli më tipik në Kosovë dhe në rajon është rritja e vazhdueshme e kostos së karburanteve duke ndikuar kështu në masë të madhe në rritjen e çmimeve të përgjithshme duke rezultuar kështu në zvogëlimin e fitimeve të ndërmarrjeve biznesore në Kosovë.

Risqe financiare- Janë risqe që lidhen me parametrat mikrofinanciare të ekonomisë. Ndikojnë në mundësitë për të financuar bizneset dhe në fitimin e tyre[90]. Të gjitha bizneset nuk ndikohen njësoj.

Normat e interesit- ndikojnë direkt në mundësinë dhe kostot e financimit. Në Kosovë aplikohen norma të larta të interesit me arsyetimin se jemi shtet në tranzicion dhe ekziston pasiguri në kthimin e kredive.

Shtrëngimi i kredisë- Ky risk ka ndryshuar mjaftë nga kriza financiare e viteve të fundit, e cila ka vënë në vështirësi edhe sistemin bankar. Rritja e nivelit të kredive me probleme i ka bërë bankat më të kujdesshme dhe konservatore në dhënien e kredive, duke zvogëluar mundësitë për financim për shumë biznese[91].

Risqe të pastra- Janë risqe ku ekziston mundësia vetëm për humbje, nga ngjarje që shkaktojnë dëme direkte ose pengojnë zhvillimin normal të aktivitetit të biznesit.

Katastrofat natyrore- janë ngjarje të menjëhershme shkatërrimtare, që shkaktojnë dëmtime të mëdha, humbje, shkatërrim të jetës dhe pronës. Mund të jenë fatale për bizneset e një zone të tërë. Përveç dëmeve direkte në prona dhe jetë njerëzish, katastrofat bllokojnë zhvillimin e aktivitetit normal të biznesit, dhe ndikojnë në rritjen ekonomike dhe parametrat kryesore mikrofinanciare.

Ndodhitë natyrore/ njerëzore që shkaktojnë dëme- Janë ngjarje me impakt më të vogël se katastrofat, por që janë fatale për një biznes nëse nuk është i mbuluar me sigurim, shembull praktik është kaplimi i ndërmarrjes nga zjarri, përmbytja nga ujërat etj.

Faktorët e brendshëm të riskut

Risqet strategjike- të gjitha bizneset kanë strategji vetanake *(të shkruar në mendjen e pronareve të bizneseve).* Elemente të ndryshëm të strategjisë se një biznesi mund të jenë burim risku nëse nuk vlerësohen si duhet.

Zhvillimi i produkteve- është element i rëndësishem. Një produkt i pamenduar mire *(jo cilësor, jo konkurrent, i vështirë për tu arritur)* është një dështim i sigurt.

Kapitali njerëzor- është aktiv ndonëse nuk pasqyrohet gjëkundi në bilancet e ndërmarrjeve, është nga elementet më të rendesishem për sukses afatgjate. Në Kosovë dhe në rajon bëhet pak në këtë drejtim nga bizneset për të formuar kapitalin e tyre njerëzor. Pak ndërmarrje kanë program formimi të punonjësve, mënyra e vetme për të mbajtur të lidhur punonjësin me ndërmarrjen është paga.

Risqet operacionale- Janë nga risqet më të neglizhuara. Konsiderohen si me efekt të vogël, por kostot që ato bartin për bizneset janë të konsiderueshme.

Burimet njerëzore- punonjësit në kompani janë burimi kryesor i riskut operacional. Gabimet, pakujdesitë dhe rastet e mashtrimit apo vjedhjeve nuk janë të pakta. Kërkojnë menaxhim të kujdesshëm, por edhe sistem të mirë kontrolli *(auditimi).*

[90] Xhevat Bakraci " Menaxhmenti i Rrezikut dhe sigurimi" Fq. 90

[91] Rejnald Muca, Gerdi Lito: Risqet me te cilat perballet biznesi shqiptar dhe manaxhimi i tyre, Dep.i Finances, Fakulteti i Ekonomise, Universiteti i Tiranes, 2011

Sistemet- Ndërmarrjet përdorin sisteme të ndryshme, për informacion dhe për shpërndarje apo marketing. Problemet më të mëdha që hasen në praktikë vijnë nga sistemet informatike, sistemi i kontabilitetit dhe informacionit financiar, sistemet e logjistikes etj.
Teknologjia- risku teknologjik ekziston për biznese të cilat kanë lidhje direkte me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Shpesh një problem në dukje i vogël mund të shkaktojë humbje të mëdha.
Risqet financiare- lidhen me pamundësinë për të paguar detyrimet/ose gjetjen e burimeve për të financuar aktivitetin dhe rritjen e biznesit.
Likuiditeti- është problem i madh në rritje. Janë të pakta bizneset në Kosovë të cilat kanë një gjendje likuide dhe nuk janë të varura nga borxhet apo kreditë bankare. Për shkak të mungesës së likuiditetit në Kosovë gati në çdo veprimtari aplikohet metoda e blerjes së mallrave/ shërbimeve me anë të ndërrimeve. Shkalla e likuiditetit është e caktuar me raportin ndërmjet çmimit të pritur maksimal dhe çmimit të tregut, që është realizuar në shitjen në një periudhë relativisht të shkurtër kohore[92]. Kriza ekonomike e ka theksuar këtë problem, pasiqë shumë biznese përballen me rënien e shitjeve dhe fuqisë blerëse, gjë që ul likuiditetin dhe rrit kohën e pagimit të faturave/borxheve, duke shtuar nivelin e borxhit në ekonomi[93].
Mungesa e burimeve të financimit-është çështje jetike. Pronaret e bizneseve të reja, kryesisht atyre të vogla, burimet për t'ia filluar punës i sigurojnë nga kursimet familjare, pasuria e lenë peng, ose nga huaja[94]. Shtrëngimi i kredisë në ekonomi është faktor i cili lidhet me kapitalin e siguruar nga huat. Faktorët tjerë lidhen me burimet e veta, nga fitimet e mëparshme. Duke rënë fitimet, bien mundësitë për të financuar investime të reja dhe rritjen e biznesit. E gjithë kjo përkthehet direkt ne rënie të investimeve private, që është komponenti më i rëndësishëm në PBB e një vendi, sidomos për Kosovën, kur eksportet, janë ende të ulta krahasuar me nivelin e importeve. Si dhe rënia e të ardhurave nga emigracioni ka reduktuar flukset hyrëse të kapitalit në dispozicion për investime.
Risqet e përgjegjsisë- *B*izneset kanë marrëdhënie me palë të treta. Dhe është e mundur që gjatë këtyre marrëdhënieve një biznes të dëmtojë palë të trete. Kështu produktet jocilësore dëmtojë klientët, mungesa e kushteve te sigurisë në punë dëmton punonjësit, ndotja e ambientit, zhurma i shkakton dëm shoqërisë etj. Këto risqe neglizhohen dhe bëhen objekt çështjesh ligjore të komplikuara dhe të kushtueshme.

Cilat janë mundësit për parandalimin e riskut në bizneset Kosovare
Në praktikat e përditshme të punës së bizneseve Kosovare sot ekzistojnë katër mënyra për tju përgjigjur riskut siç janë: Shmangia, Pakësimi, Transferi dhe Pranimi i riskut.
Shmangia e riskut eliminon rrezikun përmes heqjes dorë nga aktivitetet e punës të cilat janë me risk. Ka disa lloje të risqeve të cilave nuk mund tu shmangemi, por shpeshherë ekzistojnë mundësi ku ato mund të reduktohen me veprime të kujdesshme të parandalimit, psh. me përdorimin e masave mbrojtëse dhe masave të tjera të sigurisë, në rastet kur të përdorim materiale të llojeve të rrezikshme. Pakësimi i rriskut në përgjithsi minimizon rrezikun tek bizneset, duke përdorur metoda të ndryshme, për më tepër ai bënë të mundur edhe zvogëlimin e gjasës për të ndodhur ngjarje të dëmshme. Ndërsa transferi i riskut i kalon pasojat e riskut në një individ apo organizatë tjetër, të cilët janë jashtë biznesit tuaj. Sigurimet janë forma më e mirë e transferit të riskut, kur një kompani tjetër do të paguaj në rast të dëmit eventual të ndodhur.Pranimi i riskut përfshin pranimin e risqeve dhe të pasojave, në rast se do të ndodhnin akte jo të këndshme. Andaj pranimi i riskut gjithmonë është zgjedhje e planifikuar dhe e menduar në ndërmarrjet e biznesit në Kosovë.

[92] Xhevat Bakraci "Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimeve"Prishtine, Fq. 135
[93] Isa Mustafa: "Menaxhmenti Financiar", Botimi i dyte, Prishtine, 2007
[94] Isa Mustafa: "Menaxhmenti Financiar", Botimi i dyte, Prishtine, 2007, Fq 210

Në përgjithësi, pranimi i riskut është i menduar atëherë kur, për më tepër rreziku i humbjes së mundshme financiarisht nuk është edhe aq e rëndësishme për biznesin, ose kur kostoja e sigurimit nga dëmi është shumë e kushtueshme për biznesin.
Menaxheret duhet të kuptojnë që në çdo biznes koha është e rëndësishme, prandaj vonesat mund ta kthejnë një porosi fitimprurëse në një humbje parash[95].
Në përgjithësi nga risqet është problem që të sigurohemi, por që rrisqet mund të minimizohen gjithmonë përmes informacionit dhe planifikimit të duhur. Prandaj në këtë çështje duhet bërë monitorim të përhershëm dhe të rregullt në mënyrë që të reagojmë sa më shpejt në raste kur paraqiten situata të tilla të mundshme. Mund të bëhet zvogëlimi i riskut nga humbja e punëtorëve të mirë dhe largimi i tyre nga puna. Personeli duhet që në mënyrë permanente të trajnohet për detyra të llojllojshme dhe vazhdimisht të bëhet përgaditja e tyre profesionale.
Me angazhim të mirë të menaxhmentit drejtues mund të bëhet zvoglimi i riskut nga vdekja e punëtorëve, duke bërë sigurimin e jetës së tyre. Një numër i madh i njerëzve që merren me biznese mendojnë për riskun e pronës vetëm atëherë kur përmendet menaxhimi i tij. Andaj më së lehti është që të mbrohemi dhe të sigurohemi kundrejt humbjes së pasurisë pa marrë parasysh se a është strategji e mbrojtjes së keshit, sistem i sigurisë, mbrojtje nga zjarri ose sigurim i sistemit kompjuteristikë, rregullisht duhet të identifikohen risqet potenciale dhe të dilet me plan konkret për zvogëlimin e ekspozimit të riskut, duke përfshirë rrezikun nga humbja totale e biznesit apo pronës. Mënyra më efikase dhe efiçiente për mbrojtje nga rreziqet e punëtorëve është zgjedhja e kujdesshme dhe mbikëqyrja e tyre. Me rritjen e biznesit, është e rëndësishme edhe gjetja dhe trajnimi i punëtorëve shtesë për ndërmarrjen. Është shumë me rëndësi nëse ata janë punëtorë janë të aftë për punë dhe të ndershëm. Një numër i madh i bizneseve shpeshherë nuk e shohin ose e minimizojnë rëndësinë e posedimit të marrëdhënieve të mira me punëtorë për të poseduar biznese të suksesshme. Punëtorët gjithmonë janë burimi kryesor i mirëqenës së biznesit, prandaj edhe duhet të trajtohen si të tillë. Dhe gjithherë mbajtja e marrëdhënieve të mira me punëtorë zvogëlon ekspozimin tuaj ndaj risqeve të punëtorëve. Edhe risqet që fokusohen në konsumatorë paraqiten në forma të ndryshme. Një rrezik i pastër, i cili mbulohet nga sigurimi, është nëse konsumatori lëndohet në vendin e punës. Për aktivitetet në shitjen me pakicë, vjedhja nga konsumatori është tepër e mundshme, por kjo ndërlidhet me rrezikun e pasurisë. Risk i vazhdueshëm i konsumatorit është edhe kur ai më nuk blen tek ju, ose kur nuk paguan për atë që e ka blerë. Mënyra e vetme për reduktimin e këtij risku është t'i dalloni konsumatorët tuaj dhe të vëzhgoni për së afërmi. Shumë biznese që janë në rritje përqendrohen në rritjen e shitjeve dhe të numrit të konsumatorëve të rinj, pa u përqendruar në dëshirat dhe në aftësitë paguese të klientëve.

Përfundime

Si përfundim në lidhje me Menaxhimin e riskut në Bizneset Kosovare mund të konstatojmë se njohja, vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve për bizneset vendore është shumë i rendesishëm.
Bizneset në përgjithsi duhet që të jenë në gjendje të menaxhojnë dhe ta parandalojnë riskun çdo herë dhe jo ti ikin atij. Nëse iket nga risku dmth. se iket nga fitimi, pasi përmes procesit te investimeve bizneset i realizojnë objektivat e veta afatmesme dhe afatgjatë.
Të gjitha vendimet që merren për riskut duhet që së pari të bëhet vlerësimi i riskut për të ditur se sa ai risk do të ndikojë në biznesi. Parashikimi i ardhmëris për bizneset është mjaftë i vështir por këtu qëndron aftësia e menaxherit për të rrezikuar dhe për të përdorur njohurit që posedojnë menaxherët e bizneseve.

[95] Stephen P. Robbins & David De Cenzo: Bazat e menaxhimi, Botimi i gjashte, Tirane, 2011, Fq.588

Duke shpresuar se bizneset Kosovare do të përdorin gjithnjë e më shumë teknikat më të reja të menaxhimit të riskut dhe do tu drejtohen institucioneve dhe njerëzve të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut për të përmirësuar këto biznese dhe për të pasur sa më pakë risqe në të ardhmen si dhe të krijojnë më shumë perspektiva pune, dije, ecje nëpër rrugët e jetës pa risqe të bizneseve.

Literatura

1. PANARITI Suzana: Menaxhim i Projektit, 2009, Tiranë;
2. HOTI Hamdi & All.: **"Problemet Financiare të Biznesit Familjar në Kosovë"** Revistë ndërkombëtare shkencore dhe hulumtuese DISKUTIME, nr. 9 janar 2013 **ISSN,** PRINT **1857-825X, ISSN** online**: 1857-8543;**
3. HOTI, Hamdi & All.: Konferenca e parë Ndërkombëtare mbi Kërkimin dhe Edukimin– Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Maj 2013 "**SME IMPACT ON ECONOMY",** www.icrae2013 **ISSN:2308-0825** www.unishk.edu.al **;**
4. HOTI, Hamdi: CORPORATE ALBANIA, The Past, the Present and the Future Proceeedings Tirana 09-10 november 2012 UET- AAB, "**Sources of Economic Grouth and Sustainable Development**" info@ue.edu.alwww.uet.edu.al**ISBN 978-99956-39-85-3;**
5. HOXHA Rifat: CORPORATE ALBANIA, The Past, the Present and the Future Proceeedings Tirana 09-10 november 2012 UET- AAB, **Risk managment and its role in Kosovos economic development** info@ue.edu.alwww.uet.edu.al**ISBN 978-99956-39-85-3;**
6. MUSTAFA Isa: Menaxhmenti Financiar, Botimi i dyte, Prishtinë, 2007;
7. KUKA Ibrahim, PULA Justina, KRASNIQI Besnik: Menaxhmenti dhe Vendosja, Prishtine, 2006,
8. GOVORI, Fadil, Financë, Prishtinë 2010;
9. MUSTAFA Muhamet, Menaxhmenti i Projekteve Investive, Prishtine, 2007;
10. MUCA Rejnald, LITO Gerdi: Risqet me te cilat perballet biznesi shqiptar dhe manaxhimi i tyre, Departamenti i Finances, Fakulteti i Ekonomise, UT, Tiranë 2011;
11. BUQINCA Qemal: Menaxhimi i sistemeve organizative, Prishtine, 2006;
12. ADEMI Bedri: Menaxhimi i bisnesit familjar, Universiteti Fama, 2008;
13. BAKRACI Xhevat: Menaxhmenti i Rrezikut dhe sigurimi, Prishtine 2007;
14. S.Trisshmann, Robert E.Hoyt, David W. Sommer,"Risk managment and Insurance",12 th edition, Thomson, South -Western,2005;
15. Raportet për Kosove: Ministria e Financave, Enti I Statistikës, BQK, Banka Botërore, IMF, etj;
16. KUME, Vasilika, Manaxhimi Strategjik, Tiranë 2003.

M.A Haseda Rragami,
Pedagoge në Universitetin e Veriut Argenti

14 Bashkimi doganor i Shqipërisë me Komunitetin Europian

Fjalët kyçe: dogana, Marrëveshja ad Interim, nomeklature e kombinuar, tarifë doganore, harmonizim i legjislacionit.

Abstract
In this paper ëill be considered the issue of the customs union between Republic of Albania and the European Union , in the framework of harmonization the legislation . Such association has tha bases in the Interim Agreement , as one of the most important instruments in view of the Stabilisation and Association Agreement for the aproximatian of Albanian legislation with European legislation in the field of customs . This agreement defines the customs fees and the operation of a joint administration between Albania and the EU , while respecting the principle of most favored nation . Albania has welcomed the European Commission's annual reports together ëith recommendations , by taking initiatives and regulations in their application . Alignment of customs legislation would mark a significant progress for our foreign policy and further integration of Albania into Euro-Atlantic structures.

Hyrje
Zhvillimet historike të vitit 1990 e gjetën Shqipërinë të papërgatur dhe e futën atë në një tranzicion shumë të vështirë për tu kaluar. Viti 1997 vulosi disa hapa pas dhe arena ndërkombatare e konsideroi si një sistuatë tepër serioze. Sigurisht i takonte Bashkimit Europian të ndërmerte hapat e para për "rimëkëmbjen" ekonomike të Shqiprërisë. Doganat ishin një ndër sektorët më të rëndësishëm që ndikonin direkt në ekonominë shqiptare. BE propozoi Marrëveshjen mbi Tregtinë dhe Bashkëpunim tregtar dhe Ekonomik dhe MSA –në (nenet 14.15,34, 43 dhe 97) të cilat do të mundësontë bashkëpunimin e Shqipërisë dhe BE në fushën e doganave , por do të nxisnin edhe vendosjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë më vendet e Europës Juglindore me anë të zhvillimit tregtar mes tyre. Pika kulmore e bashkëpunimit do të ishtë Marrëveshja e Ndërmjtme si vazhdim i marrëveshjes së tregtisë së 1992-isht e cila angazhoi të gjitha strukturat përkatëse shqiptare për zbatimin e dispozitave të saj si dhe neneve të MSA- së. Qëllimi ishte dhe vazhdon të jëtë përafrimi me legjislacionin europian si një ndër kushtet më kryesore që Shqipëria duhet të përmbushë për integrimin e saj me të drejta të plota në Bashkimin Europian.

Marrëveshja e Ndërmjtme (ad interim) mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe zbatimi i saj
Marrëveshja e Përkohshme mbi Tregtine dhe Bashkëpunimin tregtar midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian u nënshkrua në shtator të vitit 2006, pasi u pa si një domosdoshmëri për implementimin e MSA-së e cila ka për qëllim vendosjen e lidhjeve të ngushta dhe të qëndrueshme bazuar në reciprocitet dhe interes të ndërsjellë, dhe që duhet t'i japë mundësinë Shqipërisë të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet të vendosura më parë. Për këtë është i nevojshëm zhvillimi i lidhjeve tregtare nëpërmjet forcimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve në këtë fushë, veçanërisht nëpërmjet Marrëveshjes mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe

Ekonomik nënshkruar më 11 maj 1992, e cila hyri në fuqi më 4 dhjetor 1992. Marrëveshja e tregtisë së lirë siguron: Zbatimin e një tregu të hapur, mbështetur në parimet e OBT-së dhe veçanërisht në nenin XXIV të GATT 1994[96]; Përafrimin e legjislacionit tregtar, nëpërmjet harmonizimit të tij me "*acquis communitares";* Eliminimin e të gjitha kufizimeve sasiore dhe masave të tjera me efekt të njëjtë; Ndalimin e zbatimit të çdo lloj kufizimi sasior dhe masa të tjera me efekt të njëjtë; Liberalizimin e përshkallëzuar të tarifave doganore; Periudhën tranziore për arritjen e një zone të tregisë së lirë, e caktuar 10 vjet, me nga 2 faza nga 5 vjet; Eliminimin e diskriminimit fiskal. Në kuadrin e lëvizjes së lirë të mallrave, për produktet industriale[97], me hyrjen në fuqi të marrëveshjes do të bëhet eleminimi reciprok i tarifave doganore me përjashtim të produkteve industriale të ndjeshme shqiptare, të cilat Shqipëria zotohet se do t'i reduktojë me zhvillimin e një performance të mire ekonomike. Mënyra e reduktimit të tarifave doganore per produktet e ndjeshme industriale të tarifave bazë në fuqi, në momentin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes (tarifës së kombit më të favorizuar në tregti) bëhet në mënyrë të tillë që në janarin e vitit të pëstë pas hyrjes në fuqi , tarifat do të shkojnë në 0% . Si produkte të ndjeshme industriale do të konsiderohen kripa e detit, hidrokarburet, tulla, tjegulla, sapun dhe detergjentë, produkte plastike, çimento, hekuri i ndërtimit etj. Gjithashtu do të bëhet eleminimi reciprok ikufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë, tarifave doganore te eksportit dhe masave me efekt të njëjtë. Për sa i përket bujqësisë dhe peshkimit[98], nga ana e Bashkimit Europian do të këtë eleminim të të gjitha tarifave doganore me përjashtim të gjetheve të gjalla, mishit të gjetheve, sheqerit dhe vera. Ndërkohë eleminohen tarifat doganore për zarzarvatet dhe frutat. Eleminimi i kuotave doganore bëhet kështu: Eliminim total të tarifës doganore për sheqerin,peshkun e ujrave të ëmbla,si troftë, krap, levreku. Reduktimi i tarifave doganore vjen duke u ulur në % qe prej vitit kur kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi. Mbi këto elemente dhe sasirat përkatëse do te zbatohet tarifa e plote MFN (kombi më i favorizuar). Nga ana e Shqipërisë do të këtë reduktim të tarifave doganore deri në masën 0% pas vitit të katërt të implementimit të kësaj marrëveshjeje. Nga dita e hyrjes në fuqi të marrëveshjes palët nuk do të vendosin asnje tarifë të re doganore në import apo eksport apo masë tjetër me efekt të njëjtë, nuk do të vendosin asnjë kufizim të ri sasior në import apo eksport apo masë të re kufizuese me efekt të njëjtë, mbi ato masa që ekzistojnë në çastin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes[99]. Gjithashtu palët do të eliminojnë menjëhere çdo diskriminim të mundëshëm në sistemin fiskal të brëndshëm me ndikim të drejtëpërdrejtë ose jo dhe do të eliminojnë menjëherë të gjitha rimbursimet e brëndëshme me përjashtim të atyre me natyrë indirekte (TVSH). Palët do të eliminojnë menjëherë të gjitha taksat doganore në import me natyrë fiskale dhe nuk kufizohen në krijimin e zonave të tregtisë së lirë, bashkimeve doganore dhe bashkëpunimin në kufi. Sipas marrëveshjes palët mund të ndërmarrin masa kufizuese dhe ndaluese për importin dhe eksportin e mallrave që rrezikojnë moralin publik, mbrojtjen e shendetit, vlerat kulturore, pronësisnë intelektuale, industriale dhe tregtare dhe rregullat për arin dhe argjendin. Ndër masa të tjera tregtare përmendim: e drejta e pakufizuar për lëvizjen midis palëve, thjeshtëzim i formaliteteve për lëvizjen e mallrave, liberalizimi i pagesave dhe tranfertave tek llogaritë, mbrojtja dhe nxitja e konkurrencës, vlerësimi i rolit të konventave për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, hapja e tregut për kontratat publike. Palët do të punojnë për të vendosur një bashkëpunim të posaçëm dhe të veçantë në fushën e doganave, me synim që të garantojnë pajtim masat që duhet të zbatohen në fushën e tregtisë, përafrimin e sistemit doganor shqiptar me atë të Bashkimit Europian, mbështetjen nga ana komunitare për hapjen e rrugës për masat liberalizuese sipas Marrëveshjes së Stabilizim

[96] Neni 3 i Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe neni 16 i MSA-së
[97] Shih nenet 5,6,7,8,9,10 të Marrëveshjes së Ndërmjetme
[98] Shih nenin 11,12,13,14,15,16,17,18 të Marrëveshjes Ad Interim
[99] Neni 20 e në vijim i Marrëveshjes dhe neni 23 I MSA-së

Asocimit si dhepër përafrimin gradual të legjislacionit doganor shqiptar me *acquies communitares.* Menjëherë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjës së Përkohshme, në kuadrin e zbatimit të saj, Shërbimi Doganor Shqiptar e studioi atë me hollësi, së bashku me anekset dhe protokollet përkatëse mbi reduktimet tarifore, kuotat, eleminimin e tarifave, tarifat sipas MFN (kombi më i favorizuar), zhvilloi të gjitha veprimet përkatëse, kjo me anë të ngritjes së grupeve ndërsektoriale dhe bashkëpunuese në këtë fushë[100]. U bë e mundur që të gjitha detyrimet e reja tarifore të hidheshin në sistemin e kompjuterizuar të përpunimit të të dhenave, të testuara dhe të përdorura me efikasitet të plotë. Gjithashtu janë përgatitur dhe janë dërguar udhëzime mbi zbatimin e tarifave të reja sipas marrëveshjes dhe mbi dokumentacionin e detyrueshëm që vërteton origjinën preferenciale të mallit. Po ashtu janë organizuar seminare me punonjësit e dëgës së doganave dhe janë punësuar personel i ri për zbatimin e marrëveshjes dhe rregullat e origjinës së mallit. Në web side e doganës është rifreskuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm në shërbim të publikut si psh: Marrëveshja ad Interim, tarifat e reja sipas kësaj marrëveshjeje, rregullat e origjinës, dokumentacioni i detyrueshëm, nomenklatura e mallrave për vitin 2014 etj. Po në këtë webside është vendosur një rubrikë për pyetje, komente, sugjerime, kontakte të drejtpërdrejta, kjo për të lehtësuar procedurat e marrjes së informacionit dhe zgjidhjen e situatave për çështje që kanë të bëjnë me Marrëveshjen[101]. Promovimi dhe respektimi i marrëveshjes është bërë më anë të një fushatë njoftimesh në mediat elektronike. Në zbatim të marrëveshjes, Drejtoria e Përgjithme e Doganave ka përfunduar përgatitjen e Bazës Rregullatore dhe Udhëzimeve përkatëse për dhënien e Autorizimit Doganor të Statusit të Eksportuesit të Miratuar, një procedurë kjo lehtësuese për ekportuesit e mallrave me origjinë shqiptare. Të gjitha çertifikatat e origjinës së mallit dërgohen në njësitë qëndrore për verifikim dhe shqyrtim të mëtejshëm. Autoritetet Doganore të vendeve të BE- së u janë përgjigjur pozitivisht kërkesave për bashkëpunim administrativ në fushën e origjinës së mallit, sipas kritereve të vendosura në marrëveshje. Në zbatim të kërkesave për verifikim origjine të ardhura nga autoritetet doganore të vendeve të BE- së, janë ndërmarrë të gjitha hapat e parashikuara, si për kontroll të dokumentave ashtu edhe kontroliin fizik, duke përfshirë ambjentet e prodhuesve dhe eksportuesve. Numri i fallsifikimeve të dokumentave të origjinës në eksport nga Shqipëria është zero. Po ashtu grupe pune nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave zhvillojnë vizita kontrolli dhe konsulence mbi zbatimin e Marrëveshjes në terren. Të gjitha degët doganore si dhe Departamenti Operativ dhe Hetimor janë të pajisur me dosjen e vulave doganore të vendeve të Bashkimit Europian. Janë përgatitur dhe janë dërguar instruksione me shkrim për degët doganore mbi dokumentacionin e detyrueshëm që vërteton origjinën preferenciale. Po ashtu është sqaruar dhe dërguar rregullorja përkatëse pranë degëve doganore mbi dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e trajtimit tarifor preferencial me kuotë të importit të verës më origjinë nga BE-ja[102]. Paraqitet shumë i rëndësishëm fakti që hyrja në fuqi e marrëveshjes së ndërmjetme krijoi mundësinë e shkëmbimit të asistëncës së ndërsjelltë më të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Strukturat doganore shqiptare do të jenë gjithmonë në koherencë me zhvillimet në importin dhe eksportin e mallrave me vendet e Bashkimit Europian dhe do të përmbushë me përpikmëri të gjitha nenet e Marrëveshjes së Ndërmjtme, kjo edhe për efekt të integrimit të Shqipërisë në Bashkmin Europian.

[100] Shih Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, kapitulli Doganat, 2008-2012, Tiranë
[101] Shih webside www.dogan.gov.al
[102] Iva Zajmi, Tregu i Përbashkët Europian, Tiranë 2010. Fq 306

Iniciativat ligjore për miratimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave

Që kur Marrëveshja e Përkohshme ka hyrë në fuqi, qeveria shqiptare dhe strukturat e saj ligjvënëse kanë ndërmarrë iniciativa ligjore për implementimin e kësaj Marrëveshjeje. Administrata doganore është pjesë e Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Ky proçes ka për qëllim, ndër të tjera, edhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin europian, i cili ka përcaktuar iniciativat ligjore dhe nënligjore afatshkurtra dhe afatmesme. Në kuadër të prioriteteve afatshkurtra, janë miratuar vendime të qeverisë dhe dispozita zbatuese. Të tille janë vendimet të dalë në funksion të VKM nr 205, datë 13.04.1999 " Për disa shtesa dhe ndryshime për dispozitat e Kodit Doganor". Vendime të tilla bëjnë të mundur përafrimin e plotë të legjislacionit. Vendimi i datës 13.02.2010 përcakton Drejtorinë e Origjinës, Tarifës, Aksizës dhe TVSH, si institucioni kryesor që përditëson nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore, administron origjinën e mallrave sipas marrëveshjeve preferenciale, proçedurat e lëshimit të çertifikatave të origjinës, ndjek zbatimin e masave të politikës tregtare, të kuotave dhe tavanëve tarifore dhe të masave antidumping. Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale e cila mbron të drejtat e pronësisë intelektuale për mallrat që hyjnë e dalin nga territorin shqiptar, një përafrim pothuajse i plotë me rregulloren e KE nr 1383/2003 dhe rregullorja KE nr 1891/2004. në lidhje me masat e autoriteve doganore në mbrojtje të së drejtës së pronësisë intelektuale. Po ashtu, vendimet e dala në kuadër të ndryshimeve të dispozitave të kodit doganor, u bë e mundur përafrimi i rregullores së KE- së nr 82/97, duke futur për hërë të parë në legjislacionin shqiptar konceptin e informacionit detyrues të origjinës[103]. Ndërsa përafrimi i rregullores së KE- së nr 1602/2000 dhe rregullores 881/2003 mundëson unifikimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me listën e veprimeve përpunuese që kërkohen për tu kryer mbi materialet e jo- origjinës, me qëllim që produkti i fabrikuar të përfitojë statusin e origjinës, më legjislacionin e BE-së dhe Marrëveshjën ad Interimit. Për të plotësuar detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, në kuadrin e miratimit të Nomenklaturës së Mallrave, janë ndërmmarë iniciativë ligjore për ndryshimin e ligjit nr 9461, dt 21.12.2005 " Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore", ndryshim i cili mundëson përcaktimin e rregullit bazë në lidhje me përcaktimin e nivelit tarifor në rastet e bashkimi të kodeve të nomenkalturës së mallrave. Konkretisht është miratuar me vendim nr. 1067 date 14.12.2013" Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2014", nomenklatura e kombinuar për këtë vit e cila është hartuar në përputhje më marrëveshje e përkohshme, në respektimin e reduktimit të tarifave doganore nga ana e Shqipërisë, për mallrat industrial, bujqësorë dhe peshkimin, si dhe respektimin e procedurave bashkëpunuese më shtetet eksportuese të Bashkimit Europian në vendin tonë. Baza për vendosjen e nomenklaturës së kombinuar të mallrave është niveli më i ulët tarifor por edhe zbatimin e tarifave të kombit më të favorizuar, që në këtë rast është Shqipëria. Për sa i përket iniciativave afatmesme, strukturat përkatëse kanë kanë ndërmarrë hapa për përafrimin e legjislacionit doganor me l'aquis communitaire për pjesët që nuk janë të përafruara. Kështu Kodi doganor i është nënshtruar disa ndryshimeve këto ndryshime kanë konsistuar në harmonizimin pothuajse të plotë i dispozitave në lidhje me proçedurat e thjeshtëzuara, përafrim kjo me rregulloren e KE nr 2913/12. Gjithashtu në kuadër të këtyre ndryshimeve, u bë e mundur përafrimi më rregulloret përkatëse në lidhje me regjimet e përpunimit aktiv dhe pasiv të mallrave si dhe në lidhje më proçedurat e tranzitit. Në rastin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, vlen për tu përmendur për afrimi pothuajse i plotë me rregulloret e KE- së përmes së cilave mundësohet ndërhyrja e administratës doganore dhe me iniciativë të saj në rastet kur konstaton se ka shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale.

[103] Shih VKM nr 274, dt 12.04.2010 "Për disa ndryshime në dispozitat zbatuese të Kodit Doganor"

Administrata doganore dhe strukturat ligjvënëse do të jenë gjithnjë koherente me ndryshimet në legjislacioni europian në funksion të doganave dhe do të ndermarrë iniciativa të mëtejshme ligjore për zbatimin e Marrëveshjes së Përkohshme dhe partneritetit me Bashkimin Europian.

Vlerësimi i Komisionit Europian për progresin e Shqipërisë në fushën e doganave

Komisioni Europian është një ndër institucionet më të rëndësishme që ka luajtur dhe vazhdon të luaje një rol vendimtar për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Që prej vitit 2003, ai i ka paraqitur qeverive shqipëtare progres raportet për përparimet që ka bërë vendi ynë në fusha të ndryshme, kjo në kuadrin e respektimit dhe zbatimit të MSA-së dhe marrëveshjeve të tjera integruese si dhe rekomandimet përkatëse që Shqipëria duhet të ndjekë për aderimin e mëtejshem në strukturat euro-atlantike. Vlerësime pozitive ndër vitë kanë ardhur nga ky komision edhe në fushën e doganave dhe bashkimit doganor me vendet e komunitetit si edhe me vendet e Europës Juglindore, si formë e bashkëpunimit dhe marrëdhënies së fqinjësisë së mirë. . Dukë iu referuar progres raportit të fundit, atë të vitit 2013, në fushën e legjislacionit doganor, Shqipëria përditësoi nomenklaturën e mallrave në linjë me versionin 2013 të Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së. Shqipëria ratifikoi Konventën Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Med dhe zbatoi Konventën ATA për Importimin e Përkohshëm. Megjithatë ky komision u shpreh se duhet të forcohen kapacitetet zbatuese si edhe sensibilizimi i përgjithshëm rreth procedurave të Konventës së ATA-s[104]. Norma e përdorimit të vlerës së transaksionit u rrit por sërish mbetet e ulët sipas standardeve të BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në futjen e procedurave të thjeshtuara, masave të sigurisë dhe konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik. Duhen zbatuar procedura unifikuese në të gjithë vendin me qëllim që nëpunësit doganorë të kenë më pak hapësira interpretimi. Kodi i ri Doganor ende nuk është miratuar. Për sa i përket kapaciteteve administrative dhe operacionale, Shqipëria ka nisur pjesëmarrjen në programin e BE-së për Doganat 2013. Akademia e Tatimeve dhe Doganave filloi punën në maj me strategjinë e trajnimit të doganave, si pjesë të programit të saj. Terminali doganor i Tiranës u përurua dhe infrastruktura e pikave të kalimit kufitar po përmirësohet. Është rritur kapaciteti dhe efikasiteti i laboratorit doganor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) e ka shtuar bashkëpunimin me institucionet e tjera, përfshi mbi zbulimin e materialeve radioaktive. Gjithashtu është miratuar një rregullore e brendshme për politikën e sigurisë në sistemin TIK (teknologjia e informimit dhe komunikacionit) doganor. Funksionon sistemi për pagesat elektronike të detyrimeve dhe tarifave doganore si dhe deklarimi onlinetë akcizës. Është bërë funksional shkëmbimi elektronik i të dhënave me doganat kosovare. Por pavarësisht këtyre, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur ndërfunksionimin *online* të DPD-së me sistemin doganor dhe të akcizës së BE-së. Strategjia e TIK-ut nuk është e harmonizuar me Strategjinë për Biznesin[105]. DPD miratoi strategjinë e brendshme për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe rriti përpjekjet e saj për të parandaluar hyrjen e produkteve të falsifikuara në Shqipëri. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorrupsion e shtoi veprimtarinë e saj dhe raportoi në komisionin e disiplinës shkelje të kodit të etikës nga zyrtarët e doganave. Po ashtu është zgjeruar sistemi i monitorimit me kamera 24 orë në pikat e kalimit kufitar. Raporti në fjalë përshëndet të gjitha përparimet që ka bërë Shqipëria në fushnë e doganave, dukë u shprehur pozitivisht për tarifat, origjinën dhe importimin e përkohshëm si dhe forcimin e administratës doganorë, por shprehet se nevojiten përpjkje më të shumta për tu përshtatur më sistemin TIK, thjeshtësimin e proçedurave, lehtësimin e tregtisë. Gjithashtu paraqitet shumë e nevojshme miratimi i Kodi të Ri Doganor në linjë me standartet e Bashkimit Europian.

[104] Progres raporti për Shqipërinë, Komisioni Europian, Bruksel, 16.10.2013
[105] Shih Raportin Anlitik të Komisionit Europian për Shqipërinë, 2013

Në këtë kontekt dua të theksoj se vlen për tu përshëndetur progresi i Shqipërisë në fushën e bashkëpunimit doganor me vendet fqinje, Malin e Zi, Maqedoninë, Kosovën dhe Greqinë, duke lehtësuar lëvizjen e lirë të personave, mallrave dhe shërbimeve, si dhe lehtësimin e proçedurave të kalimit transit në vendet e tjera të Europës Juglindore, duke intensifikuar në këtë mënyrë bashkëpunimin rajonal me këto vende, në përputhje me rekomandimet dhe legjislacionin europian.

Konkluzione

Në fushën e doganave janë marrë disa angazhime në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Ndërmjetme neni 41 dhe protokolli 5, si dhe nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit nenet 14, 15, 34, 43, dhe 97. Qëllimi kryesor për fushën e Doganave është rritja e standardeve e strukturave doganore, vënia e tyre në shërbim te komunitetit, ndalimi i kontrabandës, korrupsionit, monopoleve, dhe krijimi i një klime te favorshme konkurrence për biznesin. Shërbimi Doganor ka hartuar strategjitë dhe plane te specifikuara, te cilat konsistojnë ne rritjen e ndjeshme te nivelit te vjeljes se te ardhurave, përfshirjen gjithnjë e me intensive të Shërbimit Doganor ne luftën kundër trafikut te drogës, armeve, makinave te vjedhura, qenieve njerëzore dhe forcimin e administrimit të burimeve njerëzore.Në kuadrin e proriteteve afatshkurtëra që konsistojnë në përafrimin e legjislacionit doganor, forcimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit, bashkëpunimi me vendet candidate për anëtarësim siç është Turqia, ndalimi i diskriminimit fiscal për produktet e BE-së, bashkëpunimi administrative me komunitetin për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimet ne dogana, zbatimi i plotë i marrëveshjes përsa përket origjinës së mallit, tarifat doganore, masat me efekt të njëjtë etj, Shqipëria ka ndërmarrë iniciativa ligjore që konsistojnë në ndryshimet e kodit doganor për proçedurat tranzitit, dhënia e informacioni detyrues i origjinës, mbrojtja e pronësisë intelektuale, proçedurat e thjeshtësuara për bashkëpunim administrative dhe rregjimet e përpunimit aktiv dhe pasiv. Për prioritetet afatmesme që konsistojnë në rritjen e vazhdueshme e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit doganor si dhe lufta kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit dhe procedurave doganore, si dhe i zbatimit te tyre ne linje me acquis communautaire duke filluar me analizën e diferencave mes tyre, miradministrimi dhe mire-menaxhimi i kapaciteteve njerëzore për zbatimin korrekt dhe uniform te marrëveshjeve te tregtisë se lire dhe ne luftën kundër kontrabandës dhe trafiqeve, tranferimi nga sistemi ASYCUDA++ ne ASYCUDAWORLD. Ndryshime te mëtejshme ne ligj për te përfshire te gjithë stafin doganor ne shërbimin civil, përmirësimi i transparencës si dhe shkëmbimi i informacionit me vendet anëtare te BE-se për te lehtësuar zbatimin e masave për te parandaluar evazionin. Siç shihet Shqipëria ka marrë seriozisht angazhimet e saj për realizimin e detyrave në fushën e doganave, duke treguar përparimin e saj në rrugën drejt integrimit. Megjithatë, në planin personal dua të them se prej shumë vitesh jëmi akoma në fazën " po punojmë" por po punojmë , me ritme të ngadalta. Uroj që këto ritme të përshpejtohen dhe në një të ardhme të afert të realizojmë qëllimet tona.

Bibliografia

- Zajmi, Iva, "Tregu i Përbashkët Europian", ribotim, Tiranë 2010.
- Marrëveshja E Ndërmjetme (Ad Interim) mbi Tregëtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar, shtator 2006.
- Progres-raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, Bruksel 16.10.2013.
- Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.
- Ligj nr 9461, dt 21.12.2005 " Për nomenklaturën e kombinuar të mallrave dhe tarifën doganore".
- VKM 1067 dt 14.12.2013 "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të nomenklaturë së kombinuar të mallrave dhe tarifës doganore për vitin 2014".

- VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- VKM Nr. 274, datë 13.04.2010 Për një ndryshim në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 Për Dispozitat Zbatuese të KD, i ndryshuar.
- VKM Nr. 419, datë 27.06.2012 Për një ndryshim në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 Për Dispozitat Zbatuese për KD, i ndryshuar.
- VKM Nr. 143, datë 13.02.2013 Për disa shtesa në VKM 205, datë 13.04.1999, Për Dispozitat Zbatuese të KD, i ndryshuar.

Kastriot Blakaj[106]
Armend Huskaj[107]

15 The influence of internet services on e-business and electronic economy profits

Key words: Online services, Internet, Programing, Protocol, Communication

Entry

Nowadays, computers and data are crucial on information systems. We can benefit from internet and computer networks a lot, information exchange possibility, increase on business success, access chance in different sources at real time. Sales activity from enterpriseswas limited in many aspectsuntil internet was discovered, beginning with marketing, payments and many other things that are inter-related to its activity. Internet brought so many benefits and facilitates in doing business. Therefore special attention is paid to computer supply in companies, where every computer should be connected to computer network. The companies that have large capacity have their own personal network where then every computer or personal network is connected to ***Internet,*** *which is the network of all networks. The computers are connected to each other in order to communicate between them or with any of the network services, the communication in network is enabled through "****Protocols****", protocols are rules that describe ways of communications for computers between them. The project will explain the architectures that are used in business for interconnections of computers in the network, furthermore some of the main internet services shall be mentioned by giving explanations about how a business can profit from the service and respective application.*

II. Arkitekturat e lidhjes së kompjuterëve në rrjet tek bizneset

Varësisht prej madhësisë, nevojës dhe mundësive buxhetore të qasjes në internet, firmat përdorin njëren prej arkitekturave të rrjetave kompjuterike: LAN, MAN, WAN, Client/Server apo Workgroup.

II.1 LAN(Local Area Network)

Është sistem i rrjetes kompjuterike në të cilën kyqen/lidhen kompjuterët dhe pajisjet periferike te një zyre ose kompanie. Pajisjet gjenden në një distancë te vogël fizike. Kjo lidhje bëhet me qellim te shfrytezimit te përbashkët të resurseve, pra ndarjes se tyre (p.sh një printer perdoret prej disa shfrytezuesve).

II.2 MAN (Metropolian Area Network)

Rrjeta MAN është një rrjetë që nderlidhë shfrytëzuesit më resurset e kompjuterit në siperfaqe gjeografike apo regjione që janë më të mëdhaja se sa ato të mbuluara nga rrjetat lokale LAN por janë më të vogla se siperfaqet e mbuluara nga rrjetat e gjera WAN. Termi është aplikuar te nderlidhjet e rrjetave në një qytet mbrenda një rrjete të gjerë.Kjo rrjetë gjithashtu është perdorur që të bëjë nderlidhjen e disa rrjetave lokale duke i lidhur ato me linja "backbone". Shembuj të ketyre rrjetave të madhësive të ndryshme mund të gjinden në siperfaqet metropolitane të Londres, Lodit (Poloni) dhe Gjeneves. Universitetet gjithashtu perdorin këtë term që të pershkruajnë rrjetat e tyre.

[106]KastriotBlakaj PhD (c). Teaching Assistant–Dukagjini European College
[107] Student of Dukagjini European College –Computer Sciences

Rrjetat MAN kan shumë karakteristika të përbashkëta me rrjetat hyrëse, siq janë: protokolet e ndryshme dhe shpejtësitë e kanalit.



Fig.1 Rrjeti MAN

II.3 WAN(Wide Area Network)

Kur Kompjuterët që gjënden në distanca të medha janë të lidhur mes vete përmes rrjetës kompjuterike atëherë kemi të bejmë me WAN. Shembull mund të jetë një kompani që zyrat i ka ne dy qytete te largëta dhe shfrytezuesit kanë mundesi që të bejnë shkembimin e informatave nga të dy zyrat.

II.4 Client/Server

Një arkitekturë e rrjetit në të cilin çdo kompjuter në rrjet është ose klient ose server. Serveret janë kompjuter te fuqishëm të dedikuar per menaxhimin e disqeve, shtypseve ose trafikun në rrjet. Serveret sigurojnë të dhënat për të gjithë kompjuterët që janë brenda rrjetit. Klientet ne anën tjetër janë kompjuter personal(PC), në të cilët shfrytezuesit i përdorin programet aplikative. Klientet lidhen në serverë me qellim të shfrytëzimit të resurseve siq janë fajllat dhe pajisjet e gjithashtu edhe për fuqi procesuese.



Fig.2 Arkitektura e rrjetit Client/Server

II.5 Workgroup

Disa kompjutër të lidhur në rrjet paraqesin një grup punues. Në kete rast shfrytezuesit mund të bejnë ndarjen e shtypesit, modemit, skanerit, por edhe të informatave të tyre nepër kompjuter. Shfrytezuesit mund t'u japin qasje shfrytëzuesve të tjerë në resurset e tyre. Workgroup i ka edhe të metat e veta, pasi qe ne rast të kyqjes se më shumë shfrytëzuesve ne një kompjuter, ai do të ngadalsohet shumë, pastaj siguria është më e vogël dhe ne rast se gabohet në dhenien e të drejtave, mund të vie edhe deri te keqperdorimet e ndryshme.



Fig.3. Arkitektura e rrjetit Workgroup

III. E-Serviset (E-Service)

Koncepti i E-serviseve(Electronic Service) përfaqëson një aplikim të shquar në shfrytëzimin e informacionit, përdorimin e informacionit dhe teknologjitë e komunikimit në fusha të ndryshme. Megjithatë për të sigurar një definicion të saktë për e-serviset është relativisht e vështirë, hulumtuesit kanë dhënë definicione të ndryshme për sa i përket përshkrimit të e-serviseve. Përkundër të gjithë këtyre përkufizimeve të ndryshme, mund të argumentohët se ata të gjithë bien dakord në lidhje me rolin e teknologjisë në lehtësimin e ofrimit të shërbimeve, të cilat i bëjnë ato më shumë shërbime elektronike.

III.1 Arkitektura e E-serviseve

Varësisht nga llojet e shërbimeve, ka funksionalitete të caktuara që kërkohën në shtresat e caktuara të e-serviseve në kuadër të arkitekturës. Por nuk përkufizohën vetëm në shtresën e të dhënave *(burime të të dhënave)*, shtresën e përpunimit *(sistemet e shërbimit të klientëve, sistemet e menaxhimit, depotë e të dhënave të sistemit, sistemet e integruara të përmbajtjes së konsumatorit)*, shtresën e integrimeve *(Enterpise Application Intergration)*, shtresën e Integrimeve *(Integrimin e E-serviseve)* dhe shtresën e prezantimit *(ndërfaqet e konsumatorëve përmes të të cilave web faqet dhe e-serviset janë të lidhura)*.

III.2 Domeni i E-Serviseve

Termi "E-Service" ka aplikime të shumta dhe mund të gjendet në shumë disiplina. Dy fushat më dominuese të aplikimit të E-seviseve janë: E-Business ose E-Commerce, të cilat janë shërbimet të ofruara kryesisht nga bizneset ose organizatat joqeveritare.

E-Qeveria (E-Government) janë shërbime të ofruara nga qeveria për qytetarët apo bizneset (sektori publik është ana e ofertës). Përdorimi dhe përshkrimi i e-serviseve në këto faqe është i kufizuar në kontekstin e qeverisjes elektronike, vetëm ku e-servisi është i lidhur me prapashtesa "Public". E-serviset Publike.

III.3 Përfitimet e biznesit nga E-serviset

- Qasja në një bazë të madhe të konsumatorëve.
- Arritja e zgjerimit të tregut.
- Ulja e pagesës në hyrje në tregje të reja dhe ulja e kostos në marrjen e konsumatorëve të rinjë.
- Kanal alternativ i komunikimit për konsumatorët.
- Rritja e shërbimeve për konsumatorë.
- Rritja e përceptuar e imazhit të kompanisë.
- Fitimi i avatazheve konkurruese.
- Potencial për rritjen e njohurive të konsumatorit.

III.3.1 World wide Web

World wide web (shkurtimisht shenohët si www, ose si 3w, i cili zakonisht njihet si veb), është një sistem i dokumenteve të ndërlidhura me hipertekst të cilat qasen nëpermjet internetit. Web-i është përmbajtja më e gjërë të cilën na e ofron interneti, fjala Web d.m.th merimangë. Webi përbëhet nga lokacione të caktuara me përmbajtje specifike të cilat njihen me emrin Web site. Web sajtet përbëhen nga lokacione më të ngushta të cilat quhën web page. Në secilin Web sajt, faqja e parë quhët *Home Page* apo faqe amë e cila përbëhet nga Web faqet tjera. Adresa e secilës nga Web sajtet është unike në të gjithë botën, por dy Web sajte nuk mund ta kenë adresen e saj URL të njejtë. Me anë të një browseri(shfletuesi), mund të shihen web faqet të cilat mund të përmbajnë tekst, fotografi, video dhe lloje tjera të multimedias, dhe mund të lundrohët prej njëres faqe ne tjetrën nëpermjet lidhjeve "hyperlinks".

Funksioni i www-së Termat world wide web dhe internet janë përdorur shpesh në jetën e përditshme si të njejta duke mos bërë dallim ndërmjet tyre. Megjithatë ato nuk janë të njejta, **Interneti** është një sistem global i cili i ndërlidhë të gjitha rrjetat kompjuterike, përkundër **world wide web**-it i cili është një prej shërbimeve(serviseve) i cili ekzekutohët në internet. www-ja është përmbledhje e dokumenteve të tekstit dhe burimeve të tjera, të lidhura me anë të hiperlidhjeve dhe URL-ve(Lokatori univerzal i burimit) të cilat qasen nga web shfletuesi prej serverave të internetit. Me pak fjalë web-i mund të mendohët si një aplikacion i cili "Ngitet" në internet.

Për ta parë një faqe në internet zakonisht duhët të shtypet adresa e saj URL në web shfletues, ose duhët ndjekur një hiperlidhje për atë faqe ose burim të saj. Më pastaj shfletuesi e nis një seri të mesazheve të komunikimit prapa skenave, në mënyrë që të shkojë ta marrë dhe ta shfaqë atë, mirpo perdoruesi nuk ka nevojë të ngarkohët që ti vërej këto procese.

Linkimi shumica e web faqeve përmbajnë lidhje (hyperlinks) në faqet e tjera të lidhura, në fajllat e shkarkueshëm, dokumentet burimore, definicionet dhe burimet e tjera të internetit. Një hyperlink themelor në gjuhën HTML do të dukej kështu:

<ahref="http://dukagjinicollege.eu">www.dukagjinicollege.eu

Një ndërmarrje do të përfitonte shumë nga World Wide Web-i, së pari përmes tij do të mund të gjente informacione relevante për afarizmin e saj, ta përcjellë gjendjen e tregut, të shikojë çmimet e produkeve apo shërbimeve të konkurrentëve të saj etj. Së dyti një ndërmarrje do të përfitonte shumë nëse do ta ndërtonte një web faqe e cila do të sherbente për qëllime të marketingut dhe promocionit, duke mbajtur në të shënime rreth produkteve apo shërbimeve, krijimi dhe mirëmbajtja e një web faqjeje, nuk e ka koston edhe shumë të lartë krahasuar me marketingun i cili bëhet ne media të shkruara apo vizuele.

III.3.2 FTP

File Transfer Protocol (FTP) (Protokolli i Transferimit të Fajllave) është një protokoll rrjeti që përdoret për transferimin e të dhënave nga një kompjuter në një tjetër përmes një rrjeti siç është Interneti. FTP ndërtohët mbi arkitekturën Klient/Server dhe përdorët për të shpërndarë kontrollë dhe lidhje të të dhënave ndërmjet klientit dhe serverit. Një FTP klient mund të lidhet me një FTP server për të manipuluar fajllat në atë server.

Përparësi e tij ndaj shërbimeve tjera është që me futjen (Loging) e kompjuterit personal në atë llogaritësin shërbyes (Server) prezantohet e gjithë amëza e llogaritësit nga aty shpejtë mund të barten ose të shkarkohen regjistra të tëra. Përpos kësaj ky shërbim ofron edhe protokollin FTP i cili e bënë të mundshëm prezantimin e amëzës dhe përdorimin e saj nga një kompjuter i largët, sikur të ishte ajo amzë në vetë kompjuterin e perdoruesit.

III.3.2.1 Mënyrat e lidhjes FTP

FTP punon përmes TCP-së. Sipas parazgjedhjes lidhet në portin 21 për lidhje hyrëse nga klienti FTP. Një lidhje në këtë port nga klienti FTP formon rrjedhën kontrolluese përmes së cilës barten udhëzimet nga klienti FTP tek serveri FTP dhe në disa raste edhe anasjelltas. FTP përdor "out-of-band controll", që do të thotë se përdorë një lidhje tjetra për kontrollin dhe të dhënat. Rrjedhimisht, në mënyrë që transferi të zhvillohet, kërkohet një lidhje tjetër, e cila quhet "data stream" apo rrjedha e të dhënave. Varësisht nga mënyra e transferit, procesi i përgatitjes së data stream ndryshon. Porti 21 për kontrollim (ose program), porti 20 për të dhënat.

Mënyra Aktive - Në mënyrën aktive, klienti FTP hap një port dinamik, ia dërgon serverit FTP numrin e portit dinamik mbi të cilin po funksionon përmes "control stream" dhe pret një lidhje nga serveri. Kur serveri FTP fillon lidhjen e të dhënave me klientin FTP, ai lidh portin burimor me portin 20 në server. Për të përdorur mënyrën aktive, klienti dërgon një PORT komandë, me IP-në dhe portin si argument. Formati për IP dhe port është "h1,h2,h3,h4,p1,p2". Secila fushë është një paraqitje decimale 8 bitëshe e IP-së së hostit, e përndjekur nga një port i përzgjedhur i të dhënave. Për shembull, një klient me IP 192.168.0.1, duke "dëgjuar" mbi portin 49154 për lidhjen e të dhënave do të dërgojë komandën "PORT 192,168,0,1,192,2". Fushat e porteve duhet të interpretohen si p1×256 + p2 = port, ose, në këtë rast, 192×256 + 2 = 49154.

Mënyra Pasive - Në mënyrën pasive, serveri FTP hap një port dinamik, ia dërgon klientit FTP IP adresën e serverit për t'u lidhur dhe portin në të cilin po dëgjon (një vlerë 16-bitëshe e thyer në një bajt të lartë dhe të ulët, përmes "control stream" dhe pret një lidhje nga klienti FTP. Në këtë rast, klienti lidh portin burimor të lidhjes në një port dinamik.Për të përdorur mënyrën pasive, klienti dërgon komandën *PASV* ndaj së cilës serveri do të përgjigjej me diçka si "227 Entering Passive Mode (127,0,0,1,192,52)". Sintaksa e adresës IP dhe portit janë të njëjta me argumentin e PORT kamandës.

Mënyra e zgjeruar Pasive - Në mënyrën e zgjeruar pasive, serveri funksionon njëjtë si në mënyrën pasive por transmeton vetëm numrin e portit (jo të kthyer në bajta të lartë dhe të ulët) dhe klienti e ka idenë se po lidhet me adresën e njëjtë IP që ishte lidhur më parë. Mënyra e zgjeruar pasive ishte shtuar nga RFC 2428 në Shtator 1998. Derisa transferohen të dhënat përmes data stream, control stream qëndron pa vepruar. Kjo mund të shkaktojë probleme me transfere të mëdhaja me firewall të cilat ndalin seancat pas periudhave të gjata të qëndrimit në këtë mënyrë të control stream. Derisa skedat mund të transferohen me sukses, seanca kontrol mund të çlidhet nga firewall, duke shkaktuar ndonjë error.

III.3.3 Serviset E-Commerce (Serviset e tregtisë elektronike)

Data on accounting and financial information are stored by taxpayers for at least 5 years, starting from the end of the tax year, which the documents belong to. Records, books and financial information are documents containing chronologic and systematic information on taxpayers' trading operations, which are kept to determine the amount of taxes for these taxpayers.

Taxpayers conducting flow of goods and services, for which payment is not made through banks, are obliged to introduce and use the fiscal system through the use of fiscal devices in order to record cash payments and issue tax receipts. Taxpayers, private individuals or legal entities and traders cannot perform purchase or sales transactions in cash among them if the value of transaction is higher than 300.000 ALL.

The minimum registration threshold for VAT is determined by the Council of Ministers (the threshold). For 2010 this threshold is 8 million.

Registered taxable persons are obliged to request deregistration no later than 15 days from the last day they made taxable supplies as part of their economic activity. Taxable persons, who want to deregister, are subject to procedures stipulated in the law "On tax procedures in the Republic of Albania".

Each individual, who is a partner in a commercial company, is responsible for the company's tax liabilities to the tax administration, according to provisions in the company charter. According to commercial registry, over 95 percent of companies are limited liability companies. The remainder is joint stock companies, partnerships and less than 0.5 percent is limited partnerships.

At the moment a company is created and starts its economic activity, it is responsible for:

Calculation of VAT and timely declaration and payment;

Payment of advance tax installments for profit tax to pay every month;

Calculation, timely declaration and payment of tax on incomes from employment for employers and employees;

Calculation, timely declaration and payment of social and health insurances contributions;

Monthly payment of advance income tax installments in time;

Withholding and payment of withheld tax, under obligation from the Law "On Income tax";

Calculation, timely declaration and payment of taxes according to specific activity "for gambling, casinos and hippodromes";

Calculation, timely declaration and payment of excise under specific law "On Excises";

Calculation, timely declaration and payment of national taxes and local taxes.

In order to calculate taxes, taxpayers who are subject to VAT or profit tax keep registers, accounting records, books and financial information and issue tax receipt or tax coupon, in accordance with relevant laws and regulations pursuant to them.

Taxpayers keep their accounts in accordance with provisions of the law "On accounting and financial statements" and act pursuant to that law in accordance with IFRS principles. In order to register economic transactions related to taxes, taxpayers can also use books, records or documents specified in specific tax laws and respective regulation provisions. Taxpayers are required to use basic documentation, including tax invoice, in accordance with tax legislation and relevant legal provisions.

In order to calculate their tax liabilities taxpayers, who are subject to the law "On local tax on small business", keep records, books and other documents, and issue simple tax receipts or tax vouchers, in accordance with provisions in the law "On local tax system" and provisions in the Law "On income tax". In order to calculate their tax liabilities taxpayers keep records, books and other documents, and issue simple tax receipts, tax certificates and tax vouchers, in accordance with the law of the field and regulations issued pursuant to that law. Also, taxpayers keep tax records as required by tax procedures law, specific tax laws and provisions and regulations adopted pursuant to them.
Tax legislation has excluded public and private non-profit organizations from income tax and VAT (if NGOs meet criteria for public status). Meanwhile, managers and employees in such organizations are subject to tax like all other employees. Public institutions are exempted from calculation, declaration and payment of profit tax, based on their public status.

COMPARING ALBANIAN FISCAL POLICY AND FISCAL SUSTAINABILITY MANAGEMENT WITH EUROPEAN COUNTRIES

Albanian fiscal policy and fiscal sustainability management has been floating very often compare with other European countries.
Tax system has been changed about 60 times / year in last 10 years, creating problems and difficulties for local and foreign business community operating in Albania, compare with other European countries where tax system is a stable one.
Total revenues / PBB ratio in last 10 years in Albania has been about 24 - 25%, compare with European countries that has this figure in terms of about 38 - 44%.
On tax burden, in the "Paying taxes 2010-2011" World Bank report Albania was listed in 92-nd place between 183 economies. Businesses in Albania pay about 40.6% of total profits for taxes. Taking into the account procedures and costs for business payments, Albania has been ranked in place 149 between 183 economies. All other countries of the region has been classified in a better position compare with Albania, especially Macedonia in 33 place, Croatia 42, Montenegro 138.
Tax payments in Albania are about 42, compare with a smaller number for other European countries.

Conclusions & Recommendations

The tax models, tax levels and its applications are attributes of specialists of the economics, while politics just should learn and listen from / to them.
Functional finance is an economic theory based on effective demand principle. It states that government should finance itself to meet explicit goals, such as taming the business cycle, achieving full employment, ensuring growth, and low inflation.
The principal ideas behind functional finance can be summarized as:

- Governments have to intervene; the economy is not self-regulating.
- The principal economic objective of the state should be to ensure a prosperous economy.
- Money is a creature of the state; it has to be managed.
- Fiscal policy should be directed in the light of its impact on the economy, and the budget should be managed accordingly, that is, 'balance' is not important in itself.
- The amount and pace of government spending should be set in the light of the desired level of activity, and taxes should be levied for their economic impact, rather than to raise revenue.

- Principles of 'sound finance' apply to individuals. They make sense for households and businesses, but do not apply to the governments of sovereign states, capable of issuing money.

The government's fiscal policy should be governed by three rules:

- There government shall maintain a reasonable level of demand at all times. If there is too little spending and, thus, excessive unemployment, the government shall reduce taxes or increase its own spending. If there is too much spending, the government shall prevent inflation by reducing its own expenditures or by increasing taxes.
- By borrowing money when it wishes to raise the rate of interest and by lending money or repaying debt when it wishes to lower the rate of interest, the government shall maintain that rate of interest that induces the optimum amount of investment.
- If either of the first two rules conflicts with principles of 'sound finance' or of balancing the budget, or of limiting the national debt, so much the worse for these principles. The government press shall print any money that may be needed to carry out rules 1 and 2.

Tax system in Albania changes very often and tax burden is higher compare with other European countries, which creates problems and difficulties for local and foreign business operating in Albania

APPENDIXES



Graphic 1. Inflation rate 1990 - 2012 (INSTAT)



Graphic 2. Unemployment rate 2000 - 2012 (INSTAT)



Graphic 3. GDP / Head1990 - 2010 (INSTAT)

Graphic 4. Budget deficit 2005 - 2012 (http://www.shtetiweb.org)



Graphic 5. Public debt 2005 - 2012 (http://www.shtetiweb.org)



Graphic 6. State budget revenues and expenditures 2007 - 2011



Graphic 7. Fiscal revenues and revenues from taxes and customs (INSTAT)



Graphic 8. PPB and total revenues

References

1. O' Sullivan, Arthur; Steven M. Sheffrin (2003). Economics: Principles in action. Upper Saddle River, New Jersey 07458: Pearson Prentice Hall. pp. 387. ISBN 0-13-063085-3.
2. "Cliff Notes, Economic Effecs of Fiscal Policy". Retrieved March 20, 2013.
3. Heyne, P. T., Boettke, P. J., Prychitko, D. L. (2002): The Economic Way of Thinking (10th ed). Prentice Hall.
4. Larch, M. and J. Nogueira Martins (2009): Fiscal Policy Making in the European Union - An Assessment of Current Practice and Challenges. Routledge.
5. Hansen, Bent (2003): The Economic Theory of Fiscal Policy, Volume 3. Routledge.
6. Balassone, F. and Franco, D., 2000. Assessing Fiscal Sustainability: A Review of Methods with a View to EMU. In Fiscal Sustainability, ed. Banca d'Italia, 21–60. Rome: Bank of Italy
7. Theoretical Prerequisites for Fiscal Sustainability Analysis - Burnside, 2005. Chapter. 2 in Craig Burnside, "Fiscal Sustainability in Theory and Practice," World Bank.
8. European Commission, 2009. Sustainability report 2009. European Commission.
9. Bagnai, A., 2004. Keynesian And Neoclassical Fiscal Sustainability Indicators, With Applications To Emu Member Countries (Public Economics No. 0411005). EconWPA.
10. Daniel Mitchell. "Albania Joins the Flat Tax Club." Cato at Liberty, 9 April 2007
11. Sommerfeld, Ray M., Silvia A. Madeo, Kenneth E. Anderson, Betty R. Jackson (1992), Concepts of Taxation, Dryden Press: Fort Worth, TX
12. Hyman, David M. (1990) Public Finance: A Contemporary Application of Theory to Policy, 3rd, Dryden Press: Chicago, IL
13. Sommerfeld, Ray M., Silvia A. Madeo, Kenneth E. Anderson, Betty R. Jackson (1992),Concepts of Taxation, Dryden Press: Fort Worth, TX
14. Hyman, David M. (1990) Public Finance: A Contemporary Application of Theory to Policy, 3rd, Dryden Press: Chicago, IL
15. James, Simon (1998) A Dictionary of Taxation, Edgar Elgar Publishing Limited: Northampton, MA
16. Zodrow, The Property Tax Incidence Debate and the Mix of State and Local Finance of Local Public Expenditures (2008), citing Fischel, Regulatory Takings: Law, Economics, and Politics (1995)
17. Edward J. Nell, Mathew Forstater, Reinventing functional finance: transformational growth and full employment, ISBN 1-84542-220-1, Edward Elgar Publishing 2003
18. Forstater, Mathew, Functional Finance and Full Employment: Lessons from Lerner for Today
19. Lerner, Abba P., Economics of Employment, McGraw Hill (1951)
20. Shijaku G, Gjokutaj A, Politika fiskale dhe rritja ekonomike: Rasti i Shqipërisë
21. World Bank Report on tax burden 2010 - 2011
22. PWHC report on tax burden.

Fatos Ukaj,
Universiteti "Hasan Prishtina",
Fakulteti Ekonomik,
Prishtinë, Kosovë.
fatos_ukaj@yahoo.com

25 Efektet e Biznesit Ndërkombëtar në zhvillimin e turizmit bazuar në resurset e vendit-gjendja në Kosovë.

Impacts of the International Business on tourism development based on the resources of domestic country- the situation in Kosova.

Abstract
Issues reviewed on this paper has to do with the necessity of knowledge of circumstances in international business and particularly in tourism, that has to do with the issues in the environment of the touristic country and implications on sustainability based on utilization and maintaining of available resources. Development of tourism affects the environment and what is known is that the environment cannot be seen separately from economic resources, cultural, historical, etc. Vast majority of activities towards the development of tourism through the activities in international business have as a result changes in the environment and have economic effects. For that it is important that the decision making bodies to be conscious for the consequences and in same time the welfare of upcoming generations in the tourist country. Any breach and destruction of t he resources available will cause as the boomerang the collapse of the tourism, the aim of this paper is to analyze and identify such influencing factors as they are foreign direct investment. In the paper will agreed conclusions and recommendations based on the findings.
Key words: *International Business, tourism, environment, sustainable development, resources.*

Abstrakt
Në ketë punim shqyrtohen çështjet e domosdoshmërisë së njohjes së rrethanave në biznesin ndërkombëtar dhe posaçërisht në turizëm, e që lidhet me çështjet në mjedisin e vendit turistik, dhe implikimet në qëndrueshmërinë bazuar në shfrytëzimin dhe ruajtjen e resurseve në dispozicion. Zhvillimi i turizmit ndikon në mjedisin jetësor dhe ajo që dihet është se mjedisi nuk mundet të shikohet ndaras nga resurset ekonomike, kulturo historike , etj. Shumica e aktiviteteve në drejtim të zhvillimit të turizmit nëpërmjet aktiviteteve në biznesin ndërkombëtar kanë si rezultat ndryshimet në mjedis dhe kanë efekte ekonomike. Për ketë është me rendësi që vendimmarrja gjithnjë të jetë e vetëdijshme për pasojat dhe mirëqenien edhe të gjeneratave të ardhshme në vendin turistik. Çdo prishje dhe shkatërrim i resurseve në dispozicion do të sjellë si boomerang edhe rënien e turizmit, qëllimi i këtij punimi është , që të bëjmë analizën dhe të identifikojmë faktorët ndikues siç janë Investimet e Huaja direkte. Në punim do të bihen përfundime dhe rekomandime bazuar në të gjeturat.
Fjalët Kyçe*: Biznesi ndërkombëtar, turizmi, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm, resurset.*

1. Hyrje

Turizmi njihet dhe numërohet si një prej aktiviteteve ekonomike shumë të rëndësishme në Kosove dhe në Rajonin e Ballkanit perëndimor në përgjithësi, dhe ketë duhet që ta trajtojmë në kuadër të mjedisit të ndryshuar falë ndikimit të globalizimit në kërkesat e pushuesve apo turistëve. Një zhvillim i turizmit patjetër është i lidhur edhe me zhvillimet integrale të ekonomisë vendore, duke pretendua se edhe turizmi do të ndihmoj në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Është vërejte së edhe në vendet e rajonit turizmi ka një lëvizje pozitive drejt përkrahjes së zhvillimit të turizmit. Vete rëndësia që e ka turizmi si një prej levave të zhvillimit ekonomik të vendit, ka sjelle orientim strategjik për gjetjen e investitorëve, duke i kushtua pra vëmendje të posaçme turizmit si një sektor i rëndësishëm dhe strategjik. Investimet e jashtme pra janë të mirëseardhura për vendin, por sa janë krijuar kushte, përkatësisht si është ambient afarist për investim. Çfarë infrastrukture ligjore kemi në mënyrë që investitorët të mund të kryejnë misioni e vete por edhe të arrihen efektet ekonomike por duke e ruajtur mjedisin dhe duke pas një qasje moderne ndaj ekologjisë. Është evidente pra se duhet të lëvizet drejt përqafimit të një qasje për zhvillim të qëndrueshëm që po e pretendojnë edhe vendet e zhvilluara por edhe vendet e rajonit që e kane turizmin si bazë për zhvillim, apo të kundërtën zhvillimin e bazojnë në një pjesë të madhe në turizëm. Një pritje nga ky punim është se si të gjendet një qasje moderne për zhvillimin e turizmit, i cili do të jete i bazuar në ligjet e tregut, e jo i dirigjuar. Një qasje e tillë kërkon që ata që e kanë nën mbikëqyrje industrinë e turizmit dhe zhvillimin e saj ketë mund ta bëjnë duke aplikuar praktikat më të mira evropiane dhe botërore, duke kryer menaxhimin e aktiviteteve bazuar në planifikim, organizim, dhe kontroll të tyre. Ka hapësire këtu për aplikim të një marketingu adekuat i kombinuar me metoda interdisciplinare që do të jetë në gjendje të përshtatet varësisht nga ndryshimet e mjedisit dhe situatës ekonomike. Cili mix i marketingut mund të jap efekt maksimal në atraktivitetin e vendit për Investimet e Huaja. Ata që e bëjnë Biznesin ndërkombëtar kërkojnë mjedis mikpritës për biznesin e tyre, ne do të duhej të kërkojmë që biznesi të ketë kujdes ndaj ruajtjes së mjedisit dhe sjellje miqësore dhe dashamirëse ndaj ambientit në vend.

2. Çështjet parësore të mjedisit dhe turizmi

Niveli i globalizimit të arritur e bën të dukshëm nevojën për integrime dhe bashkëpunim ekonomik edhe në regjionin e Ballkanit, e turizmi si një industri premtuese ka nevojë për bashkëpunim. Zhvillimi i biznesit ndërkombëtar ka pas një rritje në periudhën e kaluar dhe turizmi ka një pjesëmarrje në ketë bashkëpunim ekonomik ndërkombëtar. Bazuar në të dhënat e WTO(Organizata Botërore e Turizmit) ne nivel botëror , Turizmi në të dhënat për vitin 2013 ka pjesëmarrjen prej 9% të GDP (impakti direkt, indirekt), në çdo 11 të punësuar një është në turizëm, pjesëmarrje prej 6% në exportin botëror, 1.035 milion turist në vitin 2012, ndërsa llogariten 5-6 miliard turist vendor. Sipas të dhënave nga enti i statistikave të Kosovës në vitin 2012 kemi 48,790 vizitor të huaj (te regjistruar zyrtarisht) që është një rritje prej 60.76% krahasuar me vitin 2011 kur ka pas 30,349 vizitor të jashtëm. Pikërisht tek turizmi na paraqiten me së shumti ndikimet e Biznesit si në aspektin ekonomik por edhe në atë ekologjik dhe social gjithsesi. Një turist i cili vjen në Kosovë për të vizituar p.sh. Trashëgimin kulturo historike të vendit, ka nevoja shtesë apo sekondare që janë nevoja për akomodim, restorante, transport, shoping, gjë që automatikisht e paraqet nevojën për të rrit aktivitetet ekonomike lidhur me zhvillimin e turizmit. Në anën tjetër kërkesat e turistëve kanë të bëjnë edhe me shfrytëzimin e resurseve të caktuara të cilat nga eksploatimi i tepërt mund të kenë ndikim në ambientin jetësor dhe natyrën, sepse edhet evidente se krijohet një sasi e mbeturinave për të cilat duhet pas kujdes.

Ndërsa puna në turizëm kërkon njerëz të arsimuar dhe me njohuri të gjera, që në kontakt me turistët e jashtëm të mund të përmbushin kërkesat dhe nevojat e tyre, e pikërisht këtu mund të shihet ndikimi social në vend, pra nëpërmes punësimit, arsimimit dhe kujdesit për mjedisin. Pra ndeshemi me një zinxhir i cili deri të zhvillimi i turizmit na sjell nëse kemi ofertë të mirë turistike, investime të mjaftueshme, përkrahje institucionale dhe resurse njerëzore dhe materiale. Në anën tjetër zhvillimi i turizmit drejtpërdrejt apo tërthortë ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit-rajonit, shpenzimin më të madhe të resurseve (uji, energjia, etj), dëmtimin e florës dhe faunës, ndotjen e ambienti (mbeturinat, automjetet), ndikimi i turistëve në stilin dhe mënyrën e jetës së vendorëve (ndërrimi i normave morale, kulturës, etj). Sa i kushtohet këtyre problemeve rendësi në Kosovë dhe në rajon mbetet për të dëshiruar, bazuar në strategjitë e zhvillimit të turizmit, del se për pasojat anësore nuk ka ndonjë strategji, dhe se përveç aspektit ekonomik të zhvillimit të turizmit duhet kushtuar vëmendje ndikimeve që ka ky fenomen në mjedisin dhe ambientin e vendit. Nëse kemi një zhvillim të turizmit dhe ekonomik në përgjithësi, atëherë qëllimi do të duhej të ishte që ky të jete "Zhvillim i qëndrueshëm" . Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Ai përmban brenda saj dy konceptet kyçe: Koncepti i "nevojave", në mënyrë të veçantë nevojat thelbësore të botës së varfër, për të cilat prioritet parësor duhet dhënë; dhe ideja e kufizimeve të imponuara nga gjendjes së teknologjisë dhe organizimit shoqëror për aftësinë e Mjedisit për të plotësuar nevojat e tanishme dhe ato të ardhshme.[WCED 1987]. Një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit do të duhej të jete objektiv e secilit vend , dhe kjo do të arrihej nëse harmonizohet dëshira për profit, ruajtja e resurseve, veçorive specifike siç janë kultura dhe tradita, menaxhimi i mbeturinave, kujdesi ndaj natyrës, etj. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i një vendi arrihet me bashkëpunimin në nivel të institucioneve shtetërore dhe subjekteve ekonomike, por në fakt ky bashkëpunimi do të duhet të bazohet në tre përbërësit e vetë, e ato janë ekonomia, ekologjia dhe shoqëria e vendit. Këto tri dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm janë në ndërveprimin e vazhdueshëm të ndërsjellë duke e plotësuar njëra tjetrën. (Ebner,D. & Baumgartner,R.J 2006). në nivel ndërkombëtar që nga vitet e 90 ta (Deklarata e Rios 1992) është bere e qarte se duhet pas kujdes ndaj ndikimit të zhvillimit të turizmit në mjedis, pse kjo të behet çështje ndërkombëtare, sepse ndikimi i mjedisit nuk ndihet vetëm në vendet e destinacionit turistik por edhe në vendet tjera të rajonit e me gjere. Pra ndikimi pozitiv drejtpërdrejt hetohet nëpërmes zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqenies në destinacion turistik dhe në vendet me të cilat ai bashkëpunon, por edhe ndikimi negativ hetohet nëpërmes shpenzimit të resurseve, ndotjes, edhe tek vendet tjera. Sa i kushtohet rendësi këtyre çështjeve mbetet përgjegjësi e institucioneve shtetërore që do të duhej të përkushtohen në krijimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit. E roli i subjekteve ekonomike nuk është më i pa rëndësishëm që përpos përfitimeve ekonomike ato shprehin një mosgatishmëri dhe vullnetin e tyre për tu marrë me seriozisht me çështjet e mjedisit. Askush nuk e mohon nevojën për të pas llogarit ekonomike të bizneseve pozitive, por duhet vu theksin se ata duhet të vetëdijesohen se përpos shpenzimeve të identifikueshme të tyre qofshin ato monetare apo materiale, duhet llogarit edhe shpenzimet jo monetare të resurseve që ju kanë lenë në dispozicion për të arrit kënaqjen e turistëve dhe nevojave të tyre.

3. Biznesi Ndërkombëtare

Zhvillimi ekonomik si imperativ i institucioneve vendore, ka të bëjë edhe me turizmin i cili mund të jete një shtyllë e ekonomisë kombëtare. Niveli i globalizimit e ka bërë të mundshme dhe të nevojshme që ndikimi i zhvillimeve në lëmin e turizmit në vendet e rajonit e me gjerë të nxisë ndërmarrësit vendor të investojnë në kapacitete kryesisht hoteliere, dhe shërbimet përcjellëse.

I gjithë ky zhvillim po shkon drejt përmirësimit të ofertës, cilësisë dhe kujdesit ndaj vizitorëve, me aplikimin e një marketingu që mbetet për të dëshiruar. Zhvillimi në ketë globalizim nënkupton edhe përshtatjen dhe harmonizimin me standardet e turizmit në evropiane dhe botërore të cilat kërkojnë një menaxhim me ndryshe, aplikim të konceptit të marketingut, ndërsa transferimi i dijes është esencial dhe për ketë ka rendësi bashkëpunimi ndërsektorial në ekonomin e vendit, me qëllim të shfrytëzimit të risive në vendet e ndryshme në bote, dhe aftësive të ekspertëve vendor në lëmin e turizmit. në krijimin e një oferte turistike duhet të koncentrohemi në pasurit dhe trashëgimin kulturo historike, e cila ndodhë që inkorporohet në resurset e përafërta të vendeve në Ballkan, e kjo do të duhej të shihej si një mundësi, e jo si një pengesë, kjo për arsye se me një përshtatje të mire , turistet që e vizitojnë një vend të rajonit mund të interesohet edhe për ofertën e Kosovës. Në situatën aktuale një definim i turizmit e bënë atë një aktivitet të organizuar që në ketë kohe po e krijon një kapital i cili mund të jetë faktor vendimtar në zhvillimin e mëtejmë të ekonomisë vendore, në funksion të zhvillimit të turizmit si edhe të degëve tjera të ekonomisë, kulturës, sportit etj. Kosova duhet që të integrohet në zhvillimet dhe iniciativat rajonale, që do ta bëjnë ofertën turistike të Kosovës pjesë e paketave turistike për vizitorët nga e gjithë bota. Globalizimi si fakt ka arrit edhe tek ne, dhe vetëm se po shihet interesimi i vizitorëve nga Japonia, Evropa,etj për të kaluar disa ditë në Kosove, pasi që kane vizitua ndonjë vend tjetër të Ballkanit, të vazhdojnë në Shqipëri dhe tutje. Mungesa e resurseve siç është deti dhe liqenet, mund të kompensohet me bjeshkë, trashëgimi kulturore dhe historike. Kjo e bënë integrimin dhe bashkëpunimin rajonal të nevojshëm dhe të pa evitueshëm. E me pas me pak invencion dhe investim do të vie deri tek kyçja e Tour operatorëve botëror në sjelljen e vizitorëve nga e tëre bota. Prognozat e "Vizionit turistik 2020" të Organizatës Botërore të Turizmit[WTO] parashohin se vizitat ndërkombëtare në nivel botëror do të arrijnë në 1,56 miliard deri në vitin 2020, apo do të realizohet një qarkullim afërsisht 2 bilion USdollar, gjë që vetvetiu po e tregon rriten e degës së turizmit në nivel botëror.



Fig.1 Ardhja e Turistëve të Huaj sipas mjetit të Komunikacionit (te dhëna nga WTO)

4. Karakteristikat e Investimeve dhe organizimi në Turizëm

Investimet direkte të Huaja apo FDI(Foreign Direct Investment) janë të nevojshme, të mirëpritura dhe të rëndësishme për Kosovën por edhe për vendet e regjionit siç janë Shqipëria dhe Mali i Zi, ato do të ishin si një infuzion për ekonomin në tersi por edhe për turizmin si një potencial me të cilin llogaritin këto vende dhe ekonomit e tyre. Investimet direkte të Huaja (IHD) është përcaktuar si investim ndërkufitar nga një njësi ekonomike rezidente në një ekonomi me objektiv të marrjes së një interes të qëndrueshëm në një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër.[OECD 2013]. Investimet në Turizëm janë të rëndësishme edhe për faktin se ato janë investime të cilat e lajnë pjesën ma të madhe të kapitalit të freskët në vendin ku investohet, kryesisht si kapital, teknologji, dhe know-how që bihet në vendin pranues të investimeve. Investimet e Huaja direkte në Kosove në vitin 2012 ishin 232 milion euro që është për 41,2% më pak se në vitin 2011 , që është 5% të PBB që është një përkeqësim i dukshëm.[BQK 2012]. Në praktiken e deritanishme në Investimet e jashtme nuk ka arsye për lavd, hiqe Malin e Zi ku pjesa më e madhe e investimeve në turizëm është bë nga të huajt, ky trend edhe në Kosovë edhe në Shqipëri do të duhej të marre një kah tjetër duke u bë tërheqëse për investitorët e jashtëm. Kapaciteti i investitorëve vendas është i vogël dhe i limituar, ndërsa investitorët e jashtëm të mëdhenj ende nuk kanë vendos të hyjnë në ketë regjion, pik së pari nga mungesa e informacioneve, rrethanat politiko-juridike, kriza financiare, etj. Investimet serioze nga Investitorët e mëdhenj do të sjellin kapital të madh me vete, dhe mu për ketë në lojë do të jenë shumat e mëdha dhe projektet e mëdha afatgjata, vendet e rajonit nuk e kane arrit që të komunikojnë me palët e interesit dhe ti bindin në mundësit, resurset, legjislacionin,sigurinë e investimeve, dhe përparësitë tjera në krahasim me konkurrencën(vendet tjera), e cila duhet ceke se është e madhe në hapësirën e gjere siç janë Kroacia,Qipro dhe Greqia. Nuk është se nuk ka pas interesim nga investitorët e mëdhenj, por reagimi i qeverive ka qenë i ngathet dhe jo insistues në ofrimin e përkrahjes, dhe për ketë arsye shume nga ta janë hamend dhe tërheq nga ideja për të investuar . Pikërisht faza kur shprehet interesi i investitorëve në këto vende është problematike, sepse burokracia e ngadalëson dhe e komplikon çdo hap të procesit, por edhe i mjegullon gjërat, gjë që e bënë që investitori të humbë durimin dhe besimin në vendin ku dëshiron me investua kapitalin e vetë. Pikërisht këtu nevojitet një komunikim i bazuar në konceptin e marketing mixit, duke e bërë të nevojshme që edhe sistemi që i përcjell investimet: që nga ndërmarrjet turistike, qytetet e caktuara, dhe vendi turistik në përgjithësi të informatizohet dhe automatizohet,ashtu që investitorëve tu behet atraktiv dhe e lehte investimi për të cilin kane mjaft informata për kushtet , kohën, dhe detyrimet që i presin. Definitivisht sot shpejtësia në ekonomin botërore, por edhe moment i duhur janë faktorët që e përcaktojnë mundësin e një vendi për zhvillim, dhe nëse vendet e regjionit siç janë Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi nuk e përshtatin ekonomin e vetë një ritmi të tillë, për të ruajtur hapin me botën, atëherë të tjerët në rrethin e afërt por edhe të largët do ta shfrytëzojnë, duke e lanë ekonomin dhe turizmin e këtyre vendeve në nivel të ultë zhvillimi dhe jo atraktiv për investitorët, e kjo sigurisht se nuk është në interes të askujt duke përfshi qeveritë e vendeve përkatëse. Në Investimet direkte të Huaja, dallojmë dy mënyra dominante të investimeve, të cilat janë Investimet Horizontale direkte të Huaja, dhe Investimet Vertikale Direkte të Huaj.[GDWH 2011]. Investimet horizontale direkte të huaja në fakte janë atëherë kur investohet në të njëjtën lëmi në shtetin tjetër , në ketë rastë do të ishte që ndërmarrjet turistike të rajonit e më gjerë të investojnë në lëmin e turizmit në vendet tona. Këtu ekziston mundësia që të investohet në kapacitetet ekzistuese në vendin e investimit duke ndërtua dhe zgjerua kapacitete, apo duke filluar projekte krejtësisht të reja nga fillimi. Në Mal të Zi dhe Kroaci ka disa shembuj ku kompanitë e mëdha botërore kanë ngrit kapacitetet e objekteve turistike me investime direkte qoftë përmes privatizimit, partneritetit, franshizës etj, në ketë raste është me rendësi se ndërmarrjet-investitorët serioz e kanë të njohur dhe e kuptojnë riskun

e veprimit në mjedis politik dhe kulturor tjetër nga vendi i tyre domicil, dhe ju përshtaten rrethanave "rregullave të lojës", për të mund të zgjerojnë aktivitetin e vetë në këto vende si ekspansion, pasi që janë prezent edhe në vendet tjera turistike të rajonit, apo dëshirojnë të shfrytëzojnë përparësinë e të qenit i pari në vendet që e kanë synim zhvillimin e turizmit. Investimet Vertikale direkte të huaja në fakt na paraqiten në dy forma, e para atëherë kur investitori dëshiron që me investimin e bërë në vendin tjetër të arrij të siguroj inpute për procesin në vendin amë. Dhe e dyta është kur investitori dëshiron të investoj në një vend në të cilin do të shfrytëzonte për shitjen e outputeve të tij. Kur është fjala të investimet në turizëm, edhe këto forma janë të aplikueshme dhe kemi investitor nga lëmit e ndryshme që investojnë në transport, sport e rekreacion, vend parkingje për jahte,etj. Tek të dy mënyrat e investimeve direkte të huaja shtrohet pyetja për të marre përgjigjen se pse një investitor do të hynte në telashe dhe të dëshiron që të shpenzoj në ngritjen e kapaciteteve në një vende të huaj.? Sigurisht se çdo investitor i ka argumentet e veta specifike që e bëjnë për te një vende me përparësi para tjetrit për të investuar . Por në përgjithësi janë dy përgjigje në ketë pyetje dhe atë, e para është Argumenti i sjelljes strategjike, ndërsa e dyta bie mbi atë të qasjes ndaj tregjeve jo perfektë. Argumenti i sjelljes strategjike ka të beje me rastin kur investitorët dëshirojnë që me hyrjen e tyre në tregje të reja të shfrytëzojnë përparësinë e të qenit i pari , për të mundë me diktua në të ardhmen "rregullat e lojës". Hyrja në tregjet jo perfektë është mënyrë e cila preferohet për ata që dëshirojnë në atë vend të fusin know-how'in e vetë duke arrit përparësi dhe nxjerr përfitime, por edhe duke siguruar qëndrueshmëri në atë treg duke investua në vendet strategjike turistike.

5. Përfundim

Programet e qeverive për zhvillim ekonomik i kanë dhënë turizmit një rendësi të madhe si një prej shtyllave të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të vendit, si në Kosovë ashtu edhe në Rajon. Normalisht se vëmendja është të rritja e numrit të vizitorëve ndërkombëtar të cilët e kane si destinacion Ballkanin, dhe Kosova këtu mund të përfitoj nëse shpejtë rreshtohet dhe i shpejton hapat në integrimin e vete në iniciativat e rajonit. Kapacitetet e veta turistike duhet ti zhvilloj duke krijuar përparësi konkurruese në relacion me vendet e rajonit, por edhe të ketë ofertë që është kompatabile (plotësuese) me vendet fqinje. Zhvillimit të turizmit duhet ti epet rendësi dhe prioritet karshi degëve tjera ekonomike duke e pas parasysh ndikimin e tij në degët tjera mbështetëse të turizmit, zhvillimin me të harmonishëm regjional si dhe punësimin e popullatës aktive. Kyçja në tregun ndërkombëtar të turizmit do të behët me i lehtë me tërheqjen e investimeve të huaja, tejkalimi i situatës së tensionuar politike në rajon, rritjen e komunikimit ndërshtetëror, si dhe Involvimin direkt të BE me projektet e veta për stabilizim dhe krijimin e parakushteve për integrim të mundshëm të rajonit në BE në të ardhmen. Kjo pritje e ndihmës nga jashtë nuk do të thotë se vendi nuk duhet të përgatitet intensivisht , duke filluar nga përqafimi i normave dhe standardeve ndërkombëtare dhe Evropiane në turizëm, duke u munduar në valorizimin e pozitës së vet dhe trashëgimisë si një përparësi komparative. Përparësi e vendit është në strukturën e lloj-llojshme në ofertën e vete turistike(duke fillua nga natyra, trashëgimia historike e kulturore) që mund të krijoj avantazhin e afërsisë me destinacionet e njohura turistike në rajon. Duhet adaptua përvojat e mira në rajon dhe me gjerë me Investimet e huaja dhe arsimimin e resurseve njerëzore(punëtorëve turistik) si faktor kyç në zhvillimin e turizmit, rritjen e punësimit, dhe mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi. Në rrethanat e mjedisit aktual në rajon e më gjerë roli i institucioneve të vendit si lokomotivë e përcakton fatin e suksesit të zhvillimit të turizmit në vend.

6. Referenca:

[1] WTO(World Tourism Organisation) http://www.unwto.org/facts/eng/vision.htm
UNWTO Tourism Highlights 2013,
http://dtxtq4w60xqpw.cloudfront.net/sites/all/files/pdf/unwto_highlights13_en_hr.pdf
[2]Enti i Statistikave të Kosoves ,Statistikat e Hotelieris TM3 2013,
http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/81-hoteleria
[3]Banka qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2012,
http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-RV-2012.pdf
[4]Ebner,D. & Baumgartner,R.J. 2006. The relationship between Sustainable Development and Corporate Social Responsibility. www.crrconference.org
[5]World Commission on Environment and Development. "Our Common Future, Chapter 2: Towards Sustainable Development "Report of the World Commission on Environment and Development, A 42/427, Geneva , Switzerland, June 1987. http://www.un-documents.net/ocf-02.htm; http://www.un-documents.net/wced-ocf.htm
[6]Report of the World Commission on Environment and Development, *The United Nations Conference on Environment and Development,Having met* at Rio de Janeiro from 3 to 14 June 1992, http://www.un-documents.net/rio-dec.htm
[7]GDWH, What is Foreign Direct Investment, Horizontal and Vertical, 11 Januar 2011.
http://guidewhois.com/2011/01/what-is-foreign-direct-investment-horizontal-and-vertical/
[8]OECD Fact book 2013, Economic, Environmental and Social Statistics, Foreign Direct Investment. ISSN :1814-7364 (online), 09 January 2013,
http://www.oecd-ilibrary.org/sites/factbook-2013
en/04/02/01/index.html?itemId=/content/chapter/factbook-2013-34-en
[9] Fatos Ukaj, Fetije Ukaj, "Characteristics of Marketing and Investment with Special Emphasis
in Tourism", "Journal of Environmental Management and Tourism" JEMT; Association of Sustainable Education, Research and Science (ASERS) Romania, Biannually Journal, Volume II Issue 2(4) Winter 2011. ISSN 2068-7729. p 261-267.
http://www.asers.eu/asers_files/jemt/JEMT%20Volume%20II%20Issue%202_4_%20Winter %202011_short.pdf

PhD (c). Jeta Nushi,
Universiteti Evropian i Tiranës
Gazmend Zajmi, nr 21, Pejë, Kosovë
Tel:+38649/856-214
Email: jeta_n@hotmail.com

26 Kriza globale financiare dhe ndikimi i saj në ekonominë e Kosovës

Abstract
The current global crisis is a problem that has to do with the drastic fluctuations of financial markets in the U.S., Europe and Asia and increase the risk that the debt crisis has sunk Greece, Portugal, Ireland, Spain and many other countries. It actually started in August of 2008 that has unfolded its size drastically threatening a collapse of the financial system around the globe.Financial markets in New York, London, Frankfort, Tokyo etc, almost all scholarship global financial quartets recording a drastic decline blocking billions of investor's portfolio wealth.Now that that trend is spreading in the European markets, we are faced with a question: How are outcomes influences of the financial crisis on the economy of Kosovo?Neither Kosovo can't escape from this crisis; its effects are felt even in Kosovo. It is known that Kosovo is a small country and the economy generally generates very little income in comparison with other countries also the Gross Domestic Product (GDP) and exports are not as large as other countries of the developed world.However it is the obligation of government institutions to deal with all economic policies to overcome this crisis.
Keywords: The global crisis, financial markets, the impact of the global financial crisis in Kosovo, FDI, exports, remittances

Hyrje:
Në këtë punim kryesisht do të flitet për krizën globale financiare të shek. XXI dhe evoluimi i saj, shkaqet e krizës financiare dhe ndikimi i krizës globale financiare në Kosovë. Siç dijmë krizat financiare nuk janë ndonjë dukuri e panjohur. Kriza globale financiare është një problem që i gjithë bota është duke u ballafaquar dhe është shpërndarë në gjithë rajonin duke filluar nga Amerika e deri në Evropë. Eurozona sapo po festonte dekadën e parë të ekzistencës së saj kur kriza globale financiare u lind në vitin 2007 dhe u transferua në krizën e borxhit publik. Faza e parë të krizës filloi në SHBA dhe pas kësaj në Eurozonë ku paraqet fazën e dytë. Faza e dytë e krizës jo vetëm që fshiu të gjithat arritjet e monedhës së euros por nxori edhe defektet strukturore të Eurozonës. Faza e parë paraqet fillimet e krizës globale financiare periudha 2001-2007, filloi me krizën e aksioneve të teknologjisë dhe mbaroi me krizën globale financiare. Kriza financiare që kaploi Amerikën ishte një nga tensionet më të ashpra ekonomike që nga Koha e Depresionit të Madh. Mirëpo kriza e shek. XXI që u zhvillua në SHBA mori një anë tjetër apo efekt anësor rritja e shpejt e borxhit publik kjo themi se filloi fazën e dytë të krizës që tani është përqendruar në Eurozonë. Fillimet e krizës globale financiare u shfaqen në shtetin Amerikan gjatë vitit 2003-2004. Banka e Rezervave Federale (FED) aplikonte përqindje të ulët të interesit duke nxitur konsumatorët të marrin kredi për të investuar në blerjen e shtëpive. Mirëpo shumë shpejt tregu financiar u ngop d.m.th. u zhvillua një formë e njohur e financimit e quajtur "subprime". Pas disa viteve bankat filluan të ndryshojnë normat e interesit, kjo formë e tregut u zgjerua në sektorin imobilier-hipotekë, tek kartat e kreditit dhe në sektorin tjerë që ishin marr me kredi. Pasi që bankat rriten normat e interesit, u ulë kërkesa për kredi, bankat u përballen me problem të tërheqjes së kredisë kështu që në vitin 2007 borxhet e këqija arritën në 15%.

Në shkurt të vitit 2007 kriza kaloj tek bankat kryesore duke kaluar në krizë financiare ku përfshihen kredi më të mëdha hipotekare që nga viti 2007. Kjo krizë shënoi rënien të tregut të bursës, dhe të tregut financiar ku kjo krizë kthej qendrën financiare një shekull mbrapa të viteve 30-ta të shek XX. Por kriza ekonomike që filloi nga Amerika në vitin 2008, goditi fillimisht këto vende të dobëta të eurozonës. Edhe në këto vende kriza ekonomike ashtu si në Amerikë filloi në sektorin e strehimit. Kriza në këtë sektor, i përballi bankat e këtyre vendeve me pamundësinë e marrjes së kësteve të kredive dhe me falimentim dhe më pas kriza u zgjerua në të gjithë sistemin financiar të këtyre vendeve dhe situata u rëndua edhe më shumë me rritjen e deficitit buxhetor dhe të borxheve qeveritare. Bankat e këtyre vendeve morën kredi të shumta dhe me përqindje shumë të lartë interesi. Një nga faktorët e zhvillimit të lartë ekonomik të Greqisë, Irlandës, Spanjës dhe Portugalisë, para fillimit të krizës ekonomike ishte shtimi i aktiviteteve financiare të bankave të këtyre vendeve. Këto vende duke ndjekur politika financiare dhe monetare favorizuese, arritën të tërheqin investitorët. P.sh Irlanda në vendet e eurozonës ka nivelin më të ulët të tatimeve. Për shkak se rritja ekonomike e Greqisë, Irlandës, Spanjës dhe Portugalisë ishte artificiale, këto vende u goditën më shpejt nga kriza financiare. Dhe ja, pa asnjë paralajmërim ose shenjë të dukshëm që mund të tërhiqte seriozisht vëmendjen, një mëngjes korrikut të vitit 2008 ekonomitë dhe sistemet financiare më të fuqishëm të planetit filluan rrugën drejt një depresioni të dhimbshëm, më i rëndi i tetëdhjetë viteve të fundit. Filluan debatet mbi shkaqet e krizës, mbi fajtorët që i shkaktuan atë. U hartuan planet urgjente të veprimit për stopimin dhe kontrollin e saj. Në këtë këndvështrim filluan të hartohen politikat financiare e ekonomike të domosdoshme, u bënë plane veprimi mbi llogaritjen e kostove dhe të kohës së mundshme të daljes prej saj, u ndërmorën veprimet e menjëhershme e dinamike të mjaft qeverive e bankave qendrore për t'i ngritur asaj të gjitha "barrikadat" e mundshme të përhapjes dhe të infektimit të të gjithë sistemit financiar e ekonomik botëror. Ndërveprimi i këtyre kushteve në tregun evropian me faktorë të jashtëm, d.m.th. i "infektimit" përtej Atlantikut, është treguar në skemën nr. 2.



Skema 1. Kalimi i krizës Amerikane në tregun Evropian

Burimi :Watt Andrew, ,,The Economic and Financial crisis in Europe: addressing the causes and the repercussions'', EEE Policy Brief, No. 3 – 2008.

Janë paraqitur katër mekanizma kyçe të transmetimit infektimit të krizës përtej Atlantikut :

1. Rënia e konsumit në Shtetet e Bashkuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndikuar në mundësitë e shitjes eksportuesit evropian, të cilët tashmë janë prekur nga vlerësimi i çmimit të euros,
2. Sektori financiar evropian ka qenë "klienti" kryesor i aseteve toksike nga bankat amerikane. Kolapsi i tyre ka udhëhequr implosion në sektorin bankar evropian, i cili më pas e goditi kompanitë evropiane,
3. Uljet e normave masive nga ana e FED-it në përgjigje të krizës çoi në rënien e mëtejshme të dollarit kundrejt euros, duke krijuar presion konkurrues për procedurat evropiane,
4. Së fundi, pas një vonese kriza ka prekur vendet në zhvillim, jo vetëm Kinën, ku raportet e fundit sugjerojnë një rritje të papunësisë, e cila rezultoi në një reduktim të kërkesës importit të tyre.

Një analizë e përshkruan këtë proces në këtë mënyrë:

Kjo sëmundje ka gëlltitur sistemin bankar evropian dhe të gjithë ishin të befasuar me efektet dramatike të krizës financiare në ekonominë evropiane. Sistemi financiar evropian ka qenë një terren ushqyes për këto instrumente financiare të turbullta, pasi fitimet e akumuluara dëshpërimisht kanë kërkuar një qarkullim më të lartë se ato që kanë mund të ofrojnë atyre investimet në ekonominë reale. Edhe gjatë falimentimit të bankës investuese ,"Lehman Brothers" në mes të shtatorit të vitit 2008, ndikimi i krizës amerikane në Evropë ende është konsiderohet si i moderuar. Mekanizmi themelor me të cilin kriza financiare dhe bankare goditi ekonominë reale është dështimi i bankave për shkak humbjeve të tyre financiare dhe humbjes së besimit të kryej këtë funksion në bazë të financimit të kompanive ekonomike dhe nuk kanë qenë në gjendje të financojnë operacionet e tyre të përditshme, investimet janë bllokuar, dhe konsumi ka ra në ato pjesë të tregut ku financimi i kredive ka luajtur një rol të rëndësishëm(ndërtimin SHBA dhe në një numër të vendeve evropiane, në përgjithësi makinat në SHBA dhenë Evropë).

Ndikimi i krizës globale financiar në Kosovë

Ekonomia botërore po vazhdon të ballafaqohet me njërën ndër krizat financiare më të mëdha në histori. Pasojat e krizës financiare u reflektuan edhe në sektorin real të ekonomisë, duke shkaktuar po ashtu njërën ndër krizat më të mëdha ekonomike globale. Në këtë drejtim, qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të zhvilluara ishin aktive në ndërmarrjen e masave për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vendet e tyre dhe kohët e fundit jemi dëshmitarë të shenjave të para të një rikuperimi ekonomik në disa ekonomi. Argumentohet se kriza globale financiare nuk e ka goditur Kosovën drejtpërdrejtë, ekonomia e saj ka ndjerë efektet e saj indirekte. Vendet donatore kanë hezituar të rrisin ndihmën e tyre për Kosovën për shkak të problemeve të brendshme, rritja dramatike e papunësisë si në Evropë ashtu edhe në SHBA, ka prekur diasporën kosovare. Rënia pasuese e dërgesave nga kosovarët të cilët punojnë jashtë vendit ka mundësi të ketë ndikim negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi. Ndërsa vëzhguesit nuk pajtohen për rëndësinë relative të faktorëve të ndryshëm kontribuues, është pranuar në përgjithësi se krizat formojnë një kombinim të zhbalancimeve të paqëndrueshme globale makroekonomike, politika monetare të shthurura dhe dobësi strukturore në sistemin financiar. Në shumë vende në zhvillim, kriza është manifestuar kryesisht përmes kushteve të tregtisë dhe lidhjeve në investimeve, duke përfshirë edhe rënien në çmimet e mallrave, eksporteve, remitancave dhe investimeve të huaja direkte.

Ndërsa kanalet e përhapjes ndryshojnë shumë përgjatë vendeve në zhvillim, sektori bankar ishte gjithashtu një nga sektorët e rëndësishëm të prekur nga kriza e sidomos për ato vende në zhvillim që kanë sistemet financiare të integruara me tregjet ndërkombëtare. Ulja në disponueshmërinë e kredive të huaja dhe përkeqësimi i perspektivës në tregjet globale dhe lokale çuan në shtrëngimin e kushteve të kredisë, në ulje të ritmit në kredi, në normat e rritjes së depozitave dhe norma interesi më të larta, si dhe përhapje në shumë vende në zhvillim. Nga ana tjetër, sektori bankar në Kosovë është perceptuar se nuk do të preket nga kriza globale. Sektori bankar në Kosovë nuk është ekspozuar huamarrjes së jashtme dhe për këtë arsye nuk u prit se do të vuaj nga rrjedhat dalëse financiare. Në shumë raste kemi dëgjuar edhe deklaratat nga qeveria dhe zyrtarët e Bankës Qendrore se sistemi bankar në Kosovë është i matur (i kujdesshëm) prandaj nuk është prekur nga kriza pasi nuk është integruar me tregjet ndërkombëtare financiare. Ekonomia e Kosovës vazhdon me stabilitet duke reflektuar normë pozitive të rritjes dhe stabilitet adekuat në rrafshin fiskal dhe monetar.

Kriza në Eurozonë ndikoi në zvogëlimin e remitencave në Kosovë

Remitencat në Kosovë, të cilat, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 ishin 234 milionë euro, ku pësuan rënie, si pasojë e krizës ekonomike në Eurozonë. *Nga krizat financiare në Evropë kishin ulje të nivelit të remitencave apo dërgesave nga diaspora jonë. Në momentet e para të krizave në vendet evropiane bie niveli i remitencave. Ulja e remitencave në Kosovë shkakton ulje të investimeve, ulje të konsumit dhe, në përgjithësi, shkakton ulje të GDP-së. Një gjë e tillë e tkurr ekonominë e Kosovës.* Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, brenda 5 vjetësh, dërgesat nga jashtë arrijnë në 3 miliardë euro. Pjesa më e madhe e dërgesave nga jashtë në Kosovë përdoren për konsum, ndërsa një pjesë tjetër për investime.

*Remitencat, apo të ardhurat që vijnë në Kosovë nga emigrantët, në 12 vjetët e fundit kanë qenë me shumë domethënie për ekonominë e Kosovës. Ndonëse pjesa më e madhe e tyre ka shkuar për konsum dhe jo për investime kapitale, një gjë e tillë edhe në këtë mënyrë ka ndikuar në ekonominë kosovare, sidomos në ngritjen e Bruto Produktit Vendor. S*hkalla e lartë e varfërisë dhe e papunësisë në Kosovë ka bërë që një pjesë e madhe e qytetarëve kosovarë të varen nga paratë e dërguara nga familjarët e tyre që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme të Evropës. Rënies së dërgesave nga diaspora (remitencave) e cila edhe pse nuk është ndikuar sa është pritur megjithatë ka pësuar një rënie prej rreth 5% në vitin 2009. Zvogëlimi i këtyre dërgesave, ka ndikuar direkt në gjendjen ekonomike dhe sociale të këtyre familjeve. Sipas statistikave zyrtare, konsiderohet se afër 25 për qind e popullatës ose mbi 500 mijë emigrantë kosovarë jetojnë në vende të ndryshme të Evropës. Sipas një sondazhi të Institutit të Hulumtimeve Gallup, të bërë kohë më parë, pas anketimeve të zhvilluara në 135 vende të botës, del se Kosova radhitet lart në listën e vendeve që marrin remitenca, me 23 për qind apo me më së shumti në rajon. Dërgesat e emigrantëve janë njëra ndër komponentët me sensitive nga mund te ndikohet ekonomia e Kosovës. Sidoqoftë, marrë parasysh se emigrantët Kosovar gjenden në vende si Gjermania dhe Zvicra, te cilat nuk janë prekur nga kriza e eurozonës, edhe kjo kategori nuk pritet te reflektoj shumë. Trendët për dërgesa gjithashtu janë pozitive deri në vitin 2012.



Fig 2 Harta Makroekonomike

Kriza në Eurozonë ndikoi në Investimet e Huaja në Kosovë

Kriza ekonomike e cila karakterizon disa nga vendet e eurozonës aktualisht nuk ka reflektuar ndonjë efekt negative në ekonominë e Kosovës. Ky mos reflektim vjen kryesisht si rezultat i një ekspozimi te ulët të sektorit real te ekonomisë së Kosovës ndaj sektorit te jashtëm, si dhe një ekspozimi të matur të sektorit financiar ndaj sistemit financiar të vendeve të eurozonës. Ekonomia e Kosovës ndikohet nga tri kanale kryesore nga zhvillimet e vendeve të eurozonës. 1) Eksportet, 2) Investimet e huaja direkte dhe 3) dërgesat e emigrantëve. Ndikim negative në ekonominë e Kosovës deri më tani nuk është vërejtur as në këto 3 kanale, marrë parasysh se eksportet e Kosovës kanë vazhduar të jenë në rritje. Sidoqoftë edhe po të reflektohej kriza nga eksportet, baza aktuale e eksporteve mbetet e ulët, prandaj nuk mund te ketë ndikim substancial. Sa i përket investimeve te huaja direkte, ekonomia e Kosovës pritet të karakterizohet me trende pozitive. Gjate vitit 2011 investimet e huaja direkte janë rritur për afër 15%, që tregon një performancë të mirë të ekonomisë së Kosovës në këtë kontekst. Gjithashtu, duhet të theksohet se pjesë e rëndësishme e IHD-ve janë investimet nga firmat e huaja që operojnë në Kosovë prandaj, edhe në rast të përkeqësimit te ekonomisë nga eurozona, firmat e huaja në Kosovë pritet të kenë performancë të mirë, e gjithashtu edhe vazhdimësi në rritje të investimeve të tyre. Investimet, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 24.3 përqind në PBB, përkundër ndikimit neutral në PBB-në reale pritet të shënojnë rritje nominale prej 3.9 përqind gjatë vitit 2013 ndërkohë që në vitin paraprak patën shënuar rënie nominale prej 10.7 përqind. Rritja e investimeve pritet të jetë rezultat i rritjes së investimeve private prej 6.8 përqind, përderisa investimet publike pritet të shënojnë një rënie të lehtë prej 0.3 përqind. Rritja e investimeve private, të cilat përbëjnë rreth 60 përqind të gjithsej investimeve, ndër të tjera pritet të jetë rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte (IHD) dhe kredive investuese.



Burimi: BQK (2013)

Fig 2. IHD sipas sektorëve kryesor ekonomik

Kriza në Eurozonë ndikoi në eksport

Ekspertet e ekonomisë vlerësojnë se Kosova po ballafaqohet me një problem shumë të rendë dhe me një krizë të thellë ekonomike, me një problem të rendë social dhe me një varfëri shumë të madhe e cila dita-ditës po rritet. Vetë fakti i një gjendje të tillë ekonomike, sipas tij tregon se politika ekonomike në Kosovë, nuk ka qenë efikase dhe është dështuese. Sipas ekspertëve ekonomik Kosova në kohë krize u karakterizua me rënie të dukshme të eksportit ku vetëm në tremujorin e fundit te vitit 2008 eksporti i Kosovës kishte rënë për 40% ndërsa në tërë vitin 2009 eksporti ka qenë për 18% më i ulët se në vitin paraprak, mirëpo, rritja e eksporteve të shërbimeve neutralizoi efektin e gjithsej eksporteve. Përveç kanaleve të sektorit të jashtëm të ekonomisë të cilët po ndikohen nga zhvillimet në ekonominë globale, ekonomia në vend vazhdoi të tregojë performancë solide.

Perceptimet e FMN-së për të përballur krizën në Kosovë

E ndodhur përballë krizës financiare dhe recesionit që përfshiu ekonominë globale, ekonomia e Kosovës ka arritur t'i rezistojë valës së parë të krizës. Nëse dëshirojmë ti analizojmë efektet e krizës së pari duhet ti analizojmë këto sektorë sepse këto sektor janë çështjet kryesore të funksionimit të ekonomisë në Kosovë, si dhe janë të ndërlidhura mes veti sa asnjëra pa tjetrën nuk funksionojnë. Në Kosovë sa është rritur ekonomia ashtu është rritur edhe niveli i krizës. Mirëpo për ta ditur se Kosova është prekur nga kriza, duhet analizuar sipas aspektit të shpenzimeve apo konsumit. Mirëpo për rritjen e konsumit Kosova nuk ka aq buxhet që me pas konsum qeveritar atëherë duhej të marr borxh nga Banka Botërore apo Fondi Monetar Ndërkombëtar në mënyrë që të kryej shpenzime si publike ashtu edhe qeveritare. Kosova në krahasim me vende tjera ka qenë më pak e shpenzuar dhe nuk ka bërë aq investime sa janë duhur dhe atë që i kanë shpenzuar i kanë kthyer, por vendet e zhvilluara dhe ato vende në zhvillim kanë marrë kredi dhe borxh por nuk i kanë menaxhuar mirë por prapë kanë kërkuar borxhe dhe gjithmonë kanë qenë minus dhe pastaj qeveria e tyre si p.sh SHBA-ja dhe Britania e Madhe kanë ndërmarrë hapa që konsumin publik dhe investimet publike ti ulin atëherë konsumi i qeverisë dhe investimet e qeverisë janë rritur ndërsa eksportet dhe importet kanë rënë e gjitha kjo ka shtuar krizë në sistemet financiare në mënyrë që ti rrisin PBB-në. Roli i FMN-ës ka qenë që qeveria të ketë politika të mira, kanë ardhur auditorë të jashtëm ku kanë kontrolluar punën e ekonomisë dhe më në fund i paraqesin apo postojnë raportet ku tregojnë ka po shkon ekonomia e Kosovës. FMN në rastin e Kosovës fokus kryesor e ka ruajtjen e stabilitetit financiar dhe stabilitetit fiskal.

Në këtë rastë mbështetja e ofruar nga FMN-ja ka ndihmuar që këta dy sektorë të jenë mjaft stabil, gjë që dëshmohet edhe përmes indikatorëve të cilët publikohen çdo ditë. Për të ruajtur stabilitetitin fiskal është arrit edhe marrëveshja për program me Qeverinë në vitin 2010 e cila marrëveshje ka qenë e paraparë të mbështesë Kosovën me 108 milion euro përgjatë periudhës 18 mujore sa ka qenë planifikuar programi. Në të njëjtën kohë edhe tani FMN ka rrit një marrëveshje me qeverinë për një program te ri i cili pritet të miratohet në fund të këtij muaji përmes të cilit Kosovës i mundësohet të përfitoj fonde në vlerë prej 107 milion euro përgjatë periudhës 20 mujore. Program në vete përmban edhe një varg politikave te cilat do të ndihmojnë Kosovën në ruajtjen e stabilitetit dhe qëndurshmërisë financiare. Sipas FMN-së, gjatë reflektimit të krizës në Kosovë e që është prekur sektori i eksportit dhe importit Kosova më shumë ka importuar se ka eksportuar, vlera e eksportit ka qenë rreth 300 milion euro ndërsa ka importuar rreth 12 miliard euro, gjë që është një diferencë shumë e madhe. Remitencat nuk janë ra qa shumë në krahasim me krizën, për shkak të emigrantëve që janë nëpër botë rreth 500.000 vetë, gjë e cila prapë së prapë i ndihmon ekonomisë së Kosovës.

Përfundimi

Kriza globale financiare e shekullit XXI goditi një pjesë të madhe të shteteve të botës ku pretendon të vazhdojë edhe në ditët në vijim. Kriza ekonomike financiare e shek. XXI ka filluar në SHBA dhe ende vazhdon edhe në ditët e sotshme dhe ka tendencë vazhdimi meqenëse jemi në fillim të shekullit, mendoi se numri i krizave në këtë shekull siç po vazhdon do të jetë më e madhe në krahasim me shekujt e kaluara dhe ende mbesim me kurajë se çka do të ndodhë në të ardhmen, cila krizë është në radhë. Nga kriza globale financiare humbën miliona të cilat tash dhe në të ardhmen do të bartin humbjet e mëdha financiare me kurrizin e tyre, përmes zvogëlimit të fuqisë blerëse dhe rritjes së tatimit që shteti do të bartë tek ta për ta mbuluar rrezikun që shteti sot ka marrë mbi bankat të ashtuquajtura " produkte të infektuara financiare". Humbën mijëra të punësuar në ekonomi por padyshim humbësi më i madh i krizës është vetë sistemi kapitalist botëror.

Në hulumtim është vërejtur se kriza në Kosovë për shkak te ekspozimit të ulët të ekonomisë tonë ndaj tregjeve ndërkombëtare nuk ka qenë e ndikuar edhe aq shumë. Fillimisht viti 2009 mund të konsiderohet viti kur efektet e krizës janë reflektuar në Kosovë, kjo kryesisht përmes uljes së remitencave, uljes së eksporteve, dhe zvogëlimit të investimeve të jashtme direkte. Këto efekte ishin prezentë edhe në vitin 2010, 2011, 2012 dhe pritet të na shoqërojnë edhe gjatë viteve 2013 dhe 2014. Nga studimi i fenomeneve, formës dhe implikimeve që pati kriza financiare dhe ekonomike globale, vlerësojmë që disa sugjerime për kapërcimin e saj nevojitet rregullim i kujdesshëm dhe mbikëqyrje e sistemit financiar në një proces të balancuar liberalizimi mund të kontribuojë në një stabilitet financiar më të mirë, duhen rishikuar standardet dhe metodat e kontabilitetit të zbatuara deri më tani, të cilat duhet të marin parasysh edhe riskun dhe gjithashtu sistemi bankar duhet të bëjë një menaxhim më të mirë të tij, zbatimin e konsolidimit fiskal dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së financave publike, promovimin e rritjes së qëndrueshme dhe hapjen e vendeve të punëve të reja, promovimin e konceptit të menaxhimit të krizës, përmirësimin e menaxhimit ekonomik, forcimin e sektorit financiar (forcimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare dhe tregjeve).

Biblografia

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës " Raporti i stabilitetit financiar" nr 2, dhjetor 2011
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës " Raporti i stabilitetit financiar" nr 4, janar 2014
3. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës " Raporti vjetor 2012 " nr 3, qershor 2013
4. Beqa Beqir (2009), " Kriza financiare globale: efektet shkatëruese të saj ", *Albania Press,* http://www.albaniapress.com/lajme/8115/Kriza-financiare-globale-efektet-shkaterruese-te-saj-.html
5. Civici Adrian (2010), " Kriza financiare apo globale ", UET Press, Tiranë
6. http://www.evropaelire.org/content/article/24397436.htmlhttp://www.bqk-kos.org/repository/docs/2014/BQK_FSR_4.pdfhttp://www.telegrafi.com/ekonomi/kriza-ne-eurozone-zvogelon-remitencat-46-9700.html
7. Lubrani Osnat " Zhvillimi& tranzacioni", UNDP Kosovo, http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Development%20and%20Transitions_shqip.pdf
8. Mishkin Frederic (1991), "Anatomy of Financial Crisis"
9. Otto Dettmer (2007), " CSI: credit crunch – Central banks have played a starring role", *The Economist,* http://www.economist.com/node/9972489?story_id=9972489
10. Watt Andrew (2008), " The economic and financial crisis in Europe: addressing the causes and the repercussions", European Economic and Employmend Policy Brief, No. 3-2008, ISSN 1782-2165

Ma.Marsida (Salihi) Tafilica[1],
Drnt. Kilda Gusha (Çela)[2]
[1] *Lecturer in the faculty of science education*
Email: marsidasalihi@yahoo.it
[2] *Directory of Public Health Shkoder*
Email: kildacela@hotmail.com

27 The role of the eu in conflict resolution (the case of the south caucasus)

Abstract
This article tries to give the conflict in the South Caucasus and the EU's influence in the region. We will try to offer understanding of Georgian-Abkhazian, Georgia-Ossetian and Nagorno-Karabakh conflict, the ethnic conflict which turned into full scale between these regions. Focusing on the background of the issue and developments on it, we will analyze these, employing theoretical perspectives. Lastly we will discuss the influence of the European Union in the South Caucasus. How did the EU react towards problems in the South Caucasia? How did other international organizations react for solving the conflict in this region? These are some of the main questions that will be raised in this project. But the key point of this study is to provide a detailed analysis on the subject of how the European Union changed the shape of solving the problems in South Caucasia. While doing this exercise our focus is going to be the reasons of emergence of conflict and following no war, no peace – stalemate situation between these countries.
Keywords: EU Conflict Resolution, ENP, Georgia, Russia, Abkhazia, South Ossetia, Nagorno-Karbakh.

INTRODUCTION

The European Union, historically considered as a peace project, has accepted conflict resolution as a primary objective in its own aim. The European Union came out as a result of the Treaty of Maastricht when entered into force on 1 November 1993. This supranational organization was established with the aim of getting economic and political union between members of Europe.

The EU followed the steps of European Economic Community, an organization formed among six countries in 1957. Its primary goal was not just bringing economic integration as EEC did, but also to promote peace and security in Europe. Since peace is a synonym for quiescence and an antonym for war, all states of Europe came together to form this kind of organization in order to prevent any kind of conflict and to bring peace in the world. To reach peace, it is necessary that all parties should act right. This can be better understood in the book of Immanuel Kant titled "Perpetual Peace" where he claimed: "*No treaty of peace shall be regarded as valid if made with the secret reservation of material for a future war*."[1]

In this project, it will be presented the role of the European Union in many conflicts, but it will focus more in the South Caucasus and more specifically in Abkhazia, South Ossetia, and Nagorno-Karabakh regions.

In this study, the answer to the question how the EU could deal with the situation created there will also be given. Its successes and failures, supports and refusals, above all, the solution or dissolution of the problems will be examined.

Aforementioned countries, including Russia, have always tried to approach the EU. They considered the integration into the European Union as a key factor for the solution of their problems and without being part of any discrimination.

The phrase below describes it in a better way: "*A historical document which will allow us to continue our course towards entering Europe without the discrimination which took place in the past. We move forward as equal partners towards our mutual interests.*"[2]
The main theme of this paper is the role of the European Union in Abkhazia, South Ossetia, and Nagorno Karabakh conflicts. We will try as much as possible to be flexible in exploring the role of EU in conflict resolution, particularly in these three cases.
The first part contains a short overview of the emergence of conflicts and their continuity, that is, the explanation of history of these conflicts. The second part looks at the membership approaches in the Union's relations and how it could be part of these conflicts. How could it intervene and what are the instruments it applied for the resolution of the problems? And the final part is a general discussion of the successes and failures of the Union, while dealing with conflicts in countries with a membership perspective.

GEORGIAN – ABKHAZIAN CONFLICT

The Georgian – Abkhazian conflict is an ethnic conflict between Georgians and Abkhazians in Abkhazia, an autonomous republic in northwestern Georgia where its independence is de facto recognized. Abkhazia is a place composed of 18 percent Abkhazians and 48 percent Georgians, with the remainder Armenian, Greek, and Russian. The Georgian conflict that began in August 1992 and ended in 1993 was one of the bloodiest in the post- Soviet area and it remains still unresolved. The conflict of Abkhazia with Georgia lasted for 13 months and, in this case, Russia supported Abkhazians. Although there were peace agreements which were managed by Russia and by the UN observers, the war was restarted by Abkhazians and it ended with Georgia's military defeat.

GEORGIA – OSSETIAN CONFLICT

Another ethnic conflict in the post-Soviet area is the Georgian – Ossetian conflict which began in 1991 and lasted till 1992. South Ossetia is an autonomous region in the north central part of Georgia, bordered to the north by Russia. In 1990, South Ossetia declared itself a sovereign republic. The northern part of Ossetia is located in Russia and approximately 600.000 Ossetians live there, while South Ossetia is a region that geographically belongs to Georgia. Although there were many discussions and efforts to stop the tension that rose between these two regions and to bring peace, the conflict continued till nowadays and has remained unresolved. Even with the mediation of Russia and the OSCE, in August 2008, the situation in Georgia and in South Ossetia became worse that brought them into war.

NAGORNO – KARABAKH CONFLICT

Nagorno – Karabakh is a region in southwestern Azerbaijan and it is de jure part of Azerbaijan, but de facto governed by the internationally unrecognized Nagorno – Karabakh Republic.
The Nagorno – Karabakh conflict took place from February 1988 to May 1994 between Armenians in Nagorno – Karabakh and those in the Republic of Azerbaijan. Also concerning this conflict, there were many diplomatic efforts and mediators such as Russia, Great Britain, and Turkey, but their influence had little success. Many other organizations entered also to mediate, including the United Nations and the Conference on Security and Cooperation in Europe (CSCE). All of them had little influence in this region.

THE EU'S ROLE IN CONFLICT RESOLUTION IN SOUTH CAUCASUS

The European Union has been present in the area of South Caucasus from the early 1990's, when democracy began to emerge in these young countries and, at the same time, a number of conflicts were present there. The attention of the EU has been seen mostly in 2001, especially with September 11th terrorist attacks in the United States of America. This attention of the EU to the South Caucasus culminated in the appointment of the EU Special Representative (EUSR) in July 2003 and then with the participation of the three post – Soviet states into the European Neighborhood Policy (ENP) in June 2004. All these three conflicts have had their own impact on the European Union and so on. Instability in these regions was a big risk and a threat to European Union security. The bloc's special representative for the South Caucasus, Peter Semneby, said in an interview: "*Without stability, without a consensus around the rules of the game in terms of democratic institutions, elections, and so on, there will not be a basis for a mutually beneficial relationship based on mutual trust and common values with the EU.*"[3]
The problem of the EU's security is that Nagorno-Karabakh, Abkhazian and South Ossetian conflicts have been ranging in Europe's neighborhood. Stability in these regions would serve the interests of the European Union in that area, where the most important ones are energy resources and pipelines.
The European Union has served two functions in these regions: the first one is as a security actor and the second one is as a financial actor. The status of the EU as a **security actor** in the South Caucasus (particularly in Georgia) has become more visible in 2003 and later on. The investment that the European Union has made as a security actor was to appoint a Special Representative for the South Caucasus. These Representatives are delegates of the EU that have specific duties in the region. The aim was to promote democracy and good governance in these countries.[4]
The EU does not participate directly in negotiations on Nagorno – Karabakh, Abkhazia, or South Ossetia. The EU's relations with Azerbaijan and Armenia are not strong, and if we take into consideration this, it has stronger relations with Georgia and has been more present there than in any other regions of South Caucasus. The European Union has been many times criticized for not raising discussions with its partners for these conflicts and for not employing sanctions or any other means to advance peace. But, the arrival of a European Union Special Representatives is a good chance and a good moment to show its political presence there. At the same time, it has the opportunity to serve as an observer in the three negotiation forums for conflict resolution.
Another initiative of the European Union that we mentioned also before, was to launch a European Security and Defence Policy (ESDP) mission. It also made a great contribute by employing Rapid Reaction Mechanism which is "*designed to allow the Community to respond urgently to the needs of countries threatened with or undergoing severe political instability or suffering from the effects of a technological or natural disaster. Its purpose is to support measures aimed at safeguarding or re-establishing the conditions under which the partner countries of the EC can pursue their long term development goals.*"[4]
The European Union has included Armenia, Azerbaijan, and Georgia in the European Neighborhood Policy (ENP) and started Action Plan negotiations in 2006. We will mention about the ENP now, while, for the Action Plan, we will talk later in a more detailed way. The ENP was developed in 2004 with the objective of avoiding the emergence of new dividing lines between the enlarged European Union and our neighbors and instead strengthening the prosperity, stability, and security of all concerned…[5]

Despite all these instruments and policies that the EU applied, it also had a closer cooperation with the United Nations (UN) and the Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE). For the EU, these are an opportunity to reposition itself in the South Caucasus, to take part in conflict resolution and to be involved in the process of democratization, good governance, and the promotion of human rights in the region.

Most of the European Union member states did not and still do not consider the South Caucasus to be of significant strategic importance. If we compare them with Moldova, Ukraine, and Belarus – Armenia, Azerbaijan, and Georgia have to take a back seat. Compared to Russia, the U.S., Turkey and Iran, or the UN, OSCE, NATO, and the Council of Europe, the European Union is lesser active than the aforementioned actors. It is only in the last years that the EU has begun to define itself in the South Caucasus throughout its policies and its applied instruments.[6]

The EU engagement in the Nagorno-Karabakh, Abkhazia, and South Ossetia conflicts came as a result of the EU's 2004 enlargement. In order to avoid instability on its borders, the EU's interest is to have the countries around it well-governed. But, stability in the countries around its borders is not its only interest. Some other interests are also, to ensure access to Caspian oil and gas, develop transport and communication corridors between Europe and Asia, and prevent such threats as smuggling, corruption, trafficking and environmental degradation. Russia and the U.S. have their interests as well in these regions. So, sometimes they cooperate with the EU and other times they see it as a rival for their interests.

In 1996, the EU applied the same approach as to other former Soviet republics by signing Partnership and Cooperation Agreements (PCA) with all these three countries. It will encourage political, commercial, economic and cultural cooperation between these countries (Armenia, Azerbaijan, and Georgia) and the EU. From this Agreement, they also will get an understanding and partnership for mutual benefit. The EU implemented Technical Assistance to the Commonwealth of Independent States (TACIS) programs, that are foreign and technical assistance programs which are implemented by the European Commission to help members of the Commonwealth of Independent States, in their transition to democratic market – oriented economy.

By serving as a security actor in the South Caucasus, the EU launched European Security and Defence Policy (ESDP). One of the efforts of the ESDP was the rule of law mission to Georgia in 2004. This mission was to support the Georgian authorities in challenging the criminal justice system.

We talked about the role of the European Union in the South Caucasus as a security actor. Now we will talk about the European Union as a **financial actor**. Since the conflicts began in the South Caucasus, the EU has been an aid provider responding immediately to humanitarian crises caused by Abkhazian, South Ossetia, and Nagorno-Karabakh conflicts. The aid could be provided mostly by European Commission Humanitarian Office (ECHO), and food aid through the Food Security Program (FSP) that gave 168 million euro in Georgia[7], 160 million euro in Azerbaijan[8], 171 million euro in Armenia[9]. Later, Georgia continued to receive ECHO help in contrast with two other states.

One of the most important negotiations was Action Plan negotiation that, for the EU, was a chance and a good opportunity to enhance itself in the South Caucasus. Not only for the EU, but also for the countries of the South Caucasus, according to one EU member state ambassador, Action Plans are an opportunity to define a "*comprehensive roadmap for reform*"[10].Tbilisi was the one which wanted to be the first priority in its Action Plan by resolving its internal conflicts. For Georgia, it's of great importance to be included in Europe. That is the reason that, in cooperation for resolving Georgia's internal conflicts, a draft "Elements for Inclusion" was proposed to Brussels.

Tbilisi considers integration into Europe a key factor for resolving its conflicts. There are two issues which shape the Georgian perspective of the EU in the realm of security: the first one is that Georgia fears that the EU would be on Russian side, since they both are working on developing a Common Space of Cooperation in the Field of External Security in which they share the responsibility for an internal order. They will cooperate to strengthen dialogue in order to challenge the threats of today such as terrorism, the proliferation of WMD, existing regional conflicts, etc. The second concept of Georgia for the EU is positive, since it believes that the *Statement in Georgia* could be helpful. That Statement is claimed to ensure the safety and protection of civilians, promote human rights, and stop violence.[11]

CONCLUSION

We want to conclude my paper in few words by giving the essence of what we have mentioned before. The European Union is a supranational organization and one of its own aims is to promote and secure peace in the world. Peace is a broad concept, but in this case, by peace, we mean freedom, democracy, and human rights. It is this kind of peace that the EU has always tried to support and it has always tried to extend it in many countries as much as possible, including non-European states too. One example for this is the intervention in the conflicts in the South Caucasus region. But this intervention has been analyzed in two respects: in positive and negative. On one hand, the European Union has claimed that its mission is to promote peace, to deter violence and to bring serenity and the resolution of problems in the region.

On the other hand, the EU has been criticized a lot for non-intervention and its minimal intervention has been for its own interests that we mentioned before.

According to the Euro MP that criticized the lack of political will, "*Europe cannot afford to have the South Caucasus without democracy*".[12]

There are many justifications that the European Union has raised for this issue. But it is important to know that the EU and some other organizations behave according to their interests. The fact that the EU has considered Georgia to be of first priority means a lot.

In our opinion, the European Union should done more for resolving the conflict by increasing its political visibility. Unlike with other actors such as UN, OSCE, or the Council of Europe, its effort and contribution has been minimal. More agreements with other partners are required. At the same time, the EU should have sent troops there and also should have the capacity to use soft and hard tools in order to find a better solution for these conflicts.[13]

Bibliography

1. Kant, Immanuel, *Perpetual Peace*, New York, Cosimo publisher, 2005.
2. Msn Encarta.
3. Peuch, Jean-Christophe, "*European Union: Democratization Key to Conflict Resolution in South Caucasus*", June 17, 2008.
4. http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/cpcm/rrm/index.htm.
5. Ganzle, Stefan, "*The European Neighbourhood Policy (ENP) and the Modes of EU 'External Governance*", University of British Columbia.
6. Commission Staff Working Paper, 15 March 2007.
7. Information provided by the Europa House Information Point, Baku, February 2006.

PhD. Orhan M. Çeku, Mll
Ligjërues i së drejtës në Kolegjin
"Pjetër Budi" – Prishtinë

Ph.D. Ismail mehmeti
Drejtor në Doganën e Kosovës

28 Harmonizimi i Sistemit Fiskal nga Vendet e Ballkanit Perëndimor në Funksion të Integrimit në BE

Harmonization of Fiscal System of the Western Balkans Countries towards EU Integration

Dega Mitrovicë

Abstrakt:

Procesi i integrimit në tërësi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Unionin Evropian, është i gjatë dhe i ndërlikuar. Ky proces kërkon hartimin dhe realizimin e politikave të shumta qeverisëse, deri të përmirësimi i infrastrukturës me theks të veçantë asaj ligjore. Harmonizimi ligjor kërkon për afrim të ligjeve nga vendet aspirante në procesin e integrimit. Përafrimi i legjislacionit përbën një instrument bashkëpunimi të vendeve të cilat kanë synim bashkërendimin e politikave të caktuara. Në funksion të këtij procesi do të ishte edhe bashkëpunimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt arritjes së qëllimit final – integrimit të plotë në Union Evropian. Ky bashkëpunim do të përfshinte shumë fusha dhe politika publike. Njëra prej tyre është bashkëpunimi në harmonizimin e sistemit fiskal të vendeve relevante. Sistemi fiskal përbën në thelb bazën ligjore për realizimin e politikës fiskale dhe plotësimit të buxhetit të shtetit. Në këtë punim do të studiohet harmonizimi i sistemit fiskal të vendeve të Ballkanit Perëndimor në funksion të përgatitjes së këtyre vendeve për integrim në UE.

Në punim do të analizohen termet sistemi fiskal dhe politika fiskale, harmonizimi i tyre nga shtetet dhe efekti i tyre në funksion të integrimit. Në funksion të mbarështimit të temës do të përdoren metodat e analizës dhe sintezës, deskriptive, deduksioni dhe induksioni etj.

Harmonizimi fiskal sjellë dobi të shumta ekonomike, financiare – fiskale dhe juridike. Ky harmonizim u siguron subjekteve të së drejtës (personave fizik dhe juridik), lëvizjen e kapitalit dhe faktorëve prodhues, eliminon tatimin e dyfishtë dhe efektet tjera negative në ekonomi.

Harmonizimi i sistemeve fiskale të vendeve të përmendura do të mundësonte, që ekonomia e tyre të jetë e gatshme t'i përballojë konkurrencës në tregun e gjerë të Unionit Evropian.

Fjalë kyçe: Sistemi fiskal, harmonizim, politikë fiskale, Ballkani Perëndimor, etj.

Abstract:

The whole process of integration of the Western Balkan countries in European Union is long and complex. This process requires the design and implementation of numerous government policies, to the improvement of infrastructure with special emphasis on the legal one. Legal harmonization requires outreach of the laws of the aspirant countries in the integration process. Approximation of legislation is an instrument of cooperation of countries that aim coordination of certain policies. In view of this process was the cooperation of the Western Balkan countries towards achieving the ultimate goal - full integration into the

European Union. This cooperation would include many areas and public policy. One of them is cooperation in harmonizing fiscal system of relevant countries. The fiscal system in the essence constitutes of the legal basis for the implementation of fiscal policy and fulfillment of the state budget. This paper will study the harmonization of the fiscal system of the Western Balkan countries in order to improve these countries' integration into the EU.

In the paper will be analyzed terms as fiscal system and fiscal policy, their harmonization from the states and their effect on integration. For evolving this subject will be used analysis and synthesis methods, descriptive, deduction and induction etc.

Fiscal harmonization brings economic, financial - fiscal and legal benefits. This ensures harmonization of law subjects (natural and legal persons), the movement of capital and production factors, eliminates double taxation and other negative economic effects.

Harmonization of fiscal systems of the countries mentioned will allow that their economy is ready to face the competition in the wider European Union.

Keywords: *fiscal system, harmonization, fiscal policy, the Western Balkans, etc.*

Hyrje

Harmonizimi sistemit fiskal i një vendi në epokën globale nuk mund të shikohet brenda një qëllimi të kufizuar nacional i cili nuk i merr për bazë ndërvarësitë ndërmjet kombeve. Në kohën e integrimeve globale, politikat kombëtare fiskale përafrohen ndërmjet veti duke i harmonizuar instrumentet fiskale sepse përdorimi i këtyre mekanizmave shkakton efekte rajonale dhe më gjerë.

Me sistem fiskal nënkuptojmë tërësinë e dispozitave ligjore të cilat rregullojnë materien e mbledhjes së të hyrave publike dhe financimin e shërbimeve publike, që janë të ndërlidhura në mes veti për realizimin e qëllimeve të caktuara. Këto qëllime do të përmbledhshin në ato më kryesore e që janë: mbledhja sa më e madhe e mjeteve monetare, shpërndarja dhe shpenzimi tyre në mënyrë efiçente. Sistemi fiskal përbëhet prej ligjeve fiskale të cilat përbëjnë bazën e realizimit të politikës fiskale në vend. Përmes tyre shteti orienton politikat e taksimit apo realizimit të të hyrave publike me të cilat plotësohet buxheti i shtetit, më pas të financohen shërbimet e shumta publike.

Politika fiskale përfaqëson tërësinë e metodave dhe të veprimeve të përdorura nga qeveria dhe organet e saj, për gjetjen, grumbullimin dhe përdorimin efiçent të burimeve të nevojshme për plotësimin e programeve të saja gjatë një periudhe të caktuar kohore. Politika fiskale është pjesë e rëndësishme e politikës ekonomike dhe përfshin politikën e sigurimit të të ardhurave buxhetore, politikën e shpenzimeve buxhetore dhe politikën e administrimit të borxhit shtetëror.[129]

Përmes realizimit të politikës fiskale konkrete arrihen synime të shumta ekonomike dhe financiare. Realizimi efikas i politikës fiskale rezulton me plotësimin e buxhetit të shtetit, përmes të cilit bëhet e mundshme funksionimi i institucioneve shtetërore, financohen shpenzimet e përgjithshme dhe të përbashkëta shtetërore, arrihet punësimi i dëshiruar dhe mirëqenia sociale.

Sistemi fiskal është sistem komplementar dhe përbëhet prej nën sistemeve tjera të cilat kanë qëllim inkasimin e mjeteve monetare për plotësimin e buxhetit të shtetit dhe financimin e shpenzimeve publike.

[129]Guid qytetare për buxhetin,Tiranë 2002 fq. 21.

Pra, përgjithësisht është i njohur fakti se sistemi fiskal përbëhet prej: a.) sistemit tatimor, si sistemi kryesor, b.) sistemi doganor, c.) sistemi i taksave, ç.) sistemi i kontributeve, etj. në tërësi ky sistem duhet të funksionojë mirë në mënyrë që të realizohen qëllimet e paracaktuara. Në të shumtën e rasteve sistemi fiskal i një shteti është në kundërshtim me të shteteve tjera. Në kuadër të këtij shqyrtimi duke i ditur divergjencat e mëdha që ekzistojnë në shtetet e Ballkanit Perëndimore paraqitet nevoja e domosdoshme për bashkëpunim në mes të këtyre vendeve.

Sistemi Fiskal dhe Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare

Pas Luftës së Dytë Botërore shqyrtimi i avantazheve të tregtisë midis vendeve të ndryshme dhe të dëmeve ekonomike ashtu edhe politike që sjellin politikat proteksioniste të kohës para luftës, i ka shtyrë shtetet që t kërkojnë marrëveshje të atilla që t'i shmangin tatimet e dyfishta dhe ta lehtësojnë tregtinë ndërkombëtare, duke zbatuar edhe politika bashkërenditjeje fiskale, deri tek miratimi i formave të bashkimeve doganore midis shteteve të ndryshme. Ky proces ka arritur kulmin e vet me krijimin e tregjeve të përbashkëta dhe të bashkimeve ekonomike si dhe duke zbatuar edhe politika harmonizimi fiskal.[130]

Në nivel ndërkombëtar, nëse qeveritë kombëtare dhe institucionet ndërkombëtare nxisin lëvizjen e lirë të tregtisë dhe nëse nuk ndërhyjnë në shpërndarjen efikase të të ardhurave të siguruara nga tregjet, atëherë ndërvarësia në rritje mes ekonomive do të çojë drejt një zhvillimi më të madh ekonomik për të gjitha shtetet e përfshira[131].

Marrëdhëniet ekonomike midis shteteve të ndryshme, me shkëmbim mallrash dhe shërbimesh, varen në mënyrë thelbësore nga ndërhyrja e sistemit fiskal, nëpërmjet aplikimit të tagrave doganore. Këto, siç është e njohur mund të vilen në çastin kur importohet një prodhim (tagër importimi), atëherë kur ai eksportohet (tagër eksporti) ose kur mallrat kapërcejnë territorin kombëtar (tagër kalimi) [132].

Secili shtet sovran varësisht nga niveli i përgjithshëm i zhvillimi shoqëror dhe ekonomik, varësisht nga orientimet programore të klasës politike në pushtet, aplikon instrumente dhe tarifa të caktuara fiskale, qoftë për ekonominë vendore, ashtu edhe në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve. Përveç tarifave doganore dhe jo doganore që aplikohen rregullisht nga shtetet për mallrat që importohen apo eksportohen apo taksë transiti, qëllimet e të cilave janë të ndryshme si: a.) taksa të llojit fiskal, qëllimi i të cilave është plotësimi i buxhetit të shtetit, 2.) taksë doganore mbrojtëse, për të mbrojtur prodhuesit vendor dhe për të penguar importin me të cilën edhe balancohet bilanci tregtar me botën e jashtme, 3.) taksa anti damping, si kundërmasa ndaj subvencioneve të shteteve tjera, 4.) taksa të reciprocitetit, etj., sistemi fiskal përbëhet prej shumëllojshmërisë së instrumenteve tjera fiskale të cilat aplikohen nga shteti për nevoja të veta. Instrumentet fiskale të cilat miratohen nga shtetit në nivelin qendror duhet të kenë formë juridike përkatëse – ligji përkatës për llojin e instrumentit fiskal.

"Pushteti për të vendosur tatime është një pushtet i fuqishëm mbi të cilin bazohet e gjithë fabrika kombëtare. Ky pushtet është kaq i domosdoshëm për ekzistencën dhe prosperitetin e një kombi, sa është edhe ajri për njeriun."[133]

---

[130] Mario Leccisotti, Leksione të Shkencës së Financës, Elite, Tiranë, 2000, fq. 613

[131] Karen A. Mingst: "Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare", Albanian Institute for International Studies, Tiranë, 2008, fq. 301

[132] Mario Leccisotti, Leksione të Shkencës së Financës, Elite, Tiranë, fq. 608

[133] Harvey S. Rosen: "Financat Publike", Albin, Tiranë, 2003, fq. 305

Harmonizimi i Sistemeve Fiskale

Veprimtaria legjislative e shteteve varët përgjithësisht nga e drejta e patjetërsueshëm e një vendi që të miratoj ligje dhe akte tjera juridike, në përputhje me strategjinë legjislative e cila hartohet duke u bazuar në nevojat e vendit dhe marrëdhëniet e përgjithshme shoqërore. Miratimi i një ligji ka për qëllim rregullimin e një sfere të caktuar shoqërore me norma juridike. Norma e caktuar juridike duhet të prodhojë produktivitet dhe siguri juridike, por, ajo duhet edhe të ndikojë në zhvillimin e marrëdhënieve financiare, fiskale të vendit. Në kohën e sotme e cila quhet koha e "integrimeve", shtetet përmes marrëveshjeve ndërkombëtare synojnë të rregullojnë sfera të interesit të përbashkët, dhe tu përshtatën nevojave të përbashkëta.

Në lidhje me konceptin harmonizim është më rëndësi të kuptohet dy nocione themelore dhe dallimet në mes tyre: 1. Bashkërenditje fiskale, dhe 2. Harmonizim fiskal.

1.) "Me bashkërenditje fiskale kuptohet veprimtaria e një shteti me qëllim që të rregullojë sjelljen e tij në lëmin fiskal, në mënyrë që të mos bjerë në kundërshtim me atë të shteteve të tjera dhe të mos e kufizojë mundësinë që të realizohen objektivat e përbashkëta.

2.) Ndërsa *harmonizim* kemi kur shtetet e veçanta pranojnë struktura fiskale të njëllojta apo që janë konform ndaj objektivave të përbashkëta."[134]

Me harmonizim të sistemit fiskalnënkuptojmë rregullimin me ligj të instrumenteve financiarë duke eliminuar kolizionet fiskale me pasoja negative financiare për subjektet ekonomike dhe qytetarët. Politikat fiskale harmonizojnë të hyrat dhe shpenzimet duke përcjellë indikatorët makroekonomik dhe politikën monetare. Harmonizimi fiskal është paraqitur nga nevoja që llojet e caktuara të formave fiskale të sistemeve të dyfishta të bashkohen, respektivisht të unjësohet regjistrimi i përfshirjes fiskale ndërmjet formave të ndryshme të sistemit fiskal[135].

Pra, konkretisht "me harmonizim të sistemeve fiskale duhet nënkuptuar veprimtarinë legjislative të një të shteti, që konsiston në miratimin e ligjeve në fushën e tatimeve, taksave, dhe formave tjera fiskale, ashtu që sistemet fiskale përkatëse të shteteve sovrane të jenë të njëllojta apo u përgjigjen objektivave të njëjta të përbashkëta. Veprimtarisë legjislative të shtetit i paraprinë marrëveshja ndërkombëtare e tyre. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, shtetet i bëjnë ndryshimet e nevojshme legjislative sipas obligimeve të marra. Nëse shtetet nënshkruese të kontratave ndërkombëtare për përshtatje të sistemit fiskal, dispozitat e marrëveshjes i inkorporojnë në legjislacionin e tyre, atëherë kemi harmonizim të sistemeve fiskale konkrete. "[136]

Harmonizimi i sistemeve fiskale kërkon aktivitet ligjor dhe aprovim të instrumenteve fiskale të njëjta me shtetet e treta, duke e bërë për-afrimin apo përshtatjen e legjislacionit pozitiv fiskal me atë të shteteve tjera të pavarura. Ky aktivitet i shtetit bazohet në të drejtën autonome për miratimin dhe ndryshimin e politikave fiskale përmes aprovimit të ligjeve nga parlamentet e vendeve përkatëse.

Kjo formë e bashkëpunimit të shteteve sovrane nuk është edhe aq e lehtë të aplikohet në praktikë, për arsye të shumta duke u nisur nga fakti se secili shtet i ka specifikat e veta ekonomike, sociale, politike etj. dhe jo çdo herë këto specifika nuk përputhen me të vendeve tjera.

Harmonizimi i sistemit fiskal duhet të përfshijë disa çështje prej të cilave po veçojmë: harmonizimi i brendshëm dhe harmonizimi ndërkombëtar.

---

[134] Mario Leccisotti, Leksione të Shkencës së Financës, Elite, Tiranë, 200, fq. 613

[135] Dragan Roller "Fiskalna Tehnika", Informator, Zagreb, 1988,

[136] Orhan Çeku, Sheqir Kutllovci, Ismail Mehmeti: Integrimet Ekonomike në Kontekstin e harmonizimit të Legjislacionit, Revista "Diskutime", Viti II, Nr. 3/4, Prill-Maj, Tetovë, 2013

Harmonizimi i brendshëm duhet shikuar në dy aspekte: harmonizimi në shtetet e përbëra (federatë, union, etj.), dhe shtetet unitare.

Në shtetet e përbëra, harmonizimi fiskal është më kompleks dhe si i tillë varët nga kompetencat dhe të drejtat kushtetuese që kanë njësitë autonome në kuadër të shtetit të përbërë. Në këto sisteme qeverisëse zakonisht, ekziston një decentralizim apo ndarje e kompetencave në mes të qendrës dhe njësive përbërëse. Është e kuptueshme se tatimi i dyfishtë është i eliminuar, por decentralizimi këtu nënkupton se njësitë përbërëse mund të kenë strukturë fiskale të ndryshme nga njësitë tjera dhe nga qendra. Ky konglomerat i ndryshëm i strukturës fiskale në kuadër të një shteti sovran shpesh sjellë komplikime të ndryshme në ekonomi e me të edhe mos alokim efikas të burimeve. Alokimi efikas i resurseve është një prej qëllimeve kryesore të politikës dhe sistemit fiskal. Ta marrim si shembull Republikën Federale të Gjermanisë. "Gjermania është një vend me rregullim federativ i cili i ka tri nivele fiskale: niveli fiskal federal, i Landit (Land-i nënkupton shtet autonom në kuadër të Republikës Federale të Gjermanisë) dhe vendor (i qarkut, komunës apo qytetit). Të drejtat dhe detyrat ndahen në tri nivele. Niveli qendror nxjerrë ligje me të cilat përcakton të drejta dhe detyra për të tria nivelet sipas nevojës për plotësimin e obligimeve të rëndësisë së përgjithshme për të gjithë qytetarët. Ligjet nxirren edhe në nivel të landeve dhe ato lokale sipas rrethit ligjor të veprimit. Rrjedhimisht barra e zbatimit të këtyre detyrave u takon landeve të cilat janë të obliguara ti përmbushin duke zbatuar Ligjin Themeltar[137] (Neni 108 i Ligjit Themeltar). Kjo shkakton efekte financiare, psh. sipas ligjit federal në Gjermani çdo fëmijë tre vjeç ka të drejtë ligjore për të shkuar në një kopsht fëmijësh. Kopshti është në përgjegjësi të autoriteteve lokale dhe ngarkesa financiare që rrjedh nga ky ligj nuk e ngarkon autoritetin i cili e ka nxjerr atë, në këtë rast shtetin federal"[138]. Ky rast më së miri na tregon kompleksitetin fiskal të shteteve të përbëra dhe njëkohësisht rëndësinë e sektorit të alokimit dhe distribuimit, pa harmonizimin e të cilëve nuk mund të funksionoi shteti i përbërë. Unioni sa më i madh i taksave ndihmon më shumë në drejtim të harmonizimit fiskal dhe krijon mundësi të alokimit dhe shpërndarjes më të drejtë çka edhe ndikon në forcimin e shtetit të përbërë.

Duhet vlerësuar së në rrethanat e krizës ekonomike dhe financiare kjo çështje ka filluar të ndryshojë ashtu që të bëhet një harmonizimi më i madh i strukturës dhe legjislacionit fiskal në këto vende.

Në kuadër të shteteve unitare ekziston një politikë dhe sistem unik dhe janë raste të vogla ku ekzistojnë ndryshime të caktuara. Por, edhe në këto shtete kemi raste të mos harmonizimit fiskal. Kjo ndodh në ato raste kur kemi decentralizim të madh të pushtetit. Njësitë administrative territoriale në bazë të specifikave të tyre caktojnë strukturë fiskale të veçantë për kategori të caktuara të burimeve fiskale, por pa rënë ndesh me sistemin e kombëtar fiskal. Janë këto situatat kur ekzistojnë specifika të caktuar në njësit administrative territoriale dhe caktohen taksa të veçanta, si p.sh. taksa për shërbimet hotelerike turistike, etj.

Harmonizimi i Sistemeve Fiskale të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Në këtë punim me vende të Ballkanit Perëndimore kemi për qëllim ato shtete të cilat akoma nuk janë bërë pjesë e UE-së, siç janë: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Të gjitha këto shtete dikur ishin pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe kishin sistem komunist të qeverisjes.
Pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, këto shtete me vështirësi ju qasën reformave të përgjithshme të funksionimit të shtetit.

[137] Ligji Themeltar është Kushtetuta e Republikës Federale të Gjermanisë
[138] Volfgang Renzch: Finanacat vendore në Gjermani: Njohuri themelore fq. 62- 66 (rasti i Gjermanisë): Financat dhe probleme të decentralizimit të Evropës Juglindore

Këto shtete qartazi janë përcaktuar për integrim në EU. Si rrjedhojë e përcaktimit të tyre, kjo rrugë kërkon punë dhe ndryshim rrënjësor të politikave publike.

Pa zgjeruar në fusha të ndryshme, po përmendim idenë e temës bosht të këtij punimi.

Ku jemi? Çka duhet të bëjmë? Çfarë duam të arrijmë?

Janë këto disa prej pyetjeve të cilat duhet t'u japin përgjigje adekuate në mënyrë që arrijmë aty ku synojmë. Në fakt, të gjitha këto shtete kanë marrëdhënie kontraktuale me UE-në, me përjashtim të Republikës së Kosovës, e cila është duke pritur nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim me UE-në. Edhe këto shtetet tjera janë në fazën fillestare të integrimit, për disa ekzistojnë pengesa vështirë të kalueshme, siç është rasti i problemit të Greqisë me Maqedonisë rreth emrit të kësaj të dytës, apo problemi i brendshëm i Bosnjës dhe Hercegovinës. Këto më shumë mund të interpretohen si probleme politike dhe të cilat mund të zgjidhen me marrëveshje politike. Por, ajo çka mbetet për t'u bërë është përgatitja e infrastrukturës për integrim të plotë në UE.

Rreth pyetjes së dytë, çka duhet të bëjmë? Harmonizimi i sistemeve fiskale duhet të arrihet në faza të caktuara. Faza e parë do të ishte kalimi nga Zona Tregtisë së Lirë që ekziston aktualisht në kuadër të Marrëveshjes CEFTA, në krijimin e Unionit Doganor të këtyre vendeve."Zona e Tregtisë së Lirë mund të rregullohet lehtë politikisht por shkakton vështirësi administrative, ndërsa të unioni doganor situata është e anasjelltë".[139]"Unioni doganor është bashkim ekonomik doganor që bëhet me marrëveshje apo kontratë ndërkombëtare ndërshtetërore për liberalizimin e tregtisë apo për eliminimin e barrierave doganor në mes të shteteve pjesëmarrëse apo nënshkruese të kësaj marrëveshje. Kjo donë të thotë se shtetet anëtare të unionit doganor e bartin një pjesë të sovranitetit shtetëror tregtar tek unioni apo bashkimi i shteteve. Karakteristikë e unionit doganor është se shtetet anëtare i eliminojnë taksat dhe pengesat tjera doganore, ndërsa për shtetet e treta aplikojnë tarifë të njëjte. Në këto raste territori doganor është më i madh se territori shtetëror i një shteti, sepse përfshinë territorin shtetëror të të gjithë anëtarëve të Unionit"[140]. "Njëherë kur vendoset unioni i tillë, kryerja e çështjeve administrative rreth doganës është relativisht e lehtë? Për të mira duhet të paguhet dogana menjëherë posa të kaloj kufirin e unionit, e pasta brenda kufijve mund të transportohet lirisht dhe të shitet ndërmjet shteteve. Për dërgesën që është e shkaktuar në Marsejë apo Roterdam duhet të paguhet dogana në të njëjtin vend, por ajo nuk do të ballafaqohet me pagesa shtesë, nëse dërgesa do të transportohet më tej në Munih. Mirëpo që të mund të funksionoj ky sistem i thjeshtë shtetet duhet të merren vesh rreth shkallëve doganore, dogana duhet të jetë e njëjtë si në rast se malli është shkarkuar në Marsejë, si në Roterdam apo në Hamburg, sepse përndryshe importuesit do ta zgjedhin vendin e importit ku do të ishte kompensimi më i vogël. Për këtë arsye unioni doganor kërkon që të gjitha shtetet të merren vesh aplikimit të shkallëve të njëjta doganore."[141]

Pas krijimit të Unionit Doganor, këto shtete duhet të vazhdojnë me harmonizimin fiskal, ku do të arrijnë marrëveshje të përbashkët për eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe harmonizimin sa më të madh të strukturës fiskale. Donë të thotë se stadi i parë i harmonizimit fiskal është eliminimi i tatimit të dyfishtë. Këto shtete të nënshkruajnë marrëveshje ndërkombëtare të përbashkët për eliminimin e taksimit të dyfishtë.

[139] John Pinder: "Bashkimi Evropian, hyrje e shkurtër ", OXFORD – University Press, 2001, në shqip Instituti për Zhvillimin e Habitatit, fq. 278

[140] Orhan M. Çeku: " E Drejta Doganore", Ligjërata të Autorizuara, Kolegji "Pjetër Budi" Prishtinë 2013, fq. 68

[141] Paul R. Krugman – Maurice Obstfeld: "Ekonomia Ndërkombëtare I, Teoria dhe Politika Ekonomike", Kolegji "Victory" & Instituti i Hulumtimeve Shkencore VICTORY, Prishtinë, 2010, fq.278

Nga praktika fiskale dihet se tatimimi përmes ligjeve bëhet mbi bazën e dy kritereve: 1.) Parimi i Rezidencës dhe 2.) Parimi i Burimit.

8. Baran, Roger & Zerres, Christopher & Zerres, Michael, *Customer Relationship Management (CMR),* BusinessSumup, 2008.
9. Mihart, Camelia, *Impact of intergrated Marketing Communication on Consumer Behaviour: Effects on Consumer Decision,Making Process,* Published by Canadian Center of Science and Education, April, 2012.
10. Grup Autorësh, *Parimet e Marketingut ,Principles of Marketing*, shkarkuar më Dhjetor 2013, nga: http://www.saylor.org/site/textbooks/Principles%20of%20Management.pdf

Mr. Llokman Hebibi
Prodekan në FAB-Kumanovë
Universiteti Shtetëror i Tetovës,Republika e Maqedonisë
E- mail: llokman.h@gmail.com

31 Roli i politikës fiskale ne zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë

Subject: The Role of Fiscal Policy in the Economy Development of the Republic of Macedonia Fiscal policy affects the realization of the economic policy aims (employment, price stability, statement balance of payments, and economic growth rate) while collecting the public revenue and public expenditure realization, which creates effects on macroeconomic aggregate performance and its behavior of economic entities. This research paper will include: the analysis of the economic policy and the role of public sector in the economy of the Republic of Macedonia, drafting the strategic plans for employment growth rate, operative-stimulating measures for creating workplaces undertaken by the state of the Republic of Macedonia in comparison with some other regional countries. According to many analyses, the economy of the Republic of Macedonia will not be immune to external developments and it is necessary for the government to take appropriate measures in soothing the situation. Fiscal policy has a special importance in the national economy which helps in the formulation of financial strategy, defining the vision, mission and objectives, as well as the analysis of the state sector which continually plays the leading role in the development of the national economy. Economic policies with the special focus on fiscal policy can have an impact on budget revenues due to the possible decrease of imports – as a result of the lowered overall demand when considering that the main source of budget revenues are the tax revenues. This may have a reflection in public spending with negative impacts on economic activities of the country. Reducing economic activities may also have an impact on reducing the level of savings in the country which could be reflected in a lower level of deposits. In concluding part of this research paper will be given suggestions and recommendations for improvement and overcoming problems facing the economy of the Republic of Macedonia.

Keywords: *fiscal and monetary policies, budget deficit, public debt, investment decline, increase unemployment, reforms.*

Politika fiskale ndikon në realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike (në punësim, stabilitet të çmimeve, në saldon e bilancit të pagesave dhe në normën e rritjes ekonomike) më vet faktin e mbledhjes të të hyrave publike dhe realizimin e shpenzimeve publike, me ç'rast krijon efekte në ecurinë e agregateve makroekonomik dhe në sjelljen e subjekteve ekonomike.
Ky punim shkencor do të përfshijë analizën e polikës ekonomike dhe roli i sektorit publikë në ekonomin e Republikes së Maqedonisë, hartimin e strategjive dhe planeve strategjike për rritjen e punësimit, masat operative-stimulative për krijimi e vendeve të punës të ndërmarra nga ana e shtetit të Republikës së Maqedonisë si dhe krahasimin me disa vende ne rajon.Sipas analizave të shumta ekonomia e Republikës së Maqedonisë nuk do të jetë imune ndaj zhvillimeve të jashtme, dhe është e nevojshme që qeveria të ndërmarrë masa të përshtatshme për qetësimin e situatës.Politika fiskale ka një rëndësi të veçantë në sektorin e ekonomise nacioanle i cili ndihmonë në formulimin e strategjisë financiare , përcaktimin e vizionit, misionit dhe objektivave si dhe ne analizën e sektorit shtetëror i cili vazhdimishtë luan rolin kryesor ne zhvillimin e ekonomise nacionale.

Politika ekonomike me theks të posaçëm politika fiskale mund të ketë ndikim në të hyrat buxhetore për shkak të rënies së mundshme të importeve – si rezultat i rënies së kërkesës së përgjithshme kur kemi parasysh se burimi kryesor i të hyrave buxhetore janë të hyrat tatimore.

Kjo do të mund të reflektohej në shpenzime publike me ndikime negative për aktivitetin ekonomik në vend. Zvogëlimi i aktivitetit ekonomik po ashtu mund ka ndikim edhe në uljen e nivelit të kursimeve në vend, gjë që mund të reflektohet në nivel më të ulët të depozitave.

Në fund të këtij punimi shkencor do të jepen propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin dhe tejkalimin e problemeve me të cilat përballet ekonomia e Republikës së Maqedonisë.

Fjalë kyçe: politika fiskale dhe monetare, deficitet buxhetore, borxhet shtetërore, renia e investimeve, rritja e papunësia, reformat, etj.

Roli i politikës fiskale ne zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë

Roli dhe funksionimi i shtetit në udhëheqjen e politikës ekonomike është i pakontestueshëm, në realizimin e stabilitetit të tregut dhe të çmimeve, në shkallën e kënaqshme të punësimit, në ruajtjen e ekuilibrit të bilancit të pagesave si dhe në realizimin e shkallës së caktuar të rritjes dhe të zhvillimit të ekonomisë së Republikës së Maqedonisë. Në kuadrin e politikës ekonomike, politika fiskale është njëra prej komponentëve më me rëndësi për secilën ekonomi nacionale.

Me anë të politikës ekonomike përcaktohen parimet në bazë të të cilave duhet të udhëhiqet ndonjë aksion, si dhe masat dhe mjetet për arritjen e qëllimeve të caktuara. Politika ekonomike shqyrton proceset ekonomike si dhe instrumentet, masat dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Maqedonisë për realizimin e qëllimeve të saj.

Për realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike Republika e Maqedonisë shfrytëzon mjetet e caktuara respektivisht instrumentet me ndihmën e të cilave realizohen qëllimet.Këto nstrumentet të politikës ekonomike zakonisht orientohen në:

- *Instrumentet e financave publike (politika fiskale),*
- *Instrumentet e politikës kreditore-monetare,*
- *Instrumentet e sistemit dhe të politikës së çmimeve,*
- *Instrumentet e tregtisë së jashtme dhe të sistemit devizor,*
- *Instrumentet e sistemit dhe të politikës së të ardhurave dhe*
- *Instrumentet e kontrollit të drejtpërdrejtë.*

Me politikën fiskale zakonisht nënkuptohet shfrytëzimi i instrumenteve të financave publike d.m.th. të hyrave publike dhe të dalave publike për realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike. Andaj, politika fiskale është instrument shumë i rëndësishëm i politikës ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

Politika fiskale ndikon në realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike (në punësim, stabilitet të çmimeve, në saldon e bilancit të pagesave dhe në normën e rritjes ekonomike) më vet faktin e mbledhjes të të hyrave publike dhe realizimin e shpenzimeve publike, me ç'rast krijon efekte në ecurinë e agregateve makroekonomik dhe në sjelljen e subjekteve ekonomike.

Mekanizmi i veprimit të politikës fiskale ka të bëjë me efektet afatgjate të saj siç është ndikimi i saj në zhvillimin dhe rritjen e shpejt ekonomike. Funksioni i shtetit gjithnjë e më shumë po bëhet si ndërmjetësues në zhvillimin ekonomik i cili duhet të kujdeset për krijimin e kushteve të përgjithshme, për ruajtjen e shpejtuar të rritës dhe të zhvillimit ekonomik.

Në vend që të caktoj prioritetet e zhvillimit të ndonjë sektori, veprimtarie apo dege,Republika e Maqedoniosë sot merret me sendërtimin e infrastrukturës themelore, me udhëheqjen e politikës industriale, politikën e zhvillimit regjional si dhe me përparimin e shkencës dhe të arsimit si faktor me rëndësi të zhvillimit që sjellin rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë së vendit në tregun ndërkombëtar të integruar (globalizimi).
Së këndejmi shkalla e zhvillimit të ekonomisë së prodhimit) të shtetit caktohet me sasinë dhe cilësinë e resurseve njerëzore dhe materiale dhe me shkallën e arritur të zhvillimit teknikoteknologjik. Politika fiskale, pra ndikon në shkallën e shpejtuar të rritjes ekonomike aq sa me instrumentet e të hyrave publike dhe të shpenzimeve publike mund të ndikohet në faktorët e lartë.

Politika fiskale, si dhe politika monetare, përbëhet nga një tërësi instrumentash që synojnë ndryshimin e gjëndjes së treguesve makroekonomikë. Politika fiskale shprehet dhe mbështetet në ligjet përkatëse financiare që janë në fuqi në R.e Maqedonisë dhe konsiston në ndërhyrjen e qeverisë për të përballuar shpenzimet e shtetit nëpërmjet administrimit të të ardhurave që mblidhen përmes sistemit fiskal. Një problem tipik dhe mjaft kufizues me të cilin qeveritë ballafaqohen në këtë fushë është evazioni fiskal.
Objektivat e politikës fiskale të qeverisë së Republikës së Maqedonisë mund të jenë të shumtë, por ato fokusohen në bazë të tre funksioneve tradicionale të ndërhyrjes, që shteti bën në sferën ekonomike:
a) funksioni shpërndarës i burimeve të financimit, të nevojshëm për prodhimin e atyre mallrave dhe shërbimeve që tregu i lirë nuk është në gjëndje të furnizojë në mënyrë efektive, përfshirë dhe të mirat publike, si për shëmbull, drejtësia, mbrojtja kombëtare, infrastruktura rrugore, etj;
b) funksioni ri-shpërndarës, që synon ndryshimin e shpërndarjes së të ardhurave e të pasurisë nëpërmjet ndryshimit të taksimit të burimeve të të ardhurave të taksapaguesve;
c) funksioni rregullator i aktivitetit ekonomik nëpërmjet ndryshimit të nivelit të taksimit ose kontrolli i agregatëve makroekonomike.
Klasifikimi sipas funksioneve, është jo vetëm i dobishëm për një analizë sistematike, por ai duhet të mbahet gjithmon në konsideratë, sepse një ndërhyrje në buxhetin e shtetit tëb R.së Maqedonisë prodhon njëkohësisht efekte mbi shpërndarjen e burimeve, mbi ri-shpërndarjen e të ardhurave dhe mbi agregatët makroekonomik.
Të ardhurat fiskale përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave në Republikën e Maqedonisë. Politika fiskale ka për objektiv fillestar të garantojë të hyrat buxhetore minimale. Por nga momenti që vazhdimësia financiare e shtetit është garantuar, shteti vendos objektiva të tjera të politikës fiskale.
Në mënyrë tipike ndeshen dy qëndrime të dallueshme dhe të kundërt në fushën e politikës fiskale, të cilat, varen nga opsionet politike dhe secila ka kufizimet e veta. Nga njëra anë, kemi nje politike fiskale, që mbështetet në detyrimin fiskal krahasimisht të lartë mbi të ardhurat e mëdha, duke favorizuar kështu një ri-shpërndarje të të ardhurave në shoqëri; ana negative e saj qëndron në kufizimin e mjeteve monetare që të "pasurit" mund të shpenzojnë në investime, e si rrjedhim, kjo sjell një kufizim të rritjes ekonomike. Nga ana tjetër, kemi një detyrim fiskal të njëtrajtshëm, që ruan investimet, por me pasoja të mundëshme negative mbi konsumin, pra, mbi klasat e mesme dhe të varfra, të cilat përbëjnë shumicën dërrmuese të konsumatorëve në Maqedoni.
Ulja e të ardhurave të disponueshme ndikon në uljen e kërkesës në treg dhe si rrjedhim kemi një kufizim mbi ofertën dhe rrjedhimisht mbi prodhimin, investimet e mbi vetë rritjen ekonomike.

Pas disa viteve rikuperimi të brishtë nga recesioni global, si grup gjashtë vendeve të Evropës Juglindore (EJL6) – Republika e Maqedonisë,R e Shqipëria, Kosova, Mali i Zi Bosnje dhe Hercegovina dhe Serbia - kanë përjetuar një recesion të dyfishtë, Përkeqësimi i kushteve të jashtme, ndikimi i ashpër në aktivitetin ekonomik, dhe një rritje e vazhdueshme e papunësisë patën efekt negativ mbi konsumin, investimet dhe eksportet. Rimëkëmbja e kreditimit dhe konsolidimi fiskal janë të kërcënuara. Kreditë me probleme – të cilat vetëm disa vite më parë u mendua se po stabilizoheshin - janë përsëri në rritje. Si rezultat, mjedisi, brenda dhe jashtë rajonit, është bërë shumë më i vështirë për tu menaxhuar, dhe kompensimet e politikave ekonomike të nevojshme për të stabilizuar ekonomitë dhe ringjallur rritjen ekonomike janë më të ashpra.

Është bërë gjithashtu e qartë se edhe në rrethanat më të mira, rruga për rimëkëmbjen e qëndrueshme do të jetë e vështirë: rritja në vitin 2014 tani pritet të jetë mesatarisht 1.6 për qind dhe rreziqet mund të jenë tepër të mëdha. Retë në horizontin e vitit 2013 janë ndikimi global i "greminës fiskale" të SHBA, rimëkëmbja e lëkundur e Eurozonës dhe çmimet e larta të lëndëve të para - rreziqe ndaj të cilave të gjitha vendet e EJL6 janë shumë të prekshme. Gjithashtu shqetësuese për popullsinë e rajonit do të jetë rreziku 1i një goditje të re të çmimeve të ushqimit, që mund të përkeqësojnë varfërinë dhe të ushtrojnë presion mbi shtresën e mesme.

Në këtë situatë të brishtë, Maqedonia, Shqipëria dhe në veçanti Mali i Zi do të duhet të vazhdojnë reduktimin e deficiteve fiskale dhe reduktimin e borxhit, në të njëjtën kohë që duhet të vazhdojnë të përmirësojnë klimën e investimeve dhe të reformojnë tregjet e punës dhe sektorin publik. Në të gjitha vendet e ballkanit, pagesat e borxhit të sektorit publik përbëjnë një sfidë të veçantë për menaxhimin fiskal dhe për sektorin privat, ndërkohë që ka ende reforma strukturore të tjera të papërfunduara. Pas dy vitesh krize të thellë dhe një rimëkëmbje të ngadaltë, me një papunësi dhe varfëri në rritje, dhe një recesioni në vazhdim – me gjithë përpjekjet më të mira për konsolidim fiskal dhe reforma strukturore, të cilat duhet të vazhdojnë - ekziston rreziku që vendet EJL6 të jenë futur në një rreth vicioz që përforcon ciklin e shtrëngimit afatgjatë, të rritjes ekonomike të ulët ose dhe negative, të borxhit të lartë, madje dhe të rreziqeve më të larta të trazirave sociale. Për të shmangur këtë, në këtë raport argumentohet se qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe qeverit e vendeve të rajonit duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të përshpejtuar reformat fiskale dhe strukturore. Këto vende e kanë konsumuar tërësisht hapësirën e tyre fiskale dhe i kanë reduktuar investimet publike (përveç Kosovës, që përbën një përjashtim) në një fraksion të asaj që nevojitet për të ruajtur stokun e kapitalit publik në infrastrukturën bazë. Investimet private janë tkurrur nga mungesa e investimeve publike plotësuese produktive, rimëkëmbja e ngadaltë e kreditimit dhe kërkesa e ulët e brendshme. Kërkesa e jashtme është minimale, dhe eksportet janë jo vetëm të ulëta, por ato pengohen për tu bërë motor i shpejtë i ri i rritjes ekonomike nga probleme të infrastrukturës, financave, dhe mangësi të tjera.

Ky raport argumenton se është e nevojshme para së gjithash të ndiqet një politikë më intensive reformash për të reduktuar borxhin publik dhe të përshpejtohen reformat strukturore, veçanërisht në qeverisjen e sektorit publik, klimën e investimeve, dhe tregjet e punës. Republika e Maqedonisë dhe vendet e rajonit duhet të përgatiten dhe për goditje të reja çmimesh të ushqimit, duke pasur parasysh prekshmërinë e tyre.

Nëse këto reforma të përshpejtuara materializohen, atëherë mbështetja e jashtme – e koordinuar mirë dhe e fokusuar për rajonin si një të tërë, jo thjesht për vende të veçanta – nga BE dhe institucionet financiare ndërkombëtare (IFI) mund të ndihmojë në lehtësimin e tranzicionit drejt një rritje më të qëndrueshme në periudhën afat mesme.

Në Nëntor të vitit 2012, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore njoftuan financimin e 30 miliard euro për vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore gjatë dy viteve të ardhshme. Për vendet e EJL6, kjo iniciativë që vjen në kohën e duhur ka të ngjarë të zbatohet nëpërmjet Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor(ËBIF), si dhe burime të tjera të IFI. Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) është gjithashtu i rëndësishëm sidomos për reformat institucionale dhe zhvillimin rural. Nëpërmjet fokusimit të saj në infrastrukturën me rëndësisë rajonale (hekurudha, autostrada, energji, dhe gaz) dhe në vendet e punës dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, eficienca e investimeve, rritja ekonomike dhe punësimi mund të zgjerohen ndjeshëm.
Megjithatë, financimi shtesë për rritje ekonomike dhe vende pune mund të jetë efektiv vetëm nëse shoqërohet me reforma të intensifikuara fiskale dhe strukturore.

Politika fiskale—deficite dhe borxhet shtetërore

Pas përmirësimit të gjendjes në vitin 2010 dhe 2011, situata fiskale në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet e rajonit u dobësua në mënyrë të konsiderueshme në gjysmën e parë të vitit 2012, pasi recesioni i dytë ndikoi në buxhetet qeveritare. Deficiti fiskal mesatar i vendeve të EJL6 u përmirësua nga -3,9 për qind e PBB në 2010 në -3,1 për qind në vitin 2011, pjesërisht për shkak se rritja ekonomike filloi të rimëkëmbej. Duke pritur që kjo prirje të vazhdonte në vitin 2012, qeveritë vepruan bazuar në supozime disi optimiste të të ardhurave.
Megjithatë, rritja u ngadalësua në të gjithë rajonin në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe u bë negative në gjysmën e parë të vitit 2012 në mes të trazirave të vazhdueshme në Eurozonë, të shoqëruara nga një dimër i ashpër që ka zvogëluar ndjeshëm aktivitetin ekonomik. Me rritjen e ngadalshme dhe buxhetimin optimist, të ardhurat nuk u realizuan në një masë të konsiderueshme; deficitet po rriten përsëri në shumicën e vendeve.
Duke përdorur tashmë një pjesë të konsiderueshme të financimit të tyre të vitit 2012, shumë qeveri do ta kenë të vështirë të përmbushin objektivat e rishikuara të tyre të deficitit për vitin 2014. Për shembull, si Serbia dhe Maqedonia kishin përdorur deri në Gusht rreth 75 për qind të të ardhurave të planifikuara për vitin 2013. Prandaj, deficitet ka të ngjarë të jenë më të larta se sa pritej.

Megjithëse Republika e Maqedonisë dhe vendet e rajonit kanë zbatuar politika fiskale kundërciklike për gjatë një periudhe më të gjatë, suficitet ishin shumë të vogla për të krijuar hapësirë manovrimi gjatë një krize të zgjatur. Pas vitit 2000, balanca fiskale strukturore përgjithësisht ka lëvizur në përputhje me rritjen ekonomike. Gjatë periudhës së rritjes më të madhe (2005-07), vendet e EJL6 mesatarisht kishin suficite (megjithëse në retrospektivë ato nuk ishin asnjëherë të mëdha sa duhej - sidomos në Mal të Zi, i cili përjetoi edhe bumin më të madh por edhe dështimin më të keq) dhe më pas, në 2008, kaluan në deficite për shkak të goditjeve të efekteve të krizës ekonomike. Problemi ishte se vendet në rajon nuk krijuan burime të mjaftueshme gjatë bumit ekonomik për të financuar deficitet e zgjatura gjatë krizës.
Në të vërtetë, pavarësisht nga rritja mesatare prej rreth 3.8 për qind në vitet 2000, ato kishin deficite strukturore mesatarisht mbi 1 për qind të PBB. Disa politika fiskale kundërciklike ishin më të suksesshme se të tjerat. Maqedonia,Kosova, Mali i Zi, dhe në një masë më të vogël Bosnja kishin teprica fiskale në bazë strukturore gjatë zgjerimit. Megjithatë, pavarësisht rritjes së fortë ekonomike Shqipëria dhe Serbia kishin deficite.
Me tregtinë dhe kërkesën e brendshme në nivele të ulëta, përqindja e të ardhurave fiskale ndaj PBB u zvogëlua në shumicën e vendeve të EJL6 në gjysmën e parë të vitit 2012 në krahasim me vitin 2011. Deri më tani në vitin 2013, të ardhurat janë më të ulëta se sa në njëjtën periudhë e vitit të kaluar me një mesatare prej 0.6 për qind të PBB-së në Maqedoni, Shqipëri, dhe Serbi.

Aktiviteti i ngadalësuar ekonomik ka goditur rëndë veçanërisht disa burime të të ardhurave,në Maqedoni , mbledhja e tatimit mbi fitimin është reduktuar, të ardhurat nga TVSH janë zvogëluar. Për shkak të problemeve në tregun e punës, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë reduktuar në Maqedoni. Përveç të ardhurave të ulëta aktuale në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, Republika e Maqedonisë ka realizuar të ardhura më të ulëta se ato të parashikuara në buxhet.
Shpenzimet në R e Maqedonisë janë rritur, për arsye të ndryshme,shpenzimet korrente janë rritur në shtatë muajt e parë të vitit 2013, të udhëhequra nga përfitimet e sigurimeve shoqërore. Në Maqedoni, ulja në shpenzime kapitale ka kompenusar pjesërisht ose plotësisht rritjen e shpenzimeve korrente. Megjithatë, ndryshe nga vendet e tjera të EJL6, shpenzimet kapitale të Maqedonisë u rritën me gati 25 për qind, kryesisht për projekte të kapitale.

Shumica e vendeve të EJL6, edhe pse me kohë të ndryshme, kanë njohur nevojën për të zgjidhur problemet fiskale në mënyrë të drejtpërdrejtë me përpjekjet për të rritur të ardhurat dhe zvogëluar shpenzimet.

Për shkak të aktivitetit të dobët dhe buxheteve nën presion,Republika e Maqedonisë dhe shumica e vendeve në rajon kanë pësuar rritje të pagesave të prapambetura për rimbursimet e taksave dhe pagesave të prapambetura qeveritare që nga viti 2008. Pagesat e prapambetura krijohen kur pagesat nuk kryhen brenda një periudhe të arsyeshme pas mbarimit të afatit të tyre. Megjithatë, përkufizimi i pagesave të prapambetura mund të ndryshojë në varësi të vendit dhe llojit të faturës. Stoku i pagesave të prapambetura është i vështirë për t'u matur me saktësi, por në Ballkanin Perëndimor ai vlerësohet mesatarisht 1–3.5 për qind e PBB të kombinuar.

Për rrjedhojë, të ardhurat e pakta dhe fluksi i shtrënguar i parasë e ka shtyrë qeverinë e Republikës së Maqedonisë të zgjasin periudhat e pagimit dhe të vonojnë pagesat, gjë e cila natyrisht vë në lëvizje një reaksion zinxhir të mospagimit nga ana e furnizuesve privatë e për rrjedhojë një shterim të likuiditetit në një ekonomi tashmë në vështirësi. Në disa raste bizneset janë inkurajuar që të shtyjnë paraqitjen e faturave për punën e kryer, ose qeveritë kanë lehtësuar kërkesat për regjistrimin e detyrimeve, në mënyrë që të mbulohet shtrirja e plotë e detyrimeve të pagesës. Ndikim ka patur dhe sjellja e agjentëve ekonomik: disa kompani private, të cilave u detyrohet sektori publik, janë të detyruara të shmangin taksat për të qëndruar në biznes. Në raste ekstreme, pagesat e prapambetura mund të çojnë në një kolaps total të disiplinës së pagesave,

Shkaqet për krijimin e pagesave të prapambetura janë komplekse dhe ndryshojnë sipas vendeve, por ndikimi i tyre mund të jetë i dëmshëm në disiplinën financiare, likuiditetet dhe veprimtarinë ekonomike. Një nga arsyet kryesore për pagesat e prapambetura kanë qenë parashikimet tepër optimiste të të ardhurave që çuan në shpenzime të cilat nuk mund të mbulohen nga të ardhurat e mbledhura. Rritja e pagesave të prapambetura mund të lehtësojë përkohësisht fluksin e parasë për qeveritë, por ndikimet janë shumë më të gjera dhe në fund pagesat duhet të kryhen. Vonesat në pagesat e qeverisë kanë efekt të drejtpërdrejtë negativ në konsum, punësim dhe investime, sepse njerëzit të cilët kanë kryer furnizimin e mallrave dhe shërbimeve nuk kanë marrë fondet që u duhen për të paguar faturat dhe për të vazhduar bizneset e tyre. Situata ekonomike e bën këtë edhe më të vështirë për shkak se bizneset nuk mund të marrin hua për të marrë paratë e nevojshme për të paguar pagat dhe furnizuesit e tyre. Faturat e papaguara gjithashtu ndikojnë në gatishmërinë dhe aftësinë e tyre për të investuar në rritjen dhe zgjerimin e biznesit. Në periudhë afatmesme, furnizuesit e qeverisë do të rrisin çmimet ose do të kërkojnë të para-paguhen nëse ata mendojnë se nuk do të paguhen brenda një kohe të arsyeshme. Disa firma do të ndërpresin ofertat për kontratat qeveritare, e cila do të reduktojë konkurrencën dhe vlerën e parasë.

Është me rëndësi jetike që qeveria e Republikës së Maqedonisë të veprojnë shpejt për adresimin e pagesave të prapambetura kur ato janë ende të menaxhueshme. Nëse rriten në mënyrë të pakontrolluar, pagesat e prapambetura mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë fiskale dhe besueshmërinë kredimarrëse të vendit në mënyrë të pariparueshme. Disa rritje në deficit – nëse janë të financueshme –do të ishin të justifikuara nëse përfshijnë një plan kohor për eliminimin e pagesave të prapambetura. Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë duhet të monitorojë nga afër detyrimet dhe pagesat për të garantuar që njësitë buxhetore respektojnë afatet e pagesave dhe nuk kompensojnë reduktimin e pagesave të prapambetura duke shkaktuar detyrime të reja të pakontrollueshme.

Republika e Maqedonis pretendon se është brenda niveleve të qëndrueshme të borxhit publik. Borxhi publik në Maqedoni është i moderuar - rreth 30 për qind e PBB,sipas të dhënave të publikuara.

Në Republikën e Maqedonisë rifinancimi i borxhit – sidomos ai me probleme afat-shkurtra – do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në kërkesat e financimit bruto. Deri tani,Republika e Maqedonisë ka qenë në gjendje të rinovojnë borxhin e saj, por nëse ai rinovim do mund të vazhdojnë varet nga besimi i tregut. Këto ulje mund të pengojnë daljen në tregje për financimin e deficitit. Vlerësimet mund të ulen më tej nëse materializohen rreziqet aktuale të qëndrueshmërisë fiskale dhe të borxhit.

Së fundi, nga periudha afatshkurtër deri në atë afatmesme Republika e Maqedonisë përballet me rreziqe të mëdha, të brendshme dhe të jashtme, që mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë fiskale. Rreziqet e jashtme janë të lidhura me rritjen e dobët ekonomike në Maqedoni dhe në pasigurinë e sektorit financiar në mbarë botën. Përhapja e vazhdueshme e efekteve (nëpërmjet kërkesës për eksporte ose gërryerjes të besimit të biznesit) nga një Eurozonë me performancë të dobët ka të ngjarë se do të ushtrojë presion të mëtejshëm për rënie të të ardhurave dhe të kërkojë rregullime ekuivalente të shpenzimeve. Ankthi i tregjeve financiare mund të bëjnë të vështirë ose të kushtueshëm sigurimin e fondet të nevojshme për të financuar deficitet e qeverive. Rreziqet e brendshme janë kryesisht politike. Ata reduktohen nëpërmjet mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve gjatë cikleve zgjedhore në Maqedoni.

Konkluzionet

1. Reforma të Tregut të Punës: Papunësia e rëndë dhe e vazhdueshme, veçanërisht në radhët e grupeve të prekshme, kërkon reforma të guximshme të tregut të punës në Republikën e Maqedonisë. Bërja e kushteve të tregut më fleksibël do të ndihmojë që të zgjidhen ngurtësitë strukturore në tregjet e punës.
2. Reformat arsimore: Reformat për përmirësimin e cilësisë së arsimit të mesëm dhe të lartë, trajtimin e mospërputhjes së aftësive dhe rritja e "fleksigurisë" (kombinimi i fleksibilitetit dhe sigurisë) së tregut të punës janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve të fuqisë punëtore por do të kërkojnë kohë.
3. Integrimi i tregtisë, mjedisi i biznesit dhe konkurrenca: Thjeshtëzimi i rregullave të biznesit, trajtimi i problemeve të qeverisjes dhe zbatimi i kontratave dhe të drejtave të pronësisë janë fusha ku Republika e Maqedonisë mund të zbatojnë reforma për rezultate të shpejta. Rajoni gjithashtu mund të përfitojë nga harmonizimi i rregulloreve përtej kufijve dhe thellimi i integrimit tregtar dhe financiar. Hapja e tregjeve dhe mundësive për zhvillimin e biznesit -- p.sh., nëpërmjet privatizimit dhe në monopolet e rregulluara tradicionalisht si energjia, elektriciteti dhe hekurudha -- janë ndërmjet fushave ku nevojiten përpjekje të përbashkëta.
4. Rrjetat e sigurisë sociale dhe përfshirja sociale: Përtej ofrimit të një rrjete sigurie për të papunët në kohë krize, asistenca sociale mund të bëhet më efiçente duke

targetuar më mirë grupet, duhet të shmangë krijimin e një kurthi varfërie. Politikat e aktivizimit në kombinim me asistencën e targetuar sociale duhet të parandalojnë që papunësia e përkohshme të zhvillohet në një varësi afatgjatë. Asistenca sociale e mirë-projektuar dhe e mirë-ofruar mund të rrisë stimujt që njerëzit të punojnë.

5. Për të mbështetur këto reforma të intensifikuara,Republika e Maqedonisë mund të përfitojnë nga financimi i jashtëm për rritje ekonomike, infrastrukturë dhe vende pune.
6. Problemet ekonomike me të cilat po ballafaqohet eurozona dhe ekonomitë e vendeve të rajonit, nuk do të reflektohen në zhvlerësimin e valutës së Maqedonisë. Denari si valutë kombëtare do të mbetet stabil sepse garanci janë rezervat në deviza, që janë në nivelin më të lartë historik, prej rreth 3 miliardë eurosh.
7. Banka Qendrore e Republikës së Maqedonisë mbetet konsekuente politikës së kursit stabil të denarit ndaj euros dhe mbajtjes së inflacionit në nivel të ulët në krahasim me inflacionin në eurozonë.
8. Vlerësohet se mbajtja e stabilitetit të valutës kombëtare ka edhe çmimin e vet. “Politika fiskale dhe monetare do të duhet të harmonizohet në kahje restriktive. Shkalla e kamatave do të jetë relativisht e lartë, kjo mundëson stabilitetin e denarit por në mënyrë indirekte, ekonomia do të ndjejë pasojat e kësaj politike”.
9. Sipas analizave të shumta ekonomia e Republikës së Maqedonisë nuk do të jetë imune ndaj zhvillimeve të jashtme, dhe është e nevojshme që qeveria të ndërmarrë masa të përshtatshme për qetësimin e situatës.

Literatura:

1. Enti shtetëror I statistikës së RM-së(2007,2008,2009,2010,2011,2012)
2. Financat Publike-Prof.Dr.Sabahudin Komoni,Prishtinë,2008
3. Goran Kvrgic”Finansisko Trziste” Beograd 2011
4. Krimi Ekonomik,Sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri,Kosovë dhe Maqedoni përballë krimit ekonomik-Iljasa Salihu,Shkup 2012.
5. Kriza Financiare,Prof.Dr.Adrian Civisi,Tiranë 2010
6. Opservatori për MPPS në Maqedoni(2004,2005,2006),
7. Raporti vjetor për 2007,2008,2009,2010.2011,2012 Shkup,

MSc Anila Medja[157]
MSc Suzana Taipoviq[158]
Universiteti "Luigj Gurakiqi" Shkodër,
Master Shkencorë " Turizëm i Qëndrueshëm" .

32 Impaktet e festivaleve dhe eventeve në Shkodër & Ulqin

Fjalët kyçe: *Turizmi i Eventeve dhe Festivaleve, Impakte ekomomike, Tipet e eventeve, Sezonalitet, Komuniteti pritës.*

Project Description
Events and festivals are an important element of the tourism offering, and an opportunity to increase tourist flows and offer a variety of entertainment opportunities for local residents and tourists, even outside seasonal tourism.
In the Adriatic area, there are different events that attract thousands of people and, in turn, have a positive impact on the local economy.
The project aims to create a network of events and festivals with a low impact on the environment. The assumption is to develop a infrastructure to match environmental and tourist indicators with a new method for communities' involvement and good practice solutions in the organization and management of events/festivals.
In this study we will look at the basic principles of the impact of events in the economy and society, specifying the needs of Shkodra and Ulcinjregion.
This study concludes that festivals and events have a greater impact multiple in domestic economy than budget with which it operates, and therefore municipalities and the government of Montenegro and Albania should create conditions for the functioning of such organizations which have the potential to turn small investments into huge benefits for the local economy.

Metodologjia
Për shkak të informalitetit të vogel i cili ekziston në Ulqin & Shkodër, matja e saktë e impaktit ekonomik dhe qarkullimit të parasë në një periudhë të caktuar kohore është e vështirë. Të vetëdijshëm për këtë, është përpiluar një pyetësor i cili është plotësuar nga 100 pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Bashkia Shkodër dhe Komuna Ulqin.
Mostra e anketuesve prej 100 vizitorësh është 1/11 standarte e vizitorëve total të Festivaleve dhe Evenimenteve, gjë që konsiderohet si një mostër gjithëpërfshirëse dhe e pranuar. Hulumtimi është bërë me vizitor rezident dhe jorezident dhe ka zgjatur 3 ditë.
Përmes pyetësorit janë kërkuar të dhëna specifike për çdo respondent sikurse shuma e shpenzuar për ushqim dhe pije, bujtinë, transport si dhe shpenzime të tjera, pritshmritë e evenimentit etj.
Analiza bazohet në të dhënat zyrtare të ofruara nga organizatorët e festivaleve dhe evenimentevezyrtare dhe nxjerrin në pah se festivalet & evenimentet jo vetëm që kanë një impakt të madh për jetën kulturore, ato kanë edhe një ndikim të madh dhe të shumanshëm për ekonominë e vendit. Përfitues të drejtpërdrejtë nga Festivalet dhe Evenimentet janë bizneset lokale në keto qytete në veçanti dhe rajoneve të tyre rurale në përgjithësi, si: kafe-baret, restorantet, shitësit ambulant, hotelet, qiradhënësit, etj., por edhe bizneset në nivel kombëtar, si avio-kompanitë, agjensitë turistike, bankat apo kompanitë e telekomunikacionit.

[157] E-mail address: medjaanila@yahoo.com
[158] E-mail address: suzanataipi@yahoo.com

Hyrja

Turizmi i Eventeve dhe Festivaleve është një ndër format e turizmit që në ditët e sotme tregon rritjen me te shpejte, duke u bërë gjithnjë e më popullor në zona të ndryshme si një mjet për të rigjallëruar ekonomitë rajonale.

Avancimi i teknologjive, ndryshimet klimaterike (dmth rritje të thatësirave dhe përmbytjeve / stuhive), karakteret sezonale, nevoja për punësim dhe të ardhura shtesë kanë sjellë nevojën për diversifikimin e industrisë, nga format tradicionale të turizmit, duke u fokusuar në trende të reja të turizmit për terheqjen e sgmenteve te reja të konsumatorve.

Eventet dhe festivalet janë përdorur me sukses të madh në shumë fusha si një mjet për të tërhequr njerëzit në rajonet në të cilat tradicionalisht kanë një apel turistik sezonal. Evenimentet post sezonale në rajon në kohët ë fundit janë një shembull i praktikave më të mira, duke u bërë gjithnjë e më popullor në mesin e turistëve, duke injektuar të ardhura shtesë në rajon dhe duke hapur oportunitete në një kohë që turizmi i karakterit sezonal shkon drejt fundit.

Ky ekspozim shtesë vepron si një formë indirekte e marketingut për rajonin në tërësi, duke ofruar një mundësi për të arritur një treg të pashfrytëzuar më përpara,sic është në rastin e Shkodrës & Ulqinit. Këto segmente të konsumatrorëve të rinj në turizmin e eventeve dhe festivaleve sjellin me vete para të reja, zgjerimin e mëtejshëm të tregut dhe më pas si rrjedhojë rrisin potencialin e të ardhurave në gjenerata. Është gjithashtu e rëndësishme për të njohur se eventet dhe festivalet janë atraksionet që kanë tërheqjen e pushtetit dhe që mbajnë pushtetin. Kjo do të thotë se ata jo vetëm sjellin vizitorë të rinj, por ato gjithashtu ndihmojnë për të mbajtur vizitorët në rajon në periudha më të gjata.

Duhet të theksohet gjithashtu se vlerësimi i ndikimit ekonomik nuk duhet të jetë përgjegjës vetëm për të vlerësuar suksesin e një eventi apo festival , por edhe vëmendje shtesë mund të fitohet nga rajoni pritës si rezultat i drejtpërdrejtë i eventit / festivalit që do të mund të mbledh përfitime shumë më të madha ekonomike në të ardhmen si rezultat i ekspozimit të rritur.

Ky studim synon bizneset, organizatorët e eventeve dhe organizatat rajonale ose lokale të turizmit që janë angazhuar më parë në kërkime për impaktet ekonomike të eventeve.

1.Punimi

Eventet variojnë nga evente lokale të bazuara në komunitet (p.sh. artit dhe vepra artizanale), të evente të mëdha (p.sh. Festivalin Kombëtar Folklorik), dhe ato që janë klasifikuar mega-evente. Si përmasat e këtyre eventeve rriten në mënyrë për të bërë pjesëmarrjen më të madhe, mbulimin nga media, kostot e mundshme dhe përfitimet, duke përfshirë dhe impaktet ekonomike.

Për më tepër, natyra e eventeve mund të ndryshojnë për shkak të numrit të mjediseve(vendeve) të përdorura gjatë eventit. Eventet mund të jenë të gjitha të përfshira në një ose mbahen në shumë vende në të gjithë rajonin psh. Ndërlidhhja e eventeve dhe festivaleve Shkodër &Ulqin. Eventet e shumëfishta janë më të vështira për tu vlerësuar sepse mosta dhe zona e studimit janë më të mëdha, dhe ënshtë shpesh një shans i numërimit të të njëjtit vizitori shumë herë.

Një kornizë për kategorizimin e eventeve është e dobishme për të përcaktuar mangësitë strategjike nëpërmjet identifikimit të eventeve të ndryshme, kohën e tyre, vendndodhjen dhe temat. Ajo është gjithashtu e dobishme për të klasifikuar eventet për të vlerësuar performancën ekonomike në përshtatje të tilla si koha e eventit (nëse zhvillohet në vjeshtë apo në dimër), vendndodhjen e saj (nëse është në Shkodër apo Ulqin), ose temat e tyre (nëse është një event sportiv, kulturor, agrikulturor, artizanat, një event muzikor etj).

Jago dhe McArdle (1999) paraqesin një kornizë që merr parasysh aspektet e përkohshme si koha, aspektet hapësinore apo vendore dhe aspektet tematike të eventeve në mënyrë për ti kategorizuar ato. Kjo kornizë është paraqitur në Figurën 1.

Figure 1 – Tipet e Eventeve



[Burimi: Jago & McArdle, 1999:7]

Identifikimi i secilit prej këtyre aspekteve janë të rëndësishme kur konsideron vlerën e përgjithshme të një eventi në komunitetin pritës. Implikimet hapësinore e një eventi përfshijnë jo vetëm përfitime të dukshme dhe kufizimet ndaj qytetit / rajonit pritës, por edhe emërtimin e eventit si psh: me emrat e qyteteve. Titulli i një eventi duhet të reflektojnë saktësisht rajonin pritës apo rajonin furnizues (p.sh. Konkurimet shtetërore) për të siguruar njohje për të gjithë të përfshirët.

Evente dhe festivale që zhvillohen gjatë vitit 2014 në qytetin e Shkodrës janë: Bilbilat e vegjel të Shkodrës këndojnë, Çmimi Pjetër Gaci" teatri "Migjeni".Eskpozita me tema të ndryshme nga Galeria e arteve, Dita ndërkombëtare e librit, aktivitete letrare, ekspozita, takime Kampionatet pranverore, basketboll, volejboll, minifutboll, Dita e Luleve, Festivali i 52-të mbarëkombëtar i këngës për fëmijë, Koncerte me tema të ndryshme, Dita e Liqenit, aktivitete promovuese me qender në Shirokë, Festivali i muzikës moderne, Aktivitet sportiv 3-garësh "Triathlone Labeat", në Shirokë, Aktivitete në kuadër të ditës botërore të turizmit, Festivali letrar i Shkodrës, "Dita e lumturimit te Nënë Terezës", Kampionati i vrapimit në natyrë, aktivitete me rastin e festave të nëntorit,Dita e poezisë për fëmijë, çmimi "Miku i librit", Mbrëmje tradicionale e vitit të ri, 30 dhjetor, Aktivitete me rastin e festave te fundvitit, në sheshet e qytetit etj. [Burimi: Bashkia Shkodër, 2014]

Në qytetin e Ulqinit zhvillohen këto tipe të eventeve dhe festivaleve: Moto Meeting (Safari beach), Kite Surf (gara ne plazhin Kite Surf Dolcinium), Southern soul festival Montenegro, Old timer fest, Panairi ndërkombëtar të librit, Dita e Shegës dhe skena verore. [Burimi: Organizata Turistike Ulqin, 2014]

Shkalla e një eventi ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me shkallën e impakteve që rezultojnë nga eventi, shkalla e impakteve (të tilla si numri i të pranishëmve, profili i medias, infrastrukturës, kostot dhe përfitimet) të rritet së bashku me shkallën e eventit. [Burimi: McDonnell et. al 1999:10]

Kërkime të bëra më përpara kanë treguar një tendencë që pjesëmarrsit në evente mund të japin shpenzimin më të madh për person sesa një spektator i eventeve. Për këtë arsye, ndikimi ekonomik i eventeve mund të ndryshojnë për shkak të llojit të eventit të zhvilluar dhe tregut të synuar për ketë event.

Fluksi pozitiv i të ardhurave në një rajon nuk duhet të jetë faktor i vetëm i marrë parasysh gjatë përcaktimit të suksesit të një eventi.

Ndikimet negative sociale të një eventi mund të bëjë një dëm të madh në të ardhmen e një eventi në rajonin e tij bazë, dhe ndikimet ekologjike mund të shkaktojë vdekjen e parakohshme të një eventi apo festivali të menaxhuar keq.
Në anën tjetër, ka shumë ndikime të tjera pozitive që mund të kundërshtojnë ndikimet negative ekonomike. Një ngjarje që hap sezonalitetin e turizmit në rajon dhe në mënyrë të barabartë shpërndan rrjedhën e parave në një rajon, duke rritur mundësitë për punësim me kohë të plotë. Hapja e më shumë vende pune me kohë të plotë në një rajon shkakton shumë impakte pozitive dhe përmirësim të mirëqëënies sociale në atë rajon.
Efektet e tjera pozitive dhe negative janë të përshkruara në Tabelën 1, dhe duhet të merren parasysh në vlerësimin e impaktit ekonomik. Për më tepër, këto ndikime ndryshojnë për shkak të madhësisë dhe përmasave të eventit duke filluar nga një event lokal bazuar në komunitet si një shfaqje arti, në një mega-event të tilla si Lojërat Olimpike.
Tabela 1 – Impaktet e mundshme që rezultojnë nga eventet POSITIVE & NEGATIVE

Tipi i impakteve	**Pozitive**	**Negative**
Ekonomike	-Rritja e shpenzimeve -Krijimi i punësimit -Rritja e ofertës së punës -Rritja e nivelit të jetesës	-Rritjet e çmimeve gjatë eventeve -Spekulime të pasurive të patundshme -Dështimi për të tërhequr turistët -Investime më të mira alternative -Kapitali joadekuat në vlerësimin e kostove të eventit
Turizëm/ reklamë	-Rritja e ndërgjegjësimit të rajonit si destinacion udhëtimi turistik -Rritja e njohurive në lidhje me potencialin për investime dhe aktivitet tregtar në rajon -Krijimi akomodimeve dhe atraksioneve të reja turistike -Rritja e aksesit	-Përvetësimi i një reputacion të varfër si rezultat i objektivave joadekuate, praktikave të parregullta ose çmime të fryra -Reagimet negative nga ndërmarrjet ekzistuese për shkak të mundësisë së konkurrencës të re për fuqi punëtore dhe ndihmës së qeverisjes vendore
Fizik / Mjedisorë	-Ndërtimi i objektivave të reja -Përmirësimi i infrastrukturës lokale -Ruajtja e trashëgimisë	-Dëme ekologjike -Ndryshimet në proceset natyrore -Ndotja arkitektonike -Shkatërrimi i trashëgimisë -Mbipopullimi
Social/ Kulturor	-Rritja e nivelit të përhershëm të interesit lokal dhe pjesëmarrjen në llojet e veprimtarisë lidhur me eventet	-Komercializimi i aktiviteteve të cilat mund të jenë të natyrës personale ose private -Ndryshimi i natyrës së eventit ose aktivitetit të

	-Forcimi i vlerave dhe traditave rajonale	akomodimit të turizmit -Rritja e mundshme në krim -Ndryshimet në strukturën e komunitetit, zhvendosje sociale.
Psikologjikë	-Rritja e krenarisë lokale dhe shpirt të komunitetit -Rritja e ndërgjegjësimit të perceptimeve jo-vendore	-Tendencë drejt qëndrimeve mbrojtëse në lidhje me rajonin pritës -Shoku kulturor -Keqkuptimet çojnë në shkallë të ndryshme të armiqësisë pritës / vizitor
Politik/ Administrativ	-Rritet njohuria ndërkombëtar të rajonit dhe vlerave -Zhvillimi i aftësive midis planifikuesve	-Shfrytëzimi ekonomik i popullatës lokale për të kënaqur ambiciet e elitës politike -Shtrembërimi i natyrës së vërtetë të eventit për të reflektuar vlerat elite -Dështimi për të përballur -Paaftësia për të arritur qëllimet -Rritja në shpenzimet administrative -Përdorimi i evneteve për vendimet legjitime jo popullore -Legjitimimi i ideologjisë dhe realitetit socio-kulturor

[Burimi: Hall 1992: 8]

Faktorë të tjerë që mund të kontribuojnë në një event të suksesshëm mund të përfshijnë:

• Rritja në kohëzgjatjen e qëndrimit të vizitorëve në rajon / qytet;
• Rritja e shpenzimeve vizitor në rajon / qytet;
• Përmirësimi i vetëdijes për destinacionin; dhe
• Rritja e krenarisë qytetare apo solidaritetin e komunitetit.

Këta faktorë janë të gjithë të qartë e të dobishme për një rajon dhe industrinë e saj të turizmit, edhe pse kostoja në të cilën ata janë marrë duhet të arsyetohet.

2.Observime

Janë shqyrtuar 4 lloje të eventeve turistike: festivale popullore dhe festat (46,7%) Panairet dhe ekspozita (tregti) (39,5%) Evenimentet kulturore (7,7%) Konferenca (6%).



Tregohet një dominim të eventeve me një komponent të fortë të traditës dhe kulturës popullore, që do të merren parasysh kur vlerësohet impaktete ekonomike që rrjedhin nga turizmi i disa prej këtyre eventeve dhe festivaleve.

Ngurtësia në agjendat nënkupton mungesën e fleksibilitetit për datën eventit. Është gjithashtu e rëndësishme për t'u marrë parasysh se datat lehtësojnë për të ofruar aktivitete jashtë sezonit të pikut (sezonin e ulët dhe të mesëm).
Rëndësishme që të komentohet është heterogjeniteti i motiveve ekzistuese që mund të përdoren për të krijuar një ofertë me larmi të madhe të eventeve të reja. Ndonëse disa evente të tjera të ndihmojë për të ofruar aktivitete jashtë sezonit të lartë (evente të gastronomisë) dhe të tjera, janë të kufizuara në data të jo te caktuara kalendarike.
Në 10 vitet e fundit janë krijuar evente të reja. Brezi i evente të reja i përgjigjet nevojës për të rritur ofertën ekzistuese të kohës së lirë dhe ripërcaktimin e ofertës turistike. Rritja e ofertës së eventeve përbën disa dyshime mbi qëndrueshmërinë e këtyre eventeve në kontekst të resurseve dhe pamjaftueshmërisë së kompetencave.
Prania mesatare e turistëve është në mes të moderuar dhe të ulët, në varësi të rajonit. Asistentët kryesore janë lokale (74% e eventeve mbi 50% janë komuniteti lokal). Në rajonet e brendshme turistët janë të pakët, ndërsa në destinacione bregdetare janë më të frekuentuara sidomos Velipoja dhe bregdeti i Ulqinit, ku impakti i perceptuar i eventeve në industrinë turistike është i lartë.

3.Konkluzione

Turizmit të Eventeve & Festivaleve kontribuon për të krijuar një imazh të favorshëm, për të zgjeruar sezonin tradicional të turizmit, për të përhapur kërkesën e turizmit në mënyrë të barabartë, për të tërhequr vizitorët vendas dhe të huaj.
Përfitimet e eventeve dhe festivaleve në Shkodër & Ulqin do të kontribuonin në shqyrtimin e pabarazive historike të së kaluarës, krijimin e një imazhi të favorshëm, përcakton destinacionin si një atraksion turistik,thërheq vizita të përsëritura, krijon përparësi konkurruese globale, dhe krenari në komunitetin lokal.
Prioritet duket të jetë qëllimi kulturor dhe turistike për organizatorët. Shkodra & Ulqini janë duke ofruar llojin e eventeve që më mirë përputhet me nevojat e turistëve për argëtim dhe për t'ia kaluar mire kohën e tyre të lirë duke ndërthurur edhe nevoja e komunitetit pritës për evente.
Temat e eventeve më shumë janë të traditave popullore dhe festivale. Ka një rrezik për të ndjekur trendet e reja të tregut duke ofruar risi që ndikon në humbjën e autenticitetit. Rajonet bregdetare bëjnë një përjashtim si organizatorët e eventeve turistike, sepse kjo do të thotë një avantazh konkurrues dhe mund të supozoj një inovacion. Në rajonet bregdetare eventet kanë një orientim të fuqishëm turistik.
Identiteti lokal është i rëndësishëm në eventet e këtyre 2 qyteteve në shqyrtim për shkak të një nivel i lartë i përfshirjes së komunitetit. Eventet ndihmojë për një kohezionit social pasi qe edhe turistët nuk paraqiten si asistentëtkryesorë por ata ndikojnë në krijimin e eventeve të reja.

Bibliografia

1. Bashkia Shkodër, (2014), *Kalendari i Aktiviteteve 2014 Art Kulture*.
2. Hall, C. M., (1992), *Hallmark Tourist Events: Impacts, management, and planning.* London, Belhaven.
3. Jago, L.K., & McArdle, K.O. (1999), A Temporal, Spatial and Thematic Analysis of Victoria's Special Events, in Proceedings of *1999 CAUTHE National Research Conference.* Adelaide, South Australia, eds Davies, J. & Molloy, J.
4. McDonnell, I., Allen, J. & O'Toole, W. (1999), *Festival and Special Event Management.* Milton, Jacaranda-Wiley.
5. Organizata Turistike Ulqin, (2014), Kalendari i Manifestimeve, http://www.ulcinj.travel/al/kalendari-i-manifestimeve

PhD Florida Veljanoska
InternationalUniversity of Struga,
MSc. Majlinda Axhiu
International University of Struga

33 The level of sophistication of e-tax services in the southestern countries in comparison to the EU member states

Abstract

The electronic supply of government services was spreading dramatically in the past decade, all over the world. The governments in EU countries, as well as the governments in other developed countries had put much attention on offering different kind of e–services for the citizens and the companies. Although, the developing countries tried to follow the developed countries trend, they are still far below the level in developed countries. E–tax services are very important component of the e-government services. They are considered as one of the factors which determine the quality of investment climate, as they influence the time, the cost and the effort of accomplishing tax obligations. Although e-tax services are very important, very little literature has been dedicated on this issue, and the great part of the researches elaborate the availability of the e-government services as a whole, and only mention e-tax services.

The aim of this paper is to show the level of development of e-tax services in some of the SEE (South-East European) countries, compared to the EU countries. The main focus is put on the situation in the Republic of Macedonia. Namely, on the path to EU membership, SEE countries, including Republic of Macedonia, must meet some of the EU benchmarks connected with the fiscal policy, and e-tax services, as a part of it. As a consequence of that, the government in the Republic of Macedonia has introduced many measures, which made enormous improvement in the e-government services.

The analysis in the paper has shown that although the government in the Republic of Macedonia made great improvements in the e-tax services, the availability of these services in the country is below the level in the developed countries.

The results from this research can be very useful for the policy creators, and can be used as a path for the introduction of the future measures by which will be improved the quality of e-tax services.

Key word: E-tax, European Union, SEE countries, Republic of Macedonia

Introduction

Availability of e-services is growing very fast all over the world. The people and the companies prefer to get and pay services online, instead of spending time, effort and money, when they physically do the same work. The expansion of e-services is in all areas. E-commerce spread rapidly, and many companies made their good available online. Availability of the goods online became one of the major factors, which determine the success of the businesses.

E-services became very popular among the governments, as well. In the past decade has been made great improvements in the offering of the e-governments services. The governments in EU countries, as well as the governments in other developed countries have introduced many measures which were correlated with the quality and the availability of e-government services. Although, the SEE countries tried to follow the EU trend in offering e-government services, they are still far below their level.

(2)Në zonat rurale (komunat) niveli i taksës për cdo kategori minimale të ndërtesës(përjashtuaar seksionin III) është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.

(3)Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit , të destinuara për shitje , por që janë ende të pashitura , taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientet e hipotekuara si:

-Apartamente banimi do t,i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë"Ndërtesa banimi"

-Ndërtesa biznesi do t,i nënshtohet taksës mbi ndërtesat në kategorine "Ndertesa te tjera për tregti dhe shërbime".

Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banese , për shtëpine ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës , si më sipër , ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera , taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës , që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.

Sipas Qeverisë pritet që në vitin 2014 *ndryshimet në taksimin e pasurive të paluajtshme* (vetëm për ndërtesat) do të gjenerojë rreth 1.1 miliardë lekë në buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.

2.Veçoritë e mënyrave të vlerësimit të bazës së Taksimit të pasurive të paluajtshme në vende të ndryshme të Europes.

Le te hedhim një vështrim mbi komponentët e taksës së pasurisë së paluajteshme, përgjegjësisë administrative, dhe aplikimit të taksës në disa vende të Europës:

Mali i Zi

Komponentët e taksës së pasurisë. Subjekt i taksës janë: toka ndërtesat qofshin apo jo në pronësi dhe klasifikohen sipas destinacionit të pronës : ndërtesa banimi, ndërtesa biznesi,ndërtesa për qëllime industriale, tokë bujqësore, administrim pyjesh.

Përgjegjësia administrative. Bashkitë janë përgjegjëse për arkëtimin dhe administrimin e taksës

Sistemi i aplikuar. Aplikohet mbi vlerën e pasurisë dhe është 0,08-0,8% e saj.

Kosova

Komponentët e taksës së pasurisë. Taksa mbi pasurinë: ndërtesa me qëllim banimi,me qëllim biznesi,industrial, toka bujqësore dhe toka të abandonuara.

Përgjegjësia administrative. Përgjegjësia është e qeverisjes vendore

Sistemi i aplikuar. Bazohet në vlerën e tregut të pasurisë në përputhje me standartet dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe norma e taksës është 0.5-1 % të vlerës së tregut të pasurisë.

Serbi

Komponentët e taksës së pasurisë. Tatimi është në katër kategori: a)transferim i pasurisë,b) mbi trashëgiminë dhe dhuratat, c)pasurinë dhe d) tarifat për përdorim trualli urban

Përgjegjësia administrative Përgjegjësi e qeverisjes vendore nëpërmjet agjensive të saj në çdo njësi.Tarifa për përdorimin e truallit është përgjegjësi e njësive vendore.

Sistemi i aplikuar. Taksa e Pasurisë bazohet në vlerën e tregut në 31 Dhjetor të vitit të më parshëm ku vlera e tregut është vlersuar sipas një formule.Është nga 0.4-2% të vlerës së pasurisë bazuar në vetëdeklarim.Tarifa e përdorimit të truallit urban si tarifë kompensimi bazohet në sipërfaqen në m^2 për çdo kategori.

Maqedoni

Komponentët e taksës së pasurisë. Taksa e pasurisë së paluajtëshme, dhuratave dhe trashëgimisë, transferimi i pasurisë.

Përgjegjësia administrative. Zyra e të Ardhurave në Ministrine e Financave.Njësitë vendore ngrejnë komisione verifikimi dhe Ministria e Financave kontrollon vlerësimin e bërë.

Sistemi i aplikuar. Aplikohet mbi vlerën e tregut dhe është 0,1-0,2%, por për ndërtesa banimi mund të ulet 50%.Mbështetet në vetëdeklarim ose në vlerësimin e përafërt të punonjësve të zyrës së pasurive të ngjashme.

Kroaci

Komponentët e taksës së pasurisë. Aplikohet për 6 taksa të ndryshme:a)taksa mbi shtëpitë e pushimit, b)taksa mbi tokën bujqësore të lënë djerrë, c)pronat e biznesit te pashfytëzuara, d)tokë për ndërtime e pa shfrytëzuar,e)taksa mbi banesat f)taksë mbi ndërtesa biznesi, garazhe.

Përgjegjësia administrative. Është e Këshillit vendor. Koefiçentët janë përcaktuar nga niveli qëndror, dhe këshilli vendor miraton nivelin përkatës brënda limiteve të përcaktuara.

Sistemi i aplikuar. Vlera për m^2 bazohet në dy koefiçientë: a)zonën ku është ndërtesa dhe b) natyrën e përdorimit të pasurisë.

Rumani

Komponentët e taksës së pasurisë. Taksë ndërtese për ndërtesa banimi, tregëtare, industriale, shtëpi pushimi, garazhe etj.

Përgjegjësia administrative. Këshilli vendor përcakton nivelin e taksës brënda një kufiri maksimum të vendosur me ligj

Sistemi i aplikuar. Baza e taksës është sipërfaqe në m^2 ose bazuar në vlerën e ndërtesës midis limiteve 1-1,5% Për ndërtesat e banimit, taksa është 0.2 % e vlerës së pasurisë për qytetet dhe 0.1 për zonat jo urbane dhe për kompanitë kjo taksë varion nga 0.5% deri në 1 % e vlerës

kontabile të pasurisë. Taksa e truallit në Rumani është një taksë më vete dhe është në shumë fikse për m2, bazuar në vendndodhjen e saj.

Hungari

Komponentët e taksës së pasurisë. a)taksa mbi ndërtesën dhe b)taksa mbi truallin urban

Përgjegjësia administrative. Këshilli vendor përcakton nivelin dhe mënyrën e pagesës.

Sistemi i aplikuar. a)sipërfaqe në m^2 e ndërtesës/truallit, b)rregulluar mbi vlerën e tregut të ndërtesës/truallit(3% e vlerës së tregut por jo më shumë se një maksimumi dhe një minimum).

Slloveni

Komponentët e taksës së pasurisë. Objekt i ligjit janë toka dhe ndërtesat në të duke përcaktuar 9 modele specifike të pasurisë si dhe tarifat e përdorimit të tokës për përdorim.

Sistemi i aplikuar. Bazohet në vlerën e pronës dhe destinacionin e përdorimit të pronës: a)banesa 0,1-1%, b)shtëpi pushimi 0,2-1,5%, c)ndërtesa biznesi 0,15-1,25%.

Bullgaria

Sistemi i aplikuar: Taksimi është me përqindje mbi vlerën e ndërtesave. Ndërtesat e reja rezidenciale taksohen me 0,2%, bizneset , industrialet dhe ndërtesat e tjera jo rezidenaciale taksohen me 0,4%, ndërsa shtëpitë e pushimit taksohen me 0,6% të vlerës së tyre. Për ndërtesat me madhësi të madhe egziston një normë taksimi shtesë. Ndërtesat e reja rezidenciale në zotërim të njerëzve të thjeshtë(çfarë do të kuptojmë më njerëz të thjeshtë) janë të përjashtuara për një periudhë 5-vjecare.

Burimi: USAID " Taksa mbi pasuritë e paluajtshme-instrument inovativ për rritjen e të ardhurave" Tetor 2010".

Italia

Niveli i Taksës së pasurisë varion nga 0.4% deri në 0.7 % të vlerës fiskale të pasurisë.

Greqia

Taksa vjetore e pasurisë së paluajtshme për personat juridik është 0.6% e vlerës së pasurisë.
Taksa vjetore për ndërtimet dhe tokën kanë një tarif prej 0.25 % - 0.35 % të vlerës së pronës.

Sllovakia

Tatimi mbi pronën nuk është i bazuar në çmimet e pronës e tregut të përgjithsëm, dhe toka është trajtuar më vetenga ndërtesa. Baza e tatueshme per token varet nga zona e saj dhe përdorimi. Ka 11 klasifikime te tokës, për 8 prej të cilave vlera e vlerësuar e tatimit percaktohet ne vartesi te cilësisë se tokës, sipas vlerësimit te Ministrise se Buqesise. Për tokat bujqësore të dhënat e mbledhura në cilësi dhe produktivitet të mundshëmjanë shumë të detajuara, dhe parcela në afërsi mund të ketë në thelb produktivitetit te vleresuar te ndryshme.

Ka gjashtë kategori të ndërtesave, duke filluar nga banesat rezidenciale e deri tek ndërtesat industriale.Norma bazë e tatimit shkon nga 1 SK(korone sllovake) ne 10 Sk për metër katror, dhe rritet me 0.75 SK(korone sllovake) për çdo kat. Normat mund të rregullohen çdo vit.

Çekia

Përcaktimin i politikave të taksimit në pronë në Republikën Çeke është përgjegjësi e parlamentit, por administrata tatimore dhe drejtimi i çështjeve të politikës strategjike janë shumë të centralizuara në Ministrinë e Financave

Në Çeki Ligji i taksimit të pasurive të patundshme e përcakton bazën tatimore dhe normen.Toka dhe ndërtesat janë të përfshira në bazën e taksimit në pronë, por vlerësimi i secilit bëhet veç e veç. Baza tatimore reflekton kryesisht fushën e parcelave të tokës dhe hapësirën në tokë të ndërtesave. Procesi me të cilin vlera aktuale pronës përcaktohet është e përcaktuar me ligj.

Normat e taksave janë të përcaktuara, dhe ka norma të veçanta për tokën dhe për ndërtesa.
Edhe pse vlerësimi i taksimit të pasurive të paluajteshme është i bazuar në zonën në metra katror, disa ndryshime mund të bëhen nga administratorët e taksave vendore si funksion i madhësisë së qytetit dhe llojin te tokës ose ndërtesave në fjalë.
Vlerësimi i pronave plotësohet nga tatimpaguesi, i cili është gjithashtu përgjegjës për llogaritjen aktuale të taksave. Vetë-raportimi i të dhënave është i pazakontë në shumicën e vendeve, dhe vetëvendosjen e vlerës së tatueshme është edhe më pak e zakonshme
Kështu tatimi në vlerë është kryesisht një funksion i tokës ose ndërtesës në metra katror dhe jo çmimi i tregut.
Estonia
Dhe në Estoni në vitin 1994 u kalua nga baza e taksës në karakteristika fizike të pronës në bazën e taksë në vlerë. Ligji i vitit 1994 thekson se qëllimi i vlerësimit është për të përcaktuar vlerën e tregut të tokës, duke përdorur njohuritë e përgjithëshme , parimet dhe metodat e vlerësimit të pronës. Këto standarde udheheqin vlerësimin e tokëspër vlerësimin tatimor, për klientët privatë (vlerësimit), dhe për kërkesat për rikthim të pronës.
Nga informacioni i paraqitur dhe nga një studim më i hollësishëm i zhvillimeve ekonomike në këto vende, dhe përsosja e sistemeve tatimore përkatese konstatojmë se në periudhën e trazicionit kryesisht për vendet e Europës Lindore baza e taksës mbi pasurinë e paluajtshme ka qënë vendosur fillimisht mbi karakteristikat fizike të pronës si siperfaqja në metër katror ose hektarë dhe vendndodhja e pronës. Me konsolidimin, formalizimin dhe zhvillimin e tregut të pasurive të paluajtshme kalohet gradualisht në një taksë me bazë vleren e tregut të pasurive te paluajtshme.
Nga kjo paraqitje konstatohet se:
1. Në pjesën dërmuese të vendeve të rajonit por edhe në vendet e Bashkimit Europian në pasuritë e paluajtshme përfshihen ndërtesat, trualli, toka bujqësore.
2.Baza e taksës mbi pasuritë e paluajtshme është ajo që bazohet mbi vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme ,gjë që është më e drejtë, shoqërisht më e pranushme, efektive dhe efiçente, me e kontrollueshme dhe me impakte pozitive në realizimin e të ardhurave prej saj.
3.Kalimi nga baza e taksë mbi karakteristika ***fizike n***ë ***baz***ë***n e taks***ë***sme baz***ë ***vler***ë***n e tregut*** ë***sht***ë rezultat i një procesi të gjatë historik dhe është realizuar nëpërmjet disa hapave dhe zhvillimeve që duhen mbajtur parsyh edhe në Shqipëri dhe që do t'i trajtojmë në zhvillimin e çështjes së më poshtme.

3.Sugjerime pë**r rritjen e efektivitetit t**ë **sistemit t**ë **taksimit t**ë **pasurive t**ë **paluajtshme.**
Mënyrat e mësipërme të taksimit të pasurive të paluajtshme mendojmë se duhet të përdoren në të ardhmen edhe në Shqipëri. Kjo është një domosdoshmëri që diktohet nga shumë faktorë dhe mbi të gjitha edhe nga procesi i integrimit të vendit tonë në Bashkimin Europian.
Duke patur parasysh vullnetin politik, politikat dhe procedurat administrative për t'ju përshtatur pikpamjeve kulturore të të drejtave pronësore, për mënyrën se si këto të drejta janë pranuar në komunitet, në realitetet e ambjenteve lokale dhe tregjet e pronës dhe kapacitetet administrative, mund të prodhojë një sistem taksash të drejtë dhe të qëndrushëm.
Problemi i kalimit të taksimit të pasurive të paluajtshme nga sistemi aktual në atë mbi bazën e taksushme vlerore ka edhe një sërë poroblemesh ndër të cilat do të veçojmë ***bazën tatimore.***
A do të lidhet vlera e bazës së taksës me vleren e tregut të kapitalit apo me karakteristikat fizike të pronës? Në qoftë se tregjet e pasurive të paluajtshme janë mjaft të konsoliduar , kjo është një arsye e fortë për të lidhur vlerat e tatueshme me vlerat e tregut.

Por në qoftë se tregjet e pasurive të paluajtshme nuk janë të kompletuara dhe të arsyeshme të funksionojnë mirë, qasja më e mirë është që të lidhë vlerën e tatushme (bazën e taksës) me karkteristika të pronës të tilla si madhësia dhe vendndodhja etj.
Në Shqipëri si bazë e taksës së pasurive të paluajtshme është toka dhe ndërtesat (toka dhe përmirësimet).Vlera e taksës përcaktohet si produkt i tarifës me sipërfaqen për m^2 në rastin e ndërtesave ose me hektarët ne rastin e tokës. Taksës i detyrohen personat fizik dhe juridik posedues së këtyre pasurive.Taksa nuk është uniform në të gjithë vendin ajo është e ndarë në tre nivele sipas ligjit. Përjashtime nga kjo taksë janë të sanksionuara në Ligjin nr. 9632 dt. 30.10.2006 Neni 22 Pika 4 ku thuhet se përjashtohen pronat shtëterore dhe të njësive vendore që përdoren për qëllime jofitimprurese, ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarësit me qira të paliberalizuara, ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, pika 6 e këtij neni parashikon të përjashtohet nga pagimi i taksës dhe subjekte të parashikuara me ligj të vecantë (invalidet e punës, veteranët Shqiptarë të luftës kundër pushtusve nazifashist,të verbrit, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik).
Në Shqipëri sic shikohet dhe nga miratimi **Ligjit nr 181/2013 date 28.12.2013** " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore " vlera e bazës së taksës nuk është e lidhur me vlerën e tregut të pasurive te paluajtshme por me karakteristikën fizike të pasurisë sic është siperfaqja në metër katror apo në hektarë dhe vendndodhjen.
Ndonjëherë rritja në vlerë e pasurive te paluajtshme është rezultat i vendimeve të përdorimit të tokës të marra nga Qeveria Lokale, të tilla si dhënia e të drejtave të zhvillimit në tokën që ishte më parë tokë bujqesore. Ndonjëherë rritja e vlerës është thjesht rezultat i rritjes së popullsisë. Çështja është se kjo vlerë e rritur nuk është rezultat i ndonjë investim të bërë nga pronarët e tokës ose banorët, por është rezultat i drejtpërdrejtë i investimeve publike. Rritja e vlerës së pasurive të paluajtshme si rezultat i faktorëve të mësipërm u jep të drejtën organeve të qeverisjes vendore që ta *konstatojnë këtë vlerë të rritur dhe të kërkojnë prej saj taksa shtesë nga pasuritë e paluajtshme* në të ardhmen. Koncepti i **"konstatimit t**ë **vlerës s**ë **rritur"** është që Qeveritë Lokale duhet të jenë në gjendje që të përcaktojnë një pjesë të rritjes së vlerave së pasurive të paluajtshme private, për të ndikuar që ata të paguajnë për shërbimet publike që sollën si rrjedhim vlerën e rritur.
Një situatë e tillë e bën të domosdoshme kalimin nga taksa e bazuar në karakteristik fizike siç është sipërfaqja në taksën e bazuar në vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme.
Pas ketij ndryshimi qytetarët do të presim që të shohin ndikimin e taksave që ata paguajnë për një infrastrukturë më të mirë, shërbime të përmirësuara dhe përmirësime të tjera sociale në komunitet. Kur kjo bëhet dhe ata shohin përmirësimin në jetën e tyre, ata janë më të gatshëm të paguajnë taksat dhe të mbështetin zyrtarët lokalë.
Suksesi afatgjatë i taksës mbi pasuritë e paluajtshme do të varet shumë në perceptimin e publikut se tatimi është i drejtë dhe se të ardhurat e mbledhura nga taksa të rezultojnë në përmiresime në infrastrukturë dhe shërbime lokale.
Një **tjetër atribut** potencialisht i rëndësishëm i taksës së pasurive të paluajtshme është se, kur është e dizenjuar në mënyrë të përshtatshme, të ardhurat që rezultojnë kanë tendencë të rriten si rritet ekonomia lokale.

Në rast se si bazë e taksës së pasurive të paluajtshme meret vlera e psurisë së paluajtshme atëhere duhen përcaktuar standartet bazë për mënyrën se si toka dhe prona (pasuritë e paluajtshme) duhet të vlerësohen për qëllime tatimore.
Po ç'farë standarti do të përdoret për përcaktimin e vlerës (vlera e tregut, vlera vjetore e qirasë etj.) Në këtë mes ka disa çështje të rëndësishme administrative:

• Çfarë aftësish dhe trainimesh do të jenë të nevojshme për personelin në mënyrë që të ruajë vlerat në nivelet e kërkuara ligjërisht?
• Cili nivel i qeverisjes dhe cila agjensi duhet të jetë përgjegjëse për ruajtjen e vlerave të sakta të tatueshme?
• Kush do të sigurojë burimet teknike dhe financiare për të krijuar dhe ruajtur praktikat e vlerësimit të pranueshme?
• Do të monitorohen praktikat e vlerësimit dhe të vlerësohen rregullisht për të siguruar ndershmërinë dhe saktësinë? Nëse po, nga kush?
Pjesë e suksesit të sistemit të taksimit të pasurive të paluajtshme është dhe grumbullimi i taksës.
Performanca e organeve të administratës publike të ngarkuara me arketimin e kësaj takes mund të vleresohet me anë të raportit të mbledhjes së tasave mbi pasuritë e paluajtshme.
Raporti i mbledhjes është përqindja e taksave të arketuara realisht mbi taksat e faturuara për një periudhë të caktuar kohe , zakonisht për një vit fiskal. Suksesi i mbledhjes kërkon vullnet politik, një administratë të aftë e të trainuar, zbatim korrekt të ligjit ,mbështetje gjyqësore dhe praktika të shëndosha administrative etj.
Çështjet kyçe administrative në këtë fushë përfshijnë në vijim:
• Cilat agjenci(institucione apo subjekte) do të jenë përgjegjëse për mbledhjen e taksës?
• Si do të shpërndahen faturat tatimore?

• Ku dhe si do të mblidhen taksat? Kjo është një pikë e rëndësishme sepse ajo ndikon në kostot e pajtueshmërisë për tatimpaguesit.

• Çfarë procesi do të përdoret për të trajtuar ankesat?
• Çfarë sanksionesh do të përdoren në rastet e mospagesës së taksave?
• A do të ketë mbikëqyrje nga agjencitë e tjera ose niveleve të tjera të qeverisjes?
Mendimet për problemet e shtruara më sipër dhe që kanë të bëjnë me efektivitetin në arketimin e taksave nga pasuritë e paluajtshme do të jenë objekt i një studimi të vecantë.
Po Shqiperia në ç'pjesë të rrugëtimit për kosolidimin e sistemit Tatimor të Taksimit të pasurive të paluajtshme ndodhet?
Megjithë ndryshimet në Ligjin e aprovuar në kohët e fundit për mënyrën e taksimit të pasurive të paluajtshme të cilat përbëjnë një risi, përsëri niveli i taksimit të pasurive të paluajtshme ë***sht***ë ***shum***ë ***i ul***ë***t***. Nëqoftëse bëjmë një krahasim të nivelit të taksës së ndërtesave për m^2 për ndërtesa të ndërtuara pas vitit 1993 me rreth 30 lekë/m^2, pra për një ndërtesë banimi me një sipërfaqe 100 m^2 paguhet 3000 lekë në vit, me taksën e bazuar mbi çmimin mesatar te tregut të ndërtesave te ketyre viteve rreth 6.500.000 lekë (rreth 450 euro/m^2) me tarifë 0.1% të vlerës së tregut të zbatuar në shumicën e vendeve Europiane, vlera e taksës del 6,500 lekë, më shumë se dyfishi i vlerës së parë, ky tregues rezulton në një tarif rreth 0.05%. Në zonën II ky tregues është përafërsisht rreth 0.02% , ndërsa në zonën III është përafërsisht 0.015% etj. Në vendet e rajonit ky tregues është rreth 1% të vlerës së ndërtesës dhe në vendet e BE edhe më i lartë, prandaj është i ***domosdosh***ë***m p***ë***rmiresimi i manaxhimit t***ë ***taks***ë***s mbi pasurit***ë ***e paluajtshme.***
Ky proces objekt studimi mendojmë se duhet të realizohet në disa hapa:

(i) Konsolidimi i sistemit aktual nëpërmjet arkëtimit të detyrimit nga të gjithë subjektet.
(ii) Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet formalizimit të pasurive të paluajtshme dhe krijimi i një *regjistri fiskal* t*ë pasurive* t*ë paluajtshme* dhe të një regjistri *kadastral per tok*ë*n bujq*ë*sore* .

(iii) Përdorimi i kësaj takse për infrastrukturën dhe shërbime të tjera publike duke rritur transparencën dhe ndikimin e saj mbi ndërgjegjësimin e taksapaguesit se ajo po shkon për përmirësimin e shërbimeve për ta. Kalimi nga sistemi aktual i bazës së taksueshme mbi sipërfaqe,në mënyrën e ***taksimit t***ë ***vler***ë***s se pasurive te paluajtshme*** si një mënyrë moderne e menaxhimit të taksimit të pasurive të paluajtshme, bazuar edhe në përvojën e vendeve të Bashkimit Europian ku ne aspirojmë të antarësohemi së shpejti.

Një nga çelësat e suksesit për çdo program është vlerësimi i vazhdueshëm për të vlerësuar përparimin, drejtimin dhe ndikimin. Nga kjo perspektivë është gjithashtu e dobishme të marrim në konsideratë se si taksa mbi pasuritë e paluajteshme do të vlerësohet. Praktika më e mirë sugjeron se taksa mbi pasuritë e paluajtshme duhet të vlerësohet nga tre këndvështrime: tatimpaguesi , administrata tatimore dhe synimet e publikut të gjerë.
Vlerësimi nga perspektiva e tatimpaguesit do të fokusohet në barrën e përgjithshme tatimore, drejtësia në shpërndarjen e kësaj barre nëpër ekonomite familjare, dhe kostot e shkaktuara tatimpaguesve në përputhje me tatimin. ***Drejtësia tatimore*** vlerësohet duke krahasuar ekonomitë familjare në rrethana të ngjashme.***Eshtë konsideruare drejtë*** në radhë të parë, nëse familjet që kontrollojnë tokë dhe prona të ngjashme paguajnë një taksë të ngjashme.
Një pikëpamje është se taksa që lidhet me një pronë të caktuar duhet të jetë proporcionale me shërbimet publike që shfrytëzohen nga ata që zotërojnë pronën.Pikëpamja alternativë është se pronat me me shume vlere priren të jenë të kontrolluara nga njerëz me të ardhura të larta dhe me kapacitet më të madh për të paguar taksat.
Monitorimi i shpenzimeve administrative është disi më i paqartë. Një studim ka sugjeruar se kostoja e administrimit të takses vjetore mbi pasurite e paluajtshme nuk duhet të kalojë katër për qind të të ardhurave të grumbulluara (Gallagher, 2004). Kjo ndoshta është më e rëndësishme për të miratuar një metodë të qëndrushme për një kontekst të caktuar dhe të monitorojë raportin me kalimin e kohës.
Matës i efektivitetit të një takse mbi tokën dhe pronën është nëse ajo rrit të ardhurat në sasi të mjaftueshme për të financuar pjesën e synuar të shërbimeve publike.
Që një sistem i taksimit të pasurive të paluajtshme të funksionoje mirë duhet të ekzistojë një ndarje e përgjegjësisë administrative ndërmjet nivele të shumta të qeverisë.

4. Konkluzione

1.Menaxhimi i taksimit të pasurive të paluajtshme është një problem i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë për rritjen e të ardhurave të pushtetit lokal. Ky problem merr një rëndësi të veçantë në kushtet aktuale të zhvillimeve ekonomike ku kriza ekonomike është prezente edhe në vendin tonë dhe do të shërbejë megjithse modestisht si një mundësi për plotësimin e nevojave të rritura për likuiditete.
2.Taksat e arkëtuara nga pasuritë e paluajtshme duhet të përdoren për shpenzime në *infrastruktur*ë në formën e investimeve ose të shpenzimeve për mirëmbajtjen e saj si një element i ndjeshëm, duke lidhur më mirë se deri sot taksat e paguara me përfitimet e komunitetit si kundërshpërblim i kësaj pagese.
3.Ndryshimet modeste të bëra në ligjin për sistemin e taksave vendore për disa ndryshime në tarifat e taksës së pasurive të paluajtshme për ndertesat janë të arsyshme dhe pa ndikime të ndjeshme në barrën tatimore tek subjektet taksapaguese.
4. Shuma e të ardhurave të grumbulluara nga organet e pushtetit vendor nga taksat e pasurive të paluajtshme ë*shtë shum*ë *e ulët* krahasuar kjo me shumën e programuara në buxhetin e çdo viti por edhe si pëshe specifike në PBB. Një evazion të madh fiskal ka si në arkëtimin e taksave të pasurive të paluajtshme nga ndërtesat e të gjitha llojeve por vecanërisht nga ndërtesat e

destinuara për banesë por edhe nga taksa e tokës bujqësore. Përpjekjet e bëra nga organet e pushtetit vendor në këtë drejtim deri tani kanë qënë të ulëta dhe shpesh të ndikuara politikisht.
5.Niveli i taksës për banesat aktualisht është shumë i ulet dhe pagimi i rregullt prej tyre duhet të vlente më tepër për efekt të *moralitetit tatimor*(ndërgjegjësimin e taksapaguesve) duke patur parasysh që kanë kaluar 23 vjet që nga procesi i ndryshimeve demokratike. Pagimi i taksave prej tyre duhet kuptuar si një *domosdoshmëri për përfitim shërbimesh publike*.
6. Panvarësisht nga të metat që mund të ketë sistemi aktual i taksimit të pasurive të paluajtshme detyrë themelore aktualisht ngelet *konsolidimi i saj*. Organizimi i ri i territorit qe pritet të kryhet së afërmi e ka mëse të domosdoshme një gjë të tillë për të realizuar funksionet e tij.
7. Sanksionet e vendosura për mos pagimin e kësaj takse pothuajse janë inegzistente.Sanksionet dhe mënyra e vendosjes, dhe mbledhjes së tyre duhet të jenë më të qarta dhe më të zbatushme.
5. Rekomandime
Konsolidimi i sistemit aktual të taksimit të pasurive të paluajtshme mendojmë së është një proces komplekse që duhet të realizohet në disa hapa, ku do te veçonim :
a)Rritja e përpjekjeve dhe performancës së administratës publike të organeve të pushtetit vendor në drejtim të arkëtimit të taksës së pasurive të paluajtshme duke parashikuar *nje raport te ri* të arketimit të kësaj takse.
b) Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për formalizimin e pasurive të paluajtshme dhe krijimi i një *regjistri fiskal* të *pasurive* të *paluajtshme* dhe të një regjistri *kadastral* për *tokën bujqësore*.
c) Ngritja e një njësie të specializuar kombëtare që do të ndihmonte në formalizimin e pasurive të palujtshme, e që do të kryente vlerësimin dhe përditesimin e vlerave të pasurive të palujtshme dhe transferimin e këtij informacioni në rregjistrin fiskal**.**
d) Përdorimi i kësaj takse për infrastrukturën dhe sherbime publike duke rritur transparencën dhe ndikimin e saj mbi ndërgjegjësimin e subjekteve të taksuara se kjo taksë po shkon për permirësimin e shërbimeve publike të ofruara nga ana e Qeverisë Qëndore e Lokakle.
e)Kalimi nga sistemi aktual i bazës së taksueshme mbi sipërfaqe, në mënyrën e ***taksimit t***ë ***vler***ë***s s***ë ***pasurive t***ë ***paluajtshme*** si një mënyrë moderne e menaxhimit të taksimit të pasurive të paluajtshme, bazuar edhe në përvojën e vendeve të Bashkimit Europian ku ne aspirojmë të antarësohemi së shpejti.
Baza e taksimit do të jetë *vlera e tregut e pasurive* të paluajtshme dhe tarifa e taksimit të jetë në përqindje mbi vlerën e tregut të saj duke patur parasysh destinacionin e ndërtesës.Vlera e tregut mund të ndryshojë në çdo 5-10 vjet dhe mund të përcaktohet nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Tarifa konkrete do të jetë produkt i një diskutimi të gjerë duke patur parasysh edhe pjesëmarrjen e grupeve të interesit dhe vendimarrja do të jetë politike.
f)*Ajo q*ë *ka rënd*ë*si dhe duhet kuptuar edhe nga politikëberesit* ë*sht*ë *fakti qe menaxhimi i sistemit t*ë *taksimit t*ë *pasurive t*ë *paluajtshme sot edhe n*ë *t*ë *ardhmen duhet vler*ë*suar m*ë *mir*ë *se deri m*ë *sot duke zgjeruar edhe m*ë *tej baz*ë*n e taksimit t*ë *pasurive t*ë *paluajtshme duke p*ë*rfshir*ë *n*ë *to edhe pasuri t*ë *paluajtshme t*ë *cilat deri m*ë *sot jan*ë *anashkaluar*.

5 Referenca

1. *-Shoqata e Bashkive te Shqiperise "Manual per te ardhurat vendore", Tirane 2011*
2. *-Shoqata e Bashkive te Shqiperise "Menaxhimi i taksave vendore" , Tirane 2010*
3. *-Gjika A,Shutina D,"Taksa mbi pasurite e paluajtshmeinstrumenti per rritjen e te ardhuravedhe zbatimin e politikave urbane ne nivelin vendor",Tirane 2010*
4. *-USAID "Taksat dhe tatimet " Guide , Tirane 2006*
5. *-USAID "Taksa mbi pasurite e paluajtshme-instrumet inovativ per rrritjn e te ardhurave vendore",Tetor 2010*
6. *-Hilmia S, Angjeli A."Financat publike" Tirane 1994*
7. *-Rosen S.Harvey "Financat publike" Albin , Tirane 2003*
8. *-Allan,C.M. (1971)"The Theory of Taxation" (London :Penguin Books)*
9. *-Almy,R. (2001) "A Survey of Property Tax System in Europe", Slovenia*
10. *-Bird,R. (2000) "Subnational Revenues : Realities and Prospects"*
11. *-Ebel,R. (2003) "Subnational Tax Policy Desing and Fiscal Decentralization"*
12. *-FDI – CEE publications (2006) "Reforming Property Taxation in South –East Europe"*
13. *-Word Bank , (2007) "Urbane Sector Review", Albaniaa*
14. *-Word Bank, (2008" Albania Policy Note on Locaal Finance"*
15. *-Lawrence Walters(2010)" Land and Property Tax"*
16. *-Jane H. Malme and Joan M. Youngman Lincoln Institute of Land Policy(2001) "The Development of Property Taxationin Economies in Transition"*
17. *-Ligji nr 9632 date 30.10.2006" Per sistemin e taksave vendore" i ndryshuar me ligjin nr 10.117 date 23.04.2009*
18. *-Ligji nr 9920 date 19.5.2008 " Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar*
19. *-NALAS (March 2009) "Improvement of Local Administration Taxes in South - East Europe; Guidelines on Local Property Tax Administration"*
20. *-Ligji nr 181/2013 date 28.12.2013 " Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore "*

Shaip Osmani1

36 Vështrime gjeostrategjikë mbi rolin e bashkësisë ndërkombëtare pas viteve të 90-ta në Ballkanin Perëndimor

Abstrakt
Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Ballkani Perëndimor ishte nga rajonet që përjetoi tranzicionin më të vështirë, sepse ky proces u shoqërua me konflikte dypalëshe dhe shumëpalëshe, me luftëra lokale dhe rajonale, me përplasje politike dhe etnike. Bashkësia ndërkombëtar ndërhyri aktivisht në Ballkan, respektivisht në periudhën e konfliktit në Bosnjë-Hercegovinë, në Kosovë dhe Maqedoni. Prania ndërkombëtare është civile dhe ushtarake. Në këto zhvillime rol determinant kanë luajtur SHBA, NATO, BE, OKB, OSBE, KE dhe një sërë aktorësh të tjerë rajonal e jo politikë. Si pasojë, Ballkani u fragmentarizua politikisht dhe në hartën e tij. Aktualisht, Ballkani ndodhet i orientuar tërësisht drejt strukturave evropiane dhe euro-atlantike. Asnjë vend i Ballkanit përfshi Kosovën nuk ka orientime të tjera përveç këtyre. Kjo e bën procesin më të lehte, sepse kemi të bëjmë me pranimin e të njëjtave vlera dhe të hyrjes në të njëjtat interesa rajonale, evropiane e global.
Do të analizoim politika ndërkombëtare mbas viteve 90-ta mbi rolin e politikës ndërkombëtare dhe intensfikimin e saj mbi rolin politik në këtë periudhë kohore. Një trajtim analitik i kushtohet pozicioneve të palëve në këto konferenca, duke analizuar ndikimin e raporteve ndërkombëtare, si dhe reflektimet e interesave gjeostrategjike në këto konferenca. Këtu janë marrë në trajtim dhe analizë: Konferenca e Hagës; Komisioni i Badinterit; Konferenca e Londrës dhe vazhdimi i sai në Gjenevë dhe Konferenca e Dejtoni .dhe shkoputje nga Konferenca e Rambujes, sidhe në rolin dhe ndikimin e këtyre konferencave, përfitimet dhe humbjet që patën palët në këto konferenca dhe dobit dhe dopsit që i'u sollen këto politika ndërkombëtare shteteve në konflikt.

***Key words**: Prania ndërkombëtare, orjentimet, implementimetë dhe diplomacia imponuse*

Hyrje

Proceset demokratike të viteve të 90-ta në Ballkanin Perëndimorë, me theks të veçantë pas rënies së Murit të Berlinit, u përcollën në tërësi me sfida të ndryshme, në krahasim me ato që ishin në luftën e ftohtë. Këtë më së miri e dëshmoj shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë. Duke qenë se origjina e Luftës së Ftoftë ishte shumë e lidhur me ndarjen e Evropës në mes SHBA-ve dhe BRSS-së mundë të datohet që viti 1989 ishte edhe përfundimi i kësaj lufte. Ky është viti i shembjes së Murit të Berlinit i cili konsiderohet edhe momenti kyçë në përfundimin e Luftës së Ftoftë. Kjo fazë solli ndryshime të mëdha në skenën politike dhe atë të sigurisë, sepse u realizua skenari i Bashkimit të Gjermanisë dhe shpërbërja e BS në vitin 1991, të cilat ndikuan në rrjedhën e shumë konflikteve nëpër botë, përfshirë këtu shumë konflikte dhe shpërbërje të shteteve federale në Afrikën e Jugut në Lindjen e Mesme në disa pjesë të Evropës si dhe konfliktet në Ballkanin Perëndimor[165].
Në rajonin e Ballkanit Perëndimor këto procese u shoqëruan me konflikte dypalëshe dhe shumëpalëshe, me luftëra rajonale e lokale, me përplasje politike dhe etnike. Faktori ndërkombëtar ndërhyri aktivisht në Ballkan, respektivisht nga koha e konfliktit në Bosnjë-

[165] Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike, Prishtinë 2008, fq.209.

Hercegovinë, në Kosovë dhe Maqedoni, prania ndërkombëtare është civile dhe ushtarake. Në këto angazhime ndërkombëtare, rol determinant kanë luajtur ShBA, NATO, BE, OKB, OSBE, KE dhe një sërë organizmash rajonale e jo politike.

Si pasojë e luftërave, Ballkani Perëndimor u fragmentarizua politikisht edhe në hartën e tij, sepse nga gjashtë shtete kryesore ballkanike, klasike që kishim mbas Luftës së Dyte Botërore, pas Luftës së Ftohtë kemi një Ballkan me dhjetë shtete të reja, ku shtohen Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Unioni Serbi-Mali dhe Kosova. Fragmentarizmi i Ballkanit erdhi për shumë shkaqe, historike, politike, ekonomike, ushtarake, gjeopolitike e strategjike. Ky proces solli pasoja edhe në procesin e integrimit të këtij rajoni.

Me shembjen e Murit të Berlinit secili vend socialist evropian e shihte vetën se ishte e pa shmangshëm përfundimin e regjimit të atëhershëm dhe të sistemeve ekonomike –politike të socializmit që kaploj këto shtete. Iniciativa e parë në secilin prej këtyre vendeve do të lidhet me eliminimin e themelimeve juridike mbi të cilat këto vende e kishin ngritur pushtetin totalitar i cili ishte roli udhëheqës i Partisë Komuniste[166]. Fundi i Luftës së Ftoftë përfaqësonte një ndryshime shumë të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare, fundin e një epoke historike dhe fillimin e një epoke tjetër të re e cila ishte fillimi i konflikteve civile dhe etnike nëpër Botë. Luftërat në Ballkanin Perëndimor ishin shfaqur me shpërbërjen e federatës Jugosllave. Në Jugosllavi u rishfaq rivaliteti i Luftës së Ftoftë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, si dhe vija e vjetër ndarëse të dallimeve etnike, fetare, politike dhe historike që kishin ngrirë për rreth gjysmë shekulli[167].

Jugosllavia ishte një shtet i përbashkët i cili u krijua në vitin 1918 nga gërmadhat e perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze si mbreti Serbe Kroate dhe Sllovene. Ky shtet funksionoi deri në fillim të viteve 90-ta. Vlen të theksohet se për shkak të pozitës së saj gjeostrategjike, si dhe asaj politike, gjatë periudhës së lutës së Ftoftë, shteti komunistë Jugosllavë fitojë një rëndësi të madhe në raportet lindje-perëndim. Në kuadër të konfortimeve Lindje–Perëndim në këtë qëndrim që e patë Jugosllavia në arenën ndërkombëtare, komunistët krijuan një ekuilibër që nga jashtë duket i qëndrueshëm, sidomos pas viteve të 50-ta kur Jugosllavia refuzoi sferën e ndikimit sovjetik dhe për efekt gjeti mbështetje ndërkombëtare të perëndimit. Mirëpo, kriza ekonomike dhe politike e viteve të 80-ta, në Jugosllavin e përbashkët filluan të ndryshojnë shumë elemente si ato politike, ekonomike, etnike etj[168].

Por me përfundimin e Luftës së ftoftë Jugosllavia humbi pozicionin e saj strategjik në konceptin e politikës së sigurisë së perëndimit në kuadër të kësaj humbi edhe përkrahja ekonomike. Mos interesimi i krizës që po shfaqët në horizont sipas Pobert L. Haqinges thelbi i problemit ishte "Se qeveritë në Uashington dhe në shumicën e kryeqyteteve Evropiane, Jugosllavia nuk kishte rëndësi të madhe, nga se ky vend nuk do të mundë të zhvillohej si në arenën e konfliktit Lindje–Perëndim"[169].

Kriza politike dhe ekonomike e këtyre viteve ndikoi që nacionalizmit agresiv në Serbi në krye me Sllobodan Millosheviqi, i cili vjen në pushtet më 1989, ndikoi që Jugosllavia të hynë në një faze kritike të historisë së saj. Serbia, si shtet që u shfaqë qartë dhe hapur me idenë e dominimit në pjesën më të madhe të shteteve të federatës, si dhe filloi procesin e ndryshimit demografik-spastrimin etnike. Të gjithë këta faktor dhe procese që kishin filluar, ndikuan në shkatërrimin e Jugosllavisë.

---

[166]Radovan Vukadinoviq, Mardhënjet Ndërkombëtare nga Lufta e Ftoftë deri te rendi global, Kolegji Universitar "Victori", Prishtinë 2007, fq. 266.

[167] Karen A. Mingst, Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Tiranë 2008, fq. 261.

[168] Syl ,Ukshini Kosova në Politikën e Jashtme të BE-së 1991-2007, Shkup 2008, fq .67.

[169] Robert L. Hutchings , Als der Kolte Krieg Zu Ende war, Eim Berichrt aus dem Immerem Macht, Berlin 1999, fq. 385 386.

Mirëpo i gjithë procesi për shkatërrimin e Jugosllavisë dhe dominimin e Serbisë në ish Jugosllavi do të intensifikohet pas dështimit të Kongresit të 14 të LKJ-së në janar të vitit 1990. Në këtë periudhë filloi formimi i partive kombëtare, për të vazhduar me ndryshime demokratike në Slloveni, Kroaci dhe Maqedoni. Për të vërtetuar këtë që ishte reale e për disa ishte e pa besuar (për serbët) e vërtetuan zgjedhjet në Kroaci dhe Slloveni që u mbajtën në prill të vitit 1990, ku në këto zgjedhje do të dominojnë partitë kombëtare, që kishin proklamuar në programet e tyre pavarësinë dhe krijimin e shteteve sovrane. Në Kosovë gjendja u bë shpërthyese pas heqjes së autonomisë së vitit 1974, kurse në Mal të Zi e Vojvodinë u përmbys udhëheqja legjitime e ma parme, duke e zëvendësuar me udhëheqje pro serbe. Kjo luftë politike që e qoi Jugosllavin drejt shpërbërjes u zhvilluar edhe në sfondin e një krize ekonomike. Në fillim u shkëput Sllovenia e pastaj edhe Kroacia shpalli pavarësinë e saj. Udhëheqja serbe në drejtimin e Millosheviqit iu kundërvë kësaj lëvizje me mjete të dhunshme.
Bashkësia ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian u përpiqen ta ruajnë status quo-në dhe integritetin federal të Jugosllavisë[170]. Bashkimi Evropian së bashku me disa shtete të tjera ndërkombëtare humbi rasti të pengoi shpërbërjen e dhunshme të Jugosllavisë. Shumë kohë para fillimit të shpërbërjes, Bashkimi Evropian ka mundë ta përdor një politik a po një trysni kundër tendencave luftarake që ishin të qarta nga udhëheqja serbe të cilat përfundimisht kishin të bënin të qarta gjatë viteve 80 në Kosovë. Sllobodan Millosheviqi e shfrytëzoi këtë kohë që në bashkësinë ndërkombëtare u bëjshin shumë ndryshime politike dhe ideologjike. Politika e udhëhequr nga Millosheviqi, që në sytë e republikave të tjera u shihte me frik si fillimi i politikës për realizimin e objektivave të Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve në të cilën vite ma parë ishte hedhur baza ideologjike për politikën serbomadhe dhe për hapjen e rrugës për ngritjen e nacionalizmit serb. Në këtë qasje serbe, kriza jugosllave filloj të marrë karakter ndërkombëtar. Mirëpo, shkaqet e shpërbërjes së Jugosllavisë janë të shumta, disa burojnë që nga koha e krimit të saj: Pabarazia e popujve që jetonin në këtë federatë[171].
Në këtë periudhë u zhvilluan një seri bisedimesh për gjetjen e mundësive për ruajtjen e dhe zgjidhjen e kontesteve në të Jugosllavisë, duke thirrur edhe një Konferenca të veçanta për këtë çështje. Për nga rëndësia dhe rezultati i tyre veçojmë:*Konferencën e Hagës; Komisionin e Badinterit; Konferencën e Londrës dhe vazhdimi i sai në Gjenevë dhe Konferenca e Dejtonit.* Këto konferenca ndërkombëtare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zgjedhjen e konflikteve. Radha e mbajtura të këtyre konferencës maratonike për krizën në ish Jugosllavi i paraprin një iniciativë (insistim) i brendshëm e qeverisë së Jugosllavisë, në një takim në Brione nën asistimin e "Treshes Ministrave" të BE-së që u mbajt me 7 korrik 1991. Qëllimi i misionit të treshes ministrore në këtë takim ishte që të krijoi rrethana për bisedime paqësore në mes palëve në konflikt. Në këtë takim u nxorë një deklaratë, ku veç tjerash thuhet: "se për shkak rrethanave dhe zhvillimeve që po ndodhin në ish Jugosllavi bisedimet mes palëve duhet të fillojnë urgjentisht më së largu derë me 1 gusht 1991. Qëllimi i këtij takimi dhe i asaj deklarate"[172]që nxori, ishte ruajtja territoriale e Jugosllavisë, mirëpo në këtë periudhë ishte krejtësisht e pa mundur. Mirëpo, të gjitha këto përpjekje ishin të pasuksesshme, sepse në shtetet e ish federatës dominonte kërkesa e ndarjes. Kjo vjen edhe si rezultat i formimit mbi vlerat jo të përbashkëta dhe ishte e pamundur për të parandaluar shpërbërjen e Jugosllavisë. Jugosllavia u shpërbë dhe disa prej republikave të saj shpallën pavarësinë e tyre.

[170] Syl Ukshini, Kosova në Poltikën e Jashtme të BE-së 1991-2007, Shkup 2008 , fq. 68.
[171]Po aty
[172]Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Universiteti AAB Prishtinë, Prishtinë 2007, fq 132.

Serbet etnik të cilët ishin pakicë në Kroaci e Bosnje Hercegovinë pushtuan një të treten e territorit kroat, e dy të treten të territorit të B e H. Në këto pjesë territoriale serbet lokal të mbështetur nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe masakruan qindra mija popullatë vendase boshnjake dhe kroate me synimin e pastrimit etnik dhe krijimit e një shtet të pastër etnik serb[173].

Sot Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian në tërësi, rrezikun e sheh tek grupet terroriste anë e mbanë botes, rrezikimi i sigurisë nga shtetet e dështuara dhe armatimi i shkatërrimit në masë. Rëndësia klasike e aleancave ka humbur kuptimin e vet, dhe sot rëndësishme dita ditës po behet shume menaxhimi i konflikteve në zona të trazuara. Qëllimi i Bashkimit Evropian, është që të shtrijë stabilitetin dhe paqen në pragun e vet, në Evropën Jug-Lindore dhe në vendet ish-Sovjetike. Dhe fokusi në ketë punim do jete pikërisht, në instrumentin evropian të politikes se sigurisë, ESDP, krijimin e saj, strukturën, funksionet dhe të ardhmen e saj.

1.Konferenca e Hagës

Për ti dhanë fund veprimeve ushtarake në territorin e ish-Jugosllavisë ministrat e jashtëm të BE-së dhe iniciativa e cila ishte filluar nga sekretarit të Përgjithshëm të NATO-së, Lord Peter Carrington[174] në fillim të shtatori të vitit 1991 mblodhi në Hagë Konferencën Ndërkombëtare mbi Jugosllavin, si përpjekje për ti sjellë pak vëmendje kaosit që po ndodhë në Jugosllavi. Në këtë konferencë BE-ja nuk u shihte që ka një forcë për të ndikuar mbi këtë konflikt, ngase BE-ja nuk mundi të ishte neutrale në vendosjen e paqes, pasi disa shtete te BE-së kishin kontakte të ndryshme ekonomik dhe historike në pjesë të ndryshme të Jugosllavisë dhe me palët në konflikt. Mandej edhe vet konferenca për paqe e (Hagës) ishte thirrur si rezultat i një kompromisi ndërmjet Parisit edhe Bonit, sepse qysh në korrik Gjermania kishte deklaruar se nuk do të ishte më i mundësh kthimi në rrethanat e vjetra.

Në këtë konferencë Bashkimi Evropian nuk u parashihte se ka një planë për zgjedhjen e konfliktit. Ndërsa, kryesuesi Lordi Kerington, paraqiti një planë në këtë konferencë, ky plan paraqitke një organizim të ri federatës jugosllave që: Jugosllavia duhet të ruhet si bashkësi të pandara në një status ndërkombëtar, një bashkim i lirë i republikave me një status ndërkombëtar dhe marrëveshja gjithëpërfshirëse. Pala serbe kishte bojkotuar konferencën si revolt e këtij plani. Me 4 Nëntor BE-ja kishte përgatit një plan të ri për jugosllavin, por as ky plan nuk kishte kënaqur interesat e serbe, me që serbët synonin një federatë Jugosllave, e cila do të mbetet pasardhëse e RFSJ-së, e cila ishte një plan i serbëve për krijimin e Serbisë së Madhe.

Konferenca e Hagës dështoi mu për shkak së strategjisë së evropianëve për bisedime dhe roli të cilën e luajtën evropianët dhe bashkësia ndërkombëtar në këtë konferencë ishte dhënia dhe përfitimi i kohës Millosheviqit për planet e ti dhe ikja nga sanksionet ndërkombëtare dhe përfitimi nga kamuflimet qe kishte diplomacia serbe. Kjo konferencë përveç pranimit të shpërbërjes së Jugosllavisë, që deri atëherë vështirë që mundë të pranohet prej mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtar, nuk solli as një element veprues apo parandalues të eskalimit të një pas njëshëm të luftërave në Jugosllavi[175]. Komiteti ndërkombëtar i kushtoi Jugosllavisë vëmendje të veçantë vetëm pas shpërthimit të luftërave në tronditjen e madhe e cila ndodhi në Evropë. Bashkësia ndërkombëtare kontribuoi më tepër që kriza e Jugosllavisë të jetë ma shumë në hije dhe pa një qasje direkt.

Bashkësisë ndërkombëtare ndikimin e saj të plotë në krizën jugosllave filloi ta ushtroi atëherë kur Këshilli i Sigurimit i OKB-së shpalli embargot e njëpasnjëshme për shitjen e armëve palëve ndërluftuese. Ndërsa për të ndërmjetësuar në konflikt, në shkurti të vitit 1991 Këshilli i

[173] Jusha .S.Coldesteini, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Botim i katërtë , Dituria Tiranë 2001, fq. 59.
[174] Syl ,Ukshini Kosova në Politikën e Jashtme të BE-së 1991-2007, Shkup , 2008, fq.181.
[175]Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Universiteti AAB Prishtinë, Prishtinë 2007 , fq. 134.

Sigurimit vendosi dërgimin e Helmetave Blu (FORPRONU)[176] në Kroaci për të mbykqyrur zbatimin e armëpushimit të datës 3 janar të këtij viti, si dhe për të lehtësuar dërgimin e ndihmave humanitare. Dislokimi i këtyre forcave u kapë në befasi nga se shpërthej lufta në Bosnje e Hercegovinë. Kjo forcë u vendos në tetor të vitit 1992 u vendos në këtë terren të ri. Impakti ushtarak dhe politik i ndikimit të kësaj force ishte tepër i kufizuar. Mirëpo, kjo forcë ndërkombëtare luajti një rol të rëndësishëm sidomos në zvogëlimin e problemeve humanitare të cilat pushtuan imediat ndërkombëtare, zbulimin e krimeve të kryera (ekzekutimet e kryera në masë të madhe, kampe të ndryshme refugjatësh, përdhunimesh) të bëra publikisht nga kjo forcat ushtarake dhe paramilitare serbe. Dislokimi i Helmet Kaltërve (Blu) në Bosnje Hercegovinë që nga tetori 1992 nuk e ndryshoi aspak situatën dhe forcat serbe vazhduan me të njëjtin ritëm.

2.Komisioni i Badinterit

Roli dhe ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare për ndërprerjen e konfliktit vazhdon edhe pas përfundimit të Konferencës së Hagës përmes dy komisioneve të cilat u formuan në këtë konferencë: *Komisioni i Badinteri* dhe *Komisioni për Sukcesion*[177]. Në gjysmën e dytë të vitit 1991, BE-ja u ndikua nga dy faktor ndikimi: një shtet evropian në Ballkan deri atëherë me një rëndësi gjeostrategjike ishte në shpërbërje e sipër, si dhe krijimin e shteteve të reja të krijuara në territorin e këtij shteti që po kërkonin njohje ndërkombëtare. Për ti dhanë përgjigje këtyre zhvillimeve, BE-ja me disa shtete të tjera jashtë bashkësisë evropiane vendosën të krijojnë një Komision Arbitrazhi. Qëllimi i këtij komision arbitrazhi ishte i drejtuar nga Robert Badinteri[178], i cili edhe hyri në historinë me emrin e ti si Komisioni i Badinterit. Në rekomandimin e tij Komisioni i Badinterit, shpërbërjen e Jugosllavisë e vlerësonte si subjekt të së drejtës ndërkombëtare. Ky komision paraqitet për të parën herë në mënyrë publike me propozimin e tij se:

- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është në proces të shpërbërjes;
- u takon republikave ti zgjedhin problemet e trashëgimisë të shteteve dhe ato që mundë të lindin nga ky proces duke respektua parime dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare, sidomos të drejta e njeriut dhe të drejtat e popujve dhe minoriteteve;
- u takon po ashtu këtyre republikave, nëse duan të punojnë së bashku për të formuar një asociacion të ri të mbështetur në instuticionet demokratike sipas zgjedhjes së tyre[179].

Ky qëndrimi i komisionit duhet parë si njëri nga dokumentet më të rendësishme për krizën e Jugosllavisë dhe duke hedhur poshtë çdo pretendim për luftë të Serbisë për një Jugosllavi unike. Komisioni i Badinteri njohu subjektivitetin e pavarur të katër republikave të Jugosllavisë: (Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë)[180].

Komisioni i Badinterit së bashku me komisionin sukcesionit u mbështet në kushtetutën e vitit 1974 të RFJ-së, mirëpo ky komision për Kosovën ishte një ndëshkim shumë i madh sepse nuk ja njohu Kosovës statusin e elementit konstituiv në federatën Jugosllave. Një gjë këtu u pa qartë se me vendimin e Komisionit të Badinteri Kosova mbetet pjesë e Serbisë dhe Jugosllavisë. Ky komision dorëzoi vlerësimin e kandidatëve potencial që duhet të njohin këto shtete.

[176] Bernard Cory , Evropa Ballkanike , Dituria , Tiranë 2002, fq. 257.

[177] Shih: Mendimi 1 i Komisionit të Badinterit, fq. 13.
[178] Syl Ukshini, Kosova në Poetikën e Jashtme të BE-së 1991-2007, Shkup 2008, fq.121.
[179] Shihni: Mendimi 1 i Komisioni të Badinterit , fq. 13 .
[180] Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë , Universiteti AAB Prishtinë, Prishtinë 2007, fq 137.

Komisioni rekomandoi njohjen e menjëhershme të Sllovenisë dhe Maqedonisë, dhe njohjen e kushtëzuar të Kroacisë me garanci specifike për pakicat serbe në këtë vend, dhe referendumi për Bosnjën e Hercegovinën i cili do të ishte valid vetëm nëse tri komunitetet do të marrin pjesë në numër të duhur. Mirëpo, gjatë punës së komisionit para rekomandimi të tij për njohje të këtyre republikave, Vatikani kishte njohur Sllovenin dhe Kroacinë. Pasi që komisioni në rekomandime e ti ishin në diskrepancë me institucione e BE-së me gjithat komision shpreh rezerva ndaj Kroacisë. Gjermania murrë vendim që njëanshëm ta njohë Kroacinë shtet të pavarur, ndërsa ky pranim ndikon që edhe disa shtete të fuqishme ndërkombëtare që të njofin atë njëanshëm, me gjithë vërejtjet e Komision të Badinterit. Pas të gjithë kësaj mundë të themi se pas njohjes së pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë, përfundimisht dështoi misioni i Lordit Kerington dhe synimi i politikes së jashtme Evropian për ruajtjen e Jugosllavisë unike.
Vlen të theksohet se Komisioni i Badinterit bëri linja orjentuse për njohjen e shteteve të reja, Sllovene dhe Kroate në Janar të viti 1992 e ma vonë edhe të B e H në prilltë vitit 1993. Natyrishtë këtë njohje ishin të rëndësishme nga pikëpamja juridike –ndërkombëtare të luftërave etnike, sepse ajo ishte periudha determinuese e përcaktimit se në ish Jugosllavi zhvillohej luftë ndërkombëtare, e jo për luftë civile[181]. Me gjthë iniciativat e vazhdueshme, Komisioni i Badinterit nuk arriti që të bindë Millosheviqin për një armëpushim të qëndrueshëm, për të hapur mundësin për një zgjedhje të mundshme në territorin e ish Jugosllavisë. Bashkësia ndërkombëtare u detyrua që ndaj ish Jugosllavisë të merr masa tjera të presionit duke sanksione ekonomike për RFJ-në mbështetur në rezolutën 757 të vitit 1992 të KS-së, të cilat nuk dhanë rezultatet e pritura.

3.Konferenca e Londrës

Ideja për thirrjen e një konference paqësore për Jugosllavinë nuk ishte as e re as origjinale por ishte një domosdoshmëri e ndaljes së mosmarrëveshjeve që gjithnjë e më shumë gjeneroheshin në shtetet e Jugosllavisë. Para sajë dhe para konferencës së Keringtonit (Hagës), ideja për thirrjen e një konference ndërkombëtare ndër të parët e inicoi diplomacia austriake në prill të vitit 1991, por konflikti në hapësirën e Jugosllavisë nga zhvillime politike dhe ushtarake ende nuk kishin marrë përmasa të tilla tragjedive e katostrofale. Konferenca e Londrës u thirr pas dështimit të dymbëdhjetëshes evropiane që të shuaj zjarrin e luftimeve në territorin e ish Jugosllavisë[182]. Kur u thirr konferenca e Londrës Bashkësia ndërkombëtare u gjind në një situatë të palakmueshëm. Në fillim të Konferencës së Londrës, si dhe gjatë punimeve të saj BE-ja ishte në një situatë shumë kritike. Ndërsa në këtë kohë në sfondin e diplomacisë globale qarkullonte ideja në promovimin e sekretarit të atëhershëm të OKB-së Butros Galit për diplomaci preventive dhe për OKB si "Qeverisje Botërore". Në një pozicion të pa lakmueshëm gjendet edhe SHBA-ja, në faktin që ishin para zgjedhjeve presidenciale dhe ishte me rrezik nëse ajo futet në një luftë të palakmueshme[183].
Duke i analizuar këto zhvillime të bashkësisë ndërkombëtare mund të konstatojmë se konferenca e Londrës u thirr dhe u organizua si justifikim dhe mbulues e pa aftësisë të botës perëndimore për të zgjedhur problemet në Jugosllavi. Në periudhën e planifikuar për organizimin e konferencës për realizimin e paqes në ish Jugosllavi, zhvillimet në terren kishin marrë përmasa të mëdha, sidomos në Kroaci, ndërsa në këtë kohë filloi edhe lufta në BeH.
Pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në konferencën e Londrës u ftuan vetëm përfaqësuesit e gjashtë republikave sllave të ish Jugosllavisë, përfaqësuesit e BE-së, të gjithë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Kanada, Japonia (përfaqësuesit e të shtatëshes më të pasur në

[181] Sylë Ukshini, Kosova në Politikën e Jashtme të BE-së 1991-2007, Shkup 2008, fq. 123.
[182] Blerim Reka , Diplomacia Preventive dhe Kosova , Prishtinë 1999 , fq 146.
[183] "LONDON SESSION" – OUN AND SITUATION IN FORMER YUGOSLAVIA", (The Asambly and Securiti Council resolutions for former Yugoslavia , no. 713/91-no. 824/93) United Nations Reference papers, may,7, 1993.

Botë), përfaqësues të botës Islame dhe të shteteve fqinjë. Si palë e interesuar u futën edhe shqiptarët e Kosovës dhe vendeve të tjera, serbet e Bosnjës, myslimanët e Sanxhakut dhe hungarezet e Vojvodinës[184].

Në konferencën e Londrës u nxorën dokumente bazë mbi të cilat vendosën themelet e parimeve politike të operacionalizimit të zgjedhjes së krizës në territorin e ish Jugosllavisë, e ato janë: Parimet Themelore, Program Aksional, Deklarata për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Deklarata për Serbinë.

Parimet bazë që solli konferenca e Londrës ishin: Ndërprerja e luftës; mosnjohja e fitimeve territoriale të realizuar me forcë; respektimin e standardeve ndërkombëtare për të drejta e kolektive; respektimi i territorit të gjithë shteteve në rajon; zgjedhja e të gjithave çështjeve kontestuese përmes arbitrazhit, zbatimi i vendimeve që merr OKB-ja; zbatimi i ndihmave humanitare dhe kontrollimi i armëpushimit[185].

Delegacionit të Kosovës, i cili ishte i ftuar të marrë pjesë në konferencë nuk ju lejua që të jetë pjesëmarrës i drejtpërdrejt, sepse sipas pikëpamjes së atëhershme të një pjese të shteteve, dy krahinat autonome Kosova dhe Vojvodina nuk ishin njohur si pjesë sovrane të federatës Jugosllave dhe për këtë arsye nuk u njohën si palë e trashëgimisë së Jugosllavisë[186].

5.Konferenca e Londrës–Gjenevës (1992 – 1995)

Konferenca e Gjenevës ishte një vazhdim i konferencës së Londrës. Duke e parë paaftësinë menaxhuese të krizës, dhe pa mundësin e ndikimit aktiv dhe dinamik ashtu siç e kërkonte situata në terrenin e luftës, organizatorët inagurian gjoja si proces negociator paqësor, për të bartur atë që ishte konferenca e Londrës në selinë e OKB-së në Gjenevë të Zvicrës. Bashkësia ndërkombëtar në disa raste vendimet të cila u silleshin palëve ndër luftuese ishin inspiruse për të luftuar. Harta e punuar në Gjenevë vendosi aso kufijsh për të cilët vlen të luftohet. Është shumë ironike dhe njëkohësisht domethënëse dhe shkurtë reale se me këtë lëvizje të shkruar në hartë, lufta kishte marrë një hovë të ri dhe më të shtuar.[187] Mundë të themi se konferenca e Gjenevës ishte një komplot tragjik për myslimanët e B e H. Harta që u krijuar në Gjenevë ishte një kombinim hartës nacionale të B e H dhe i asaj harte që ishte rikrijuar në territoret të pushtuar me luftë. Ato vende e territore ku është shumica e popullatës kroate ju dhanë kroatëve. Kurse territoret që janë pushtuar nga serbët me luftë ju janë dhanë serbëve, ndërsa territoret e banuara me shumicë myslimane që nuk kanë arritur ti pushtonin serbët ju kanë dhuruar një pjesë serbëve e një tjetër kroatëve. Mundë të themi se një pjesë tepër e vogël e territorit ishte mbetur për popullatën myslimane, si shumicë në B e H. Ky ishte një skenar i gabuar i bashkësia ndërkombëtare, sepse një zgjidhje e tillë nuk ofronte paqe.

Konferenca e Londrës për ish Jugosllavinë dhe procesi i saj negociator për krijimin e paqes në Jugosllavi, që vazhdoi punën në Gjenevë (1992-1995) ishte një përpjekje e pa suksesshme për të arritur objektivat e synuar nga bashkësia ndërkombëtare[188]. Mirëpo, bashkësia ndërkombëtare nuk kishte të ndalur mbi zgjedhjen e këtij problemi, por mundësia ishte shumë e vogël. Iniciativat vazhdoni përmes projekt-planeve të njëpasnjëshme të cilat ishin të hartuar në kuadër të procesit paqësor. Bashkësia ndërkombëtare së bashku me negociatorët e Gjenevës sikur ishin të dedikuar për të dështuar. Plani i Vance-Owen i përpiluar në tetor 1992 ofronte një propozim konkret të funksionimit të BeH si subjekt ndërkombëtar, si një alternativë për ndërprerjen e luftimeve. Në janar të viti 93, të dy bashkëbiseduesit e këtij plani, Vance-Oëen të cilit ishin edhe negociator, mblidhen në Gjenevë të gjithë palët ndërluftuese për t'u paraqitur

[184]Po aty
[185] Po aty
[186]Wlfgang Petitsch , Robert Pichler, Rruga e gjatë në Luftë, Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare 1989-1999. fq. 76-77.
[187]Ramë Buja: Çështja e Kosovës dhe shkatrrimi i Jugosllavisë , Universiteti AAB Prishtinë, Prishtinë 2007, fq. 215-216.
[188]Ramë Buja:Çështja e Kosovës dhe shkatrrimi i Jugosllavisë , Universiteti AAB Prishtinë, Prishtinë 2007, fq. 218.

atyre një planë të ri që përbënte 10 pika dhe që kishte për qëllim themelimin e një B e H shumë të decentralizuar, të tri njësive përbërëse, të ndara në dhjet kantone[189]. Qëllimi i këtij plani ishte që ky shtet të jetë i demilitarizuar, ndërsa komiteti evropian OKB-ja, OSBE-ja do të jenë të angazhuar drejtpërsëdrejti në formimin e kushtetutës, gjyqësorit, dhe të krijojnë një planë dhe një ushtri shumë etnike etj. Plani ishte i papranueshëm për palën boshnjake dhe ata kundërshtuan, ndërsa Karaxhiq (përfaqësues i serbëve të Bosnjës) nënshkroi ketë planë nën ndikimi e Millosheviqit. Karaxhiq nënshkroi por kërkoj që të ratifikonte parlamenti serb në republikën serbe në Bosnje. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje luftimet i intensifikuan në Kroaci dhe B e H, ndërsa më 30 janar 1993 plani Vance-Owen mundë të konsiderohet i dështuar. Ky ishte dështimi i radhës i bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e konfliktit, ndërsa hartuesit e planit kërkuan nga presidenti Klinton që SHBA-të që të ushtroi ndikimin e tij, si dhe vendosjen e trupave amerikane në rajonet e luftimeve. Ndaj këtij plani SHAB-të ishin neutrale, nuk e mbështeten, mirëpo as nuk e kanë hedhur poshtë. Mirëpo, pas ashpërsimit të luftimeve në mes të kroatëve dhe myslimanëve në Sarajevë në prill dhe maj të vitit 1993, presioni e zbatimit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare e shtua. Si projekt, përfundimisht plani mur fund me referendumin e mbajtur me 15-16 maj 1993 i organizuar nga republika serbska në Bosnje, sepse me këtë akt ai u përmbysë.

Dështimi i pa shpresë për rikthyer ky planë, në tërë bashkësinë ndërkombëtare krijoj një bashllëk të dukshëm, pa as një planë, pa politikë të qartë të perspektivës së zhvillimeve, pa as një rolë të veçantë të saj, dhe nuk kishte një zgjedhje për luftërat në Jugosllavi. Vitet në vijim, pamvarsishtë prej zhvillimeve tragjike të cilat ndodhen në terrenin e luftës, dilemat dhe përpjekjet e Uashingtonit dhe Evropianëve ishin për të gjetur një zgjidhje të re dhe këta ishin në dilemat nëse ja vlen apo jo të përdorte forca në B e H. Kjo ishte arsyeja kryesore që ndikoi te bashkësia ndërkombëtare për të hiqur embargon e armëve për myslimanët. Pamvarsisht nga presionit diplomatik që bëhej nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, serbet deri në pranverën e vitit 1994 arritën të gjitha synimet territoriale ku 70% e B e H ishte nën kontrollin tyre. Në pa mundësi për të ushtruar ndikimin e tyre te serbet, bashkësia ndërkombëtare, grupi i Kontaktit mbajti një takim gjatë kësaj kohe dhe vendosi që të ndaloi çdo qarkullim armësh apo municion në këto territore. Kjo ishte strategji e gabuar e Grupi Kontaktit, sepse me këtë plan u goditën vetë myslimanët, ndërsa kroatët dhe serbët e kishin mundësin e leht të furnizimit me armë. Lufta mori përmasa të terrorit mbi popullatën civile, ndërsa bashkësia ndërkombëtare nuk ishte e aftë të reagoi në mënyrë efikase.

Pas shumë përpjekjeve diplomatike, u vendos që mbi forcat ushtarako-paramilitare serbe të bëhej kërcënim për ndërhyrje ushtarake nga ana e NATO-s, si mjet i ndërprerjes së veprimeve luftarake, i cili për efekt pat ndërprerjen e luftimeve. NATO ishte e gatshme të vepronte, mirëpo vendimet ndërkombëtare për ndërhyrje ishin të vonuara, prandaj ajo nuk arriti të veproi në parandalimin e gjenocidit në BeH. OKB-ja dërgoi rreth dyzetmijë paqeruajtës[190] në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kroaci me një shpenzim që arriti shifrën marramendëse një miliardë USD në vit. Përkundër këtij angazhimi, ky mision ishte më i dështuari në Ballkanin Perëndimor.

Deri në vitin 1995, politika e bashkësisë ndërkombëtare ishte e pa qartë në angazhimet e saj në Bosnje e Hercegovinë, sepse fuqitë e mëdha nuk ishin shumë të angazhuar në këtë konflikt. Në SHBA zhvilloheshin zgjedhjet presidenciale, prandaj ishin të rezervuara ndaj politikës ndërkombëtare në këtë luftë, ndërsa OKB-ja dështoi me misionin e saj pasi që forcat serbe pushtuan me shpejtësi dy prej tri zonat të shpallura si "zona të sigurta" në Bosnjën Lindore, ku në duatë e paqeruajtësve të OKB-së ushtria serbe bëri masakrën më të madhe pas luftës së dytë botërore (Masakra e Srebrenicës) në Evropë. Angazhimi ndërkombëtar intensifikohet pas

[189] Radovan Vukadinoviq , Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga Lufta e Ftoftë deri te rendi global, Prishtinë 2007 ,fq. 272.
[190] Jusha .S.Coldesteini , Mardhëniet Ndërkombëtare , Botim i katërt , Tiranë 2001,fq. 59.

korrikut të vitit 1995, kur nën drejtimin e fuqive të mëdha lufta mori kahe tjetër si në politiken ndërkombëtare po ashtu edhe brenda për brenda Jugosllavisë[191]. Në Bosnje Hercegovinë NATO-ja sulmoi objektivat serbe, ndërsa dy javë bombardimesh mjaftua për ti detyruan forcat serbe të pranojnë bisedime.

6.Konferenca e Dejtonit

Pranvera e vitit 1995 shënoi ndryshime shumë të mëdha në terrenin e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, por edhe në diplomacinë preventive nga shtetet më të rëndësishme të politikës ndërkombëtare. Në korrik të këtij viti nën pretekstin e zhvillimeve luftarake, forcat serbe masakruan popullatën civile në qytetin e Srebrenicës, e cila ishte nën protektoratin ndërkombëtar. sipas statistikave aty u masakruan rreth 8.000 civil të të gjitha moshave. Forcat serbe gjatë kësaj kohe pushtuan edhe zonat të cilat llogariteshin të sigurta nga paqeruajtësit të OKB-së. Kroatët të mbështetur nga SHBA-at ndërmorën sulme mbi rajonet që ishin pushtuar nga serbët të Kroacisë, me këtë rast nga territoret e pushtuara u dëbua një numër shumë i madh të forcave serbe. Gjatë kësaj periudhe nga një sulm i forcave serbe në tregun e qytetit të Sarajevës humbën jetë 37 civil, të gjithë mysliman të Bosnjës. Këto veprime, si dhe shumë e shumë të tjera ma parë shteruan shansin dhe pritjet ndërkombëtare se mrekullia e marrëveshjeve në mes palëve ndërluftuese mund të ndodhë. Të gjitha këto veprime bërën që SHBA-at dhe pjesa tjetër e bashkësisë ndërkombëtare, përherë të parë dukej se e ka ndërmend të veproi më seriozisht se asnjë herë më parë. Te kjo ndërhyrje shumë diplomat dhe ndërmjetësues ndërkombëtar mendoi se do kenë sukses, për arsye se SHBA-ja kishte vendosur përfundimisht ta marrë timon në dorë. Deri në këtë periudhë SHBA-të ishin të rezervuara ndaj kësaj çështjeje, duke e autorizua Evropën që të merrej me këtë problem

Shqetësimet për paaftësinë e bashkësisë ndërkombëtare për të zgjidhur problemin e B e H, NATO-ja i shprehë në samitin e Brukselit në të cilin ishte pjesëmarrës edhe Presidenti i SHBA-ve Bill Clinton. Në përfundim të këtij samiti u lëshua një komunikata për media, në të cilën NATO-ja sërish i kërcënon serbët me sulme ajrore. SHBA-të tashmë e kishin të qartë se Serbisë duhej treguar forca që të hiqet dorë nga projektet serbomëdha siç e projektonin disa politikan serb dhe njëherësh të detyrohej të pranonte atë zgjedhje ndërkombëtare që i imponohet, por kjo fillimisht duhej të bëhet frontet ku ajo kishte demonstruar forcën dhe dhunën dhe kishte krijuar fakte reale. Përvoja e deritanishme kishte treguar se evropianët së bashku me disa pjesë të bashkësisë ndërkombëtare ishin treguar të paafta që ta zgjidhin krizën jugosllave. Prandaj, pritej ndërhyrja amerikane që të shfaqej para se perëndimi të përballej me një bankroto politik dhe moral ndër më të rëndët e kohës së re [192]. Pas disa ndryshimeve që ndodhen në ternin e luftës mes kroatëve dhe myslimanëve të Bosnjës, gjendja në terrenin e luftës kishte ndryshua, për amerikanët. Ky ndryshim kishte ndikim në menaxhimin e krizës, sepse ishte e kuptueshme se diplomacia amerikane haptas ishte në anën e kroatëve dhe myslimanëve të Bosnjës. Pas të gjithave këtyre ndryshimeve edhe disa masakrave që kishin ndodhë me iniciativën e SHBA-ve, NATO murrë dritën jeshile që të intervenoi. Për amerikanët ishte vetëm një diplomacia e forcës e cila do të ndikonte në përfundimin e luftës.

Më 30 gushtë deri me 14 shtator 1995 filluan bombardime e kufizuar ajrore të NATO-së ndaj pozicioneve serbe për rreth Sarajevës dhe në pjesë tjera strategjike. Serbia tash e tutje e shihte vehtën si humbëse, sepse në njërën anë u sulmoheshin nga forcat ajrore të NATO-së kurse në ane tjetër nga toka nga boshnjakët–kroatët dhe ishte e pa mundë që ti furnizonte me armatim të rënd forcat e veta në terren.

[191]Po aty , faq 60.

[192] Wsley K. Clark, Të Bësh Luftë Moderne, Zëri ,Prishtinë 2003, fq. 82.

Si rezultat i këtyre veprimeve, Millosheviqi pranon propozimet e të dëbuarit special të SHBA-ve, ambasadorit Richard Hollbruk dhe me këtë rast arrin që të ruaj një pjesë të pozicioneve të cilat i kishin pushtuar forcat ushtarako paramilitare serbe. Emisari amerikan Richard Hollbruk aplikon një metodë të re pune shumë efektive, ku Beogradi dhe Grupi i Kontakti do të vihen në veprim të drejtpërdrejt dhe në interval kohor vetëm për një muaj. Nga dta 8 deri më 7 tetor arrihet pëlqimi rreth çështjeve që për vite të tëra nuk do të mundë të pajtoheshin. Mbledhja e parë e Grupit të Kontaktit të mbajtur në Gjenevë më 8 gusht, e dyta në Nju Jork me 27 shtator, ndërsa e treta 7 tetor në Moskë, ku edhe merret vendimi për thirrjen e Konferencës së Dejtonit..

Konferenca e Dejtonit, e nëntorit të vitit 1995 e cila drejtohej nga Richard Hollbrroke i dërguar i posaçëm i SHBA-ve, erdhi si rezultat i kombinimi të forcës dhe forcës poltike[193]. Në atë konferencë u arrit një marrëveshje për B e H dhe Sllavoninë Lindore, një enklavë e banuar me serbë që kishte mbetur në shteti e Kroacisë. Marrëveshja sanksionoi B eH si shtet me dy etnitete të ndara në mes të serbëve dhe kroatëve-myslimanëve. Ajo krijoi B e H si një shtet sovran të përbërë nga dy njësi me mjaft autonomi, një federatë muslimano-kroate, të quajtur Federata e B e H dhe një njësi pak më të vogël mini-shteti të drejtuar nga serbët boshnjakë, të quajtur Republika Serpska. Ajo përcaktoi gjithashtu kufijtë ndërkombëtarë dhe ndër-etnikë të vendit[194]. Marrëveshja e Dejtonit u nënshkrua më 14 dhjetor 1995, nga: Izet Begoviq, Millosheviq, Tuxhman, në Parisë, Francë. Kjo marrveshje e arritur, kishte edhe pjesen shqetsuse për mbykqyrje dhe iplementim që përbëhej nga 60.000 trupa që ishin nën komandën e NATO-së.

Marrëveshjet e Dejtonit i dhanë fund konfliktit brutal tre vjeçar në Bosnjë-Hercegovinë. Ajo përcaktoi ndarjet politike dhe strukturën e qeverisë së vendit dhe krijoi mandatin për një sërë organizata ndërkombëtare që do të ndiqnin, kontrollin dhe zbatonin elementet e marrëveshjeve. Mund të konstatojmë se kjo marrëveshje erdhi si rezultat i ndërhyrjes diplomatike dhe ushtarake të SHBA. Politika me mjete të forcës rezultoi e suksesshme në përfundimin e luftës në ish Jugosllavi.

Pas marrëveshjes së Dejtonit çështje e shqiptarëve të Kosovës mori dimensione të tjera të angazhimit ndërkombëtar. Pasi që çështja e Kosovës nuk u futë në agjendën e Dejtonit, porosia e presidentit amerikan Klinton për shqiptarët ishte se: “Kosova do të merret parasysh me një rast të veçantë, ku do ti kushtohet një vëmendja e duhur”. Për të zgjuar interesimin ndërkombëtar, që Kosova të kthehet në “çështje të veçantë”, dhe të arrij deri atje, atëherë edhe shqiptarët duhej të ndryshonin format e veprimit. Ishte momenti i fillimit të aktiviteteve edhe në rezistencën aktive-luftë. Në këtë periudhë në Kosovë filloi intensifikimi i rezistencës aktive. Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe rezistenca politike ishin duke udhëhequr një fushatë të ashpër për pavarësi, ndërsa forcat e serbe reagonin duke zhvendosur dhe masakruar popullatën civile. Këto veprime forcat serbe i intensifikuan sidomos në vitin 1998/99, mirëpo bashkësia ndërkombëtare e udhëhequr nga SHBA vepruan me shpejtësi duke ndaluar spastrimin etnik të territorit të Kosovës[195].

Në zgjedhjen e konfliktit të Kosovës kishte kundërshtime të kundërta mes fuqive të mëdha, SHBA-ve dhe Rusisë. SHBA-të mbështeten përpjekjet e shqiptarëve për pavarësi në të gjitha fazat e zhvillimit, ndërsa rusët mbështetën serbët në përpjekjet e tyre për realizimin e skenarëve të tyre.

Më në fund bashkësia ndërkombëtare në krye me SHBA e kishte kuptuar se me Serbinë mund të bisedohej vetëm me mjete të forcës dhe se historia ua kishte treguar këtë ndërkombëtarëve.

---

[193]Dokument nga Marrëveshja e Dejtonit , fq. 54.

[194] http://www.ssonline.com.mk/default-AL.asp.

[195]Jusha .S.Coldesteini , Marrëdhëniet Ndërkombëtare , Botim i katërt , Tiranë 2001, fq, 60.

Përherë të parë organizohej një Konferencë vetëm për Kosovën nga bashkësia ndërkombëtare e iniciuar nga SHBA ku u ulen në tavolinë për të biseduar mes shqiptarëve dhe serbëve në Konferenca e Rambuje. Një fakt duhet ditur se Konferenca e Rambujes la gjurmët të pashlyeshme në histori, për faktin e reflektimeve të mëpastajme politike, diplomatike e ushtarake nga kjo konferencë bashkësia ndërkombëtare si asnjëherë u bë ma unike në çështjen e sigurisë dhe zgjidhjen e problemit të Kosovës.

Konkluzionet Përfundimtare

Në fund të viteve të 80-ta, dinamika e marrëdhënieve ndërkombëtare u karakterizua me konotacione jashtëzakonisht negative. Zgjerimi i NATO-së drejt Lindjes, veprimi i NATO-s "jashtë sferës", konfliktet në Ballkanin Perëndimor dhe konfliktet në Çeçeni kontribuuan në identifikimin e marrëdhënieve në mes aleatëve euroatlantik dhe Rusisë si "paqe e ftohtë" apo "lufta e re e ftohtë".
Në ngritjet dhe zbritjet ad hoc të marrëdhënieve të tyre, aleatët euroatlantik,veçmas SHBA-të, gjithmonë ia kanë bërë plotësisht të qartë Rusisë se prej ish - statusit të saj si superfuqi, pavarësisht nga armët e dobëta nukleare, në të vërtetë nuk i ka mbetur asgjë e vlefshme që do t'i mundësonte Rusisë hyrjen e saj në klubin e të favorizuarve të Atlantikut. Ballkani Perëndimor është territor të cilin politika ruse tradicionalisht e kishte përjetuar si sferë të ndikimit të vet. Ngjarjet tragjike pas rënies së Federatës Jugosllave dëshmuan se as aleatët evropianë të Amerikës, as Rusia nuk kanë vullnet konkret politik dhe as mjete dhe instrumente objektive t'i ndalojnë konfliktet e armatosura. Politika amerikane prandaj solli paqe në Ballkan. Mund të thuhet se pikërisht për shkak të lidhjeve specifike të këtij territori me Rusinë, politika amerikane testoi mundësitë reale politike, ekonomike si dhe të atyre konkrete ushtarake dhe dimensionet e veprimit rus jo vetëm në Ballkan por edhe më gjerë. Pra, mossuksesi apo suksesi i kufizuar i Rusisë në Ballkan duheshin treguar pjesës tjetër të bashkësisë ndërkombëtare vendin dhe rolin e Rusisë në rendin e ri botëror.
Operacionet dhe Misionet paqeruajtëse në Ballkanin Perëndimor s'ishte e lehtë për ti analizuar, sepse zhvillimet e përgjithshme në këtë dy dekada, dinamika i zhvillimit të ngjarjeve, si dhe strategjitë e përdorura në këto misione ishin të llojllojshme. Pas viteve 90-ta Ballkani Perëndimor u përfshi në dhunë dhe luftëra, si pasojë e shpërbërjes së ish Jugosllavisë. Bashkësia ndërkombëtare, përkundër përpjekjes diplomatike, ajo nuk arriti që t'i parandaloj këto konflikte, prandaj e vetmja alternativë mbeti angazhimi i saj përmes operacioneve dhe misioneve të ndryshme të mbështes proceset demokratike në Ballkanin Perëndimor. Këto Misione dhe operacione në të gjitha vendet ku vepruan kishin për qëllim dhe objektiv ndërprerjen e luftës, ruajtjen e paqes dhe mbështetje në ndërtimin e paqes, si dhe mbështetjen e shteteve të Ballkanin Perëndimor në proceset e integrimeve euro-atlantike.
Përkundër përpjekjeve dhe angazhimeve të cilat dhanë rezultate të drejtpërdrejta në terrenin e luftës, mund të themi se bashkësia ndërkombëtare në Misionet e saja në Ballkanin Perëndimore në disa raste u sfidua. Si pasojë e mosveprimit të ndërhyrjes parandaluese, forcat ushtarako-policore serbe realizuan projektin gjenocidial ndaj popullatës civile në Serebrenicë, Bosnje dhe Hercegovinë.

Bibliography:

1. "LONDON SESSION" – OUN AND SITUATION IN FORMER YUGOSLAVIA", (The Asambly and Securiti Council resolutions for former Yugoslavia , no. 713/91-no. 824/93) United Nations Reference papers, may,7, 1993.
2. Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike, Prishtinë 2008
3. Bernard Cory , Evropa Ballkanike , Dituria , Tiranë 2002
4. Blerim Reka , Diplomacia Preventive dhe Kosova , Prishtinë 1999
5. Dokument nga Marrëveshja e Dejtonit , fq. 54.
6. Enver Hasani, Vetëvendosja, Integriteti Territorial dhe Stabiliteti Ndërkombëtar: Rasti i jugosllavis, Gjon Buzuku, Prishtinë, 2010
7. http://www.ssonline.com.mk/default-AL.asp
8. Jusha .S.Coldesteini, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Botim i katërtë , Dituria Tiranë 2001
9. Karen A. Mingst, Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Tiranë 2008
10. Radovan Vukadinoviq , Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga Lufta e Ftoftë deri te rendi global, Prishtinë 2007
11. Radovan Vukadinoviq, Mardhënjet Ndërkombëtare nga Lufta e Ftoftë deri te rendi global, Kolegji Universitar "Victori", Prishtinë 2007
12. Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Universiteti AAB Prishtinë, Prishtinë 2007
13. Ramë Buja, Kosova në Krizën Jugosllave, AAB Riinvest,Prishtinë 2011
14. Robert L. Hutchings , Als der Kolte Krieg Zu Ende war, Eim Berichrt aus dem Immerem Macht, Berlin 1999
15. Shaban Sinani, Kosova në Gjeopolitikë, Dritëro, Tiranë, 1998
16. Shihni: Mendimi 1 i Komisioni të Badinterit , fq. 13 .
17. Syl ,Ukshini Kosova në Politikën e Jashtme të BE-së 1991-2007, Shkup 2008
18. Wlfgang Petitsch , Robert Pichler, Rruga e gjatë në Luftë, Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare 1989-1999.
19. Wsley K. Clark, Të Bësh Luftë Moderne, Zëri ,Prishtinë 2003

Denisa Bruçaj, MA
Kolegji profesional "ARGENTI",SHKODER
Dr.sc. Jetmire Zeqiri
Fakulteti Juridik - Universiteti Shteteror i Tetoves

37 Nevoja për zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri

Abstract

Shoqëritë janë dhe mbeten e ardhmja e zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Zhvillimi dhe modernizimi i një ekonomie nuk mund të perceptohet pa një treg kapitali e bursë të zhvilluar,pa tregues të lartë makro e mikroekonomikë dhe financiarë.
Nuk është e lehtë të saktësohet kur filloi të funksionojë formalisht bursa e parë e letrave mevlerë. Mendohet se bursat e para kanë qenë me origjinë italiane. Rreth vitit 1400, në Venedik bëhej tregtimi i borxheve publike dhe hartohej një listë për këtë qëllim. Në vazhdim,gjenovezët dhe milanezët i dhanë një shtysë të madhe panaireve të këmbimit. Ndërkohë që nëvitin 1531, në Anversë të Belgjikës, lindi e para bursë e madhe e letrave me vlerë. Por duhej pritur viti 1785 që bursa e Amsterdamit (Hollandë), të ishte e organizuar zyrtarisht. Sot në botë kemi mbërritur në një numër të madh bursash, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmendim atë të New York-ut (NYSE), atë të NASDAQ, të Tokios (TSE), Bursën e Londrës(LSE), të Frankfurtit etj. Këto bursa quhen ndërkombëtare, për shkak të numrit të madh të shoqërive aksionere të listuara nga e gjithë bota, shtrirjes gjeografike të këtyre shoqërive, klientelës së ndryshme të blerësve dhe shitësve, që përdorin tregun.
Bankat e nivelit të dytë në vendin tonë po shtohen dhe po fuqizohen financiarisht, por ato në asnjë rast nuk mund të zëvendësojnë rolin e institucioneve të tjera të tregut, një ndër të cilat është dhe Bursa e Tiranës. Një sistem financiar i shëndoshë kërkon praninë e bankave, por edhe të institucioneve të tjera jobankare. Bursa është edhe më e ndjeshme se sa bankat e nivelit të dytë ndaj informalitetit ekonomik, mungesës së bilanceve reale, mentalitetit njëpronësor të biznesit etj.; fenomene që ende ekzistojnë në vendin tonë.

1.Tregu i kapitaleve është i nevojshëm:

Për të garantuar një sistem likuid dhe të qëndrueshëm, në të cilin investitorët mund të kryejnë akte shitblerjeje të letrave me vlerë. Për t'u mundësuar shoqëritë aksionere, qeverisë dhe enteve të tjera, të sigurojnë fonde për rritjen dhe investimet e tyre, nëpërmjet emetimit dhe shitjes së aksioneve, obligacioneve dhe llojeve të tjera të letrave me vlerë.
Për të mundësuar investimin e kursimeve të subjekteve që kanë teprica fondesh financiare.
Bursa e Tiranës, e para bursë në Shqipëri, u hap në 2 maj 1996, në formën e një departamenti të Bankës së Shqipërisë. Si në të gjitha vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore, me një të kaluar të ngjashme me Shqipërinë, shteti ishte promotori dhe mbështetësi kryesor i krijimit të bursës.
Në Shqipëri u ndoq një model i ndryshëm (shih aneksin) nga eksperienca e të gjitha këtyre vendeve14, pasi u vendos që Bursa e Tiranës të krijohej nën administrimin e Bankës Qëndrore dhe kjo për këto arsyje:

1. Mungesa e një tradite të mëparshme në këtë drejtim,
2. Gama e kufizuar e instrumenteve financiare,

3. Një sektor privat më i dobët sesa në vendet e tjera të Europës Qëndrore dhe Lindore,
4. Mosfillimi ende i privatizimit të ndërmarrjeve strategjike
5. Shanset e vogla të sigurimit, brenda një periudhe afatshkurtër, të eficiencës ekonomike të këtij institucioni të ri.
1. Mungesa e ekspertëve dhe e eksperiencës përkatëse jashtë institucioneve shtetërore të sferës financiare (në rastin tonë banka e Shqipërisë).

Të ndërgjegjshëm se aktiviteti i kësaj burse, për një periudhë afatmesme nuk do të ishte tregtimi i aksioneve, qeveria në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Komisionin e Letrave me Vlerë, vendosën të organizojnë pranë Bursës së Tiranës tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit. Pavarësisht se këto nuk janë aktivitete "natyrale" të bursave, me këtë lëvizje iu shërbye më shumë objektivave të tjerë si :

Krijimit të një tradite të funksionimit të aktivitetit operacional të Bursës së Tiranës, Kryerjes së një marketingu dhe edukimin e publikut dhe institucioneve, mbi funksionimin e bursës dhe funksionimin e ndërmjetësave financiarë,Grumbullimit nga stafi ekzistues i Bursës së Tiranës të një eksperience të nevojshme mbi parimet e tregtimit dhe të pastrimit e rregullimit të letrave me vlerë,

Përgatitjes graduale teorike dhe praktike të këtij stafi për të përballuar më tej angazhimin e Bursës së Tiranës në aktivitetet e reja në të ardhmen.

Pak ose aspak u bë për futjen e produkteve të reja apo zhvillimin dhe konsolidimin e atyre ekzistuese. Normalisht, duhej që Bursa e Tiranës të ingranohej në proçesin e privatizimit që do të vijonte pas vitit 1996, listimin e shoqërive aksionere, si dhe të konsolidonte më tej tregun e bonove të thesarit. Por, aktualisht, Bursa e Tiranës:

- Nuk ka ende të listuar asnjë aksion, qoftë të ndërmarrjeve të dala nga privatizimi ashtu dhe nga biznesi privat,
- Tregu primar i bonove të thesarit nuk zhvillohet më në Bursën e Tiranës që nga 1 gushti 1998,
- Bonot e privatizimit nuk u tregtuan asnjëherë në bursë, duke mos u shndërruar asnjëherë në një objekt real tregtimi

2. Produktet e domosdoshme dhe të mundshme që mund të tregtohen në Bursën e Tiranës.

Pa dyshim, produkti më thelbësor i një burse kapitalesh është aksioni. Burimet e "furnizimit" të Bursës së Tiranës me aksione janë dy: sektori privat dhe shteti.

Sektori privat

Sektori privat, të paktën për një periudhë afatshkurtër, duket se do të vazhdojë të qëndrojë larg Bursës së Tiranës. Ndër pikat që nuk favorizojnë një listim të mundshëm të këtyre shoqërive në Bursën e Tiranës përmendim:

Mosplotësimi i kritereve cilësore për listim.

Ndër këto kritere mund të përmendim nivelin e ulët të administrimit dhe cilësinë e raportimeve financiare.

Lloji i aktivitetit të bizneseve

Biznesi i madh është i përqëndruar në aktivitete me qarkullim të shpejtë të kapitalit15. Kjo tregon që në përgjithësi biznesi i madh shqiptar është ende i angazhuar në aktivitete që kërkojnë pak investim dhe kanë fitim më të shpejtë

Forma e pronësisë dhe kultura e biznesit

Biznesi i madh shqiptar është i organizuar kryesisht në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Ende në Shqipëri është në nivel të ulët organizimi në formën e shoqërisë aksionere. Përveç të tjerash, ky është një tregues i traditës dhe i kulturës së zhvillimit të biznesit, që do të

thotë se preferohen më tepër forma me një ose pak pronarë se sa bashkimi i shumë aksionerëve. Kjo, deri diku, ndikon në shkallën e ulët të nevojave për
zhvillimin e tregut të kapitaleve

Kultura e dobët financiare e administratorëve dhe stafit drejtues

Administratorët dhe stafi drejtues i kompanive shqiptare kanë pak ose aspak njohuri mbi tregun e kapitaleve, instrumentet financiare dhe përdorimin e këtij tregu për financimin e aktivitetit të tyre ekonomik.Mungesa e konkurencës së mirëfilltë midis kompaniveNjë ndër nxitësit kryesorë që bizneset të kërkojnë financime nëpërmjet bursës është dhe faktori i konkurrencës, por në Shqipëri konkurrenca brenda sektorëve respektivë të
ekonomisë nuk është në ato nivele që domosdoshmërisht të kërkojë financimin në shkallë të gjerë të bizneseve shqiptare nëpërmjet bursës.

Megjithtë ekzistojnë dhe pika optimizmi në këtë drejtim. Një pjesë e kritereve sasiore, që kanë të bëjnë më madhësinë e kapitalit aksioner dhe me numrin minimal të aksionerëve,
plotësohen në një nivel të kënaqshëm nga shoqëritë aksionere18. Kriteret e Bursës së Tiranës (të paktën ato sasiore) nuk përbëjnë pengesë serioze për kompanitë shqiptare për t'u kuotuar në të. Gjithashtu, ekziston dyshimi se pavarësisht nga niveli i ulët i fitimeve që bizneset raportojnë në zyrën e tatim-taksave, niveli i fitimit dhe gjendja financiare e biznesit privat duhet të jetë më e mirë sesa realiteti formal, gjë që duhet të shihet si një fakt pozitiv për të ardhmen.

Në kushtet kur sektori privat në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme mbetet vetëm një burim potencial aksionesh për Bursën e Tiranës, Shteti mbetet shpresa e fundit dhe e vetme për t'i siguruar aksionet Bursës së Tiranës. Këto aksione duhet të sigurohen nëpërmjet përfshirjes së saj në proçesin e privatizimit të kompanive strategjike. Një përfshirje e Bursës së Tiranës në këtë proçes, përveç garantimit të zhvillimit të mëtejshëm institucional dhe operacional për të, do të jepte dhe efekte të tjera pozitive si: privatizimin transparent të kompanive strategjike, krijimin e menjëhershëm të disa mijëra aksionerëve, të cilët pas blerjes së aksioneve në tregun primar do të fillojnë t'i shesin ato në tregun sekondar dhe kjo nënkupton të ardhura për bursën,
rritjen e kredibilitetit të Bursës së Tiranës, listimin e shpejtë dhe plotësimin më me lehtësi të të gjitha kritereve të Bursës së Tiranës nga këto kompani, nxitjen dhe promovimin tek sektori privat i përparësive të kuotimit në bursë, edukimin dhe tërheqjen e popullatës drejt titujve të pronësisë, si një alternativë investimi të fondeve të lira dhe kursimeve të tyre, përdorimi i mundshëm i bonove të privatizimit, duke i shërbyer dhe qëllimit të angazhimit të këtyre letrave me vlerë në proçesin e privatizimit.

Eksperienca të tilla (privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet ofertës publike) gjenden, pothuaj pa përjashtim, në të gjitha vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore. Një pjesë e konsiderueshme e kompanive, që janë aktualisht të listuara në bursat respektive të këtyre shteteve, janë kompanitë e dala nga privatizimi me këtë formë (përmendim këtu Poloninë, Hungarinë, Slloveninë, Kroacinë dhe Bullgarinë).

Madje, Bursa e Zagrebit, ka organizuar dhe ankandet primare të shitjes së paketave të aksioneve për disa ndërmarrje shtetërore.

Në Shqipëri, oferta publike si metodë privatizimi, nuk u aplikua në asnjë prej privatizimeve të kryera gjatë vitit 2000 si privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare, Fabrikës "Ajka", Fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë dhe në Elbasan, Kantinës së pijeve "Gjergj Kastriot Skënderbeu" etj., apo privatizimeve të mëvonshme si Banka e Kursimeve, Albtelekom, OSSH, AMC, Birra Tirana etj.

Përfundime

Funksionimi i Tregut të kapitaleve në Shqipëri mendoj se do të sillte efekte pozitive jo vetëm për kompanitë shqiptare, por edhe për ekonominë e vendit.
Përvoja ka vërtetuar se rritja ekonomike është më e madhe pas funksionimit të tregut të kapitalit. Kjo lidhje pozitive është vërtetuar dhe në ekonomi të vogla.
Në botë ka dhjetra bursa, madje dhe në rajonin e Ballkanit, që nuk mund të krahasohen me bursat amerikane, por që funksionojnë mirë dhe që u shërbejnë ekonomive

Biblografi

1. Banka e Shqipërisë "Buletini ekonomik"
2. www.amf.gov.al
3. www.bankofalbania.org

Dr.sc. Jetmire Zeqiri

Fakulteti Juridik - Universiteti Shteteror i Tetoves

Dr.në process Artan Osmani

38 Siguria e pagesave ndërkombëtare

Abstracti

Zhvillimi i forcave prodhuese dhe aplikimi i teknologjisë moderne kanë ndikuar në ngritjen e produkutivitetit të punës dhe në rritjen e sasisë të produkteve materiale. Prandaj tregu kombëtar është bërë i vogël për realizimin e tyre, prandaj është kërkuar rrugëdalja për shitjen e tepricave të prodhimit në botën e jashtme dhe njëkohesisht asnjë shtet nuk mund ti plotësojë krejtësisht nevojat e veta, dhe jane të detyruar që disa lënde të para, gjysmëprodukte ti blejnë prej vendeve të tjera. Marrëdhëniet ekonomike midis shteteve krijohen në bazë të qarkullimit të mallrave, shërbimeve, fuqisë punëtore, kapitalit, mes tyre. Prandaj këmbimi ndërkombëtar është baza ekonomike për krijimin e qarkullimit të pagesave midis vendeve.

1.Siguria e pagesave ndërkombëtare

Arkëtimi i kreditit, në varësi të çdo transaksioni ndërkombëtar, mund të rezervojë probleme të rëndësishme. Për të shmangur këtë risk është e nevojshme një njohje e thellë e fushës dhe njohja e teknikave, karakteristikat, mekanizmat, avantazhet dhe disavantazhet e formave të pagesës në një përdorim të tregtisë ndërkombëtare, bëhet një element strategjik.

Elementët që duhet të konsiderohen për një pagesë ndërkombëtare janë përgjithësisht 6:

1. **forma e pagesës** – mund të jetë: një transfertë bankare, një arkëtim bankar, një arkëtim të thjeshtë, një arkëtim elektronik
2. **mënyra** – mënyra e pagesës mund të jetë ose korrier/posta ose SWIFT
3. **data** – pra koha e pagesës mund të paraprihet, shtyhet ose të jetë kontestuale
4. **vendi i pagesës** – mund të jetë vendi i blerësit, i shitësit ose një vend i tretë
5. **valuta e përdorur** – përsa i përket monedhës mund të përdoret valuta kombëtare ose një valutë tjetër
6. **bankat që duhet të ndërhyjnë në pagesë** – janë të thirrura në çështje ato që kanë llogaritë



Variablat e lidhur me pagesën ndërkombëtare janë të shumtë dhe janë elementë për tu konsideruar në momentin e zgjidhjes së tregut dhe kryesisht janë:
- paaftësia paguese e blerësit, më mirë e përkufizuar si risku tregtar
- situata ekonomike-politike e vendit të blerësit
- mundësia për të aktivizuar një mbulim tregtar ose politik
- distanca dhe volumi i furnizimit
- politika monetare e vendit të blerësit

Për të kërkuar arritjen e një grade të lartë të sigurisë në një pagesë ndërkombëtare duhet të ndiqen disa rregulla bazë:
- të informohemi rreth besueshmërisë dhe likuiditetit të anës së jashtme (I.C.E siguron një shërbim kërkimi të anëve të jashtme me pagesë)
- duhet gjithmonë të kontraktohet mbi formën e pagesës
- të përgatitemi mbi zgjidhjet e mundshme në lidhje me pagesën
- të vendoset saktësisht forma teknike e pagesës [196]

2.Risqet në pagesat ndërkombëtare

Një nga vështirësitë më të mëdha që duhet të përballojnë sipërmarrësit që operojnë me jashtë është përcaktimi i kushteve të pagesës më të përshtatshme për të mbrojtur interest e tyre, qofshin ato shitës apo blerës: shitësi ka interes të evitojë riskun e pagesës së vonuar apo të munguar; blerësi tenton të ruajë, sa më shumë të jetë e mundur, likuiditetin e nevojshëm për të realizuar pagesën duke kërkuar ta paraprijë në lidhje me dorëzimin e mallit ose me kryerjen e shërbimit, sidomos me qëllimin e verifikimit, ndërkohë, nëse malli ose shërbimet e ofruara janë konform asaj çfarë është rënë dakort. Për të mos folur më tej për kontrata më komplekse sesa ato të shitblerjes së të mirave dhe shërbimeve, ku nevojat e dy anëve, bëhen gjithnjë e më të vështira për tu plotësuar.
Disa konsiderata që do të bëjmë këtu në vijim, për përballimin e kësaj problematike, vlejnë edhe në rastet e transaksioneve kombëtare. Megjithatë, në tregtinë me jashtë, ndërhyjnë faktorë specifikë për të cilët është e nevojshme të mbahet llogari cilët, për shembull, situate ekonomiko-financiare e vendit të interesuar nga transaksioni, karakteristikat e ndryshme shoqërore – kulturore të partnerit të huaj, mungesa e një kuadri juridik të referimit të sigurt dhe njëtrajtshëm, dhe mbi të gjitha, vështirësitë më të mëdha në aksionimin e instrumentëve të mbrojtjes në rastet e problemeve. Na jepet pra detyra e informimit të operatorëve rreth mjeteve kryesore të cilët ndërmarrja i disponon për të kryer ose për të marrë pagesat ndërkombëtare, duke marrë parasysh sistemin juridik në të cilin ndërmarrja gjendet të operojë dhe risqet që ajo has në ambjentin ndërkombëtar.

-3. Risqet kryesore në pagesat ndërkombëtare

1. **Risku i prodhimit**

Flitet për riskun e prodhimit çdo herë që sipërmarrësi vë në prodhim produktet e tij pa garancinë e rekuperimit, në total ose pjesërisht, kostot eventuale. Risku verifikohet sipas disa arsyeve të lidhura, mbi të gjitha: a) vendime të marra nga blerësi (p.sh. revokim ose pezullim të urdhërit ose mostërheqje e mallit); b) ndryshim i kushteve ekonomiko-financiare të blerësit ose të vendit të destinacionit; c) variacione të kostove të prodhimit.

[196] http://impresamia.com/internazionalizzazione/425.html

Siç do të shohim më tej, për të mbajtur nën kontroll ose për të limituar risqet, mund të jetë oportune, për eksportuesin, parashikimi i formave të pagesës pjesërisht të paraprira. Në rastet kur kjo nuk do të ishte e mundur, është gjithsesi e këshillueshme tutelimi në bazë të marrëveshjes, duke parashikuar p.sh., a) limite në aftësinë e revokimit ose pezullimit të urdhërit nga ana e blerësit, e forcuar nga klauzola penale, b) identifikimin dhe limitimin e çështjeve të forcave madhore, c) të drejtën e shitësit për të mos u përgjigjur për furnizimin në rastet kur ai mungon, pjesërisht apo në total, garancia e përbërë nga kapacitetet ekonomike të blerësit ose nga sistemi ekonomik në të cilin ky i fundit gjendet të operojë, përveç, d) klauzolave të variacionit të çmimit të lidhura me variacionin e kostove të prodhimit.

2. Risku tregtar

Risku tregtar është i lidhur në fakt me likuiditetin dhe besueshmërinë e klientëve dhe për kreditin që shitësi i jep këtyre të fundit pa garancinë e marrjes së pagesës së duhhr për skadencat e rëna dakort. Me qëllim reduktimin e këtij risku, duhet të verifikohen, para së gjithash likuiditeti dhe besueshmëria e klientit dhe të përkufizohet më kontratë një formë pagese e përshtatshme, duke mbajtur dhe parasysh për karakteristikat (kulturore, juridike, tregtare, politike) të vendit të jashtëm. Mund edhe të merret në konsideratë mundësia e pasjes së garancive nga debitori, pra vendosja e policave të sigurimit për mbulimin e riskut në fjalë.

3. Risku i kthimit

Risku i kthimit qëndron si për shitësin, edhe për blerësin, në rastet e kontratave të nënshkruara në valuta të huaja, për shembull, në vijim të pjesëmarrjes në ankande ose prokurime. Një risk i tillë konkretizohet, në substancë, kur vlera e marrëvjeshjes nuk koinçidon me korresponduesin e derdhur për aktin e pagesës për shkak të një variacioni të vlerës të monedhës së përdorur për rregullimin e raportit. Edhe ky risk mund të reduktohet ose mund të mbulohet tërësisht.

4. Risku i vendit

Një risk i tillë verifikohet në rastet kur pagesa ose transaksioni nuk realizohen, pasi vendi i anës që duhet të kryejë pagesën nuk është në gjëndje, për motive të ndryshme (ekonomike, financiare, politike por edhe të lidhura me luftërat apo shkatërrimiet natyrore), ti bëjë ballë detyrimeve financiare të ndërmarra nga sistemi në lidhje me subjektet jo residente. Një nga zgjidhjet e mundshme në këtë rast është vendosja e një police siguruese për mbulimin e këtij risku, më pak i mundshëm por i rrezikshëm.

5. Rreziqet ligjore

Rreziqet e një interpretimi të ndryshëm të kushteve kontraktore dhe tregtare dhe rreziqet që rrjedhin nga kuadri ligjor i ndryshëm. Në një transaksion ndërkombëtar është e rëndësishme që të mos merret asnjë gjë si e dhënë dhe të përcaktohen me saktësi termat dhe kushtet, duke përfshirë mënyrat e pagesës, duke përdorur terminologjinë e përshtatshme në një gjuhë të kuptueshme nga të dy palët (shpesh është e panevojshme të përmendet se bëhet fjalë për gjuhën angleze). Për të shmangur ose zvogëluar rreziqet e interpretimeve të ndryshme të kushteve të kontratës, ajo është shumë e dobishme ti referohemi, rregullave uniforme ndërkombëtare dhe praktikave të tilla si ato të zhvilluara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (Paris) dhe të përdorimit të modeleve të kontratave ndërkombëtare, përgatitur nga shoqatat tregtare apo dhomat e tregtisë, me përvojë dhe të besueshme nga pikëpamja e njohurive juridike – gjuhësore.

4.Instrumentët e mbrojtjes se destinuesit të pagesës ndërkombëtare

Informacionet tregtare dhe garancitë juridike

Siç është përmendur dhe ilustruar në paragrafin e mëparshëm, risqet e mungesës së pagesës në transaksionet tregtare mund të limitohen, si duke marrë sa më shumë e mundur informacione mbi likuiditetin dhe besueshmërinë e anës tjetër, dhe mbi riskun relativ të vendit, dhe përmes formimit të klauzolave kontraktuese dhe parashikimin e garancive të posaçme, si për shembull garancitë bankare.

Verifikimi i likuiditetit dhe besueshmërisë së klientëve

Për ndërmarrjet që operojnë në tregjet ndërkombëtare, merr një rëndësi thelbësore verifikimi i likuiditetit dhe besueshmërisë të klientëve dhe të partnerëve tregtarë, përpara dhe gjatë lidhjes tregtare. Mes kanaleve informuese të përdorshme, këshillohen, në veçanti zyrat e ICE dhe Dhomat e Tregtisë me zyra jashtë vendit, konsullatat, shoqëritë e kategorisë, bankat, të dhënat tregtare të shoqërive private operuese në nivel ndërkombëtar, rregjistrat publik në të cilët ka vend ana tjetër.
Për më tepër, mbasi merren informacionet për anën tjetër, siç e kemi parë, është gjithmonë e këshillueshme ti jepet forma e shkruar marrëveshjeve, edhe përmes përdorimit të testeve kontraktuese standarte ndërkombëtare. Mbrotjet kontraktuese mund të ndihmojnë për përballimin e problemeve të lidhura me pagesën e vonuar dhe jolikuiditetin e klientit. Një rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet formulimit të klauzolave të pagimit dhe koerencës mes dokumentëve kontraktues dhe tregtar.

Vonesa në pagesa dhe interesat

Për tu mbrojtur nga vonesat në pagesë nga ana e klientit, është e këshillueshme të përcaktohen interesat (me rregull më të mëdha së normat korrente në treg, por në mënyrë që most ë penalizohet shitësi që financohet mes bankës). Është mirë që në kontratë të parashikohet aplikimi automatik i interesave duke filluar nga data brenda së cilës blerësi duhet të kryejë pagesën. Evidentohet që aplikueshmëria e një klauzole të tillë mund të jetë e përjashtuar ose e limituar në disa raste.

Mbajtja e titullit

Sipas kontratës, mund të jetë edhe e mundur mbrojtja përkundrejt riskut që jolikuiditeti total ose i pjesshëm i klientit mund të ndalojë shitësin për të rekuperuar të mirën e dorëzuar e për të cilën shitësi, me ndodhjen e shitjes, nuk rezulton më titullari ose pronari. Përmes klauzolës së mbajtjes së pasurisë anët në fakt vendosin shprehimisht që malli mbetet në pronësi të shitësit deri në pagimin total të çmimit nga ana e blerësit, duke legjitimuar kështu kërkesën nga ana e shitësit për të marrë posesin e të mirës.
Disiplina e një klauzole të tillë varion nga porosia në porosi dhe varet nga ligjet e vendit.

Klauzola pezulluese dhe zgjidhëse

Në rastin kur ana tjetër bëhet më pak likuide, ose i nënshtrohet proçedurave të falimentimit ose para-falimentimit në vazhdimësinë e raportit, do të ishte oportune për shitësin të ketë parashikuar më parë më anën e një kontrate në favor të tij, të drejtën e pezullimit të raportit sipas normave të aplikueshme nga ligji i vendit.

Garancitë bankare

Përsa i përket formave të garancive, këshillohet letra e kreditit stand-by përmes së cilës detyrimi i pagesës garantohet nga vetë banka. Më përdorim më të vështirë janë format e tjera të garancisë në mjedisin ndërkombëtar.[197]

5.Disiplina për vonesat në pagesën e transaksioneve ndërkombëtare

Në nivelin e BE-së , direktiva 2000/35/EC , e cila është duke u diskutuar në një rishikim prezantuar nga një kornizë e përbashkët minimale në mes shteteve anëtare të BE-së që ka për qëllim luftimin e pagesave me vonesë në transaksionet tregtare në mes të bizneseve dhe në mes të bizneseve dhe administrimit publik. Ky rregull thotë se, në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, pagesa kryhet brenda tridhjetë ditëve nga data e faturës ose e dorëzimit (nëse fatura është më e hershme), dhe që nga kjo datë fillon dhe përcaktimi i interesit. Norma minimale e interesit për vonesën, që Shtetet e Bashkuara duhet të miratojnë në legjislacionin e tyre, do të jetë e barabartë me normën e interesit të objektit kryesor të rifinancimit të Bankës Qendrore Evropiane Qëndron mundësia për operatorët për të rënë dakord me kërkesën dhe pagesën e borxheve me ritme më të larta.[198]

Konkluzione dhe rekomandime

» Një nga problematikat kryesore me të cilat operatorët duhet të përballen në shitjet me jashtë janë ato të zgjedhjes së mjetit më të sigurtë për të realizuar pagesën e materialeve, duke evituar apo reduktuar risqet e lidhura dhe pagesën e munguar apo të vonuar. Distanca mes dy anëve jep komplikacione të mëtejshme në kontrollet dhe në risqet që mund të hasen.

» Në asnjë vend bankat nuk munden të menaxhojnë likuiditetin mbi më shumë se dy sisteme. Kjo ndodh sidomos në SHBA ku vetëm pak banka të mëdha janë anëtare të sistemeve klering dhe shërbejnë si ndërmjetëse për bankat e vogla, situatë e cila thjeshtëzon kontrollin e likuiditetit nga ana e autoriteteve qëndrore.

» Rritja e fuqisë të Fondit Monetar të Mbikqyrjes mbi politikat e ndërrimit mes vendeve anëtare mund të kontribojë edhe më tepër në një stabilitet më të mirë të sistemit, duke inkurajuar vendet, sidomos ato të përmasave më të mëdha, në një vlerësim më të detajuar të pasojave ndërkombëtare të politikave ekonomike të brendshme ose të kombinimit të vecantë të strukturave të përdorura për ti realizuar.

» E ardhmja e pagesave ndërkombëtare është mjaft premtuese. Mendohet se sistemet e pagesave do të bazohen mbi identifikimin biometrik. Një teknologji e pjekur tashmë dhe e përdorur gjerësisht për sistemet e sigurisë dhe mund në të ardhmen të bëhet pjesë edhe e sistemit të pagesave.

» Interneti është duke kontribuar gjithnjë e më shumë në përhapjen e pagesave elektronike dhe stimulon rritjen e segmentëve të reja si ai i celularëve apo kartave të parapaguara. Wallet elektronike janë përplotësuese të bankave dhe të kartave të kreditit.

Ato garantojnë më shumë siguri dhe forcojnë rolin e bankave. Mendohet se së shpejti ato do të bëhen sistemi kryesor i pagesave në internet.

---

[197] *Internazionalizzazione on line. I pagamenti internazionali in un'ottica legale e contrattuale Camera di Comercio Lordi*

[198] *LE PRINCIPALI FORME DI PAGAMENTO INTERNAZIONALI (Italy in new York.com)*

Bibliografia

1. Paraja në Qarkullimin e Pagesave Nderkombetare (Provimet.weebly.com)
2. *Pagamenti internazionali: Rischi, Strategie, Risultati* antonio.dimeo@studiodimeo.com www.studiodimeo.com
3. Internazionalizzazione on line.I pagamenti internazionali in un'ottica legale e contrattuale Camera di Comercio Lordi
4. **Strumenti d'incasso e pagamento domestici all'estero** http://www.aiti.it/web/guest/strumenti-d-incasso-e-pagamento-internazionali
5. http://impresamia.com/internazionalizzazione/425.html
6. Internazionalizzazione on line. I pagamenti internazionali in un'ottica legale e contrattuale Camera di Comercio Lordi
7. LE PRINCIPALI FORME DI PAGAMENTO INTERNAZIONALI (Italy in new York.com)

PhD(c) Labeat Mustafa
Fakulteti i Biznesit,
Universiteti Haxhi Zeka, Pejë
Email: labeat_m@hotmail.com

39 Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik të Kosovës

Abstrakt

Punimi trajton tematikën e zhvillimit të NVM-ve gjatë viteve 2000-2014 dhe rolin e tyre në rritjen ekonomike të Republikës së Kosovës. Faktorët që ndikojnë menaxhimin e suksesshëm të biznesit të vogël dhe të mesëm, roli dhe rëndësia e NVM-ve në numrin e përgjithshëm të punësuarve, numri i bizneseve gjatë periudhës 2000-2014 si dhe analiza të tjera të mjedisit të ambientit për zhvillim të suksesshëm të zhvillimit strategjik të NVM-ve.
Duke u bazuar në informata nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Reja – ARBK, jepen përqindjet nga viti në vit rreth të punësuarve në këta sektorë.
Trajtohet roli dhe rëndësia e menaxhmentit strategjik, me qëllim të adaptimit ndaj mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm (ekstern dhe intern) dhe theksohet rëndësia e aplikimit të SWOT analizës për rritjen e rezultateve, efikasitetit dhe eficiencës të NVM-ve.

Fjalët kyçe: NVM-të, mjedisi ekstern, mjedisi intern, menaxhim, menaxhment strategjik, SWOT analiza.

I. Zhvillimi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Klasifikimi i madhësisë së biznesit ndryshon varësisht prej vendeve. Kriteret që merren për bazë lidhur e përcaktimin e madhësisë së ndërmarrjeve janë të shumta dhe të kombinuara. Ndër kriteret më njohura që merren për bazë janë tregu lokal, kapitali, të ardhurat, profiti, shitja dhe numri i punëtorëve.
Në Republikën e Kosovës, sipas Administratës Tatimore - ATK kriteret kryesore për përcaktimin e madhësisë së ndërmarrjes janë: qarkullimi vjetor, pagesat e tatimit dhe numri i punëtorëve. Këto kritere aplikohen në mënyrë selektive te kategoritë e formuluara:
- Ndërmarrje të mëdha konsiderohen bizneset që kanë qarkullimin vjetor mbi 2 milionë €, pagesat e tatimit mbi 100 mijë €, numrin e punëtoreve mbi 250.

- Ndërmarrje të mesme konsiderohen bizneset që kanë qarkullim vjetor mbi 500.000 deri ne 2 milionë € dhe pagesat e tatimit mbi 20 000 € dhe që punësojnë 50 deri 249 punëtorë.
- Ndërmarrje të vogla konsiderohen bizneset që kanë qarkullimin vjetor deri në 500.000 €, e të cilat i punësojnë prej 10 deri në 49 punonjës.
- Mikrondërmarrje quhet ai biznes që punëson deri në 9 punonjës (http://www.sme-ks.org/repository/docs/2008_03-L-031_al.pdf).

Regjistrimi i Bizneseve në Kosovë - Deri në fund të vitit 2000 numri i regjistrimit të bizneseve kishte arritur në 29564, ndërsa deri me 23 mars 2003 kur përfundon regjistrimi i përkohshëm dhe fillon regjistrimi i përhershëm numri i bizneseve ishte rritur në 56514, ndërsa me 31/12/2003 ky numër shënoi një rritje simbolike 56572. Kjo rritje ndodhi pas përfundimit të një procesi dhe fillimit të një procesi të ri e të përhershëm të regjistrimit.



Grafiku: Trendët e regjistrimit të bizneseve prej vitit 2000 – 2008 (Burimi-ARBK)

Mbështetur në të dhënat e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve/MTI dhe të përparuara nga Agjencia për mbështetje të NVM që nga viti 2000 deri me 31.08.2010 janë regjistruar 101 598 ndërsa janë shuar 9 813. Këtij trendi duhet shtuar edhe veprimin e Administratës Tatimore të Kosovës e cila në bazë të ligjit 03/L-222 neni 12.6 dhe udhëzimit Administrativ 07/2009 neni 8 ka deaktivizuar 37480 biznese, që nënkupton se në vitin 2010 në Kosovë vepronin 54 305 biznese aktive.
Nga totali i numrit të ndërmarrjeve në Kosovë 98.37% e përbëjnë mikro ndërmarrjet, 1.35% janë ndërmarrje të vogla, 0.22% janë ndërmarrje të madhësisë së mesme dhe vetëm 0.06% janë ndërmarrje të mëdha.
Deri me datën 31.08.2010 sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve numri i të punësuarve në ndërmarrje të vogla dhe të mesme ishte 214 157, shprehur ne përqindje 79.37 %, ndërsa 20.63% e të punësuarve i takojnë ndërmarrjeve të mëdha.
Në ndërmarrje të mëdha me mbi 250 punëtorë ku janë të regjistruara edhe ndërmarrjet shoqërore dhe publike KEK, PTK etj. janë punësuar 53 658 punëtorë apo 21.66 % e të punësuarve në bizneset e regjistruara.



Grafikoni. Pjesmarrja e NVM në punësim
Burimi-ARBK

Nga ky grafikon shihet se sektori i NVM-ve në Kosovë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në formimin e vendeve të reja të punës, meqë afër 194 124 apo 78.44% e gjithë të punësuarve në ndërmarrje i absorbon ky sektor, duke marrë numrin total të punësuarve në Kosovë. Sektori privat punëson 247.782, ndërsa sektori publik punëson 75.000, që gjithsej ishin të punësuar 322.782, sipas kësaj shohim se sektori i NVM-ve merr pjesë në punësim me mbi 60%. Kjo përqindje është e përafërt me



Grafikoni Shpërndarja e bizneseve dhe punëtorëve nëpër sektore (Burimi-ARBK)

mesataren e vendeve të BE-së.

Kontributi i NVM-ve në krijimin e BPV, buxhetit të shtetit etj. në bazë të disa parallogarive konsiderohet se arrinte 40-55%.
Kontributi i sektorit të NVM-ve në Kosovë edhe nga aspekti i zhvillimit të sektorëve ekonomikë është i rëndësishëm, pasi që NVM-të janë biznese të cilat aktivizojnë edhe sektorët më të margjinalizuar, gjithashtu NVM-të shquhen me një shtrirje të gjerë sektoriale si dhe me plotësimin e diversitetit të nevojave të shoqërisë, mirëpo për

shkak specifikave që përmbajnë nuk arrijnë të kthehen në një industri me shtrirje të gjerë apo me bazë të lartë profiti.
Në vendet me të hyra të ulëta të BPV mes 100-500$/kokë banori, NVM-të kontribuojnë me mbi 60% në krijimin e BPV dhe 70% të totalit të punësuarve, ndërsa në vendet me të hyra mesatare të BPV, NVM-të kontribuojnë rreth 70% në krijimin e BPV dhe 95% në totalin e të punësuarve (Grajçevci N. 2010).

Nga viti 2000 e deri në vitin 2014 janë hapur gjithsej 130 mijë biznese të reja. Në Kosovë regjistrohen vazhdimisht biznese të reja, por gjithashtu edhe një pjesë e tyre shuhen. Sipas informatave nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të MTI-së, vetëm gjatë vitit 2014 prej datës 1 janar – 13 maj, janë regjistruar 4122 biznese të reja.
Nga data 1 janar 2012 deri më 13 maj 2013 janë regjistruar 4210 biznese.
Prej datës 1 janar 2000 deri më 13 maj 2014 janë të regjistruara 130 mijë e 708 biznese. Po gjatë kësaj kohe, janë shuar 14 mijë e 299 biznese.

Në Bashkimin Evropian NVM-të përbëjnë përafërsisht 99% të të gjitha ndërmarrjeve dhe punësojnë mbi 65 milion punëtorë, në Britani të Madhe statistikat tregojnë se nga 4.5 mil. biznese 99.3% janë biznese të vogla me më pak se 50 punëtorë dhe 0.6% biznese të mesme që punësonin nga 50-250 punëtorë, etj. (Small and Medium Sized Enterprise Statistics for the UK 2006, published 22 August 2007).

II. Faktorët që ndikojnë menaxhimin e suksesshëm të biznesit të vogël dhe të mesëm

Teorikisht dhe praktikisht pranohet se ekzistojnë një tërësi faktorësh që ndikojnë në krijimin dhe menaxhimin e suksesshëm të bizneseve të vogla dhe të mesme. Disa prej tyre janë: mjedisi makroekonomik; mjedisi politik dhe ligjor – rregullimi qeveritar; mjedisi shoqëror; aftësitë ndërmarrëse; niveli i teknologjisë; struktura e organizatës; personeli i organizatës etj.
Rritja ekonomike e qëndrueshme përmirëson qëndrueshmërinë politike dhe sociale dhe në kushtet e periudhës së tranzicionit garanton suksesin e reformave. Kjo arrihet kur në vend krijohet një mjedis i sigurt dhe i qëndrueshëm për sektorin privat. Në një mjedis ku mungojnë transparenca dhe konkurrenca e ndershme sektori privat mund të shndërrohet në një pengesë të efiçencës. Kryerja e reformave, përparimi i shpejtë i tyre në vendet në tranzicion, është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e qeverisë. Qëllimi i tyre final do të jetë krijimi i një sektori privat energjik i cili funksionon shkëmben mallra dhe shërbime dhe investon lirshëm në një mjedis të sigurt ekonomik, politik dhe ligjor.

Suksesi bizneseve të vogla varet nga përkushtimi, talenti krijues dhe motivimi i pronarit . Këtu bëjnë pjesë syçeltësia ndaj ndryshimeve, aftësia për t'u përshtatur ose për të krijuar vetë ndryshime, aftësia për të tërhequr e për të mbajtur punëtorë të aftë, vizioni lidhur me hollësitë operative, njohuri mbi tregun, domethënë njohuri mbi klientët dhe nevojat e tyre.

Çdo funksion biznesi, çdo institucion biznesi, çdo person i angazhuar në kryerjen e këtyre funksioneve për vete ose për një institucion biznesi duhet të plotësojë kërkesat dhe nevojat e njeriut. Këto biznese janë efikase dhe mbijetojnë deri në atë masë që plotësojnë në mënyrë efektive dhe ekonomike kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve.

Nevoja e njohjes së tregut dhe e konsumatorëve, është e domosdoshme. Derisa objektiv i biznesit është sigurimi i mallrave të duhura, në vendin e duhur, në kohën dhe me çmimin e duhur, atëherë procesi i menaxhimit është i domosdoshëm (planifiko, organizo udhëheq dhe kontrollo). Kontrollit duhet t' i kushtohet rëndësi e veçantë, ku përfshihen kontrolli financiar si dhe mbajtja e evidencave të sakta.

Menaxhimi i suksesshëm i bizneseve kërkon:

- Studim të kujdesshëm të tregut;
- Planifikim të menduar mirë të veprimtarive afariste;
- Organizim dhe udhëheqje profesionale;
- Kontroll të kujdesshëm të investimeve, mallrave, personelit, pajisjeve dhe ndërtesave, për të siguruar shfrytëzimin maksimal gjatë prodhimit;
- Të dhëna të mjaftueshme për shpenzimet;
- Zgjedhje të mallrave të menduar mirë;
- Vendime strategjike, duke iu referuar me zgjuarsi tregut, duke pasur parasysh edhe burimet dhe transportin e mallrave;
- Politika të drejta e të pandryshuara të objektivave të përgjithshëm, por elastike dhe të përshtatshme për të përballuar të papriturat e biznesit;
- Marrëdhënie të mira pune me furnitorët;
- Kredi të garantuara juridikisht;

- Zgjedhja e klientelës dhe përqendrimit në treg;
- Personel të zgjedhur mirë e të aftë;
- Program të planifikuar mirë për nxitjen e shitjeve.

Të gjithë këto elemente përfaqësojnë një tërësi të përgjithshme të rregullave operative moderne që duhet të jenë të pranishëm, për të krijuar një ekuilibër të përshtatshëm në biznes.

Për të menaxhuar në mënyrë efektive, faktorët personalë kanë rëndësi të veçantë. Aftësia për të drejtuar, udhëhequr, madje për të frymëzuar të tjerët, është cilësi njerëzore, ashtu si dhe aftësia për të pranuar përgjegjësi e për t'u dhënë përgjegjësi të tjerëve. Aftësia për të fituar dhe për të ruajtur besimin në sigurimin e ndihmës financiare, dhënien e kredive, përbën një veçori të rëndësisë jetike për biznesin. Nuk duhet harruar se biznesi është projektim i personalitetit të drejtuesit. Në përgjithësi, individët e kanë ose nuk e kanë atë që kërkohet dhe duke e pasur atë ata bëjnë një punë të mirë e me dëshirë ose dështojnë kur nuk e kanë. Këto çështje nuk mund të mbitheksohen, sepse suksesi i biznesit është një filozofi, një pikëpamje, një alternativë që duhet të përshkojë tërësisht mendimin e ndërmarrësit

në rast se ai do që ta ketë në dorë ndërmarrjen (Buble M., Cingula M., Dujaniq M., Dulciq Z., Bozhac M. G., Galetic L., Lubic F., Pfeifer S., Tipuric D., 2008).

III. Analiza e mjedisit për zhvillimin e suksesshëm strategjik të NVM-ve

Procesi i menaxhmentit strategjik fillon me analizën e mjedisit-rrethinës, e cila përfshin monitoringun, evaluimin dhe përhapjen e informatave nga mjedisi ekstern dhe intern në ndërmarrje.

Mjedisin ekstern e përbëjnë variablet të cilat janë jashtë ndërmarrjes dhe zakonisht janë jashtë ndikimit të menaxhmentit të lartë. Këto variabla formojnë kontekstin në të cilin ndërmarrja ekziston, kurse mund të jenë forca dhe trende të përgjithshme në mjedisin e tërësishëm social ose faktorë specifikë të cilët veprojnë në mjedisin specifik të detyrave të organizatës.

Mjedisi i përgjithshëm ose social paraqet atë pjesë **të mjedisit ekstern**, i cili është larg nga ndërmarrja shpesh quhet mjedis i largët - *remote environment,* kështu që ndërmarrja vështirë mund të ndikojë në të.

Mjedisi i përgjithshëm ose social është prezantuar nëpërmes pesë dimensioneve kryesore ose tipareve të mjedisit, të cilat janë: 1. natyrore - ekologjike, 2. shkencore - teknologjike, 3. ekonomike, 4. politike-juridike dhe 5. mjedisi sociokulturor.

1. Mjedisi natyror-ekologjik përfshin resurset materiale dhe demografike, duke filluar nga lënda e parë e deri te njerëzit si resurs kryesor i çdo ndërmarrjeje, i cili me cilësinë dhe shumësinë e vet në mënyrë indirekte ndikon në ekzistencën dhe zhvillimin e ndërmarrjes si dhe në organizimin e saj të brendshëm.

2. Mjedisi shkencor-teknologjik bën nivelin përkatës të arritjeve shkencore dhe teknologjike. Njohja e këtij dimensioni dhe e aspekteve përcjellëse të saj është paramendim për investim në veprimtarinë hulumtuese-zhvillimore si dhe për marrjen e vendimeve strategjike për përparimin e teknologjive ekzistuese dhe për përvetësimin e teknologjive të reja në ndërmarrje.

3. Mjedisi ekonomik është kornizë bazike për veprimin e ndërmarrjes. Nëpër këtë dimension në mënyrë indirekte thyhen të gjitha aspektet e ndikimit në ndërmarrje duke filluar nga strategjia e përcaktuar globale e zgjedhur, pastaj forma e pronësisë, ligjit të kërkesës dhe ofertës, të politikës së punësimit e deri te masat e politikës monetare-kreditore.

4. Mjedisi politik-juridik rregullon marrëdhëniet politike-ekonomike brenda sistemit përkatës politik në kudër të të cilit vepron ndërmarrja. Kornizat institucionale, të cilat janë dhënë me distribuimin e fuqisë politike dhe me normat juridike, determinojnë kornizat e përgjithshme ligjore për themelimin, funksionimin dhe ndërprerjen e punës së ndërmarrjeve.

5. Mjedisi socio-kulturor përmban shumë karakteristika dhe ndikime të shtresave shoqërore si dhe mënyra individuale dhe grupore të sjelljeve në ndërmarrje. Këtë dimension, që mbështetet në sistemet përkatëse të vlerave, e

përbëjnë normat dhe rregullat e sjelljes, pastaj vlerat dhe karakteristikat demografike të shoqërisë në të cilën ekziston ndërmarrja.

Mjedisi intern i ndërmarrjes përbëhet nga variablat që janë brenda saj dhe mund të ndikojë menaxhmenti në to. Këto variabla formojnë kontekstin në të cilin zhvillohet puna e ndërmarrjes dhe përfshijnë strukturën organizative, kulturën dhe resurset të cilat ndërmarrja mund t'i shfrytëzojë për të arritur përparësi konkurruese.
Menaxherët duhet të kuptojnë qëllimin e analizës së mjedisit, duhet të hetojnë nivelet e ndryshme të mjedisit ekzistues organizativ dhe duhet të kuptojnë synimet e referuara për zbatimin e kësaj analize me qëllim që të jenë më të suksesshëm në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Mjedisi intern quhet mjedisi i ndërmarrjes i cili është plotësisht nën ndikimin e ndërmarrjes. Viteve të fundit, epiqendra e interesit bartet nga mjedisi intern në atë ekstern. Kjo ka shkaktuar shfaqjen e konceptit të menaxhmentit strategjik. Veçoritë e mjedisit intern janë të lidhura me veçoritë e secilës ndërmarrje të veçantë. Në këtë kuptim mund të flitet edhe për *forcat dhe dobësitë* si veçori të mjedisit intern, përkatësisht të ndërmarrjes. Dobësitë interne dhe kanosjet ekterne mund të pamundësojnë, si ndërmarrjen në tërësi, po ashtu edhe disa pjesë të saj në arritjen e rezultateve të dëshiruara të afarizmit dhe të qëllimeve strategjike.
Forcat dhe dobësitë e ndërmarrjes janë veçori dalluese të mjedisit intern të ndërmarrjes, të cilat, së bashku me rastet dhe kanosjet nga mjedisi ekstern përbëjnë bazën për analizën e gjithanshme të mjedisit.
Mund të ndodhë që sot janë forca, qysh nesër, për shkak të ndryshimit të kushteve, mund të bëhen dobësi të ndërmarrjes.

Forcat dhe dobësitë, përbëjnë veçoritë kryesore të mjedisit intern dhe ekstern.
Forcat e ndërmarrjes, të cilat quhen edhe forca strategjike, janë aftësi pozitive që ndërmarrjes i mundësojnë të realizojë qëllimet e saj, të orientuara drejtë arritjeve të përparësive strategjike. Si forca kyçe të ndërmarrjes mund të paraqiten:

- vizioni i qartë strategjik
- arsimimi, profesionalizmi dhe aftësimi i kuadrit
- struktura organizative adekuate
- njohja e tregut
- pajisjet tekniko-teknologjike
- investim i vazhdueshëm në veprimtarinë hulumtuese - zhvillimore
- cilësia, çmimet dhe njohja e prodhimit dhe e shërbimeve
- pozita e fuqishme konkurruese
- disponimi me mjete financiare
- përpunimi i sistemit të shpërblimeve
- përpunimi i kulturës organizative

Dobësitë e ndërmarrjes, të cilat quhen edhe dobësi strategjike, në përmbajtje janë mosaftësi të brendshme të ndërmarrjes të cilat pengojnë realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes, në praktikë paraqiten për shkaqe të:

- mosekzistimit të filozofisë përkatëse afariste dhe të vizionit strategjik
- mungesës së kuadrit profesionist, përkatësisht të ekipeve jopërkatëse kadrovike
- mospërshtatjes së strukturës organizative me kërkesat e ndërmarrjes
- pajisjes jopërkatëse teknologjike të ndërmarrjes
- asortimentit joadekuat të prodhimit ose të diapazonit të shërbimeve
- pozitës së papëlqyeshme konkurruese
- mungesës së mjeteve financiare
- mos ndërtimit të kulturës organizative.

Forcat dhe dobësitë janë karakteristika kyçe të mjedisit intern të ndërmarrjes të cilat së bashku me rastet dhe kërcënimet nga mjedisi ekstern, përbëjnë bazën për analizën e gjithanshme të mjedisit. (Buble M., Cingula M., Dujaniq M., Dulciq Z., Bozhac M. G., Galetic L., Lubic F., Pfeifer S., Tipuric D., 2008)

Mjedisi intern është mjedisi i drejtpërdrejtë punues i ndërmarrjes në të cilin ndodhin të gjitha proceset dhe ngjarjet kyçe, të rëndësishme për ekzistimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Ndikimi i mjedisit në ndërmarrje

Është e rëndësishme të theksohet se mjedisi ndikon në ndërmarrje dhe në anën tjetër dhe ndërmarrja ndikon në mjedis. Mjedisi për ndërmarrjen konsiderohet si një mori faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm të cilët mund të ndikojnë në rrugën e ndërmarrjes drejt realizimit të qëllimeve të veta. Menaxhmenti duhet që në mënyrë konstante të grumbullojë dhe shqyrtojë aplikacione, të cilat kanë të bëjnë me faktorët e mjedisit, kështu që bërja e analizave të mjedisit sigurisht do të jetë shumë më e rëndësishme për menaxherët.

Qëllimi themelor i analizës së mjedisit është që t'i shërbejë menaxherit për reagim me kohë.

Për vlerësimin e mjedisit zhvillohet analiza SWOT (Strengths - Weaknesses - Opportunities – Thrats). Deri sa fuqitë (Strengths) dhe dobësitë (Weaknesses) lidhen me ndërmarrjen, përkatësisht me mjedisin intern, rastet e volitshme (Opportunities) dhe kanosjet-kërcënimet (thrats) kanë të bëjnë me mjedisin ekstern të ndërmarrjes. Një ndër detyrat kryesore të analizës së mjedisit është të identifikojë rastet e volitshme dhe kanosjet ne mjedisin ekstern, kurse forcat dhe dobësitë në mjedisin intern. Për ta kryer këtë detyrë në mënyrë të suksesshme, analiza e mjedisit duhet që:

1. të zbulojë faktorët dhe presionin e tyre që i ndihmojnë ndërmarrjes për realizimin e qëllimeve(rasteve të volitshme) të saj;
2. të përcaktojë aftësitë pozitive të brendshme të ndërmarrjes-forcat si dhe mosaftësitë e brendshme të cilat e pengojnë realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes;

3. Nëpërmes analizës SWOT duhet të lidhen rastet dhe kanosjet me fuqitë dhe dobësitë në mënyrë që ndërmarrja të pozicionohet në mjedis;
4. të sigurojnë bazën për formulimin e strategjisë me të cilën ndërmarrja do t'iu shmanget kanosjeve, duke shfrytëzuar forcat edhe duke eliminuar dobësitë e veta.

Që menaxhmenti ta bëjë analizën e suksesshme të mjedisit është e domosdoshme që në ndërmarrje të ndërtohet një sistem informativ i tillë i cili në mënyrë sistematike do të sigurojë informatat e nevojshme për gjendjen në mjedis. (Buble M., Cingula M., Dujaniq M., Dulciq Z., Bozhac M. Gonan, Galetic L., Lubic F., Pfeifer S., Tipuric D., 2008).

Për të parë sa i jepet rendësi dhe sa aplikohet SWOT analiza në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kemi bërë një pyetësor të cilin e kemi plotësuar në disa ndërmarrje të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Rezultatet e anketave

Pyetësori është plotësuar nga menaxherët e niveleve të ndryshme. Rreth 100 anketa të vlefshme dhe të plotësuara na kanë ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për menaxherët e NVM-ve në Kosovë.

Të pyetur se sa e vlerësojnë rolin e SWOT analizës për arritjen e rezultateve në menaxhimin e suksesshëm të firmës 60 % janë përgjigjur se e vlerësojnë lart, 30 % janë përgjigjur se e vlerësojnë mesatarisht, 8 % kanë thënë se e vlerësojnë pak dhe 2 % kanë menduar se bën edhe pa të.



Burimi nga autori i punimit

Vihet re se nga shumica e menaxherëve i jepet rëndësi e madhe rolit të SWOT analizës, rëndësi mesatare dhe më pak kryesisht i jepej nga menaxherët në disa firma më të vogla.

Në pyetjen se sa zbatohet SWOT analiza në ndërmarrjet ku ata punojnë kemi këto rezultate 57% deklarojnë se po zbatohet, 32 % deri diku, 8 % pak dhe 3 % nuk e aplikojnë fare. Shumica e firmave të vogla ishin ato që e përdorin deri diku, më pak apo nuk e aplikojnë fare SWOT analizën.



Burimi nga autori i punimit

Nga kjo mund të vërejmë se ndërmarrjet e vogla më shumë kanë nevojë për zhvillim të formës së menaxhimit, aftësim të kuadrove menaxhuese, me qëllim të jenë më të suksesshëm, efikas dhe efecientë në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Në pyetjen se sa janë të kënaqur me rezultatet e SWOT analizës, 50 të anketuarve të cilët thanë se zbatojnë SWOT analizën në ndërmarrjet e tyre ne morrëm këto rezultate 73% plotësisht të kënaqur, 25 % të kënaqur dhe 2% më pak të kënaqur.



Në bazë të kësaj analize vërehet se kënaqësia rreth rezultateve gjatë zbatimit të SWOT analizës ndryshon. Unë mendoj se këtu ka të bëjë strategjia, lloji i strategjisë që kanë përdorur, si është zbatuar, sa kanë qenë të aftë t'ia përshtatin strategjinë e tyre mjedisit ku veprojnë, pra janë faktorë të shumtë, të cilët i kemi cekur më lart që ndikojnë në arritjen sukseseve a po rezultateve më të larta.

Konkluza dhe rekomandime

Sektori i NVM në Kosovë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në formimin e vendeve të reja të punës me që afër 78.44% e gjithë të punësuarve në ndërmarrje i absorbon ky sektor apo duke marrë numrin total të punësuarve në Kosovë.
Kontributi i sektorit të NVM-ve në Kosovë është i rëndësishëm edhe nga aspekti i zhvillimit të sektorëve ekonomikë pasi që NVM-të janë biznese të cilat aktivizojnë edhe sektorët më të margjinalizuar.

Që të arrihen rezultate më të mëdha duhet ti kushtohet kujdes i veçantë mjedisit, si atij intern po ashtu dhe ekstern.
Viteve të fundit, epiqendra e interesit bartet nga mjedisi intern në atë ekstern dhe kjo ka shkaktuar shfaqjen e konceptit të menaxhmentit strategjik.
Forcat dhe dobësitë e ndërmarrjes janë veçori dalluese të mjedisit intern të ndërmarrjes, të cilat, së bashku me rastet dhe kanosjet nga mjedisi ekstern përbëjnë bazën për analizën e gjithanshme të mjedisit.

Qeveria duhet të krijojë kushte sa më të favorshme në ato fusha të biznesit ku do të investojë sektori privat, sidomos prioritet duhet t'i kushtohet:
Zhvillimit të sistemit bankar në përputhje me kërkesat e ekonomisë së tregut; hartimit të strategjisë së politikave të nxitjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta; reduktimit të pengesave burokratike; rritjes së eficiencës së punës së administratës shtetërore për iniciativat e sektorit privat; monitorimit të ligjit mbi konkurrencën; luftimit të ryshfeteve dhe korrupsionit; rritjes së efikasitetit të sistemit të drejtësisë etj.

Literatura

- Prof. Dr. Isak Mustafa, Menaxhimi i Biznesit dhe punësimit në ekonominë bashkëkohore, IFK, Prishtinë 2013
- Prof. Dr. Isak Mustafa, Drejtori në udhëheqjen e biznesit, Eureka, Prishtinë 1993.
- Prof. Dr. Isak Mustafa, Ndërmarrja në biznesin bashkëhor, Eureka, Prishtinë 1997.
- Qimiao Fan, Alberto Criscuolo, and Iva Ilieva-Hame, Punim për Bankën botërore.
- Small and Medium Sized Enterprise Statistics for the UK 2006, published 22 August 2007
- Prof. Assoc. Sotiraq DHAMO, Universiteti Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Prof. Assoc. Stefan QIRICI, Universiteti Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Konferenca e dytë ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi, IFK, 2003, Prishtinë
- Libri: Konferenca e Nëntë Ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi, IFK Prishtinë 2010
- Menaxhmenti Strategjik – Marin Buble, Marijan Cingula, Marcelo Dujaniq, Zelimir Dulciq, Marli Gonan Bozhac, Lovorka Galetic, Franjo Lubic, Sanja Pfeifer, Darko Tipuric - KOLEGJI UNIVERSITAR VICTORY, Prishtinë 2008
- Të dhëna nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve të reja, MTI, Prishtinë 2008, 2010, 2014.
- http://www.sme-ks.org/repository/docs/2008_03-L-031_al.pdf

Doc. Dr. Bejadin AMETI
Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup
konba@hotmail.de

40 THERRJA E KAFSHËVE SIPAS SHERIATIT ISLAM

Abstract

For the slaughter of the animal, it is necessary to clarify the proper form which enables it not to be distressed in the giving of the soul, so according to the Islamic Shari'a there are criteria and conditions through which we understand the permission to slaughter it.

The notion "Edh-katu" in its essential meaning includes these meanings: refreshment, cleansing, and simultaneously with this slaughter, they also did the refreshment and cleansing of the flesh.With this notion shari'a we understand that: The cutting of special pieces of flesh whose flesh is allowed according to Islam. We know that the expression of worship or ibadah is "all legitimate (in accordance with the Qur'an and hadith), which makes the Muslim a good purpose, aiming for the Compatibility and Pleasure of Allaah and His reward" Muhammad a. many of our everyday work has been called sadaqah that has the meaning of worship. Among the most famous studies that have been made in this area is the study of Rebecca Smith, a member of the international Veteran Veteran "VIVA". Rebecca in his study of the unconscious cut-off method, in detail, noted the risk and the bitterness of uncooked uncooked animals because he explained that most of the animals slaughtered by the unconscious method or fascinating method, their feeling is restored during the bloodshed before their death.

Key words: Slaughter, flesh, study, science, allowed, forbidden.

Abstrakt

Për therjen e kafshës duhet sqaruar formën e duhur e cila ia mundëson asaj që të mos jetë e munduar në dhënien e shpirtit, kështu që sipas sheriatit islam ekzistojnë kritere dhe kushte përmes së cilëve kuptojmë lejen e therjes se sajë.

Nocioni **"Edh-dhekatu"** në kuptimin e saj esencial ngërthen në vete këto kuptime: freskim, pastrim, njëkohësisht me këtë therje bënë edhe freskimin dhe pastrimin e mishit.

Me këtë nocion sheriati kuptojmë se: ***Prerja e pjesëve të veçanta të kafshës mishi i të cilëve lejohet sipas islamit.*** Ne e dimë se shprehja adhurim apo ibadet është "çdo gjë e ligjshme (në përputhshmëri me Kuranin dhe hadithin), që bën muslimani me qëllim të mirë, duke synuar pajtueshmërinë dhe e kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e Tij" Muhamedi a.s. shumë vepra të përditshmërisë sonë i ka quajtur sadaka që e ka kuptimin e adhurimit.Prej studimeve më të famshme që janë bërë në këtë lëmi, është studimi i Rebecca Smith, anëtar i veteranisë ndërkombëtare për animals "VIVA". Rebecca në studimin e tij të metodës së prerjes së kafshës pa ndjenja, në mënyrë të detajizuar vuri në dukje rrezikun dhe dhembshmërinë e kafshëve të prera sipas metodës pa ndjenja, ngase ai sqaroi se shumica e kafshëve që therren sipas metodës

pa ndjenja apo metodës magjepse, u rikthehet ndjenja e tyre gjatë gjakëderdhjes para vdekjes së tyre.

Fjalët kyçe: Therje, mishi, studim, shkencë, e lejuar, e ndaluar.

1. THERRJA E KAFSHËVE SIPAS SHERIATIT ISLAM

Për therjen e kafshës duhet sqaruar formën e duhur e cila ia mundëson asaj që të mos jetë e munduar në dhënien e shpirtit, kështu që sipas sheriatit islam janë vendosur kritere dhe kushte përmes së cilëve kuptojmë atë që është me adekuate dhe komode. Përdorëm fjalën adekuate dhe atë komode ngase e kemi për qëllim kafshën e cila të i gëzon këto kushte që ajo të ndjehet lirë edhe në momentin e daljes së shpirtit prej sajë. Sipas sheriatit Islam me nocionin "edh-dhekatu" në kuptimin gjuhësorë nënkuptojmë: prerje, therje, e këtë e vërteton edhe ajet-i Kur'anor ku All-llahu xh.sh. thotë: **"Me përjashtim të asaj që e keni therë (prerë)"**

Nocioni **"Edh-dhekatu"** në kuptimin e saj esencial ngërthen në vete këto kuptime: freskim, pastrim, e që nënkupton se prerja e pjesëve të veçanta të trupit të kafshës që paraprakisht e dimë që është e lejuar sipas islamit, njëkohësisht me këtë therje bënë edhe freskimin dhe pastrimin e mishit. Me këtë nocion sheriatik kuptojmë se: ***Prerja e pjesëve të veçanta të kafshës mishi i të cilëve lejohet sipas islamit.***

E gjithë kjo zgjerohet në kuptimin edhe më të gjerë nga ajo që duket në fillim, sepse në mënyrë direkte ka kuptimin edhe të adhurimit që e shprehë besimtari, kur ai e therë kafshën e tij, pa marrë parasysh qëllimin për të cilin e ka therur atë, qoftë edhe për konsumim të zakonshëm personal apo familjarë. Ne e dimë se shprehja adhurim apo ibadet është "çdo gjë e ligjshme (në përputhshmëri me Kuranin dhe hadithin), që bën myslimani me qëllim të mirë, duke synuar pajtueshmërinë dhe e kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e Tij"[199].

Referohemi në faktin e të dërguarit profetit të fundit Muhamedit a.s., kur ai shumë vepra të përditshmërisë sonë i ka quajtur sadaka që e ka kuptimin e adhurimit.

Është e qartë kur ai fjalën e mirë e quante sadaka, po ashtu edhe përshëndetjen e besimtarit, ndihmën e afruar nevojtarit, udhëzimin për të mirë, bile edhe angazhimin dhe punën që bën njeriu për të mirëmbajtjen e familjes së tij, etj. Për të gjitha këto që u përmendën, besimtarit iu është premtuar shpërblim.

[199] Dr. Hasen Ejjub TebsitulAkaid El Islamije,fq. 178, Daru Selam Kajro

Që të jetë edhe ky adhurim i pranuar me dispozita justifikuese siç është rasti konkretë therja e kafshës, e që të jetë edhe mishi i lejuar për të ngrënë, ekzistojnë disa parime në këtë çështje.

E kemi parasysh se, asnjë lloj mishi nuk është i lejuar të hahet nëse nuk bëhet therja sipas normave islame, me përjashtim të mishit të peshkut dhe karkalecit, duke mos harruar se urtësia e therjes është ruajtja dhe kujdesi i shëndetit të njeriut. Fenomen që ka nevojë të diskutohet për të po thuajse në të gjitha shoqëritë botërore është metodologjia e prerjes së kafshës. Duket qartë një mospajtim për mënyrën e therrjes së kafshëve dhe nxiti shumë studiues të bëjnë kërkime shkencore si për aspektet negative që mundet të ketë nga një therje e kafshës me një formë apo tjetër, poashtu edhe për aspektet pozitive që i dëshirojnë njerëzit që e bëjnë ashtu si ata mendojnë.

Kjo nxitje ishte edhe më e madhe pas apelit që e bëri Këshilli për ruajtjen dhe përkujdesjen e kafshëve në Angli **"FAWC"**, më 10 Qershor 2003 apeloi deri te qeveria Angleze që të parandalojë therrjen e kafshëve sipas metodës islame dhe çifute. Arsyetim ky që therja sipas formës islamepër shkakton vuajtjet e kafshës gjatë prerjes deri në momentin e daljes së shpirtit. Për këtë arsye qeveria angleze solli vendim për të hartuar ligjin në të cilën do të theksohet nevoja e humbjes së ndjenjave të kafshës para therjes, e kjo metodë njihet si metoda e therrjes pa ndjenja apo metoda magjepse.

Një prej studimeve më të famshme që janë bërë në këtë lëmi, është studimi i Rebecca Smith, anëtar i veteranisë ndërkombëtare për animals "VIVA". Rebecca në studimin e tij të metodës së prerjes së kafshës pa ndjenja, në mënyrë të detajizuar vuri në dukje rrezikun dhe dhembshmërinë e kafshëve të prera sipas metodës pa ndjenja, ngase ai sqaroi se shumica e kafshëve që therren sipas metodës pa ndjenja apo metodës magjepse, u rikthehet ndjenja e tyre gjatë gjakëderdhjes para vdekjes së tyre. Një studiues tjetër i kësaj lëmie është edhe studiuesi gjerman Schultz, profesor në Universitetin e Hanoverit, i cili pas shumë studimeve përfundoi me konkluzën se: dhembja për shkak të tarifës cerebrale "magjepsës" nuk mund të krahasohet me therrjen e ligjshme e cila shumë më pak shkakton dhembje. Pastaj ai sqaroi se metoda e therrjes pa ndjenja shkakton ndaljen e shpejtë të funksionimit të zemrës, e cila do të shpiente në rrjedhjen e gjakut që gjendet në mish, dhe kështu të bëhet pastrimi i mishit.

2. Kushtet që duhet plotësuar therrja e kafshës sipas sheriatit Islame

Sheriati Islam parasheh kushte që të jetë kafsha e therur sipas parimeve dhe normave sheriatiek duhet plotësuar këto kushte:

2.1. Përmendja e emrit të All-llahut xh.sh. para therjes.

Deri sa të përmendurit e emrit të All-llahut xh.sh. në momentin e therjes së kafshës është kusht që të jetë mishi i lejuar të jetë, e nëse nuk përmendet qëllimisht mishi i asaj kafshe të therur është i ndaluar, All-llahu xh.sh. ka thënë: ***"Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e Allahut, sepse kjo është gjynah! Në të vërtetë, djajtë i nxisin miqtë e vet që t'ju kundërshtojnë ju. E nëse ju u bindeni atyre, me siguri që edhe ju do të ishit idhujtarë."****(El-Enam: 121)*

E nëse nuk përmendet nga harresa, mishi i shtazës së tillë lejohet por duhet përmendur kur të hahet. Po ashtu dijetarët islamë janë unik në mendimet e tyre se nëse kafsha theret në emër të diçka tjetër, mishi i saj është i ndaluar (haram) për muslimanët. Referohemi në praktikën e Pejgamberit a.s.ku: "theri dy desh me dorën e Tij dhe :" … tha *bismilah* dhe *Allahu ekber* .[200] Nuk lejohet ngërnia e mishit të kafshës,e cila është therë,duke mos e shqiptuar emrin e Allahut qëllimisht. Allahu i Madhërishëm thotë:

40.1 " Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e Allahut, sepse kjo është gjunah."[201]

40.2 Qëndrim më rigoroz ndaj kësaj çështje mban Imam maliku që sipas tij të përmendurit e emrit të All-llahut xh. sh. në therjen e kafshës është pjesë përbërëse e veprës gjë që nënkupton se kafsha e cila therret pa e përmendur emrin e All-llahut xh.sh. mishi i saj është i ndaluar për besimtarët islam, pavarësisht se mospërmendja është me qëllim apo me harresë.[202]

Dobitë e përmendjes së emrit të Zotit gjatë therrjes së kafshës. Ekipi i formuar me mjek ekspertësh në krye me Dr. Fajiz Al Hakim, të ngarkuarit me obligim të eksperimentojnë rreth therjes së kafshëve. Ata kishin prerë pesë kafshë, sipas metodës islame ku para therrjes kishin

[200] Abdulaziz Bin Fet-hi Es-Sejid En-Neda(Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave Islame fq.333.
[201] Kur'an (El-En'am,121)
[202] http://jusufzimeri.com/?p=151(8 tetor 2011)

theksuar Bismil-lahin dhe tekbirin, e më pas kishin prerë edhe pesë të tjera duke mos shqiptuar emrin e Zotit gjegjësisht nuk kanë thënë "bismilah e as Allahu Ekber".

Pastaj kishin marrë mostrat nga të dyja palët e kafshëve të prera, dhe pas 48 orëve dalin me rezultate ku kanë thënë: Kafshëve të cilëve nuk u ishte përmendur emri i Allahut xh.sh. mishi i tyre ishte i mbushur me bakterie, për dallim nga mishi i kafshëve që u ishte përmendur emri i Allahut xh.sh. që ishin plotësisht të pastra nga bakteriet. Ky rezultat shpaloset në mëngjesin e 17. 09. 2000 në ora tetë e mëngjesit.

Ishte habi e madhe dhe mahnitje për të pranishmit, atëherë vendoset që i njëjti procesë të përsëritet edhe njëherë në praninë e shumë mjekëve të lëmive të ndryshme. Procesi në fjalë realizohet para syve të tyre dhe të opinionit. Kështu që njërën prej thertoreve të Damaskut më 26. 09. 2000, do të bëhet therja e kafshëve tanimë për qëllimin e kërkuar, dhe më pas procesi i laboratorit pas testimit të mishit, publikon rezuzltatin identik dhe të saktë me rezultatet e para, ku mishi i therrur me bismilah nuk mbante bakterie, kurse mishi i therrur pa bismilah përmbante bakteri e prej tyre edhe të rrezikshme.

Është edhe më mahnitëse se vazhdoi eksperimentimi edhe me një grup prej 30 mjekëve nga fushat e ndryshme dhe drejtimeve studiuese të laboratorëve. Të njëjtit konstaltuanë se mishi i prerë duke e përmendur emrin e Allahut xh.sh. dhe tekbirin plotësisht është i pastër, për dallim nga ai pa përmendjen e emrit të Zotit se në të ekzistonte bakterie. Pra rezultatet ishin aq interesante dhe mahnitëse në këtë drejtim, ku ata i përshkruanin si mrekulli që janë mbi nivelin e fantazisë. Përgjegjësi i këtij ekipi i cili ishte i autorizuar për komunikim me mediat, studjuesi Dr. Halid Halave i cili doli me këtë kumtesë.[203]

2.2. Therësi që e realizon veprën duhet të jetë musliman.

Që të lejohet mishi i kafshës së therur kushtëzohet që therësi të jetë musliman, ndërsa ata që janë **Ehlul kitab,** në princip lejohet të hahet nga ai ushqim, e ky mendim bazohet në ajetin kur'anorë ku thotë: **"Dhe ushqimet (**të therurat**) e ithtarëve të librit (***krishterëve dhe hebrenjëve***) janë të lejuara për ju, e edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ta"[4]** Në këtë

[203] http://jusufzimeri.com/?p=151(8 tetor 2011)

kontekst Ibni Abasi (Radiall-llahu anhu) ka thënë: "*është lejuar ushqimi (therja) e çifutëve dhe krishterëve për shkak se ata besuan në Teuvratin dhe Inxhilin*"[204]

2.3. Mjeti i përdorur për therje:

Sekreti i kësaj prerje,qëndron në faktin se duhet t'i dalë shpirti kafshës në një formë më të shpejtë dhe pa mundime. Për këtë shkak është kushtëzuar mjeti i posaçëm dhe vendprerja në grykë ngase kjo është mënyra më e përshtatshme për ta ndarë nga jeta me lehtësim.[205]

Të gjithë dijetarët islam janë unik në mendimet e tyre se çdo mjet prerës i cili pret dhe copëton, që shkakton daljen e gjakut, mund të përdoret për mjet prerës, dhe mishi i tillë është i lejuar. Duke u referuar në hadithin e pejgamberit (Sal-lall-llahu alehji ve sel-leme). ku ka thënë: "***Derdhe gjakun me çka të dëshirosh***, " ose në transmetimin tjetër, ***Prej arteriet me çka të dëshirosh*** "

2.4. Pjesët e caktuara që duhet prerë:

Që të lejohet ushqimi i kafshës së therur patjetër duhet të priten këto pjesë:

1. Gabzherri organi i përcjelljes së frymëmarrjes,
2. Fyti, Organi për përcjelljen e ushqimit
3. Dy arteriet e gjakut

3. Pasojat nga mos therrja islame

Dr. Darim Tabai i cili thotë: Në disa shtete kafshët mbyten sipas mënyrës së gabuar, siç është ngulfatja, ose përmes elektrocutionit ose përmes plumbit etj. Këto metoda të mbytjes së kafshëve i mundësojnë kafshës ngeljen e gjakut në trupin e saj që është një fushë pjellore për rritjen dhe zhvillimin e baktereve në mënyra të ndryshme. Këto metoda të therrjes së kafshëve i dhurojnë kafshës dhembje të tmerrshme e cila reflektohet në ngjyrën e mishit e cila anon kah ngjyra e kaltër. Kurse me përmendjen e emrit të Allahut xh.sh. çështja është krejtësisht e

[204] http://jusufzimeri.com/?p=151
[205] Hallalli dhe harami në islam ,Jusuf Kardavi. fq, 83.

kundërt dhe kafsha përjeton sikur ti afrohet një bote krejtësisht tjetër, botës së kënaqësisë dhe gëzimit të madh.

Në anën tjetër, profesor Dr. Ibrahimi Mehre, profesor i kafshëve dhe sëmundjeve të shpezëve në universitetin e Damaskut, dhe njëkohësisht edhe anëtar i ekuipazhit kërkimor mjekësor thotë: disa orientalistë pretendojnë se metoda islame për prerjen e kafshëve është çnjerëzore. Këtë mendim të tyre e mbështesin vetëm në kontraktimet dhe konvulsionet nga kafshët pas therrjes. Mirëpo në fakt, e vërteta është plotësisht e kundërta e asaj që thonë ata. Veprimi i therrjes nëse kryhet plotësisht sipas rregullit islam, duke e përmendur emrin e Allahut dhe tekbirin, atëherë menjëherë ndërpritet gjaku dhe ajri nga truri i kafshës, dhe në këtë mënyrë kafsha e humbë ndjenjën e plotë. Në anën tjetër Muhamed Menzelxhi thotë: mënyra e therrjes islame është më e mirë për shkak të presionit të gjakut i cili reduktohet në mënyrë graduale derisa të bëhet pastrimi i plotë i gjakut. Metodat tjera të therrjes shpijnë deri te paralizimi i pjesëve të trupit të kafshës që shkaktojnë në ngritjen e tensionit të gjakut deri në 28 shkallë, gjë që e bënë kafshën të vuaj nga dhimbjet e tmerrshme prej 5 deri 10 minuta, deriasa të ndalet zemra. Pastaj pas rjhepjes së lëkurës vërejmë se venet e gjakut janë të fryra me gjak, e kjo i jep mundësi prishjes së shpejtë të mishin, andaj edhe kjo arsye është që ata shpejtojnë dhe menjëherë mishin e fusin në frigurifer që të mos prishet, kurse mishi i cili është therrë me emrin e Allahut dhe tekbir, menjëherë kemi mundësi ta e lëmë të varë në shitore dhe nuk prishet ngase përqindja e gjakut të ngelë në të është minimale.

Në fund të pëprkujtojmë se cilat janë arsyet e ngeljes së gjakut në mish:

a. Zemra ndalet me vdekjen e kafshës e gjaku nuk del me shpejtësi nga kafsha pas therrjes.
b. Procesi i shokut shkakton plasjen e arterieve të vogla dhe venëve të gjakut që janë në mish dhe kështu gjaku shpërndahet nëpër mish, e mëpas nuk ekziston asnjë metodë për nxjerrjen e këtij gjaku nga mishi. Kjo mënyrë sipas nesh rezulton ngjashëm sikur kafsha e ngordhur dhe e gjakut, e këto dy ushqime sipas Kur'anit dhe sunetit janë të ndaluara për muslimanët.
c. Dëmi i tretë që vjen nga shoku është çrregullimi dhe ndryshimi që shgkaktohet në përbërjen kimike të mishit i cili bëhet i pashëndetshëm dhe jokalorik.

d. Dëmi i katër i cili është provuar dhe vërtetuar në disa studime evropjane që janë bërë kohëve të fundit është se prej disa goditjeve shkaktohet sëmundja e çmendurisë së kafshës, për shkak se goditja deformon procesin e funksionimit të trurit duke i infeksionuar qelizat nervore të trurit kur ka një vrimë në kokë pasi që të shtënat bëhen mbi kokën e kafshës.

Krejt në fund, themi se mjetet e ndryshme të goditjeve janë të dhimbshme dhe torturuese për kafshët, atëherë cili njeri ka mundësi të vëndojë dorën e tij në një burim elektrik dhe të mos ndjejë dhimbje. Pra, kujdesi i kafshëve që ata nuk flasin e as nuk ankohen është tërësisht në përgjegjësinë tonë.

3.1.**Qëllimet e therjes së kafshës**

E kemi rastin konkret me emrin e quajtur Kurbani ud-hije (sakrificë), i cili sipas dispozitave fetare e mer emrin vaxhib me të cilin i pasuri është i angazhuar të e kryen këtë detyrë. Kurbani është traditë e besimtarëve dhe kush i thotë vetes besimtar, duhet të therë kurban për Zotin. Simboli i kurbanit është afrim tek Zoti i gjithësisë. Ehe pse kemi lloje tjera të quajtur kurbane siç janë në mënyrë vullnetare apo i themi në terminologjinë Islame **(nafile)** Muhamedi a.s ka thënë :**”***Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit”***..**[206] po ashtu kemi edhe kurbanin i nedhrit (përbetimit), me të cilin obligohet besimtari kur ai e ngarkon veten me qëllim për t’iu afruar Allahut me një cështje që paraprakisht nuk është i obliguarë. Transmetohet nga Aishja r.a se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë :”*Kush përbetohet se do ta kryejë një veprim , i cili është adhurim ndaj Allahut , le ta kryejë atë përbetim .E kush përbetohet se do ta bëjë ndonjë mëkat , atë përbetim mos ta kryejë”*.[207] Poashtu kemi edhe kurbanin akika, therja e së cilit është me rastin e lindjes së fëmijës. Poashtu edhe kurbani vasijet me të cilin kuptohet se prindi që e ka lënë vasijet (porosi) para vdekjes së tij ,që t’i theret një kurban.

Mishi i ndaluar.

- **Ngordhësira.**
- **Gjaku.** Me këtë nënkuptohet gjaku, i cili ka rrjedhur pasi është prerë shtaza.
- **Mishi i derrit.**
- **Ajo që theret jo në emër të Allahut.**

[206] Musli Verbani, Kurbani -i Ud’hijes,i Hedjit,Nedhrit,Akikit dhe i Vasijetit fq 25,26
[207] Kurbani- Musli Vërbani fq 35,36,37.

- **E furmja.**
- **E mbytura.**
- **E rrëzuarja.**
- **E shpuarja** (nga briri i tjetrës).
- **Ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therni përpara se të ngordhë.**
- **Ajo që është therrur për idhuj**

Transmetohet nga ibn Xheriri e që ai transmeton prej Aliut se ka thënë:Nëse arrin ta therësh të mbyturen,të rëzuarën dhe të shpuarën nga briri i tjetrës nëse ajo e lëvis këmbën e parë apo të mbrapme, haje mishin e saj. Poashtu i Dërguari i Allahut s.a.v.s tha: " *Nga ajo e cila rrjedh gjak dhe përmendet emri i Allahut gjatë therjes hajeni mishin e saj ,por me kusht që mos të jetë e therur me dhëmbë apo me thonj.Do t'ua sqaroj këto dy gjëra:Dhëmbi është asht , kurse thoji është thik e abisinasve"*[208]

Përfundim:

Pas gjithë asaj që cekëm më lart vlen të themi në pika të shkurta konkluzionet e kësaj teme: Therja e kafshëve sipas rregullave Islame është e domosdoshme,ngase urtësia e therjes është ruatja dhe kujdesi ndaj shëndetit të njeriut. Muslimani duhet të jetë i gatshëm për të sakrifikuar cdo gjë, vetëm e vetëm për të u afruar te i Lartëmadhërishmi. Shkencërisht therja e kafshëve sipas rregullave Islame mundëson edhe pastrimin e mishit nga bakteriet e ndryshme. Jemi të obliguar të jemi të kujdesshëm gjatë therjes, në mënyrë që kafsha të ndahet nga jeta me lehtësim.

[208] Ibn Haxher el-Askalani Fet'hul -l-Bari,vëll.IX.fq.554. Tefsiri I Ibn Kethirit ,vëll.II. fq .479. [85] Tefsiri I Ibn Kethirit ,vëll.II. fq .479. [86] Tefsiri I Ibn Kethirit ,vëll.II. fq 480.

Literatura e shfrytëzuar.

- Kur'ani-(Përkthim me komentim në gjuhën shqipe)-H.Sherif Ahmeti
- Ibn Kethiri -Tefsiri II
- Abdulaziz Bin Fet'hi Es-Sejid En-Neda -Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave Islame
- Dr.Musli Verbani- Kurbani
- Jusuf Kardavi- Hallalli dhe Harami në Islam
- Dr. Hasen Ejjub – Tebsitul Akaid El Islamije
- Ibn Haxher el –Askalani- Fet'hul -l-Bari, vëll IV
- http://jusufzimeri.com/